



ALBANIAN
COMPETITION
AUTHORITY

**COMPETITION
COMMISSION
DECISIONS
2018**
OFFICIAL BULLETIN

SUMMARY

DECISIONS WITH OBJECT – PROHIBITED AGREEMENTS	1
No. 495, dated 08.02.2018.....	1
“On imposing fines to “Vodafone Albania” SHA and "Telekom Albania" SHA for not fulfilling the obligation imposed by the Competition Commission by decision no. 475, dated 21.09.2017”	
No. 499, dated 15.02.2018.....	3
“On exemption from prohibited agreement between the insurance companies for the green card”	
No. 500, dated 07.03.2018.....	9
“Opening of the preliminary investigation procedure in the public procurement market for "Tea-D" LLC and "A.E.K & CO" SHPK”	
No. 506, dated 02.05.2018.....	11
“Opening of in-depth investigation procedure in the public procurement market for "Tea-D" SHPK and "A.E.K & CO" SHPK”	
No. 509, dated 02.05.2018.....	15
“Opening a preliminary investigation procedure in the mandatory motor insurance market for third party liability for the domestic TPL product”	
No. 515, dated 22.05.2018.....	17
“The obligation to be informed from the second level banks regarding the implementation of the recommendations of the CC decision no. 453, dated 07.03.2017 “On giving some recommendations to the Bank of Albania, Albanian Association of Banks and Second Level Banks”	
No. 516, dated 22.05.2018	19
“Opening the Investigation procedure in the Banking Sector, the Raiffeisen Bank, the National Commercial Bank, the Credins Bank and the IntesaSanPaolo Bank”	
No. 526, dated 14.06.2018	21
“On the opening of the preliminary investigation procedure in the mediation of insurance market by second level banks”	
No. 530, dated 25.06.2018.....	23
“For making some recommendations to the Audiovisual Media Authority”	
No. 532, dated 25.06.2018.....	29
“For an amendment to the Competition Commission decision no. 509, dated 02.05.2018 "On the opening of the preliminary investigation procedure in the compulsory motor insurance market for liabilities towards third parties, for the internal TPL product”	
No. 535, dated 17.7.2018.....	31
“On imposing fines on 'Tea-D' SHPK and "A.E.K. & CO" SHPK due to prohibited agreements in the public procurement sector”	
No. 544, dated 20.09.2018.....	35
“On an amendment to the Competition Commission Decision no. 526, dated 14.06.2018 “On the opening of the preliminary investigation procedure in the mediation of insurance market by second level banks”	

No. 545, dated 20.09.2018.....	37
“On an amendment to the Decision of the Competition Commission no. 516, dated 22.05.2018, “Opening the Investigation procedure in the Banking Sector, the Raiffeisen Bank, the National Commercial Bank, the Credins Bank and the IntesaSanPaolo Bank””	
No. 551, dated 04.10.2018	39
“On the opening of the preliminary investigation procedure in the market for the import, production and trading of flour”	
No. 561, dated 15.10.2018	41
“On some recommendations and the closure of the preliminary investigation into the mandatory vehicle insurance market for third parties’ liability to for the domestic TPL product”	
DECISIONS WITH OBJECT – ABUSE OF DOMINANT POSITION	47
No. 493, dated 23.01.2018	47
“Closure of the preliminary investigation procedure in the market for the maintenance service of fiscal equipment for fuel trading”	
No. 497, dated 08.02.2018.....	51
“Opening of a preliminary investigation into the market of technical control service for vehicles in the Republic of Albania”	
No. 503, dated 21.03.2018.....	53
“On an amendment to the Competition Commission decision no.490, dated 20.12.2017 “On the opening of a preliminary investigation into the air transport market of passengers to the Austrian Airlines””	
No. 505, dated 29.03.2018.....	55
“Closure of the preliminary investigation procedure in the market of production, collection, manufacturing and export of tobacco and giving recommendation to the Ministry of Agriculture and Rural Development”	
No. 512, dated 17.05.2018	59
“Opening of the preliminary investigation procedure on the market of leasing of facilities for storage and sales of agroindustrial products in the city of Tirana”	
No. 514, dated 17.05.2018	61
“Opening of the in-depth investigation into the market of the mandatory technical control of motorized vehicles and their remarches in the Republic of Albania to the undertaking SGS AUTOMOTIVE ALBANIA SHPK”	
No. 517, dated 22.05.2018	65
“Recommendations regarding regulatory measures in the international maritime transport market of passengers and vehicles”	
No. 518, dated 22.05.2018	69
“Giving some recommendations to the Water Regulatory Authority on the application for changing the tariff level for “Skrapar Water Supply and Sewerage” SHA”	
No. 520, dated 31.05.2018	71
“Giving recommendations on the methodology for determining the selling price of electricity by the Last Chance Supplier”	

No. 522, dated 07.06.2018	73
“Giving some recommendations to the Water Regulatory Authority on the application for changing the tariff level for “Water Supply Gramsh” SHA”	
No. 523, dated 07.06.2018	75
“Opening of a preliminary investigation into the market of food products bearing the brand “Conad” in the Republic of Albania, specifically towards the undertaking “Conad Albania” SHPK”	
No. 525, dated 14.06.2018	77
“On the closure of the preliminary investigation in the Air Transportation market of passengers towards Austrian Airlines and giving some recommendations”	
No. 527, dated 14.06.2018	83
“On the recommendation given to the Albanian Energy Regulatory Entity regarding the contract for the sale of electricity between OSHEE and EPP”	
No. 531, dated 25.06.2018	87
“On the opening of the in-depth investigation procedure towards the undertaking “EKMA Albania” SHPK, in the rental market for storage and selling of Agro-Food products in Tirana city”	
No. 538, dated 20.07.2018	91
“On some recommendations for increasing the competition in the air transport service market in the Republic of Albania”	
No. 541, dated 04.09.2018	95
“On a change in the Competition Commission’s Decision no. 531, dated 25.06.2018 “On the opening of the in-depth investigation procedure towards the company “EKMA Albania” SHPK, in the rental market for storage and selling of Agro-Food products in Tirana city””	
No. 542, dated 04.09.2018	97
“On taking temporary measures for restoring competition in the rental market for the storage and trading of agro-food products in the city of Tirana”	
No. 547, dated 24.09.2018	103
“On issuing recommendations for enhancing competition during the process of digitization of audiovisual broadcasting”.	
No. 550, dated 04.10.2018	105
“Giving some Recommendations on the Network Code on Interoperability and Data Exchange Rules Proposed by the Combined Natural Gas Operator AlbgaZ SHA”	
No. 552, dated 04.10.2018	107
“On the Opening of the General Investigation Procedure in the Hospital Service”	
No. 558, dated 08.10.2018	109
“On the evaluation of the draft decision of the Water Regulatory Authority regarding the application for fee change for “Water Supply Sewerage Vau i Dejës” SHA”	
No. 560, dated 15.10.2018	113
“On closure of the preliminary investigation procedure against “Conad Albania” SHPK in the market of the food products holding the Conad brand in the Republic of Albania and the imposition of certain obligations”	

No. 562, dated 25.10.2018	119
“On the imposition of fines and obligations towards the undertaking “SGS Automotive Albania” SHPK in the market of the mandatory technical control of motor vehicles, and their trailers, in the Republic of Albania and giving some recommendations”	
No. 564 dated 25.10.2018	127
“The opening of the preliminary investigation against the Albanian Football Federation regarding the economic activities that it conducts”	
No. 567, dated 07.11.2018	131
“On the closure of the in-depth investigation procedure against “EMS-Albanian Port Operator” SHPK, in the loading and unloading service market and related activities, for bulk cargo at the East Terminal Harbor of Durrës and giving some recommendations”	
No. 569, dated 15.11.2018	141
“On the review of the request of the company “Conad Albania” SHPK for revocation of the decision no. 560, dated 15.10.2018 of the Competition Commission”	
No. 572, dated 22.11.2018	143
“On the imposition of fines and obligations to the enterprise “EKMA Albania” SHPK, in the rental market for storage and selling of Agro-Food products in the city of Tirana”	
No. 573, dated 26.11.2018	151
“On the Opening of the General Investigation Proceedings in the Higher Education Sector”	
No. 574, dated 26 .11.2018	153
“On the opening of the General Investigation Procedure on the Freelancer Market”	
No. 575, dated 03.12.2018	157
“On the opening of the preliminary investigation procedure to the undertaking “Bankers Petroleum Albania” LTD in the market for the production and trading of crude oil”	
No. 578, dated 20.12.2018	159
“On the Provisional Measures in the Gross Oil Production and Trading Market of Bankers Petroleum Albania LTD”	
DECISIONS WITH OBJECT – CONCENTRATIONS	163
No. 494, dated 24.01.2018.....	163
“On the authorization of the concentration obtained through the acquisition of control over the undertaking MAK ALBANIA SHPK from KASTRATI SHA”	
No. 496, dated 08.02.2018.....	167
“Obtaining the full control of the undertaking Buse Gaz S.r.l. by Messer Belgium N.V. directly and indirectly controlled by the undertaking Messer Romania S.r.l.”	
No. 501, dated 15.03.2018.....	171
“On the acquisition of control over the bank NBG Albania SHA from National Bank of Greece S.A to the American Bank of Investments SHA”	
No. 502, dated 21.03.2018.....	175
“On the authorization of the concentration obtained through the acquisition of control over Nestle USA Inc. by Ferrero International S.A.”	

No. 504, dated 29.03.2018.....	177
“On obtaining the control of the undertaking VALTELINA SHPK from ALB-ERK SHPK”	
No. 507, dated 02.05.2018	179
“On the authorization of the concentration obtained through the sale and transfer of 100% quotes of InRE SHPK to Mr. Grigor JOTI and Mr. KRISTO”	
No. 508, dated 02.05.2018	183
“On the authorization of the concentration obtained through the sale and transfer of the shares of TURGUT OZAL EDUCATION SHA to the undertaking BF COOPERATIEF U.A.”	
No. 510, dated 10.05.2018	185
“On the authorization of the concentration obtained through the sale and transfer of 6.50% of the shares of INTELLIGENT APPS GMBH, from HNH GROUP LTD to DAIMLER MOBILITY SERVICES GMBH”	
No. 511, dated 10.05.2018	189
“On authorization of the concentration obtained through the acquisition of joint control by BMW and Daimler AG over some other undertakings”	
No. 513, dated 17.05.2018	193
“On the authorization of the concentration obtained through the sale and transfer of 20% shares of "TV KLAN" SHA from Mr. Ervin Gjikota to Mr. Aleksandër Frangaj”	
No. 519, dated 31.05.2018	195
“On the authorization of the concentration obtained through the establishment of a joint venture, “Shushica Hydropower” SHPK from “Trema Engineering 2” SHPK, “GR Albania” SHPK and “ALB-STAR” SHPK”	
No. 524, dated 14.06.2018	197
“On the authorization of the concentration obtained through the change of Control in SANITARY CLEANING SHPK”	
No. 528, dated 25.06.2018	199
“On the authorization of the concentration obtained through the sale and transfer of 89% stake of Autovizion SHA to Bolv Oil SHA”	
No. 529, dated 25.06.2018	203
“On changing the control of SPORT VISION d.o.o Podgorica, Montenegro from SPORT VISION d.o.o Bijeljina, Bosnia and Herzegovina”	
No. 533, dated 05.07.2018	207
“On the authorization of the concentration obtained through the aquisition of “SKY PLC by COMCAST CORPORATION”	
No. 534, dated 05.07.2018	209
“On the authorization of the concentration obtained through the sale and transfer of 100% of the shares of the undertaking FINAL SHA to IUTECREDIT ALBANIA SHA”	
No. 536, dated 20.07.2018	211
“On the authorization of the concentration obtained through the acquisition of control by UNITED MEDIA on DIRECT MEDIA, MEDIA POINT, PINK BH and PINK MNE”	
No. 537, dated 20.07.2018	213

“On the authorization of the concentration obtained through the sale and transfer of BFSE HOLDING B.V shares to AMRYTA CAPITAL LLP”	
No. 539 dated 24.07.2018	215
“On the change of control of Hygeia Hospital Tirana SHA from Diagnostic and Therapeutic Center of Athens, Hygeia S.A at American Hospital Sha”	
No. 540, dated 24.07.2018	219
“On the authorization of the concentration obtained through the merger of SIEMENS A.G with ALSTOM S.A”	
No. 543, dated 20.09.2018	221
“Not categorized as a concentration of the notification for the transfer of 85% of the shares of the undertaking CC TIRANA SHPK to COMDATA S.p.A”	
No. 549, dated 27.09.2018	223
“On the authorization of the concentration obtained through the creation of the joint venture “AIR ALBANIA” SHPK”	
No. 554, dated 08.10.2018	227
“On the authorization of concentration obtained through the acquisition of control by Messer Group GmbH and Yeti Investments S.a.r.l on several assets of Linde Aktiengesellschaft and Praxair Inc. through MG Industries GmbH”	
No. 555, dated 08.10.2018	229
“On the authorization of the concentration obtained through the acquisition of control by INA INDUSTRIJA NAFTE d.d. and PRVO PLINARSKO DRUSTVO d.o.o on PETROKEMIJA d.d”	
No. 556, dated 08.10.2018	231
“On the authorization of the concentration obtained through the acquisition of control of the undertaking First Data Slovakia S.R.O and First Data Hellas Processing Services and Holdings S.A. from the undertaking SIA S.p.A.”	
No. 559, dated 15.10.2018	235
“On the authorization of concentration obtained through the acquisition of joint control over a new venture by Dr.Ing.h.c.F.Porsche Aktiengesellschaft and Schuler Aktiengesellschaft”	
No. 563, dated 25.10.2018	237
“On approval of the Regulation “On the organization and functioning of the Competition Authority””	
No. 565, dated 29.10.2018	239
“On the authorization of concentration obtained through the benefit of control of GORENJE GOSPODINJSKI APARATI D. D. from HISSENSE GROUP CO. LTD”	
No. 566, dated 07.11.2018	241
“On authorization of Concentration obtained through the acquisition of joint control by Daimler FS and Volkswagen FS on Mobility Trader Holding GmbH”	
No. 570, dated 22.11.2018	243
“On the authorization of the concentration obtained through the acquisition of control of Danske Commodities A / S by Equinor Refining Norway AS”	
No. 571, dated 22.11.2018	245
“On the authorization of the concentration obtained through the sale of shares of 88.89% to Societe Generale Albania SHA from Societe Generale to OTP Bank Nyrt.”	

No. 576, dated 11.12.2018	249
“On the authorization of the concentration obtained through the acquisition of control of National Commercial Bank SHA by Union Bank SHA”	
No. 579, dated 20.12.2018	251
“On initiating an in-depth procedure of the transaction occurred between PIRAEUS BANK SA and BALFIN SHPK, Komercijalna Banka AD Skopje”	
VENDIME TË TJERA	255
No. 498, dated 15.02.2018.....	255
“On Approval of the Annual Report on the Activity of the Competition Authority for year 2017 and the Main Priorities for 2018”	
No. 521, dated 07.06.2018	257
“Giving recommendations for the Draft Decision of the Council of Ministers ‘On the approval of the regulation ‘On the conditions, granting procedures and to authorizing certain categories of state aid’””	
No. 546, dated 24.09.2018	261
“On giving opinion on Law no.37 / 2018 “On determining the special procedure for the evaluation, negotiation and conclusion of the contract with the object “Designing and realization of the urban project and the new building of the National Theater”””	
No. 548, dated 24.09.2018	263
“On reviewing the request of the ERRU for the revocation of certain decisions of the Competition Commission”	
No. 553, dated 04.10.2018	267
“On the legal assessment of the p/contract of PPP/concession for the provision of diagnostic services by medical laboratories”	
No. 557, dated 08.10.2018	271
“On the evaluation of the draft decision of the Albanian Regulatory Authority of the Water Supply regarding the application for change of tariff level for “Water Supply Sewerage Librazhd Përrenjas” SHA”	
No. 568, dated 15.11.2018	275
“On issuing some recommendations to the Authority of Electronic and Postal Communications in the mobile services market”	
No. 577, dated 20.12.2018	279
“On the approval of some additions and amendments to the Regulation “On the Implementation of the Concentration Procedures of Enterprises””	
GUIDELINES.....	281
No. 1, dated 25.06.2018.....	281
“On restrictions directly related and necessary to concentrations”	
No. 2, dated 20.12.2018.....	287
“On the implementation of competition rules in the assessment of access agreements in the telecommunications sector”	

VENDIME ME OBJEKT – MARRËVESHJE TË NDALUARA

VENDIM

Nr. 495, datë 08.02.2018

“Për vendosje gjobe ndaj ndërmarrjeve “Vodafone Albania” SHA dhe “Telekom Albania” SHA për mos përmbushjen e detyrimit të vendosur nga Komisioni i Konkurrencës në Vendimin Nr. 475, datë 21.09.2017”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 08.02.2018, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Shqyrtimi i relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm mbi zbatimin e Vendimit të Komisionit të Konkurrencës Nr. 475, datë 21.09.2017.

Baza ligjore: Neni 24, shkronja (d), neni 26 dhe neni 74 i Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar (Ligji Nr. 9121/2003). Ligjin Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm mbi zbatimin e Vendimit të Komisionit të Konkurrencës Nr. 475, datë 21.09.2017,

VËREN SE:

Komisioni i Konkurrencës me Vendimin Nr. 475, datë 21.09.2017 vendosi mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun me pakicë të shërbimeve celulare dhe dhënien e disa rekomandimeve për Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) dhe për Komisionin e Mbrojtjes së Konsumatorit (KMK).

Në bazë të pikës 3 të dispozitivit të këtij Vendimi, Komisioni i Konkurrencës ka vendosur detyrimin ndaj ndërmarrjeve që operojnë në tregun e telefonisë celulare që brenda 90 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi të marrin masa për aplikimin dhe publikimin e çmimit për njësi për çdo shërbim (lekë/min., lekë/sms, lekë/MB, etj.) që përmbajnë paketat standarde, duke informuar Autoritetin e Konkurrencës.

Referuar detyrimit të mësipërm, rezulton se ndërmarrjet që ushtrojnë veprimtari në tregun e telefonisë celulare, “Vodafone Albania” SHA dhe “Telekom Albania” SHA, deri në datë 21 Dhjetor 2017, kur dhe mbaron afati i vendosur nga Komisioni i Konkurrencës për zbatimin e detyrimit sipas pikës 3 të Vendimit Nr. 475, datë 21.09.2017, nuk kanë depozituar asnjë informacion pranë Autoritetit të Konkurrencës lidhur me masat e marra për aplikimin dhe publikimin e çmimit për njësi për çdo shërbim (lekë/min., lekë/sms, lekë/MB, etj.) që përmbajnë paketat standarde.

Ndërmarrja “Albtelecom” SHA me anë të shkresës së saj Nr. 9346 Prot., datë 26.12.2017 (protokolluar pranë Autoritetit të Konkurrencës me Nr. 541 Prot., datë 28.12.2017), lidhur me përmbushjen e pikës 3 të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës Nr. 475, datë 21.09.2017, shprehet se është ndeshur me pamundësi, pasi nuk gëzon ekspertizë lidhur me këtë çështje dhe në mungesë të ndonjë metodologjie të certifikuar për këtë qëllim

i është drejtuar konsulentit të kontraktuar “Cullen International” dhe ETNO-s (European Telecommunication Network Operators Association), por pa mundur të gjejë rast të njëjtë për ta marrë si referencë.

Sipas ndërmarrjes “Albtelecom” SHA, në kushtet e reja të tregut, të realizimit të përqendrimeve për operatorët “Vodafone Albania” SHA dhe “Telekom Albania” SHA, të cilët së bashku zotërojnë më shumë se XX% të tregut kundrejt pozicionimit shumë modest të Albtelecom, duhet rishikuar masa e rekomanduar sipas Vendimit Nr. 475, datë 21.09.2017 për përjashtimin e Albtelecom nga zbatimi i përcaktimeve të këtij Vendimi.

Me anë të shkresës së Autoritetit të Konkurrencës Nr. 538 Prot., datë 27.12.2017, ju kërkua informacion ndërmarrjeve “Vodafone Albania” SHA dhe “Telekom Albania” SHA, lidhur me masat e marra për përmbushjen e detyrimit të përcaktuar në pikën 3 të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës Nr. 475, datë 21.09.2017.

Lidhur me zbatimin e rekomandimeve të dhëna me Vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr. 475, datë 21.09.2017, “Për Mbylljen e Hetimit Paraprak në Tregun me Pakicë të Shërbimeve Celulare dhe Dhënien e Disa Rekomandimeve”, Komisioni i Konkurrencës ftoi në seancë dëgjimore më datë 25.01.2018 Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare dhe Komisionin e Mbrojtjes së Konsumatorëve, të cilët nuk u paraqitën në seancë.

Nga monitorimi i faqeve të internetit të ndërmarrjeve “Vodafone Albania” SHA dhe “Telekom Albania” SHA që operojnë në tregun përkatës si dhe informacionit të depozituar prej tyre në kuadër të monitorimit të tregut të vendosur nga Komisioni i Konkurrencës në pikën 4 të Vendimit Nr. 475, datë 21.09.2017, rezulton se këto ndërmarrje nuk kanë filluar aplikimin dhe publikimin e çmimit për njësi për çdo shërbim (lekë/min., lekë/sms, lekë/MB, etj.) që përmbajnë paketat standarde.

Referuar sa më sipër, sjellja e ndërmarrjeve “Vodafone Albania” SHA dhe “Telekom Albania” SHA lidhur me mos përmbushjen e detyrimit të vendosur nga Komisioni i Konkurrencës në pikën 3 të Vendimit Nr. 475, datë 21.09.2017, brenda afatit 90 ditor, në zbatim të nenit 74 të Ligjit Nr. 9121/2003, përbën shkelje të rëndë të konkurrencës dhe gjohet në masën deri në 10 % të xhiros së vitit financiar paraardhës së secilës prej ndërmarrjeve.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, shkronja (d), nenin 26, nenin 74 dhe nenin 75 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar dhe Rregulloren “Për Gjrobat dhe Lehtësimin prej Tyre”,

VENDOSI:

1. Konstatimin e mos përmbushjes së detyrimeve të vendosura nga Komisioni i Konkurrencës me Vendimin Nr. 475, datë 21.09.2017 nga ndërmarrjet “Vodafone Albania” SHA dhe “Telekom Albania” SHA;
2. Gjohetjen e ndërmarrjeve “Vodafone Albania” SHA dhe “Telekom Albania” SHA për shkelje të rëndë të konkurrencës, konkretisht të nenit 74, të Ligjit Nr. 9121/2003 në masën 0.02% të xhiros së secilës ndërmarrjeje për vitin paraardhës financiar, përkatësisht në shumën 3 011 173 (tre milion e njëmbëdhjetë mijë e njëqind e shtatëdhjetë e tre) Lekë për ndërmarrjen “Vodafone Albania” SHA dhe në shumë 1 779 108 (një milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e njëqind e tetë) Lekë për ndërmarrjen “Telekom Albania” SHA;
3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 499, datë 15.02.2018

“Për përjashtimin nga ndalimi të marrëveshjes së lidhur midis shoqërive të sigurimit për kartonin jeshil”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 15.02.2018, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Shqyrtimi i relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm lidhur me përjashtimin nga ndalimi të marrëveshjes së lidhur midis shoqërive të sigurimit për kartonin jeshil.

Baza ligjore: Neni 4, neni 5, neni 6, neni 24, shkronja (d), neni 26 dhe nenet 48-52 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar (Ligji Nr. 9121/2003). Ligjin Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm lidhur me përjashtimin nga ndalimi të marrëveshjes së lidhur midis shoqërive të sigurimit për kartonin jeshil,

VËREN SE:

Procedura e ndjekur

Pranë Autoritetit të Konkurrencës ndërmarrjet që ushtrojnë veprimtari në tregun e sigurimeve, përkatësisht: “Sigal Uniqa Group Austria” SHA, “Intersig VIG” SHA, “Atlantik” SHA, “Sigma Inter Albanian VIG” SHA, “Albsig” SHA “Eurosig” SHA “Ansig” SHA dhe “Insig” SHA, nëpërmjet Byrosë Shqiptare të Sigurimeve (BSHS) njoftuan fillimin e procedurës për njoftimin e marrëveshjes mbi shitjen dhe administrimin e Kartonit Jeshil në zbatim të Ligjit Nr. 9121/2003, duke depozituar edhe Vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve lidhur me shitjen dhe administrimin e Kartonit Jeshil.

Pas depozitimit pranë Autoritetit të Konkurrencës të informacionit të plotë të kërkuar, me datë 12.01.2018 u krye publikimi i njoftimit në faqen e internetit të Autoritetit të Konkurrencës, me qëllim që të njihen dhe të shprehen palët e treta. Gjatë gjithë procedurës nuk ka patur kundërshtime apo komente nga palët e treta lidhur me marrëveshjen e njoftuar lidhur me shitjen dhe administrimin e Kartonit Jeshil.

Palët në marrëveshje

Palët në marrëveshje janë të gjitha shoqëritë e sigurimit të cilat e ofrojnë produktin e kartonit jeshil të sigurimit të mjeteve motorike.

Përshkrimi i marrëveshjes

Objekt i kësaj marrëveshje është vendosja e një marrëdhënie bashkëpunimi mes shoqërive të sigurimit në tregun e sigurimeve të detyrueshme të mjeteve motorike të Kartonit Jeshil, lidhur me shitjen dhe administrimin e Kartonit Jeshil me qëllim kryesor përmirësimin dhe rritjen e garancisë¹.

Sipas BSHS, marrëveshja lidhur me shitjen dhe administrimin e kartonit jeshil është në përputhje me Rregulloren “Për zbatimin e nenit 6 të LPMK ndaj disa kategorive të marrëveshjeve të vendimeve dhe praktikave në sektorin e sigurimeve”, e cila parashikon përjashtimin nga ndalimi të disa kategorive të marrëveshjeve, vendimeve dhe praktikave të bashkërenduara në sektorin e sigurimeve, të cilat kanë për objekt bashkëpunimin në lidhje me²:

- Vendosjen e tarifave të primeve të rrezikut të zakonshëm bazuar në statistika të konstatuara kolektivisht ose në numrin e pretendimeve;
- Vendosjen e kushteve të policave standarde të përbashkëta për eliminimin e policave false dhe vendosjen e sistemit të kodit unikal-bar kod dhe njoftimin në kohë reale në sistemin e informacionit të AMF-së të çdo police të kartonit jeshil;
- Shlyerja e dëmeve (parashikohet rritja e pagesës së dëmeve dhe marrja përsipër nga shoqëritë e sigurimit të pagesës së dëmeve duke shmangur policat false, të cilat ekspozonin qytetarët që kanë marrë këtë produkt para përgjegjësive penale dhe financiare për dëmet e shkaktuara jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë me mjetet e tyre motorike);
- Testimi dhe pranimi i pajisjeve të sigurisë (sistemi i kodit unikal dhe verifikimi nëpërmjet pajisjeve të sigurisë në pikat e kalimit kufitar për verifikimin e bar-kodit unikal që vlerëson nëse polica e sigurimit të kartonit jeshil është e vlefshme dhe është sipas klasës së mjetit motorik).

Qëllimi i marrëveshjes është:

- Shitja e policave të kartonit jeshil nëpërmjet një numri të autorizuar operatorësh në pikat e kalimit kufitar dhe degët qendrore të shoqërive të sigurimit;
- Procesi i shitjes të realizohet me anë të shoqërisë së brokerimit të autorizuar nga Byroja, e cila ka stafin teknik, sistemin e shitjes online në kohë reale që mundëson gjenerimin e Kodit Unikali (Nr. serial – bar kod) dhe broker fizik të licencuar.
- Të rrisë garancinë dhe sigurinë e këtij shërbimi në përputhje me standardet COB (Këshillit të Byrove), shmangien e kolapsit për përjashtimin e BSHS nga Sistemi Ndërkombëtar i Kartonit Jeshil;
- Rritjen e garancisë së drejtuesve të mjeteve, të cilët përdorin automjete përtej kufirit të RSH, të cilët duhet të jenë të siguruar kur hyjnë në vende ku një sigurim i tillë është i detyrueshëm;
- BSHS të hiqet nga statusi i monitorimit nën të cilin e ka vënë COB, (i cili është me afat jo më pak se pesë vjet) dhe të mos lejojë përjashtimin e tij nga COB.
- Forcimin e sigurisë financiare të ofertuesve të këtij sigurimi.

Sipas BSHS kjo marrëveshje ka efekte vetëm për produktin Karton Jeshil, i cili zë një pjesë të vogël të totalit të tregut të sigurimeve dhe i shtrin efektet në zonën gjeografike të territorit të Republikës së Shqipërisë. Marrëveshja nuk kufizon lirinë tregtare dhe lirinë konsumatore për të përzgjedhur produktin dhe shoqërinë sipas kërkesës së tij.

¹ Shkresa Nr. 6842 Prot., datë 14.12.2017, fq. 2.

² Shkresa Nr. 6389 Prot., datë 21.11.2017.

TREGU PËRKATËS

Tregu përkatës i produktit

Kartoni Jeshil mbulon përgjegjësinë civile të mbajtësit të mjetit motorik, ndaj dëmeve që u shkakton palëve të treta, në përputhje me parashikimin e Ligjit të një prej shteteve anëtare të Këshillit të Byrove, ku ka ndodhur rasti në sigurim. “Kartoni jeshil” është certifikata ndërkombëtare e sigurimit, e cila rregullon marrëdhëniet e ndërsjella ndërmjet zyrave kombëtare të vendeve anëtare të sistemit të kartonit jeshil. Drejtuesi i mjetit motorik, i cili hyn në territorin e Republikës së Shqipërisë me një mjet, me regjistrim të huaj, duhet të jetë i pajisur me: a) karton jeshil, të vlefshëm në territorin e Republikës së Shqipërisë; b) dokument tjetër të vlefshëm, që vërteton ekzistencën e sigurimit të përgjegjësisë ndaj palëve të treta, në ato raste kur ka një marrëveshje të veçantë dypalëshe, për mjetet me targë regjistrimi të shtetit tjetër, nënshkrues të kësaj marrëveshjeje.

Kjo policë lëshohet në territorin e Shqipërisë vetëm për automjetet me targa shqiptare dhe vepron jashtë territorit të Shqipërisë. Për njohjen e vlefshmërisë së dokumenteve ndërkombëtare të sigurimit, byroja njofton paraprakisht, autoritetet përgjegjëse për kontrollin kufitar. Autoritetet përgjegjëse për kontrollin kufitar janë të detyruara të kontrollojnë përmbushjen e kërkesave, të parashikuara në ligj.

Tregu përkatës gjeografik

Tregu përkatës gjeografik përfshin zonën në të cilën ndërmarrjet janë përfshirë në ofertën dhe kërkesën e shërbimit, në të cilën kushtet e konkurrencës janë mjaftueshmërisht homogjene. Meqenëse produkti (shërbimi) ofrohet në të gjitha pikat e licencuara për tregtimin e Kartonit Jeshil atëherë si treg gjeografik do të jetë territori i Republikës së Shqipërisë.

ANALIZA E KONKURRENCËS

Tregjet e sigurimeve në përgjithësi dhe Kartonit Jeshil në veçanti janë të rregulluar dhe të mbikëqyrur nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në bazë të ligjit organik 10076/2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, i ndryshuar.

Ndër 3 konkurrentët kryesorë në treg janë: Për vitin 2015 ndërmarrjet: Eurosig me XX%, Sigal me XX% dhe Sigma me XX%; Për vitin 2016 ndërmarrjet: Sigal me XX%, Eurosig me XX% dhe Sigma me XX%; Për vitin 2017 ndërmarrjet: Sigal me XX%, Eurosig me XX% dhe Sigma me XX%;

Sipas renditjes në vite ndërmarrja Sigal radhitet e para në 2 vite (2016-2017) me qëndrueshmëri të pjesëve të tregut në tre vite 2015-2017, ndërmarrja Eurosig e para në vitin 2015 renditet e dyta në vitet 2016-2017 dhe ndërmarrja Sigma zvogëlon ndjeshëm pjesët e tregut, duke rënë rreth XX% në vitin 2017, krahasuar me vitin 2015. Ndërmarrjet e vogla kanë rritje të pjesëve të tregut dhe në tregun përkatës Ansig ka hyrë në treg në vitin 2016 dhe është rritur ndjeshëm në vitin 2017, duke shkuar në XX%.

Nga vlerësimi i indeksit HHI për periudhën 2015-2017, ndërmarrjet ndonëse kanë ulur lehtësisht shkallën e përqendrimit (HHI në vitin 2015 është XX, në vitin 2016 është XX dhe në vitin 2017 është XX) duke kaluar nga një treg me një shkallë të lartë përqendrimi në një treg me përqendrim të moderuar, por duke ngelur në nivelin e sipërm të këtij të fundit që për vitin 2017 është XX. Kartoni Jeshil zë një peshë specifike prej XX% në totalin e tregut të sigurimeve të mjeteve motorike.

ARSYET E PËRJASHTIMIT NGA NDALIMI

Tregu i Kartonit Jeshil paraqet një sërë specifikash që duhet të merren në konsideratë gjatë aplikimit të legjislacionit të konkurrencës për shkak të riskut që e shoqëron këtë shërbim.

Sektori i sigurimeve është një nga sektorët e tregut financiar ku marrëveshjet mes operatorëve për qëllime të mbulimit të riskut të përbashkët dhe standardizimit të produkteve mund të përfitojnë nga përjashtimi nga ndalimi sipas parashikimeve të neneve 5 dhe 6 të Ligjit Nr. 9121/2003 dhe Rregullores “Për zbatimin e nenit 6 të LPMK ndaj disa kategorive të marrëveshjeve, vendimeve dhe praktikave në sektorin e sigurimeve”.

Vendimi i sjellë për përjashtim nga ndërmarrjet e sigurimeve merret në vijim të masave që Këshilli i Byrove ka vendosur ndaj Shqipërisë, dhe e konsideron që nuk cenohet aspak konkurrenca e lirë e tregut, pasi Kartoni Jeshil është vetëm një segment i sigurimit të detyrueshëm, si dhe nuk është produkt vendas sigurimi pasi risku vendoset jashtë vendit.

Marrëveshja e bashkëpunimit e njoftuar është një marrëveshje horizontale mes shoqërive të sigurimit në tregun e sigurimeve të detyrueshme të mjeteve motorike të Kartanit Jeshil, lidhur me shitjen dhe administrimin e Kartanit Jeshil me qëllim kryesor përmirësimin e tregtimit të produktit, rritjen e garancisë dhe standardizimin e këtij produkti.

Palët në marrëveshje kanë bërë vetëvlerësimin e përputhshmërisë së marrëveshjes me Rregulloren “Për zbatimin e nenit 6 të LPMK ndaj disa kategorive të marrëveshjeve, vendimeve dhe praktikave në sektorin e sigurimeve”. Sipas këtij vetëvlerësimi marrëveshja është në përputhshmëri të plotë me Ligjin “Për mbrojtjen e konkurrencës”, udhëzimin “Për formën e njoftimit të marrëveshjeve”, dhe Rregulloren “Për zbatimin e nenit 6 të LPMK ndaj disa kategorive të marrëveshjeve vendimeve dhe praktikave në sektorin e sigurimeve”.

Sipas BSHS kjo marrëveshje nuk kufizon lirinë tregtare dhe lirinë konsumatore për të përzgjedhur produktin dhe shoqërinë sipas kërkesës së tij dhe gjithashtu të disponueshëm në të gjitha pikat kufitare, ku dalin mjetet motorike jashtë territorit të Shqipërisë dhe do të kontribuojë në:

- Rritjen e garancisë së drejtuesve të mjeteve (klientëve), të cilët përdorin rrugët jashtë vendit, me qëllim që BSHS të hiqet nga statusi i Monitorimit nën të cilin e ka vënë COB;
- Forcimin e sigurisë financiare të ofruesve të këtij produkti sigurimi, kjo nëpërmjet uljes së shkallës së riskut potencial që Kartoni Jeshil të ndikojë në të gjithë biznesin e sigurimeve për shkak të rrezikshmërisë së lartë që paraqet ky produkt;
- Rritjen e cilësisë së ofrimit të shërbimeve dhe garancisë në dobi të klientëve;
- Rritjen e besimit të Këshillit të Byrove dhe anëtareve të saj të Byrosë Shqiptare të Sigurimit në sistemin e Kartanit Jeshil;
- Në përmirësimin e kushteve të furnizimit të tregut, duke përdorur sisteme informatike që lidhen me sistemin e AMF-së, duke shmangur policat e falsifikuara deri në reduktimin e plotë të tyre, eliminimin e abuzimit të agjenteve dhe operatoreve të sigurimit.
- Përfitime esenciale për konsumatorët lidhur me uljen e kostove të marrjes së sigurimit dhe mos rritjen e çmimit në të ardhmen për shkak të uljes së rezervave për dëme, përmirësimin e pagesës së dëmeve.
- Rritjen e përgjegjshmërisë për palët e treta që udhëtojnë me mjete motorike jashtë vendit, pasi byroja paguese e dëmeve është shteti shqiptar.
- Drejtimin me efikas të tregut, nëpërmjet raportimeve më të sakta, për efekt fiskal për shkak të sistemit të ri me bar kod të sigurimit, nëpërmjet progresit teknik dhe teknologjik;
- Ndërtimi i sistemeve informatike me kod universal për çdo shoqëri sigurimi është investim i kushtueshëm që nuk mund të realizohet veçmas nga secila shoqëri, pasi kostoja do ishte XX herë më e lartë, ndërkohë që tregu mbetet ende në nivele modeste.

- Marrëveshja është transparente dhe ka mbështetjen e autoriteteve publike (BSHS) dhe nuk përjashton asnjë konkurrent³ nga tregu, as hyrësit e rinj, të cilët njëlloj si ata ekzistues duhet të respektojnë standardet e vendosura nga autoritetet publike.

Palët pjesëmarrëse në marrëveshje shprehen se janë të ndërgjegjësuar për zbatimin e parimeve të konkurrencës së lirë dhe efektive në treg, duke shprehur angazhimin se nuk do të realizojnë kufizime që bien ndesh me nenin 4 të Ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si ndarje tregu, fiksime çmimi apo shpërndarje produkti, por do ta mbështesin aktivitetin e tyre tregtar vetëm në kuadrin ligjor dhe nënligjor që mundëson bashkëpunimin me qëllim miradministrimin dhe shitjen e Kartonit Jeshil.

Lidhur me marrëveshjen e propozuar për përjashtim, BSHS i është drejtuar edhe AMF, e cila me shkresën e saj Nr. 235 Prot., datë 15.01.2018, ndër të tjera, shprehet se përjashtimi i marrëveshjes është tagër i Autoritetit të Konkurrencës dhe AMF në zbatim të ligjit monitoron situatën në tregun e sigurimeve të detyrueshme motorike, si dhe në veçanti mirë administrimin dhe sigurimin e stabilitetit të produktit të sigurimit të detyrueshëm Karton Jeshil, duke garantuar pagesat e dëmeve që rrjedhin nga kjo kontratë si dhe vazhdimësinë në përmbushjen e kërkesave të vendosura nga Këshilli i Byrosë. Në përfundim, AMF vlerëson çdo vendim që siguron mbrojtjen e interesave të konsumatorëve, si dhe qëndrueshmërinë dhe besueshmërinë e tregut të sigurimeve.

KUSHTET DHE DETYRIMET

Edhe pse gjatë procedurës ndërmarrjet janë angazhuar për mos kufizim të konkurrencës, në bazë të nenit 50, pika 2 e Ligjit Nr. 9121/2003, vlerësojmë që kjo marrëveshje të jepet me kushte dhe detyrime me qëllim që të ketë konkurrencë të mjaftueshme në tregun përkatës dhe marrëveshja të mos kufizojë produktin apo shitjet, të mos ndajë tregun dhe klientët të mos bien dakord për primet e shitjes, si më poshtë vijon:

- Afati i përjashtimit të marrëveshjes të jetë për një periudhë 2 (dy) vjeçare;

Marrëveshja e njoftuar për përjashtim sipas BSHS-së parashikohet të ketë një afat vlefshmërie për një periudhë 5 vjeçare, por duke ju referuar Rregullores së Komisionit Evropian 267/2010, “Mbi aplikimin e nenit 101(3) të TFEU për kategoritë e marrëveshjeve, vendimeve dhe praktikave në sektorin e sigurimeve”, si dhe Rregullores “Për zbatimin e nenit 6 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës ndaj disa kategorive të marrëveshjeve, vendimeve dhe praktikave në sektorin e sigurimeve” përjashtimi jepet për një periudhë të kufizuar kohe tre vjeçare. Në rastin tonë, 2 (dy) vjet do të vlerësohej si periudhë e përshtatshme për këtë marrëveshje bashkëpunimi.

- Secila prej ndërmarrjeve të sigurimit, pjesë e marrëveshjes, duhet të tregtojë produktin e kartonit jeshil nëpërmjet agentëve të saj në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” dhe polica e sigurimit duhet të përmbajë logon e ndërmarrjes që e tregon dhe barkodin përkatës, duke shmangur koordinimin e sjelljes lidhur me ndarjen e pjesëve të tregut dhe caktimit të çmimeve mes palëve njoftuese të marrëveshjes.

Ndryshimet e mësipërme synojnë reduktimin e mundësisë së koordinimit të sjelljes dhe kanë si qëllim të shmangin një ndarje potenciale të pjesëve të tregut mes palëve njoftuese të marrëveshjes dhe në këtë mënyrë respektohen parashikimet e nenit 4 të Ligjit Nr. 9121/2003.

³ Edhe ndërmarrja Atlantik që nuk ka pjesë tregu për produktin Karton Jeshil e ka nënshkruar këtë marrëveshje. (Shih vendimin Nr. 16, datë 01.10.2017)

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 5, nenin 6, nenin 24, shkronja (d), nenin 26 dhe nenet 48-52 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar dhe Rregulloren “Për zbatimin e nenit 6 të LPMK ndaj disa kategorive të marrëveshjeve të vendimeve dhe praktikave në sektorin e sigurimeve”,

VENDOSI:

1. Të përjashtojë nga ndalimi Marrëveshjen e Bashkëpunimit mes ndërmarrjeve të sigurimit lidhur me shitjen dhe administrimin e Kartonit Jeshil;
2. Marrëveshja përjashtohet nga ndalimi vetëm me respektimin e kushteve dhe detyrimeve të mëposhtme:
 - a) Afati i përjashtimit të marrëveshjes të jetë për një periudhë 2 (dy) vjeçare, nga marrja e këtij vendimi;
 - b) Secila prej ndërmarrjeve të sigurimit, pjesë e marrëveshjes, duhet të tregtojë produktin e kartonit jeshil nëpërmjet agjentëve të saj në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” dhe polica e sigurimit duhet të përmbajë logon e ndërmarrjes që e tregon dhe bar kodin përkatës, duke shmangur koordinimin e sjelljes lidhur me ndarjen e pjesëve të tregut dhe caktimit të çmimeve mes palëve njoftuese të marrëveshjes.
3. Në rast të mos respektimit prej ndërmarrjeve pjesëmarrëse në marrëveshje të kushteve dhe detyrimeve të përcaktuar në pikën 2, Komisioni i Konkurrencës do të ushtrojë kompetencën e tij të revokimit të këtij përjashtimi.
4. Çdo amendim i kësaj marrëveshjeje nga palët duhet të njoftohet për përjashtim pranë Autoritetit të Konkurrencës.
5. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për monitorimin e zbatimit të këtij vendimi, njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të kryen pagesat e parashikuara në rregulloren “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 500, datë 07.03.2018

“Për hapjen procedurës së hetimit paraprak në tregun e prokurimeve publike për ndërmarrjet “Tea-D” SHPK dhe “A.E.K & CO” SHPK”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 07.03.2018, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Shqyrtimi i relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm mbi kërkesë/ankesën e Agjencisë së Prokurimit Publik.

Baza ligjore: Neni 4 dhe 42 (1) i Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar (Ligji Nr. 9121/2003). Ligjin Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës,

VËREN SE:

Pranë Autoritetit të Konkurrencës, Agjencia e Prokurimit Publik (APP), ka depozituar shkresën me Nr. 533, datë 26.12.2017, lidhur me shqyrtimin e “marrëveshjes në oferta” në prokurimin publik elektronik me objekt “Riparime të zyrave të objektit Njësia Administrative Lukovë”, Bashkia Himarë, bazuar në raportin e auditimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit (KLSH) për këtë prokurim, pasi mendohet se mund të ketë shkelje të nenit 4 (marrëveshja në oferta) të Ligjit nr. 9121 datë 28.07.20103 “Për mbrojtjen e Konkurrencës”.

Autoriteti i Konkurrencës, në vijim të procedurave ka kërkuar informacion nga KLSH dhe Bashkia Himarë për vënie në dispozicion të dokumentacionit përkatës që lidhen me procedurën e prokurimit dhe nga vlerësimi i dokumentacionit të depozituar në rrugë elektronike në sistemin e prokurimit të APP nga ndërmarrjet pjesëmarrëse në procedurën e prokurimit, rezulton se:

- Në procedurën e prokurimit, ofertues fitues është shpallur operatori ekonomik “A.E.K & Co” SHPK me vlerën 2,232,864 lekë e cila është afër fondit limit me 99.79% të tij;
- Dy operatorë ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, ndërmarrja “Tea-D” SHPK dhe ndërmarrja “A.E.K & CO” SHPK, kanë ngarkuar të njëjtin dokument në sistemin elektronik të prokurimit dhe pikërisht “Vërtetim Debie – për shlyerjen e detyrimeve të energjisë elektrike”, të lëshuar nga Drejtoria Rajonale Gjirokastër e OSHEE, për ndërmarrjen “Tea-D” SHPK me Nr. 135 Prot., datë 06.08.2015.
- Referuar Preventivave të depozituar nga të dy operatorët ekonomik, ndërmarrja “Tea-D” SHPK dhe ndërmarrja “A.E.K & CO” SHPK, rezulton se janë pothuajse identike dhe kanë ndryshime të disa zërave me një shtesë uniforme 10 lekë tek disa zëra punimesh.

Nga vlerësimi i kërkesës së APP, materialit të KLSH-së dhe dokumenteve të depozituara nga ndërmarrjet “Tea-D” SHPK dhe “A.E.K & CO” SHPK, në procedurën e prokurimit publik me objekt “Riparime të zyrave të objektit Njësia Administrative Lukovë”, vlerësojmë se mund të jemi përpara një marrëveshje të ndaluar në oferta midis këtyre 2 (dy) ndërmarrjeve, në kuptim të nenit 4, pika 1, gërma (a) të Ligjit Nr. 9121/2003.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4 dhe 42 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prokurimit publik për ndërmarrjet “Tea-D” SHPK dhe “A.E.K & CO” SHPK;
2. Raporti i hetimit paraprak duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se 3 (tre) muaj nga dita e çeljes së këtij hetimi.
3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 506, datë 02.05.2018

“Për hapjen procedurës së hetimit të thelluar në tregun e prokurimeve publike për ndërmarrjet “Tea-D” SHPK dhe “A.E.K & CO” SHPK”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 02.05.2018, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Hapja e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e prokurimeve publike për ndërmarrjet “Tea-D” SHPK dhe “A.E.K & CO” SHPK.

Baza ligjore: Neni 4 dhe neni 43, pika 1 e Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrotjtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar (Ligji Nr. 9121/2003).

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës,

VËREN SE:

I - Procedura e ndjekur

1. Pranë Autoritetit të Konkurrencës, Agjencia e Prokurimit Publik (APP), ka depozituar shkresën me Nr. 533, datë 26.12.2017, lidhur me shqyrtimin e “marrëveshjes në oferta” në prokurimin publik elektronik me objekt “Riparime të zyrave të objektit Njësia Administrative Lukovë”, Bashkia Himarë, bazuar në raportin e auditimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit (KLSH) për këtë prokurim, pasi mendohet se mund të ketë shkelje të nenit 4 (marrëveshja në oferta) të Ligjit Nr. 9121/2003.
2. Nga vlerësimi i kërkesës së APP, materialit të KLSH-së dhe dokumenteve të depozituara nga ndërmarrjet “Tea-D” SHPK dhe “A.E.K & CO” SHPK, në procedurën e prokurimit publik me objekt “Riparime të zyrave të objektit Njësia Administrative Lukovë”, në bazë të nenit 42 të Ligjit Nr. 9121/2003, Komisioni i Konkurrencës me Vendimin Nr. 500, datë 07.03.2018 “Për hapjen procedurës së hetimit paraprak në tregun e prokurimeve publike për ndërmarrjet “Tea-D” SHPK dhe “A.E.K & CO” SHPK”, vendosi hapjen e procedurës së hetimit paraprak, pasi mund të jemi përpara një marrëveshje të ndaluar në oferta midis këtyre 2 (dy) ndërmarrjeve, në kuptim të nenit 4, pika 1, gërma (a) të Ligjit Nr. 9121/2003.
3. Në bazë të nenit 35 dhe 36 të Ligjit Nr. 9121/2003 dhe Autorizimit të Komisionit të Konkurrencës (Autorizim Inspektorësh), grupi i inspektimit, gjatë periudhës së hetimit ka kryer inspektimet e nevojshme pranë ndërmarrjeve “Tea-D” SHPK dhe “A.E.K & CO” SHPK”.

II - Tregu Përkatës

4. Tregu përkatës përfshin produktet që vlerësohen si të zëvendësueshme nga konsumatorët dhe operatorët, për sa u përket karakteristikave, çmimit dhe funksionit të tyre dhe që ofrohen ose kërkohen nga ndërmarrjet në një zonë gjeografike me kushte të njëjta konkurrence. Përkufizimi i tregut përkatës përfshin dy dimensione:

- a) Tregu përkatës i produktit
 - b) Tregu përkatës gjeografik
5. Tregu përkatës i produktit është tregu i prokurimeve publike në procedurën “Kërkesë për Propozim”, me objekt “Riparime të zyrave të objektit Njësia Administrative Lukovë” Bashkia Himarë.
6. Tregu përkatës gjeografik përfshin zonën në të cilën ndërmarrjet janë përfshirë në ofertën dhe kërkesën e shërbimit, në të cilën kushtet e konkurrencës janë mjaftueshmërisht homogjene. Për vlerësimin e impaktit që shkakton ofertimi, tregu përkatës gjeografik do të konsiderohet Tregu i prokurimit publik me objekt “Riparime të zyrave të objektit Njësia Administrative Lukovë” në territorin e Bashkisë Himarë.

III - Vlerësimi i sjelljes së ndërmarrjeve në treg

7. Vlerësimi i sjelljes së ndërmarrjeve, në tregun e prokurimit publik “Rikonstruksion zyrash / Punë publike” është realizuar bazuar në metodologjinë e OECD4 “Mbi luftimin e marrëveshjeve të ndaluara në oferta në prokurimet publike”, si dhe Udhëzuesit5 të përshtatur sipas kësaj metodologjie të OECD.
8. Kjo metodologji jep format më të njohura të marrëveshjeve në oferta, mënyrat se si ofruesit bien dakord të eliminojnë konkurrencën, indikatorët e marrëveshjeve në oferta, listën e karakteristikave që ndihmojnë marrëveshjen, reduktimin e koordinimit të sjelljes në procesin e prokurimeve, risku i tenderimeve me marrëveshje, etj.
9. Bazuar në këtë metodologji është vlerësuar sjellja e operatorëve ekonomik (ofertuesve) nëse janë përfshirë në ndonjërin prej skemave të marrëveshjes në oferta.
10. Ndërmarrjet pjesëmarrëse në këtë procedurë prokurimi ishin:
- a) Operatori Ekonomik “TEA-D” SHPK;
 - b) Operatori Ekonomik “Avduli” SHPK;
 - c) Bashkimi i Operatorëve Ekonomik “Shëndelli + Kevin Konstruktion”;
 - d) Operatori Ekonomik “A.E.K&CO” SHPK.
11. Ofertuesi fitues në këtë procedurë prokurimi është shpallur operatori ekonomik A.E.K & Co SHPK me vlerën 2,232,864 lekë e cila është afër fondit limit me 99.79% të tij dhe oferta e skualifikuar pa marrë në konsideratë ofertën më të ulët është BOE “Shëndelli & Kevin Konstruktion” SHPK, me diferencë 24.86% nga fondi limit. Sipas Bashkisë Himarë, ky operator ekonomik nuk ka paraqitur dokumentet në përputhje me kriteret e dhëna në dokumentet e tenderit dhe për këtë arsye është skualifikuar. Ndërmarrja “Tea-D” SHPK ka paraqitur ofertën në vlerën 2,236,159, e cila është sa 99.94% e fondit limit.
12. Për vlerësimin e sjelljes së ndërmarrjeve është shqyrtuar i gjithë dokumentacioni i administruar dhe i paraqitur nga KLSH, Bashkia Himarë në rolin e Autoritetit Kontraktor, si edhe dokumentacioni i gjetur gjatë procedurave të inspektimit pranë ndërmarrjeve “Tea-D” SHPK dhe “A.E.K & Co” SHPK pranë zyrave ku ushtrojnë aktivitetin në Gjirokastrë dhe Sarandë, ku janë mbajtur dhe procesverbalet e inspektimit të datës 15.03.2018. Nga shqyrtimi i këtij dokumentacioni gjenden evidenca për marrëveshje në oferta që tregojnë në mënyrë direkte bashkëpunimin midis dy ndërmarrjeve pjesëmarrëse “Tea-D” SHPK dhe “A.E.K & Co” SHPK, në përgatitjen e ofertave në këtë procedurë prokurimi publik, si vijon:
- Nga shqyrtimi i dokumentacionit të depozituar në rrugë elektronike në sistemin e prokurimit të APP,

⁴ <http://www.oecd.org/competition/cartels/fightingbidrigginginpublicprocurement.htm>

⁵ <http://www.caa.gov.al/file/publikimet/brochure.pdf>

rezulton se dy operatorët ekonomik, ndërmarrja “Tea-D” SHPK dhe ndërmarrja “A.E.K & CO” SHPK, kanë ngarkuar të njëjtin dokument në sistemin elektronik të prokurimit dhe pikërisht “Vërtetim Debie – për shlyerjen e detyrimeve të energjisë elektrike”, të lëshuar nga Drejtoria Rajonale Gjirokastër e OSHEE, për ndërmarrjen “Tea-D” SHPK me Nr. 135 Prot., datë 06.08.2015.

- Gjatë inspektimit në ambientet e selisë së ndërmarrjes A.E.K & Co SHPK, u gjet dokumenti “Vërtetim Debie – për shlyerjen e detyrimeve të energjisë elektrike”, të lëshuar nga Drejtoria Rajonale Gjirokastër e OSHEE, për ndërmarrjen “Tea-D” SHPK me Nr. 135 Prot., datë 06.08.2015.
- Referuar Preventivave të depozituar nga të dy operatorët ekonomik, ndërmarrja “Tea-D” SHPK dhe ndërmarrja “A.E.K & CO” SHPK, rezulton se janë pothuajse identike dhe kanë ndryshime të disa zërave me një shtesë uniforme 10 lekë (psh njëri artikull ka vlerën 300 lekë/ ndërsa tjetri operatorë e ka vlerën 310 lekë) tek disa zëra punimesh të cilat janë të parëndësishme.

13. Sjellja e ndërmarrjeve “Tea-D” SHPK dhe “A.E.K & CO” SHPK, sipas praktikave për marrëveshje në oferta të vendeve të OECD, si edhe udhëzimit të Autoritetit të Konkurrencës, mund të përbëjë marrëveshje në oferta, e cila është e ndaluar në kuptim të nenit 4 të Ligjit nr. 9121/2003.

14. Pas vlerësimit të të gjithë dokumentacionit të administruar gjatë inspektimeve; dokumentacionit të depozituar nga organet shtetërore, përkatësisht KLSH dhe Bashkia Himarë; analizave ekonomike të kryera sipas metodologjisë së përcaktuar në raport; sjelljes së ndërmarrjeve “Tea-D” SHPK dhe “A.E.K & CO” SHPK, konstatohen shenja të kufizimit të konkurrencës, përkatësisht marrëveshje në oferta në procedurën e prokurimit publik “Kërkesë për Propozim” me objekt “Riparime të zyrave të objektit Njësia Administrative Lukovë” në Bashkinë Himarë, midis 2 (dy) ndërmarrjeve “Tea-D” SHPK dhe “A.E.K & CO” SHPK, në kuptim të nenit 4, pika 1, gërma (a) të Ligji Nr. 9121/2003

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4, nenin 24, (germa d); nenin 26 dhe nenin 43, pika 1, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e prokurimit publik për ndërmarrjet “Tea-D” SHPK dhe “A.E.K & CO” SHPK;
2. Raporti i hetimit të thelluar duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se 1 (një) muaj nga dita e çeljes së këtij hetimi.
3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 509, datë 02.05.2018

“Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik për përgjegjësitë ndaj palëve të treta, për produktin TPL e brendshme”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 02.05.2018, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Hapja e hetimit paraprak në tregun të sigurimit të detyrueshëm motorik për përgjegjësitë ndaj palëve të treta, për produktin TPL e brendshme.

Baza ligjore: Neni 4, neni 24, shkronja d, neni 26 dhe neni 42, pika 1, i ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës “Mbi monitorimin e tregut të sigurimit të detyrueshëm motorik për përgjegjësitë ndaj palëve të treta”,

VËREN SE:

Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës, bazuar në nenin 28, gërma a), të ligjit nr. 9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, në datat 23 Mars dhe 20 Prill 2018, procedoi me kryerjen e monitorimeve në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik për përgjegjësitë ndaj palëve të treta, për produktin TPL e brendshme, me qëllim vlerësimin e kushteve të tregtimit të këtij produkti dhe evidentimin nëse ka apo jo shenja të kufizimit të konkurrencës në këtë treg, në shkelje të nenit 4 të ligjit 9121/2003, i ndryshuar.

Nga monitorimi i realizuar, u vërejt se: sistemi elektronik online i shitjes së policave të sigurimit gjeneron polica vetëm të disa shoqërive të sigurimit, nga 8 shoqëri që operojnë në këtë treg, duke mos u lejuar agjentëve zgjedhjen në sistem të shoqërive të tjera të sigurimit. Kjo situatë është e përsëritur duke shfaqur problematika për konkurrencën në treg.

Tregu i sigurimeve të detyrueshme motorike ka qenë objekt i vazhdueshëm i procedurave hetimore të Autoritetit të Konkurrencës të konkluduara me masa dhe detyrime për shoqëritë e sigurimit, si dhe rekomandime për AMF-në.

Për sa më sipër, sjellja e ndërmarrjeve që ushtrojnë veprimtari në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik për përgjegjësitë ndaj palëve të treta, për produktin TPL e brendshme, mund të përbëjë kufizim, shtrembërim apo pengim të konkurrencës në kuptim të nenit 4, pika 1, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4, nenin 24 shkronja d, nenin 26 dhe nenin 42, pika 1, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik për përgjegjësitë ndaj palëve të treta, për produktin TPL e brendshme.
2. Hetimi paraprak të përfshijë periudhën kohore nga 01 Janari 2017 deri në 30 Prill 2018.
3. Raporti i hetimit paraprak duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se 2 (dy) muaj nga marrja e këtij vendimi.
4. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 515, datë 22.05.2018

“Detyrimi për t’u informuar nga bankat e nivelit të dytë në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të Vendimit Nr. 453, datë 07.03.2017 “Për dhënien e disa rekomandimeve për Bankën e Shqipërisë, Shoqatën Shqiptare të Bankave dhe Bankat e nivelit të dytë” të Komisionit të Konkurrencës.”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 22.05.2018, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Kërkim të dhënash nga disa banka të nivelit të dytë në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të Komisionit të Konkurrencës.

Baza ligjore: Neni 24, shkronja d, neni 33, neni 73, pika 1, gërma a) e Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, neni 53 i Kodit të Procedurës Administrative.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë, mbi vlerësimin e zbatimit të rekomandimeve të dhëna me Vendimin Nr. 453, datë 07.03.2017 “Për Dhënien e disa Rekomandimeve për Bankën e Shqipërisë, Shoqatën Shqiptare të Bankave dhe Bankat e nivelit të dytë” dhe dinamikat e Sektorit Bankar,

VËREN SE:

Komisioni i Konkurrencës, nëpërmjet Vendimit Nr. 453, datë 07.03.2017 “Për Dhënien e disa Rekomandimeve për Bankën e Shqipërisë, Shoqatën Shqiptare të Bankave dhe Bankat e nivelit të dytë” vendosi ti rekomandoje bankave të nivelit të dytë:

- T’i mundësojnë klientit përzgjedhjen e vlerësuesit dhe të noterit në një listë të përzgjedhur të bankës, me qëllim rritjen e konkurrencës mes ofruesve të këtyre shërbimeve.
- Nxitja e kartave lokale, që nuk kanë kosto të larta si kartat që emetohen nga skemat ndërkombëtare (MasterCard, apo Visa etj.) që do të mundësonin më shumë përdorim dhe pranim të pagesave pasi kostot do të ishin më të ulta për bankat rrjedhimisht edhe për klientët.
- Të krijojnë lehtësira për lëvizshmërinë e klientëve duke ulur kostot "bllokuese" (kostot të cilat e detyrojnë klientin të qëndrojë pranë një banke si komisione për mbyllje llogarie, kosto administrative për klientin si kohë, rimbushje formularësh, përgatitje dokumentacioni, përdorimi i teknologjive të reja për tu afruar më shumë lehtësi tek klientët) si dhe të rrisin transparencën duke i bërë më të kuptueshme këto kosto për klientin, përfshirë edhe skedën e amortizimit të kredisë, e cila duhet të jetë në gjuhën shqipe në të gjitha bankat dhe për të gjitha rastet.

Sekretariati i Konkurrencës në zbatim të Vendimit, nëpërmjet shkresave nr. 236 datë 06.06.2017 dhe nr. 56, datë 24.01.2018 “Kërkesë për informacion”, kërkoi nga 16 bankat e Sistemit Bankar informacion në lidhje me zbatueshmërinë e këtyre rekomandimeve.

Nga informacioni i depozituar pranë Autoritetit të Konkurrencës, konstatohet se Banka Credins; Banka ProCredit; Tirana Bank; Banka e Kreditit të Shqipërisë, Banka Veneto dhe Banka Kombëtare Greke nuk i janë përgjigjur kërkesës për informacion. Banka Kombëtare Tregtare, Banka Societe General, Banka Raiffeisen kanë sjellë informacion të paplotë.

Mungesa e informacionit po pengon monitorim të plotë të sjelljes së bankave në lidhje me zbatueshmërinë e rekomandime të Komisionit të Konkurrencës për shërbimin e noterëve dhe vlerësuesve të pasurisë.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, gërma d, nenit 33 pika 2, nenit 73, pika 1, gërma a) e Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, (i ndryshuar),

VENDOSI:

1. T’i kërkojë Bankës Credins; Bankës Procredit; Tirana Bank; Bankës së Kreditit të Shqipërisë, Bankës Kombëtare Greke, Bankës Veneto, Bankës Societe General, Bankës Kombëtarë Tregtare dhe Bankës Raiffeisen, që brenda datës 31.05.2018 të vërë në dispozicion të Komisionit të Konkurrencës të dhënat mbi:
 - a) listën e ofruesve të shërbimeve noterë dhe vlerësues të pasurive dhe numrin e procedurave të realizuara nga secili prej tyre gjatë vitit 2017.
 - b) Procedurën e përzgjedhjes së ofruesve të këtyre shërbimeve në vitin 2017.
2. Në rast të mos zbatimit të pikës 1 të dispozitivit të këtij vendimi, Komisioni në zbatim të nenit 73, pika 1, gërma a) të ligjit nr. 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (të ndryshuar), do të vendosë gjobë deri në 1 % të xhiros totale të vitit paraardhës financiar për shkelje të lehtë të konkurrencës;
3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 516, datë 22.05.2018

“Për hapjen e procedurës së Hetimit Paraprak në Sektorin Bankar, për Bankën Raiffeisen, Bankën Kombëtare Tregtare, Bankën Credins dhe Bankën Intesa SanPaolo”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 22.05.2018, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Hapja e procedurës së Hetimit Paraprak në Sektorin Bankar, për Bankën Raiffeisen, Bankën Kombëtare Tregtare, Bankën Credins dhe Bankën Intesa SanPaolo.

Baza ligjore: Neni 24, shkronja d, dhe neni 26 i Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, Ligji Nr. 44/2015 datë 30.04.2015 “Kodit të Procedurës Administrative në RSH”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi vlerësimin e zbatimit të rekomandimeve të dhëna me Vendimin Nr. 453, datë 07.03.2017 “Për Dhënien e disa Rekomandimeve për Bankën e Shqipërisë, Shoqatën Shqiptare të Bankave dhe Bankat e nivelit të dytë” dhe dinamikat e Sektorit Bankar,

VËREN SE:

Pesha e sistemit bankar në ekonomi e shprehur si raport i totalit të aktiveve ndaj PBB, vijon të qëndrojë në nivele të larta duke shënuar 93% për vitin 2017.

Në terma të aseteve, kredive dhe depozitave, Banka Kombëtare Tregtare; Banka Raiffeisen; Banka Intesa SanPaolo dhe Banka Credins zënë pjesën kryesore të tregut. Sipas përllogaritjeve të treguesve të përqendrimit të shprehur nëpërmjet Indeksit HHI për totalin e aktiveve, deri në shtator 2017, ky tregues përllogaritet në XXX duke mbetur në nivelin e një treguesi me një shkallë përqendrimi të moderuar. Treguesit e përqendrimit në tregun e kredisë, kanë tendencë në rritje. Pjesën më të madhe të kredisë e zë kredia e biznesit me rreth XX % të portofolit, overdrafti zë afërsisht XX % të portofolit, kredia hipotekore XX % dhe konsumatore XX % të portofolit të kredisë.

Të dhënat tregojnë për një rritje të peshës specifike të Banka Kombëtare Tregtare në tregun e depozitave dhe tregun e kredidhënies. Raiffaisen Bank vijon të mbetet një nga aktorët e rëndësishëm në treg por pesha specifike është e njëjtë me atë të bankës Credins XX %.

Vihet re se normat NEI për kredinë hipotekore në lek të aplikuara nga Banka Kombëtare Tregtare dhe Banka Raiffeisen janë më të ulta sesa mesatarja e tregut. Gjithashtu Banka Kombëtare Tregtare, Banka Raiffeisen, Tirana Bank japin kredi hipotekore në lek për periudha me afat më të gjatë krahasuar me bankat e tjera.

Overdrafti vazhdon të mbetet produkti më i shtrenjtë nga gjitha produktet e kredisë. Bankat e tjera Banka Kombëtare Tregtare dhe Banka Raiffeisen ofrojnë overdraftin për individët me norma më të ulta se mesatarja e tregut. Për overdraftin ndaj biznesit vihet re se Banka Raiffeisen aplikon norma NEI afër mesatares së tregut

dhe për overdraftin e biznesit të mesëm dhe të madh dhe norma shumë të larta NEI për biznesin e vogël. Në përgjithësi vërehet një tendencë e normave të larta NEI për biznesin e vogël në të dyja në euro dhe lek.

Nga vlerësimi i komisioneve për llogaritë rrjedhëse për 5 bankat më të mëdha në tregun e depozitave konstatohet se bankat përcaktojnë komisione për mbylljen e llogarisë dhe komisione në rast tërheqje CASH të paparalajmëruar. Këto komisione mund të përbejnë kosto bllokuese për lëvizshmërinë e klientëve dhe për më tepër kosto financiare te ta.

Gjithashtu është konstatuar se muajt e fundit bankat kanë rritur komisionet për lëshimin e një vërtetimi të gjendjes së llogarisë e cila është shumë më e lartë se vlera e publikuar në faqet zyrtare të bankës.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, gërma d dhe nenit 42, pika 1 e Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, (i ndryshuar),

VENDOSI:

1. Hapjen e Hetimit Paraprak në Sektorin Bankar për Bankën Raiffeisen, Bankën Kombëtare Tregtare, Bankën Credins dhe Bankën Intesa SanPaolo.
2. Hetimi paraprak të përfshijë periudhën kohore nga 1 janar 2016 deri në 31 maj 2018.
3. Raporti i hetimit paraprak duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se 3 (tre) muaj nga dita e çeljes së këtij hetimi.
4. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe për njoftimin e palëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 526, datë 14.06.2018

“Për hapjen e procedurës së Hetimit Paraprak në tregun e ndërmjetësimit në sigurime nga bankat e nivelit të dytë”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 14.06.2018, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Hapja e procedurës së Hetimit Paraprak në tregun e ndërmjetësimit në sigurime nga bankat e nivelit të dytë.

Baza ligjore: Neni 24, shkronja d, dhe neni 26 i Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”,

Ligji Nr. 44/2015 datë 30.04.2015 “Kodit të Procedurës Administrative në RSH”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve mbi vlerësimin e tregut të ndërmjetësimit në sigurime nga bankat,

VËREN SE:

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, nëpërmjet shkresës nr. 1789 datë 18.05.2018 “Mbi inspektimin të ndërmjetësimit në sigurime”, konstaton se, kontratat e sigurimit të ndërmjetësuar nga Raiffeisen Bank SHA si ndërmjetës në sigurime gjatë vitit 2017 dhe 3 mujorit të parë të vitit 2018 janë lëshuar vetëm nga shoqëritë Sigal Uniq Group Austria SHA për sigurimin e pronës dhe Sigal Life Uniq Group Austria SHA për sigurimin e jetës.

Gjithashtu nëpërmjet shkresës nr. 1452 datë 22.05.2018 “Përcillet ankesë”, shoqëria e sigurimit të jetës XXXXX, paraqet pretendimin se XXXX SHA “refuzon të transmetojë tek klientët e tyre edhe produktin e sigurimit të jetës për hua të shoqërisë XX SHA” duke mos i dhënë mundësi shoqërisë për të qenë konkurrense në produktet e sigurimit të jetës për hua.

Në zbatim të nenit 204, pika 5 e ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, AMF ka licensuar 4 banka në rolin e ndërmjetësimit në sigurime; Raiffeisen Bank SHA, BKT SHA, Alpha Bank SHA dhe se fundmi Bankën Credins SHA.

Tre bankat kryesore në sektorin bankar, RB, BKT dhe BC, të cilat janë edhe ndërmjetës në sigurime, zotërojnë rreth XX % të vlerës së portofolit të kredisë për vitin 2017, duke qenë kredituesit më të mëdhenj të sistemit bankar. Dy prej tyre, Raiffeisen Bank dhe BKT janë gjithashtu bankat të cilat janë objekt dyshimi dhe ankese për sjellje antikonkurrense.

Në produktin e sigurimit të jetës së debitorit, Raiffeisen Bank ka ndërmjetësuar rreth XX % të kontratave të nënshkruara me ndërmjetësimin e bankave, ndërkohë që BKT ka ndërmjetësuar XX % të këtij shërbimi.

Shoqëria e sigurimit të jetës Sigal Life Unica Group Austria, tek e cila Raiffeisen bank ka ndërmjetësuar kontratat e sigurimit është shoqëria më e madhe në tregun e sigurimit të jetës duke zotëruar mbi XX % të tregut të sigurimit të jetës sipas vlerës së kontratave. Gjithashtu shoqëria Sigal Unica Group Austria zotëron pjesën më të madhe të tregut të sigurimit të pronës nga zjarri dhe forcat e natyre duke zënë rreth XX % të tij. Dy shoqëritë e sigurimit janë pjesë e Uniq Grup.

Nga sa me sipër, jemi përpara dyshimit të arsyeshëm që dy nga bankat më të mëdha në tregut e kredidhënies mund të paraqesin sjellje abuzive në lidhje me zbatimin e kushteve të ndryshme për veprime të njëjta tregtare me palët në shërbimin e ndërmjetësimit në sigurimin e jetës dhe jo jetës.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, germa d dhe nenit 42, pika 1 e Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, (i ndryshuar),

VENDOSI:

1. Hapjen e Hetimit Paraprak në tregun e ndërmjetësimit në sigurime nga bankat e nivelit të dytë
2. Hetimi paraprak të përfshijë periudhën kohore nga 1 janar 2016 deri në 31 maj 2018.
3. Raporti i hetimit paraprak duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se 3 (tre) muaj nga dita e çeljes së këtij hetimi.
4. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe për njoftimin e palëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 530, datë 25.06.2018

“Për dhënien e disa rekomandimeve për Autoritetin e Mediave Audiovizive”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 25.06.2018, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Dhënia e disa rekomandimeve për Autoritetin e Mediave Audiovizive (AMA).

Baza ligjore: Neni 70 i Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar (Ligji Nr. 9121/2003).

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm mbi rekomandimin e KLSH,

VËREN SE:

I - Procedura e ndjekur

1. Pranë Autoritetit të Konkurrencës nga Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH) është depozituar shkresa, me objekt rekomandimi për auditimin “Mbi përputhshmërinë dhe rregullshmërinë financiare”. KLSH shprehet se nga auditimi i kryer rezultoi se AMA me vendimin Nr. 5, datë 27.01.2017 ka lëshuar një licencë private kombëtare të transmetimit audioviziv për një shoqëri aksionare në tregun e transmetimit audioviziv. Aksionarët e kësaj shoqërie rezultojnë të kenë aksione edhe në dy shoqëri të tjera, të cilat ushtrojnë aktivitet në të njëjtin treg dhe për të cilat AMA ka lëshuar më parë dy licenca private kombëtare të transmetimit audioviziv.
2. Sipas KLSH, duke marrë në konsideratë pronësitë e kryqëzuara të kësaj shoqërie aksionare me dy shoqëri të tjera, të cilat disponojnë secila nga një licencë në tregun e transmetimit audioviziv, vendimi i mësipërm i AMA-s rrit përqendrimin në këtë treg.
3. Për sa më sipër KLSH i rekomandon Autoritetit të Konkurrencës që duke marrë në konsideratë ndjeshmërinë e tregut të transmetimeve audiovizive për pluralizmin e mendimit dhe efektet negative të rritjes së përqendrimit në treg të shkaktuara nga vendimmarrja e AMA-s, të vlerësojë dhe të shprehet në lidhje me ndryshimet e strukturës së tregut të shkaktuar nga vendimmarrja e AMA-s nëpërmjet vendimit Nr. 5, datë 27.01.2017.
4. Lidhur me shqyrtimin e rastit nga Autoriteti i Konkurrencës u kërkua informacion nga AMA lidhur me vendimin Nr. 5, datë 27.01.2017 dhe relacionin përkatës, subjektet që operojnë në treg, të ardhurat vjetore të secilit subjekt që operon në tregun e transmetimit kombëtar audioviziv për periudhën 2014-2017 dhe aksionet e kryqëzuara midis shoqërive.

II - Rregullimi i Tregut

5. Ligji Nr. 97/2013 “Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (Ligji Nr. 97/2013) rregullon veprimtaria e mediave audiovizive dhe shërbimeve mbështetëse të tyre, mbi bazën e parimit të asnjësisë teknologjike në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe zbatohet për transmetimet audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare dhe shërbimet mbështetëse të tyre.
6. Në bazë të nenit 6, pika 1 të Ligjit Nr. 97/2013, AMA është autoriteti rregullator në fushën e shërbimeve të transmetimeve audio dhe audiovizive dhe shërbimeve të tjera mbështetëse në territorin e Republikës së Shqipërisë. AMA, në ushtrimin e funksioneve të veta siguron: realizimin e një mjedisi rregullator, që lehtëson zhvillimin e sektorit të transmetimeve audiovizive në Shqipëri si dhe mundëson dhe nxit zhvillimin teknologjik dhe zbatimin e tij në sektorin e transmetimit.
7. Ndër funksionet kryesore të AMA-s, sipas nenit 19 të Ligjit Nr. 97/2013 është shqyrtimi i propozimeve dhe aplikimeve për ushtrimin e shërbimeve të transmetimit, përfshirë aplikimet për transmetime numerike dhe dhënia e autorizimeve ose licencave përkatëse, në përputhje me këtë ligj.
8. AMA me Vendimin Nr. 219, datë 12.10.2016, ka miratuar Rregulloren “Për kriteret dhe procedurat për dhënien e licencës kombëtare të transmetimit audioviziv dhe licencës kombëtare të shërbimit të programit audioviziv”, e cila përcakton rregullat, kriteret dhe procedurat e licencimit për dhënien e licencës kombëtare të transmetimit audioviziv dhe licencës kombëtare të shërbimit të programit audioviziv në mbështetje të Ligjit Nr. 97/2013.
9. Në nenin 63 të Ligjit Nr. 97/2013, përcaktohet se mbajtësit e licencave kombëtare, rajonale e lokale të transmetimeve numerike audio dhe licencave kombëtare numerike të transmetimit audioviziv janë të detyruar t’u japin akses në kushte të drejta, të arsyeshme dhe jodiskriminuese, në jo më pak se 40 për qind të kapacitetit të multipleksit të tyre, OSHMA-ve që zotërojnë licencë shërbimi programi audio dhe/ose licencë shërbimi programi audioviziv. Pavarësisht këtij përcaktimi, një subjekt i licencuar për transmetime numerike ose për ofrimin e shërbimit të programit audio ose audioviziv, nuk mund të ketë më shumë se një të tretën e sasisë së përgjithshme të programeve përkatëse lokale, rajonale dhe kombëtare.
10. Mbajtësit e licencave kombëtare, rajonale e lokale të transmetimeve numerike audio dhe licencave kombëtare numerike të transmetimit audioviziv ofrojnë aksesin për transmetim në rrjetin numerik, mbi bazën e marrëveshjeve tregtare me OSHMA-të. Tarifat për dhënien e aksesit për transmetim në rrjetin numerik duhet të orientohen në kosto.
11. AMA siguron që të gjitha shërbimet që u ofrohen OSHMA-ve, që zotërojnë licencë shërbimi programi audio dhe ose licencë shërbimi programi audioviziv, nga mbajtësit e licencave kombëtare, rajonale e lokale të transmetimeve numerike audio dhe licencave kombëtare numerike të transmetimit audioviziv, bazohen në kushte të drejta, të arsyeshme dhe jodiskriminuese.
12. AMA, duke mbajtur parasysh garantimin e aksesit të barabartë dhe jodiskriminues për OSHMA-të, garantimin e konkurrencës së ndershme dhe shumëllojshmërisë së shërbimeve, pasi dëgjon pretendimet e palëve, vendos për zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

III - Struktura e Tregut

13. Referuar informacionit të dërguar nga AMA, rezulton se ndërmarrjet e pajisura me licencë kombëtare private transmetimi audioviziv numerik janë:
 - 1) “Digit-Alb” SHA;
 - 2) “Tv Klan” SHA;
 - 3) “Top Channel” SHA;

4) “Media Vizion” SHA;

5) “ADTN” SHA.

14. AMA, me vendimin Nr. 5, datë 27.01.2017 “Mbi shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “ADTN” SHA për revokim të vendimit Nr. 286, datë 29.12.2016 të AMA-s “Mbi shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “ADTN” SHA, për licencë kombëtare transmetimi audioviziv”, shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “ADTN” SHA, për licencë kombëtare të transmetimit audioviziv për shoqërinë “ADTN” SHA dhe dhënien e licencës private kombëtare të transmetimit audioviziv shoqërisë “ADTN” SHA”, ka vendosur: “Dhënien e licencës kombëtare private të transmetimit audioviziv, shoqërisë “ADTN” SHA, për një periudhë prej 15 vjetësh.”.

15. Referuar informacionit të dërguar nga AMA, struktura e pronësisë së ndërmarrjeve të pajisura me licencë private kombëtare transmetimi audioviziv numerik dhe aksionet e kryqëzuara midis tyre, paraqitet si më poshtë vijon:

IV - Pjesët e Tregut

16. Për përcaktimin e pjesëve të tregut të secilës ndërmarrje në tregun e transmetimeve audiovizive private kombëtare është përdorur kriteri i të ardhurave të realizuara nga ana e tyre. Të ardhurat vjetore të ndërmarrjeve për periudhën 2014-2017 pasqyrohen në tabelën e mëposhtme:

17. Siç e përmendëm edhe më lart, në tregun e transmetimeve audiovizive private kombëtare janë të licencuar 5 ndërmarrje. Sipas informacionit të dërguar nga AMA, 3 (tre) ndërmarrje, përkatësisht: Digit-Alb, Top Channel dhe ADTN; kanë lidhje aksionarësh. Referuar pjesëve të tregut sipas të ardhurave vjetore të secilës ndërmarrje, rezulton se ndërmarrja me pjesë më të madhe tregu për periudhën 2014 – 2017 është ndërmarrja Digit-Alb, e cila ka ulur pjesën e tregut nga XX % për vitet 2014 – 2015 në XX % për vitet 2016 – 2017. Ndërmarrja Tv Klan ka rritur pjesën e tregut për periudhën 2014 – 2017 nga XX % në XX%. Ndërmarrja ADTN, si hyrës i ri në këtë treg, duke u licencuar me Vendimin e AMA Nr. 5, datë 27.01.2017, rezulton se për vitin 2017 nuk ka realizuar të ardhura dhe për këtë arsye nuk ka ndikuar në ndryshimin e strukturës së tregut.

V - Përqendrimi i Tregut

18. Bazuar në strukturën e mësipërme të tregut, është llogaritur indeksi i përqendrimit HHI për periudhën 2014 - 2017, për të parë influencën në treg të hyrësit të ri ADTN. Të dhënat e treguesit HHI paraqiten në Tabelën e mëposhtme.

19. Nga analiza e tabelës së mësipërme të strukturës së tregut dhe shkallës së përqendrimit në treg, rezultoi se tregu ka një shkallë të lartë përqendrimi, por kjo shkallë nuk vjen nga hyrja në treg pas licencimit të ndërmarrjes “ADTN” SHA. Treguesi HHI përpara hyrjes në treg të ndërmarrjes ADTN, dhe pas hyrjes në treg të kësaj ndërmarrje, është pothuajse i njëjtë. Krahësuar me vitin 2014, shkalla e përqendrimit ndonëse është akoma e lartë, ka pësuar një rënie të lehtë. Rënia e shkallës së përqendrimit, vjen si rezultat i rënies së pjesës së tregut të ndërmarrjes me pjesë tregu më të madhe, Digit-Alb.
20. Referuar sa më sipër, nga vlerësimi i pjesë tregut, indeksit të përqendrimit dhe barrierave të hyrjes, në mbështetje të nenit 3, pika 5 dhe nenit 8 të Ligjit Nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, por dhe nga praktikat me të mira të së drejtës evropiane të konkurrencës, vlerësojmë që ndërmarrja “Digit-Alb” SHA ka pozitë dominuese në tregun e transmetimeve audiovizive private kombëtare numerike.
21. Ndërmarrja me pozitë dominuese “Digit-Alb” SHA, zotëron 100% të aksioneve të ndërmarrjes “ADTN” SHA, si dhe ka lidhje aksionerësh me ndërmarrjen “Top Channel” SHA.
22. Sipas Ligjit Nr. 9121/2003, pasja e një pozite dominuese nga një ndërmarrje në treg nuk është e ndaluar, por zotërimi i pozitës dominuese i jep ndërmarrjes një detyrim të veçantë për të mos abuzuar me këtë pozitë dominuese.
23. Referuar sa më sipër, meqenëse të tregun e transmetimeve audiovizive private kombëtare numerike ushtron aktivitet një ndërmarrje me pozitë dominuese, e cila po në këtë treg zotëron gjithashtu 100% të aksioneve të ndërmarrjes “ADTN” SHA, si dhe ka lidhje aksionerësh me ndërmarrjen “Top Channel” SHA, AMA, si organ rregullator i këtij tregu duhet të marrë masa për të shmangur ndonjë sjellje abuzuese në treg nga ana e ndërmarrjes me pozitë dominuese “Digit-Alb” SHA.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 8, nenin 9, nenin 24, shkronja (d), nenin 26, nenin 70 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

- I. T’i rekomandojë Autoritetit të Mediave Audiovizive, si vijon:
 - i. Marrëveshjet midis ndërmarrjes me pozitë dominuese dhe ofruesve të shërbimit mediatik audioviziv (OSHMA) të mos kenë klauzola kufizuese;
 - ii. Dhënia e aksesit për ofruesit e shërbimit mediatik audioviziv (OSHMA) të jetë në kushte të drejta, të arsyeshme dhe jodiskriminuese;

- iii. Tarifat për dhënien e aksesit OSHMA-ve për transmetim në rrjetin numerik të jenë të orientuara në kosto;
- iv. Në rast se gjatë mbikëqyrjes së tregut vëren shenja të kufizimit të konkurrencës nga ndërmarrjet me pozitë dominuese në treg, ta parashtrojë rastin përpara Autoritetit të Konkurrencës;
- v. Brenda një periudhe prej 6 (gjashtë) muajsh nga fillimi i aktivitetit të ndërmarrjes “ADTN” SHA, të informojë Autoritetin e Konkurrencës lidhur me ndryshimin e strukturës së tregut të transmetimeve audiovizive private kombëtare numerike.

II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 532, datë 25.06.2018

“Për një ndryshim në vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr. 509, datë 02.05.2018 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik për përgjegjësitë ndaj palëve të treta, për produktin TPL e brendshme””

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 25.06.2018, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Për një ndryshim në vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr. 509, datë 02.05.2018 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik për përgjegjësitë ndaj palëve të treta, për produktin TPL e brendshme”.

Baza ligjore: Neni 4, Neni 24, shkronja (d) dhe neni 42 i Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar (Ligji Nr. 9121/2003).

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm mbi procedurën e hetimit paraprak në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik për përgjegjësitë ndaj palëve të treta, për produktin TPL e brendshme,

VËREN SE:

1. Komisioni i Konkurrencës me Vendimin Nr. 509, datë 02.05.2018 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik për përgjegjësitë ndaj palëve të treta, për produktin TPL e brendshme”, ka vendosur hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik për përgjegjësitë ndaj palëve të treta, për produktin TPL e brendshme, për periudhën kohore nga 01 Janari 2017 deri në 30 Prill 2018, dhe raporti i hetimit paraprak të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se 2 (dy) muaj nga marrja e këtij vendimi.
2. Gjatë procedurës së hetimit paraprak janë kryer inspektime pranë shoqërive të sigurimit që operojnë në treg dhe është kërkuar informacion nga këto ndërmarrje, si dhe nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF).
3. Koha e mbetur në dispozicion, nga momenti i depozitimit të informacionit të kërkuar, është e pamjaftueshme për përpunimin, vlerësimin dhe kryerjen e analizës së sjelljes së ndërmarrjeve që operojnë në tregun objekt hetimi, duke bërë të pamundur përfundimin e procedurave dhe dorëzimin e raportit brenda afatit.
4. Komisioni i Konkurrencës çmon se realizimi i plotë i procedurave të hetimit paraprak me qëllim analizimin e sjelljes së ndërmarrjeve në treg, është i domosdoshëm për të siguruar një vendimmarrje objektive.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, germa d dhe nenit 42, pika 1 e Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, (i ndryshuar),

VENDOSI:

1. Në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr. 509, datë 02.05.2018 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik për përgjegjësitë ndaj palëve të treta, për produktin TPL e brendshme”, pika “III”, të ndryshohet si vijon:

“III. Raporti i hetimit paraprak duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se data 24 Shtator 2018.”

2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 535, datë 17.07.2018

“Për vendosje gjobe ndaj ndërmarrjeve “Tea-D” SHPK dhe “A.E.K & CO” SHPK për marrëveshje të ndaluar në tregun e prokurimeve publike”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 17.07.2018, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Për konstatimin e marrëveshjes së ndaluar dhe vendosje gjobe ndaj ndërmarrjeve “Tea-D” SHPK dhe “A.E.K & CO” SHPK në procedurën e prokurimit publik “Kërkesë për Propozim” me objekt “Riparime të zyrave të objektit Njësia Administrative Lukovë” në Bashkinë Himarë.

Baza ligjore: Neni 4, neni 24, gërma (d), neni 43, pika 5 dhe neni 74 i Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar (Ligji Nr. 9121/2003).

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit të hetimit të thelluar në tregun e prokurimit publik për ndërmarrjet “Tea-D” SHPK dhe “A.E.K & CO” SHPK dhe relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës,

VËREN SE:

I - Procedura e ndjekur:

1. Pranë Autoritetit të Konkurrencës, Agjencia e Prokurimit Publik (APP), ka depozituar shkresën me Nr. 533, datë 26.12.2017, lidhur me shqyrtimin e “marrëveshjes në oferta” në prokurimin publik elektronik me objekt “Riparime të zyrave të objektit Njësia Administrative Lukovë”, Bashkia Himarë, bazuar në raportin e auditimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit (KLSH) për këtë prokurim, pasi mendohet se mund të ketë shkelje të nenit 4 (marrëveshja në oferta) të Ligjit Nr. 9121/2003.
2. Nga vlerësimi i kërkesës së APP, materialit të KLSH-së dhe dokumenteve të depozituara nga ndërmarrjet “Tea-D” SHPK dhe “A.E.K & CO” SHPK, në procedurën e prokurimit publik me objekt “Riparime të zyrave të objektit Njësia Administrative Lukovë”, në bazë të nenit 42 të Ligjit Nr. 9121/2003, Komisioni i Konkurrencës me Vendimin Nr. 500, datë 07.03.2018 “Për hapjen procedurës së hetimit paraprak në tregun e prokurimeve publike për ndërmarrjet “Tea-D” SHPK dhe “A.E.K & CO” SHPK”, vendosi hapjen e procedurës së hetimit paraprak, pasi mund të jemi përpara një marrëveshje të ndaluar në oferta midis këtyre 2 (dy) ndërmarrjeve, në kuptim të nenit 4, pika 1, gërma (a) të Ligjit Nr. 9121/2003.
3. Në përfundim të hetimit paraprak Komisioni i Konkurrencës konkludoi se sjellja e ndërmarrjeve “Tea-D” SHPK dhe “A.E.K & CO” SHPK, sipas praktikave për marrëveshje në oferta të vendeve të OECD, si edhe udhëzimit të Autoritetit të Konkurrencës, mund të përbëjë marrëveshje në oferta, e cila është e ndaluar në kuptim të nenit 4 të Ligjit Nr. 9121/2003.
4. Për sa më sipër, Komisioni i Konkurrencës me Vendimin Nr. 506, datë 02.05.2018 “Për hapjen procedurës

së hetimit të thelluar në tregun e prokurimeve publike për ndërmarrjet “Tea-D” SHPK dhe “A.E.K & CO” SHPK”, vendosi hapjen e procedurës së hetimit të thelluar.

5. Për mbledhjen e fakteve dhe të dhënave të nevojshme në lidhje me hetimin, bazuar në nenet 33 dhe 34 të Ligjit Nr. 9121/2003 janë kërkuar të dhëna dhe informacion nga: Bashkia Himarë, KLSH dhe ndërmarrjet “Tea-D” SHPK dhe “A.E.K & CO” SHPK.
6. Në bazë të nenit 35 dhe 36 të Ligjit Nr. 9121/2003 dhe Autorizimit të Komisionit të Konkurrencës (Autorizim Inspektorësh), grupi i inspektimit, gjatë periudhës së hetimit ka kryer inspektimet e nevojshme pranë ndërmarrjeve “Tea-D” SHPK dhe “A.E.K & CO” SHPK”.
7. Autoriteti i Konkurrencës me shkresat Nr. 295/2 Prot., datë 14.06.2018 dhe Nr. 295/3 Prot., datë 27.06.2018 u dërgoi ndërmarrjeve “Tea-D” SHPK dhe “A.E.K&Co” SHPK një kopje të raportit të hetimit të thelluar, duke i ftuar që të depozitonin me shkrim pranë Autoritetit të Konkurrencës pretendimet e tyre lidhur me konkluzionet e tij.
8. Në vijim të shkresave të mësipërme, brenda afatit të përcaktuar, ndërmarrja “A.E.K&Co” SHPK nuk depozitoi asnjë pretendim lidhur me konkluzionet e raportit të hetimit të thelluar, kurse ndërmarrja “Tea-D” SHPK me shkresën Nr. 295/4 Prot., datë 04.07.2018 depozitoi pretendimet e saj lidhur me raportin e hetimit të thelluar.

II - Tregu Përkatës

9. Tregu përkatës përfshin produktet që vlerësohen si të zëvendësueshme nga konsumatorët dhe operatorët, për sa u përket karakteristikave, çmimit dhe funksionit të tyre dhe që ofrohen ose kërkohen nga ndërmarrjet në një zonë gjeografike me kushte të njëjta konkurrence. Përkufizimi i tregut përkatës përfshin dy dimensione:
 - a) Tregu përkatës i produktit
 - b) Tregu përkatës gjeografik
10. Tregu përkatës i produktit është tregu i prokurimeve publike në procedurën “Kërkesë për Propozim”, me objekt “Riparime të zyrave të objektit Njësia Administrative Lukovë” Bashkia Himarë.
11. Tregu përkatës gjeografik përfshin zonën në të cilën ndërmarrjet janë përfshirë në ofertën dhe kërkesën e shërbimit, në të cilën kushtet e konkurrencës janë mjaftueshmërisht homogjene. Për vlerësimin e impaktit që shkakton ofertimi, tregu përkatës gjeografik do të konsiderohet Tregu i prokurimit publik me objekt “Riparime të zyrave të objektit Njësia Administrative Lukovë” në territorin e Bashkisë Himarë.

III - Vlerësimi i sjelljes së ndërmarrjeve në treg

12. Vlerësimi i sjelljes së ndërmarrjeve, në tregun e prokurimit publik “Rikonstruksion zyrash / Punë publike” është realizuar bazuar në metodologjinë e OECD “Mbi luftimin e marrëveshjeve të ndaluara në oferta në prokurimet publike”, si dhe Udhëzuesit të përshtatur sipas kësaj metodologjie të OECD.
13. Kjo metodologji jep format më të njohura të marrëveshjeve në oferta, mënyrat se si ofruesit bien dakord të eliminojnë konkurrencën, indikatorët e marrëveshjeve në oferta, listën e karakteristikave që ndihmojnë marrëveshjen, reduktimin e koordinimit të sjelljes në procesin e prokurimeve, risku i tenderimeve me marrëveshje, etj.
14. Bazuar në këtë metodologji është vlerësuar sjellja e operatorëve ekonomik (ofertuesve) të cilët janë përfshirë në skemën e marrëveshjes në oferta, për faktin se dokumente të ndërmarrjes “Tea-D” SHPK u gjetën edhe në kompjuterët e ndërmarrjes “A.E.K&Co” SHPK, megjithëse dokumentet në kuptim të ligjit për prokurimin elektronik janë konfidenciale.

15. Ndërmarrjet pjesëmarrëse në këtë procedurë prokurimi ishin:

- a- Operatori Ekonomik “TEA-D” SHPK;
- b- Operatori Ekonomik “Avduli” SHPK;
- c- Bashkimi i Operatorëve Ekonomik “Shëndelli + Kevin Konstruktion”;
- d- Operatori Ekonomik “A.E.K&CO” SHPK.

16. Ofertuesi fitues në këtë procedurë prokurimi është shpallur operatori ekonomik A.E.K & Co SHPK me vlerën 2,232,864 lekë e cila është afër fondit limit me 99.79% të tij dhe oferta e skualifikuar pa marrë në konsideratë ofertën më të ulët është BOE “Shëndelli & Kevin Konstruktion” SHPK, me diferencë XX% nga fondi limit. Sipas Bashkisë Himarë, ky operator ekonomik nuk ka paraqitur dokumentet në përputhje me kriteret e dhëna në dokumentet e tenderit dhe për këtë arsye është skualifikuar. Ndërmarrja “Tea-D” SHPK ka paraqitur ofertën në vlerën XXX ose (XXX lekë me TVSh) e cila është sa XX% e fondit limit.

17. Për vlerësimin e sjelljes së ndërmarrjeve është shqyrtuar i gjithë dokumentacioni i administruar dhe i paraqitur nga Bashkia Himarë në rolin e Autoritetit Kontraktor, si edhe dokumentacioni i gjetur gjatë procedurave të inspektimit pranë ndërmarrjeve “Tea-D” SHPK dhe “A.E.K & Co” SHPK pranë zyrave ku ushtrojnë aktivitetin në Gjirokastrë dhe Sarandë, ku janë mbajtur dhe procesverbalet e inspektimit të datës 15.03.2018. Nga shqyrtimi i këtij dokumentacioni, gjenden evidenca për marrëveshje në oferta, që tregojnë në mënyrë direkte bashkëpunimin midis dy ndërmarrjeve pjesëmarrëse “Tea-D” SHPK dhe “A.E.K & Co” SHPK, në përgatitjen e ofertave në këtë procedurë prokurimi publik, si vijon:

- Nga shqyrtimi i dokumentacionit të depozituar në rrugë elektronike në sistemin e prokurimit të APP, rezulton se dy operatorët ekonomik, ndërmarrja “Tea-D” SHPK dhe ndërmarrja “A.E.K & CO” SHPK, kanë ngarkuar të njëjtin dokument në sistemin elektronik të prokurimit dhe pikërisht “Vërtetim Debie – për shlyerjen e detyrimeve të energjisë elektrike”, të lëshuar nga Drejtoria Rajonale Gjirokastrë e OSHEE, për ndërmarrjen “Tea-D” SHPK me Nr. 135 Prot., datë 06.08.2015, (dokument i cili u gjet në të dy kompjuterat e zyrës së ndërmarrjes “A.E.K & Co” SHPK).
- Gjatë inspektimit në ambientet e selisë së ndërmarrjes A.E.K & Co SHPK, u gjet dokumenti “Vërtetim Debie – për shlyerjen e detyrimeve të energjisë elektrike”, të lëshuar nga Drejtoria Rajonale Gjirokastrë e OSHEE, për ndërmarrjen “Tea-D” SHPK me Nr. 135 Prot., datë 06.08.2015.
- Referuar Preventivave të depozituar nga të dy operatorët ekonomik, ndërmarrja “Tea-D” SHPK dhe ndërmarrja “A.E.K & CO” SHPK, rezulton se janë pothuajse identike dhe kanë ndryshime të disa zërave me një shtesë uniforme 10 lekë (psh njëri artikull ka vlerën 300 lekë/ ndërsa tjetri operator e ka vlerën 310 lekë) tek disa zëra punimesh të cilat janë të parëndësishme, kur struktura e ndërmarrjes janë të ndryshme.

18. Sjellja e ndërmarrjeve “Tea-D” SHPK dhe “A.E.K & CO” SHPK, sipas praktikave për marrëveshje në oferta të vendeve të OECD, si edhe udhëzimit të Autoritetit të Konkurrencës, përbën marrëveshje në oferta, e cila është e ndaluar në kuptim të nenit 4 të Ligjit nr. 9121/2003.

19. Skema e marrëveshjes në oferta e përdorur nga ndërmarrjet “Tea-D” SHPK dhe “A.E.K & CO” SHPK është ajo e ofertës së mbuluar, e cila është dhe forma më shpesh e përdorur, në të cilën gjenden të implementuara skemat e marrëveshjeve të ndaluara në oferta. Sipas kësaj skeme, njëri nga konkurrentët pranon të paraqesë një ofertë më të lartë sesa oferta e fituesit të përcaktuar, me qëllim për të dhënë përshtypjen e një ofertë të pastër dhe një konkurrencë të sinqertë.

20. Si përfundim, referuar sa më sipër, nga vlerësimi i sjelljes ndërmarrjeve “Tea-D” SHPK dhe “A.E.K & CO” SHPK dhe dokumenteve të mbledhura gjatë procedurë së hetimit paraprak, vlerësojmë se jemi

përpara një marrëveshje në oferta në procedurën e prokurimit publik “Kërkesë për Propozim” me objekt “Riparime të zyrave të objektit Njësia Administrative Lukovë” në Bashkinë Himarë, midis këtyre 2 (dy) ndërmarrjeve “Tea-D” SHPK dhe “A.E.K & CO” SHPK, e cila përbën një marrëveshje të ndaluar në kuptim të nenit 4, pika 1, gërma (a) të Ligji Nr. 9121/2003.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4, pika 1, gërma (a), nenin 24, gërma (d), nenin 43, pika 5 dhe nenin 74, pika 1 gërma (a) të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e prokurimit publik për ndërmarrjet “Tea-D” SHPK dhe “A.E.K & CO” SHPK;
2. Konstatimin e pavlefshmërisë së marrëveshjes së ndaluar midis ndërmarrjeve “Tea-D” SHPK dhe “A.E.K & CO” SHPK në procedurën e prokurimit publik “Kërkesë për Propozim” me objekt “Riparime të zyrave të objektit Njësia Administrative Lukovë” në Bashkinë Himarë;
3. Gjositjen e ndërmarrjeve “Tea-D” SHPK dhe “A.E.K & CO” SHPK për shkelje të rëndë të konkurrencës, konkretisht të nenit 4, pika 1, gërmat (a) të Ligjit Nr. 9121/2003, përkatësisht në shumën 100,000 (një qind mijë) Lekë për ndërmarrjen “Tea-D” SHPK dhe në shumën 100,000 (një qind mijë) Lekë për ndërmarrjen “A.E.K & CO” SHPK;
4. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi, njoftimin e palëve të interesuara dhe dërgimin pranë APP-së për të përjashtuar ndërmarrjet nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit në mbështetje të Ligjit Nr. 9643/2006.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 544, datë 20.09.2018

“Për një ndryshim në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr. 526 datë 14.06.2018 “Për hapjen e procedurës së Hetimit Paraprak në tregun e ndërmjetësimit në sigurime nga bankat e nivelit të dytë”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 20.09.2018, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Për një ndryshim në vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr. 526, datë 14.06.2018 “Për hapjen e procedurës së Hetimit Paraprak në tregun e ndërmjetësimit në sigurime nga bankat e nivelit të dytë”.

Baza ligjore: Neni 24, shkronja (d) dhe neni 26 i Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar (Ligji Nr. 9121/2003).

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm mbi procedurën e hetimit paraprak në tregun e ndërmjetësimit në sigurime nga bankat e nivelit të dytë,

VËREN SE:

1. Komisioni i Konkurrencës me Vendimin Nr. 526, datë 14.06.2018 2018 “Për hapjen e procedurës së Hetimit Paraprak në tregun e ndërmjetësimit në sigurime nga bankat e nivelit të dytë”, ka vendosur hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e ndërmjetësimit të bankave për periudhën kohore nga 01 Janari 2016 deri në 31 Maj 2018. Raporti i hetimit paraprak duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se 3 (tre) muaj nga dita e çeljes se këtij vendimi.
2. Gjatë procedurës së hetimit paraprak janë kryer inspekte pranë bankave objekt hetimi dhe është kërkuar informacion prej tyre në mënyrë shkresore.
3. Koha e mbetur në dispozicion, nga momenti i depozitimit të informacionit të kërkuar, është e pamjaftueshme për përpunimin, vlerësimin dhe kryerjen e analizës së sjelljes së ndërmarrjeve që operojnë në tregun objekt hetimi, duke bërë të pamundur përfundimin e procedurave dhe dorëzimin e raportit brenda afatit.
4. Komisioni i Konkurrencës çmon se realizimi i plotë i procedurave të hetimit paraprak me qëllim analizimin e sjelljes së ndërmarrjeve në treg, është i domosdoshëm për të siguruar një vendimmarrje objektive.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, shkronja (d) dhe nenin 26 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr. 526, datë 14.06.2018 2018 “Për hapjen e procedurës së Hetimit Paraprak në tregun e ndërmjetësimit në sigurime nga bankat e nivelit të dytë”, të ndryshohet si vijon:

“3. Raporti i hetimit paraprak duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se data 22 nëntor 2018.”

2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 545, datë 20.09.2018

“Për një ndryshim në vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr. 516, datë 22.05.2018 “Për hapjen e procedurës së Hetimit Paraprak në Sektorin Bankar, për Bankën Raiffeisen, Bankën Kombëtare Tregtare, Bankën Credins dhe Bankën Intesa San Paolo”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 20.09.2018, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Për një ndryshim në vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr. 516, datë 22.05.2018 “Për hapjen e procedurës së Hetimit Paraprak në tregun e sektorit bankar, për Bankën Raiffeisen, Bankën Kombëtare Tregtare, Bankën Credins dhe Bankën Intesa San Paolo”.

Baza ligjore: Neni 24, shkronja (d) dhe neni 26 i Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar (Ligji Nr. 9121/2003).

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm mbi procedurën e hetimit paraprak në sektorin bankar,

VËREN SE:

1. Komisioni i Konkurrencës me Vendimin Nr. 516, datë 22.05.2018 “Për hapjen e procedurës së Hetimit Paraprak në tregun e e sektorit bankar, për Bankën Raiffeisen, Bankën Kombëtare Tregtare, Bankën Credins dhe Bankën Intesa San Paolo”, ka vendosur hapjen e procedurës së hetimit paraprak në sektorin bankar për periudhën kohore nga 01 Janari 2016 deri në 31 Maj 2018. Raporti i hetimit paraprak duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se 3 (tre) muaj nga dita e çeljes se këtij vendimi.
2. Gjatë procedurës së hetimit paraprak janë kryer inspekte pranë bankave objekt hetimi dhe është kërkuar informacion prej tyre në mënyrë shkresore.
3. Koha e mbetur në dispozicion, nga momenti i depozitimit të informacionit të kërkuar, është e pamjaftueshme për përpunimin, vlerësimin dhe kryerjen e analizës së sjelljes së ndërmarrjeve që operojnë në tregun objekt hetimi, duke bërë të pamundur përfundimin e procedurave dhe dorëzimin e raportit brenda afatit.
4. Komisioni i Konkurrencës çmon se realizimi i plotë i procedurave të hetimit paraprak me qëllim analizimin e sjelljes së ndërmarrjeve në treg, është i domosdoshëm për të siguruar një vendimmarrje objektive.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, shkronja (d) dhe nenin 26 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr. 516, datë 22.05.2018 “Për hapjen e procedurës së Hetimit Paraprak në sektorin bankar, për Bankën Raiffeisen, Bankën Kombëtare Tregtare, Bankën Credins dhe Bankën Intesa San Paolo”, të ndryshohet si vijon:

“3. Raporti i hetimit paraprak duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se data 22 nëntor 2018.”

2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 551, Datë 04.10.2018

“Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit të miellit”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 04.10.2018, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Hapja e hetimit paraprak në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit të miellit.

Baza ligjore: Neni 4 dhe 9, neni 24 shkronja d dhe neni 42, pika 1, i ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës “Mbi vlerësimin e ankesës në tregun e tregtimit të miellit”,

VËREN SE:

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është paraqitur një ankesë në lidhje me disa shqetësime të konkurrencës në tregun e importit dhe tregtimit të miellit në tregun e brendshëm.

Nisur nga kjo ankesë, Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës në zbatim të nenit 28 të Ligjit Nr. 9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, vendosi të realizojë një monitorim në këtë treg, për të vlerësuar dhe analizuar kushtet e zhvillimit të konkurrencës në tregjet përkatëse, efektet që mund të sjellë ndonjë nga veçoritë e tregut të grurit, miellit dhe bukës, si dhe për të parë nëse ka element që kufizojnë ose shtrembërojnë konkurrencën në këtë treg.

Për realizimin e këtij monitorimi është kërkuar informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave Agjencia Kombëtare e Ushqimit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale.

Nga informacioni i administruar rezulton se për vitin 2017 XXX% të sasisë së miellit të importuar në vendin tonë realizohet nga XXX shoqëri ku pjesën më të madhe e realizojnë ndërmarrjet Besniku Shpk dhe Elledi Shpk, të cilat zënë së bashku XXX% të sasisë së importuar në vend.

Mielli i importuar përdoret kryesisht për tregtim i paketuar në supermarkete dhe për asortimente të veçanta brumi.

Nga informacionet e administruara gjatë monitorimit, në tregun e brendshëm nuk prodhohet miell me të tilla karakteristika. Në këto kushte i vetmi produkt që plotëson kërkesat e prodhimit (pastiçeri, biskoteri) është miell i importuar që ofrohet nga shoqëritë importuese, kryesisht “BESNIKU” SHPK në 2016-2017 dhe “ELLEDI” SHPK në 2018 si importues kryesor.

Për sa më sipër, sjellja e ndërmarrjeve në tregun e importit dhe prodhimit të miellit në Republikën e Shqipërisë, në këndvështrimin e nivelit të çmimit, cilësisë së prodhimit dhe rivalitetit mund të përbëjë kufizim, shtrembërim apo pengim të konkurrencës në kuptim të nenit 4 dhe 9 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4 dhe 9, nenin 24 shkronja d, dhe nenin 42, pika 1, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit të miellit në Republikën e Shqipërisë.
2. Hetimi paraprak të përfshijë periudhën kohore nga 1 janar 2017 deri 30 shtator 2018.
3. Raporti i hetimit paraprak duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se 6 (gjashtë) muaj nga marrja e këtij vendimi.
4. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 561, Datë 15.10.2018

“Për disa rekomandime dhe mbylljen e hetimit paraprak në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik për përgjegjësinë ndaj palëve të treta për produktin TPL e brendshme”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 15.10.2018, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Dhënia e disa rekomandime dhe mbyllja e hetimit paraprak në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik për përgjegjësinë ndaj palëve të treta për produktin TPL e brendshme.

Baza ligjore: Neni 24, shkronja (d), neni 26, neni 42 dhe neni 43 pika (5) të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar (Ligji Nr. 9121/2003).

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit mbi hetimin paraprak në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik për përgjegjësinë ndaj palëve të treta për produktin TPL e brendshme dhe relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm mbi procedurën e hetimit paraprak,

VËREN SE:

I. Procedura e ndjekur

1. Komisioni i Konkurrencës, me anë të Vendimit Nr. 509, datë 02.05.2018 ka vendosur të miratojë hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik për përgjegjësinë ndaj palëve të treta për produktin TPL e brendshme.
2. Në bazë të nenit 35 dhe 36 të Ligjit Nr. 9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar dhe Autorizimit të Komisionit të Konkurrencës, Grupi i Inspektimit gjatë periudhës së hetimit paraprak procedoi me kryerjen e inspektimeve pranë ndërmarrjeve që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik për përgjegjësinë ndaj palëve të treta, për produktin TPL e brendshme. Qëllimi i inspektimeve ishte grumbullimi i fakteve dhe të dhënave të nevojshme në funksion të hetimit paraprak në tregun e sigurimit.
3. Për mbledhjen e fakteve dhe të dhënave të nevojshme në lidhje me hetimin, bazuar në nenet 33 dhe 34 të Ligjit nr. 9121/2003 janë kërkuar të dhëna dhe informacion nga ndërmarrjet e sigurimeve dhe AMF.

II. Periudha e Hetimit dhe ndërmarrjet nën hetim

4. Procedura e Hetimit Paraprak e hapur me Vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr. 509, datë 02.05.2018, “Për hapjen e hetimit paraprak në tregun e tregtimit tregun e Sigurimit të detyrueshëm motorik për përgjegjësitë nga palët e treta për produktin TPL e brendshme”, përfshin periudhën 01 Janar 2017 deri në 30 Prill 2018.

5. Ndërmarrje nën hetim janë shoqëritë e sigurimit: Sigal Uniq Group Austria SHA, Sigma Vienna Insurance Group SHA, Atlantik SHA SHA, Intersig Vienna Insurance Group SHA, Alb-Siguracion SHA, INSIG SHA, Eurosig SHA dhe Ansig SHA.

III. Tregu Përkatës

6. Tregu përkatës i produktit do të konsiderohet tregu i sigurimit të detyrueshëm motorik ndaj palëve të treta për produktin TPL e brendshme.
7. Tregu përkatës gjeografik do të konsiderohet tregu i brendshëm, pra territori i Republikës së Shqipërisë.

IV. Struktura e Tregut

8. Produkti MTPL e brendshme, në vitin 2017 (krahasuar me vitin 2016) pati një rritje prej XXX% të volumit të primeve të shkruara bruto. Gjatë vitit 2016 vlera e primeve të shkruara bruto në sigurimin e MTPL së brendshme ka qenë XXX mijë lekë, ndërsa në vitin 2017 arriti në XXX mijë lekë. Rritjen më të madhe e ka patur ndërmarrja Insig me XXX%; Albsig me XXX%; Intersig me XXX% dhe Sigal me XXX%. Për të vlerësuar dinamikën e pjesëve të tregut, ndryshimin e volumit të shitjeve dhe shkallën e përqendrimit, janë vlerësuar të dhënat e administruara nga faqja e AMF-së.
9. Tregu i sigurimit të detyrueshëm motorik MTPL rezulton se ka një tregues përqendrimi HHI = XXX për vitin 2016 dhe XXX për vitin 2017. Referuar këtij treguesi rezulton se jemi përballë një tregu me një tregues të moderuar përqendrimi dhe me një rënie të lehtë për vitin 2017.
10. Treguesi i përqendrimit për periudhën 4 mujore 2017 dhe 4 mujore 2018 (Janar – Prill 2018) rezulton me një HHI = XXX për 4 mujorin e parë 2017 dhe XXX për 4 mujorin e parë 2018. Referuar këtij treguesi rezulton se jemi përballë një tregu me një tregues të moderuar për sa i përket përqendrimit dhe me një rënie të lehtë për 4 mujorin e parë të vitit 2018.

V. Analiza e Sjelljes së ndërmarrjeve në tregun përkatës

11. Në kuadër të hetimit paraprak është vlerësuar sjellja e ndërmarrjeve në tregun përkatës për të parë nëse jemi para rastit të një marrëveshje të ndaluar, e cila mund të sjellë kufizimin e konkurrencës në treg, referuar nenit 4, apo sjellje të tjera në kundërshtim me Ligjin Nr. 9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”.
12. Secila kompani bën llogaritjen aktuariale të primit të pastër në fillim të çdo viti dhe AMF-ja, brenda muajit mars të çdo viti, miraton primet e rrezikut për llogaritjen e provigjioneve teknike për sigurimin e detyrueshëm të përgjegjësisë së pronarit të mjetit motorik për dëmet që u shkaktohen palëve të treta nga përdorimi i këtij mjeti. Tabela e tarifave të primit të rrezikut të përlllogaritura në lekë e miratuar nga AMF me vendim dhe që duhet ta zbatojnë të gjitha ndërmarrjet është e njëjtë.
13. Nga vlerësimi i informacionit të dërguar nga kompanitë e sigurimit, rezulton se primet e rrezikut të përlllogaritura nga aktuarët e secilës ndërmarrje janë të ndryshme nga njëra tjetra. AMF-ja, në vijim të raporteve aktuariale mbi llogaritjen e primit të rrezikut të përpiluara nga secila ndërmarrje, me vendim miraton primin e rrezikut për përlllogaritjen e provigjioneve teknike për sigurimin e detyrueshëm MTPL në nivel tregu, i cili është i njëjtë për të gjitha ndërmarrjet.
14. Nga analiza e primeve të rrezikut dhe primeve të shitjes të depozituara nga ndërmarrjet në AMF, rezulton se llogaritja e primeve të rrezikut kryhet me qëllim përcaktimin e nivelit të provigjioneve të secilës ndërmarrje, por nga ana e AMF-së miratohet një prim i njëjtë rreziku për të gjitha ndërmarrjet për secilën klasë. Referuar Ligjit të sigurimeve ndërmarrjet i përcaktojnë vetë primet e shitjes duke shtuar mbi primin e rrezikut shpenzimet administrative, taksat dhe normën e fitimit, të cilat janë të ndryshme për secilën ndërmarrje.

15. Nga analiza e primeve të shitjes të aplikuara gjatë vitit 2017 sipas ndërmarrjeve nga vlera më e vogël tek vlera më e madhe rezulton se për të gjitha produktet për të gjitha kompanitë ndryshimi është me XXX lekë me përjashtim të produktit C1/1 që është XXX lekë. Nga krahasimi i primeve të shitjes nga ndërmarrja pasardhëse në ndërmarrjen paraardhëse mesatarja e diferencave të primeve për të gjitha klasat është me një trend XXX lekë nga ndërmarrja në ndërmarrje që duke i mbledhur shkon e barabarte për të gjitha klasat për të gjitha ndërmarrjet me 85 lekë.
16. Nga vlerësimi i trendit vjetor të pjesëve të tregut për vitin 2017 (periudhë hetimi) krahasuar me vitin 2016 (periudhë para hetimit) rezulton se pjesët e tregut për produktin MTPL, kanë lëvizje të vogla nën XXX%. Krahasuar me vitin 2014 lëvizjet e tregut janë më të mëdha si: rritje të ndërmarrjes Eurosig me XXX%; rritje të ndërmarrjes Albsig me XXX%; rritje të ndërmarrjes Insig me XXX%; përqendrimet të ndërmarrjeve; ulje të pjesëve të tregut të Intersig me XXX%, Sigal me XXX% dhe Atlantik me XXX%. Treguesi i përqendrimit HHI është ulur dhe ngelet në një nivel të moderuar përqendrimi.
17. Referuar informacionit të dërguar nga AMF-ja dhe ndërmarrjet nën hetim, rezulton se kompanitë e sigurimit tregtojnë nëpërmjet sistemit MSHM të administruar nga ndërmarrja “Star Broker” SHA, XXX% të policave në tregun e MTPL.
18. Për të vlerësuar sjelljen e ndërmarrjeve të sigurimit është analizuar edhe lidhja midis tarifave të aplikuara nga ndërmarrjet, influenca në rezultatin financiar, lidhjen midis pjesëve të tregut dhe normave të fitimit. Sipas këtyre treguesve të performancës rezultoi se gjatë vitit 2017 ndërmarrjet për të gjitha produktet kanë realizuar XXX mln⁶ lekë me një normë fitimi për të gjithë tregun XXX%. Norma e fitimit më e lartë është për ndërmarrjen Eurosig, e cila radhitet e treta për nga pjesa e tregut të produktit MTPL e brendshme. Ndërmarrja me pjesën më të madhe të tregut të MTPL të brendshme është Sigal, por që radhitet e dyta për nga niveli i normës së fitimit. Ndërmarrja Sigma që radhitet e treta për nga pjesët e tregut, përsa i përket normës së fitimit radhitet pothuajse me një normë fitimi më të ulët se të gjitha ndërmarrjet e tjera.

VI. Funksionimi i sistemit të shitjes

19. Funksionimi i sistemit të shitjes së kontratave të sigurimit të detyrueshëm motorik kryhet në zbatim të Rregullores së AMF-së për regjistrin elektronik online të shitjeve, me anë të së cilës bëhet e mundur që të dhënat e kërkesës për shitje nga shoqëritë e sigurimit të vijnë në kohë reale në Regjistrin Elektronik Online të Shitjeve dhe për çdo kërkesë programi gjeneron një numër unik të rastësishëm, i cili shtypet në policë në momentin e lëshimit dhe shërben për të vërtetuar raportimin e policës në bazën e të dhënave qendrore të AMF-së. Afatet e vlefshmërisë së policës nuk duhet të fillojnë më vonë se 30 ditë nga data e nënshkrimit të policës, me përjashtim të rasteve të parashikuara në këtë rregullore.
20. Në zbatim të Rezolutës së Kuvendit “Për vlerësimin e veprimtarisë së AMF-së për vitin 2017”, ku Kuvendi kërkon në mënyrë të përsëritur nga AMF verifikimin e algoritmit të serverit dhe sistemi i IT-së në lidhje me sistemin e shitjes së të gjithë tregut, në përdorim të brokerit, i cili tregton TPL, Karton Jeshil dhe Kufitare, për të siguruar konkurrencë të lirë dhe pa pengesa për shkak të këtij algoritmi, AMF ka bërë verifikimin mbi funksionimin dhe logimin në sistemin e shitjeve pranë pikave të shitjes së agentëve, ndërmjetësve dhe zyra qendrore të shoqërive të sigurimit, nga ku ka konstatuar se⁷:
 - Të gjithë agentët në pikat e shitjeve, për shitjen e policave TPL dhe Kufitare përdorin sistemin e shitjes të ndërmjetësit “Star Broker”, dhe të njëjtin sistem për shitjen e policave të Kartonit Jeshil të ndërmjetësit “Euro Broker”, sisteme këto të instaluar dhe konfiguruar veçmas për secilin ndërmjetës;

⁶ Në këtë vlerë përfshihen të gjitha produktet e sigurimit të jetës dhe jo jetës.

⁷ Shkresa e AMF nr. 2375/2 prot, datë 31.08.2018, protokolluar së brendshme me nr. 411/3 prot, datë 06.09.2018.

- Agjentët nuk i aksesojnë sistemet e shitjeve nëpërmjet kodeve të caktuara nga AMF, por nëpërmjet kodeve të hapura nga ndërmjetësit;
 - Agjentët kishin akses të kufizuar në sistem në periudha të caktuara të ditës në lidhje me shitjen e policave të Shoqërisë për të cilën janë licensuar, duke u detyruar që të shisnin në dy mënyra:
 - a) *Të shisnin polica për një Shoqëri Sigurimi të ndryshme nga ajo për të cilën janë licensuar, polica të cilat raportohen në AMF me kode agjentësh të ndryshëm;*
 - b) *Të shisnin jashtë sistemit duke përdorur një format të parapërgatitur në Excel, në pritje të hapjes së aksesit për të raportuar policat në sistem në një moment të dytë për shoqërinë e vetë.*
 - “Star Broker” dhe “Euro Broker” kanë vënë në dispozicion të Shoqërive të Sigurimit sistemin e shitjeve, përkatësisht për produktet TPL, Policës Kufitare dhe Karton Jeshil, duke realizuar gjithë procesin e shitjes që nga magazinimi dhe administrimi i fletëve të policave, deri tek shitja finale e policave, me vulën e ndërmjetësit përkatës: “Star Broker” dhe “Euro Broker”.
 - Agjentët ishin të autorizuar në sistem që të shisnin në bazë të preferencës së klientëve dhe për shoqëri të tjera, duke sjellë mosrakordim të numrit të përdoruesve në sistemin e shitjeve me numrin e agjentëve të licensuar nga AMF.
 - Shoqëria e sigurimit (e përzgjedhur rastësisht) ka në funksionim një aplikacion të ndarë në dy module: “E-Insure”, i cili përdoret për administrimin dhe raportimin e policave të sigurimit; dhe “Claims”, i cili përdoret për evidentimin dhe raportimin e dëmeve të ndodhura për të cilat përgjigjet shoqëria.
 - Çdo agjent ka të drejtë për të shitur nga të dy sistemet (të ndërmjetësit apo të shoqërisë) edhe pse kryesisht përdoret sistemi i ndërmjetësve “Star Broker” dhe “Euro Broker”. Bazuar në vendimin menaxherial të drejtuesve të shoqërisë, agjentët ishin udhëzuar për të përdorur sistemin e ndërmjetësve për të shitur policat e sigurimit të detyrueshëm.
21. Në informacionin e dërguar AMF shpjegon gjithashtu evoluimin e ndërmjetësit, ku sipas saj përpara dhjetorit 2017 shitjet e policave të detyrueshme motorike kryheshin drejtpërdrejt nga sistemi i ndërmjetësve, duke raportuar në AMF me IP e sistemit të tyre, e cila paraqitet me skemën Agjent – Sistemi i Ndërmjetësit – IP e Ndërmjetësit – AMF. Por, pas dhjetorit 2017, me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv të AMF, IP e ndërmjetësit u bllokua me qëllim ndalimin e skemës së mësipërme, e cila sipas AMF-së solli normalizimin e situatës me rezultat shitjen e policave nga IP-të e shoqërive.
22. Nga inspektimet e kryera së fundi nga AMF ka rezultuar se ndërmjetësit kanë rifilluar punën nëpërmjet një skeme tjetër nga ajo e mëparshme, e cila pas verifikimeve të kryera nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare rezultoi me skemën Agjent – Sistemi i Ndërmjetësit – IP e Shoqërisë – AMF. Sipas kësaj skeme policat shiten fillimisht me sistemin e ndërmjetësit dhe më pas maskohen me IP-në e Shoqërive.
23. Bazuar në konstatimet e mësipërme, nga ana e AMF-së është konkluduar se:
- Shitja e policave kryhet nga sistemet e ndërmjetësve (Euro Broker dhe Star Broker), të cilët kanë mundësinë për të ndërhyrë në sistem.
 - Në regjistrin elektronik online të shitjeve të kontratave të sigurimit të detyrueshëm motorik pranë AMF-së nuk ka dhe nuk mund të ketë asnjë algoritëm, pasi sistemi është i ndërtuar në mënyrë të tillë që vetëm mund të raportosh polica të shitura.
24. Referuar Ligjit Nr. 52/2014, "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit", agjenti apo shoqëria e agjentëve në sigurime vepron në emër dhe për llogari të shoqërisë së sigurimit dhe vetëm për ato

veprimtari, për të cilat është miratuar apo licensuar, si dhe nuk ka të drejtë të autorizojë asnjë person tjetër që të nënshkruajë kontratën e sigurimit në emër dhe për llogari të tij/të saj.

25. Gjithashtu brokeri në sigurime dhe shoqëria e brokerimit në sigurime ushtrojnë veprimtarinë e tyre nëpërmjet negocimit me shoqërinë e sigurimit në emër dhe për llogari të konsumatorit (të siguruarit), për t'i mundësuar nënshkrimin e një kontrate sigurimi, sipas kërkesave dhe nevojave të tij.
26. Bazuar sa më sipër agjenti dhe brokeri, si ndërmjetës në sigurime, veprojnë në mënyrë të pavarur nga njëri-tjetri, duke rakorduar punën e tyre drejtpërdrejt me shoqërinë e sigurimit për/me të cilën ato veprojnë/negociojnë.
27. Veprimtaria e ushtruar nga agjenti dhe brokerat janë veprimtari të pavarura nga njëra tjetra, të cilat lidhen drejtpërdrejt vetëm me shoqërinë e sigurimit për të cilën ato janë të autorizuar të operojnë. Ndërhyrja nëpërmjet ndërmjetësimit (Brokerave), në procesin e shitjes së policave të sigurimit të detyrueshëm motorik, nëpërmjet krijimit dhe vënies në funksion të sistemeve të shitjes, të ndryshme nga ato të shoqërive të sigurimit, sjell konfuzion dhe anomali në raportimet e bëra për shitjet në sistemin online të AMF-së dhe cenim të procesit të shitjes.
28. Siç është konstatuar edhe nga vetë AMF-ja gjatë inspektimeve të kryera pranë kompanive të sigurimit, agjentëve dhe ndërmjetësve, rezulton se agjentët kryejnë shitje të policave të sigurimit MTPL edhe për shoqëritë e tjera të sigurimeve për të cilat nuk janë të licensuar. Kjo mënyrë tregtimi është në kundërshtim me Ligjin Nr. 52/2014, “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” dhe në bazë të nenit 199, pika 5 të këtij Ligji, AMF-ja mund të ndalojë ushtrimin e veprimtarisë së agjentit në sigurime dhe e çregjistron atë nga regjistri.
29. Gjithashtu, nga konstatimet e inspektimeve të kryera nga AMF-ja, rezulton se në sistemet e shitjes të përdorura nga agjentët e kompanive të sigurimit, në periudha të caktuara të ditës, agjenti i një kompanie sigurimi nuk mund të shiste për kompaninë për të cilën është licensuar, duke u detyruar të shesë për llogari të shoqërive të tjera, gjë e cila bie në kundërshtim me Ligjin Nr. 52/2014, “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”.
30. Edhe nga pikëpamja e nxitjes së konkurrencës në treg, kjo mundësi që u jepet agjentëve nga sistemi i shitjes së ndërmjetësimit, për të pasur akses në informacionin e çdo kompanie sigurimi në treg dhe për të tregtuar për çdo kompani sigurimi, rrit transparencën e tregut, por mund të çojë potencialisht në koordinimin e sjelljes së kompanive të sigurimit.
31. Për sa më sipër, AMF-ja, në bazë të kompetencave të dhëna nga Ligji Nr. 52/2014, duhet të marrë masat përkatëse për ndalimin e tregtimit të policave të sigurimit të detyrueshëm në kundërshtim me përcaktimet e këtij ligji, duke ndaluar agjentët të tregtojnë për llogari të kompanive të tjera të sigurimit për të cilat nuk janë të licensuar, si dhe për të lejuar shfaqjen në sistemin e tregtimit të agjentit vetëm të kompanisë së sigurimit për llogari të të cilit vepron.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, shkronja (d), nenin 26, nenin 43, pika 5 dhe nenin 70 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik për përgjegjësinë ndaj palëve të treta, për produktin TPL e brendshme.
2. Ti rekomandojë AMF-së që brenda afatit 90 ditor:

- a) Të miratojë primin e riskut për çdo kompani sigurimi mbështetur në raportin e përgatitur nga aktuari i kompanisë duke mos miratuar dhe orientuar një prim risku të njëjtë për të gjithë tregun e MTPL;
 - b) Të verifikojnë nëse tregtimi i TPL në sistemet e tyre të shitjeve është në përputhje me rregullat e sjelljes së tregut të miratuara nga AMF, me qëllim shmangien e pasojave të padëshiruara për konkurrencën në treg;
 - c) Të marrë masat për ndalimin e tregtimit të policave të sigurimit të detyrueshëm në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit Nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”;
 - d) Të marrë masat për të lejuar shfaqjen në sistemet e tregtimit që përdoren nga agjentët vetëm të kompanisë së sigurimit për llogari të të cilit vepron;
 - e) Të ndalojë agjentët të tregtojnë për llogari të kompanive të tjera të sigurimit për të cilat nuk janë të licensuar;
 - f) Në sistemet e tregtimit të policave të sigurimit të detyrueshëm të shmangen ndërhyrjet që nuk janë në përputhje me aktet nënligjore dhe rregullat e vendosura nga AMF, me qëllim shmangien e një koordinimi të mundshëm të sjelljes midis ndërmarrjeve konkurrencte.
 - g) Të parashtrojë përpara Autoritetit të Konkurrencës duke kërkuar fillimin e procedurave përkatëse ligjore për çdo rast për të cilin konstaton sjellje antikonkurrencte nga ana e ndërmarrjeve që ushtrojnë veprimtari në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik për përgjegjësinë ndaj palëve të treta;
3. Për nxitjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg, si dhe për të shmangur çdo sjellje të mundshme anti konkurrencte, ndërmarrjet që ushtrojnë aktivitet në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik për përgjegjësinë ndaj palëve të treta, brenda afatit 90 ditor:
- a) Të ndalojnë tregtimin e policave të sigurimit të detyrueshëm në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit Nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”;
 - b) Sistemet që përdorin kompanitë e sigurimit dhe agjentët/punonjësit e tyre për tregtimin e policave të sigurimit të detyrueshëm të lejojnë shfaqjen vetëm të kompanisë së sigurimit për llogari të të cilit vepron;
 - c) Agjentët/punonjësit e kompanive të sigurimit të tregtojnë vetëm për llogari të kompanisë së sigurimit për të cilën është licensuar;
 - d) Në sistemet e tregtimit të policave të sigurimit të detyrueshëm të shmangen ndërhyrjet që nuk janë në përputhje me aktet nënligjore dhe rregullat e vendosura nga AMF, me qëllim shmangien e një koordinimi të mundshëm të sjelljes midis ndërmarrjeve konkurrencte.
4. Ndërmarrja “Star Broker” SHA të ushtrojë aktivitet në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik për përgjegjësinë ndaj palëve të treta, në mbrojtje të interesave të konsumatorit, sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, si dhe duke zbatuar rregullat e miratuara nga AMF-ja.
5. Monitorimin e tregut të sigurimit të detyrueshëm motorik për përgjegjësinë ndaj palëve të treta nga Autoriteti i Konkurrencës për një periudhë 6 (gjashtë) mujore;
6. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIME ME OBJEKT - ABUZIM ME POZITËN DOMINUESE

VENDIM

Nr. 493, datë 23.01.2018

“Për mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e shërbimit të mirëmbajtjes së pajisjeve fiskale për tregtimin e karburanteve”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Z.	Koço BROKA	Anëtar
Znj.	Iva ZAJMI	Anëtar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 23.01.2018, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Shqyrtimi i Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm mbi hetimin paraprak në tregun e shërbimit të mirëmbajtjes së pajisjeve fiskale për tregtimin e karburanteve.

Baza Ligjore: Neni 24, shkronja (d), neni 26, neni 42 dhe neni 43 pika (5) të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar (Ligji Nr. 9121/2003). Ligjin Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm mbi hetimin paraprak në tregun e shërbimit të mirëmbajtjes së pajisjeve fiskale për tregtimin e karburanteve,

VËREN SE:

PROCEDURA E NDJEKUR

Autoriteti i Konkurrencës në bazë të neneve 8, 9 dhe 29/1 të Ligjit Nr. 9121/2003, ka shqyrtuar pretendimet që ndërmarrja Skenderi G SHPK ka dërguar për dijeni pranë Autoritetit të Konkurrencës, me shkresën Nr. 169 Prot., datë 21.11.2017 (protokolluar më tonën Nr. 483 Prot., datë 22.11.2017), lidhur me mirëmbajtjen e kasave fiskale për karburantet. Kjo shkresë i është drejtuar Ministrisë së Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrësve, Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorisë së Tatimpaguesve të Mëdhenj.

Komisioni i Konkurrencës, pas vlerësimit të pretendimeve, në zbatim të nenit 42, pika 1, të Ligjit Nr. 9121/2003 me propozim të Sekretariatit, me anë të Vendimit Nr. 491, datë 28.12.2017, “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e shërbimit të mirëmbajtjes së pajisjeve fiskale për tregtimin e karburanteve”, vendosi hapjen e hetimit për të parë nëse ka, ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës.

Komisioni i Konkurrencës ftoi palët (Skenderi G SHPK dhe AE Distribution) në seancë dëgjimore, pasi vlerësoi se mund të ishte para një rasti urgjent dhe rrezikut të kryerjes së një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm për konkurrencën, që mund të kërkonte marrjen e masave të përkohshme, sikurse parashikohet në nenin 44 të Ligjit Nr. 9121/2003.

Ndërmarrja Skenderi G SHPK me shkresën Nr. 483/2, Prot., datë 04.01.2018 shprehet se me shkresën Nr.483 Prot., datë 22.11.2017 ka paraqitur të gjitha faktet e nevojshme dhe njofton mospjesëmarrjen në seancën

dëgjimore, kurse më datë 23 Janar 2018 në ambientet e Autoritetit të Konkurrencës u zhvillua seanca dëgjimore me ndërmarrjen AE Distribution SHPK.

TREGU PËRKATËS

Tregu përkatës i produktit përfshin shërbimin e mirëmbajtjes së pajisjeve (kasave) fiskale për tregtimin e karburanteve. Tregu përkatës gjeografik përfshin zonën në të cilën ndërmarrjet janë përfshirë në ofertën dhe kërkesën e shërbimit, në të cilën kushtet e konkurrencës janë mjaftueshmërisht homogjene dhe në rastin tonë përfshin territorin e Republikës së Shqipërisë.

ANALIZA E SJELLJES SË NDËRMARRJES “AE DISTRIBUTION” SHPK

Procedura e Hetimit Paraprak, hapur me Vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr. 491, datë 28.12.2017, përfshin tregun e shërbimit të mirëmbajtjes së pajisjeve fiskale për tregtimin e karburanteve.

Ndërmarrja AE Distribution SHPK është një ndër katër ndërmarrjet e autorizuar nga Ministria e Financave e Republikës së Shqipërisë për importimin, tregtimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve fiskale në territorin e Republikës së Shqipërisë. Ajo nuk është e integruar vertikalisht në tregun ku ajo ofron produktet dhe ku operon ankimuesi.

Ndërmarrja AE Distribution SHPK, me anë të shkresës Nr. 483/5 prot., datë 22.01.2018 dhe në seancën dëgjimore të zhvilluar në datën 23.01.2018 përpara Komisionit të Konkurrencës, paraqiti shpjegime dhe argumente lidhur me objektin e hetimit.

Sipas dokumenteve të depozituara nga ndërmarrja AE Distribution SHPK, rezulton se kjo ndërmarrje ka ofruar shërbimin e mirëmbajtjes së pajisjeve fiskale për ndërmarrjen Skenderi G SHPK, megjithëse kjo ndërmarrje nuk kishte përmbushur detyrimet për një periudhë 10 vjeçare dhe në mungesë të një kontrate mirëmbajtjeje në formë të shkruar. Në bazë të VKM Nr. 781, datë 14.11.2007 është detyrim i përdoruesit të pajisjes fiskale, në këtë rast ndërmarrjes Skenderi G SHPK, që të sigurojë kontratë shërbimi mirëmbajtjeje me një shoqëri të autorizuar nga Ministria e Financave.

Ndërmarrja AE Distribution SHPK me shkresën e datës 21.11.2017 i ka kërkuar ndërmarrjes Skenderi G SHPK përmbushjen e detyrimeve kontraktore dhe atyre ligjore në mënyrë që të vijonte me ofrimin e shërbimit të mirëmbajtjes.

Sipas Kontratës së datës 11.12.2017 të depozituar nga ndërmarrja AE Distribution SHPK, rezulton se midis saj dhe ndërmarrjes Skenderi G SHPK është lidhur Kontrata për shërbimin e mirëmbajtjeje për rreth 120 pajisje fiskale, por ende nuk është shlyer detyrimi monetar nga ndërmarrja Skenderi G SHPK.

Ndërmarrja AE Distribution SHPK në seancën dëgjimore para Komisionit të konkurrencës ka depozituar edhe një e-mail të datës 28.12.2017 që ndërmarrja Skenderi G ia drejton Drejtorisë të Përgjithshme të Tatimeve për dijeni dhe ndërmarrjes AE Distribution SHPK, me anë të të cilit njofton se midis shoqërive AE Distribution SHPK dhe Skenderi G SHPK u arrit marrëveshja për zgjidhjen e problemit, e cila u përmbyll dhe me kontratën e mirëmbajtjes së pajisjeve fiskale, gjë që do të thotë se nga ana e shoqërisë AE Distribution SHPK është ofruar normalisht asistencë për të gjitha kërkesat e Skenderi G SHPK.

Në lidhje me shqetësimin tjetër të ngritur jo vetëm nga ndërmarrja Skenderi G SHPK, por edhe nga shoqëritë e tjera që tregtojnë hidrokarbure për mos ofrimin e shërbimit të mirëmbajtjes së pajisjeve fiskale të tregtuara nga ish shoqëria e autorizuar “CKV Noki” SHPK, ndërmarrja AE Distribution SHPK sqaron se i ka kërkuar Ministrisë së Financave dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve që të mundësonte shërbimin e mirëmbajtjes për pajisjet fiskale të tregtuara deri në atë moment nga ish- shoqëria e autorizuar “CKV Noki” SHPK, pas heqjes së licencës kësaj të fundit, të cilës i është përgjigjur pozitivisht dhe aktualisht ofron shërbimin e mirëmbajtjes së këtyre pajisjeve fiskale.

I vetmi shërbim që ndërmarrja A.E.Distribution SHPK nuk mund të ofrojë për këto pajisje është ai i çfiskalizimit, pra i zëvendësimit të memorieve fiskale dhe qarkut të shiritit të kontrollit elektronik të pajisjeve fiskale, pasi ky shërbim nuk mund të kryhet për arsye teknike sepse çdo ndërhyrje që kryhet në një pajisje fiskale, dhe sidomos ajo e çfiskalizimit, kërkon aprovimin në rrugë elektronike nga sistemi Nexus i monitorimit të pajisjeve fiskale, e cila nënkupton faktin, që ndërmarrja AE Distribution SHPK është e autorizuar të kërkojë në sistemin “Nexus” kod aprovimi për të kryer ndërhyrje vetëm në pajisjet fiskale të tregtuara prej saj e që mbajnë inicialet “AED”.

Mungesa e shërbimit të çfiskalizimit, për pajisjet fiskale të tregtuara nga ish shoqëria e autorizuar “CKV NOKI” SHPK nuk varet nga vullneti i ndërmarrjes “AE Distribution” SHPK, por është një problem thelbësisht teknik.

Për këtë problem teknik ndërmarrja A.E. Distribution SHPK ka vënë në dijeni jo vetëm subjektin, por dhe Ministrinë e Financave dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve me shkresën e datës 19.07.2017 dhe është në pritje të zgjidhjes teknike që do të ofrohet për të mundësuar zgjidhjen e këtij problemi.

Si përfundim, referuar dokumenteve të administruara dhe argumenteve që ndërmarrja AE Distribution SHPK depozitoi në rrugë shkresore dhe në seancën dëgjimore përpara Komisionit të Konkurrencës, mbi sjelljen e saj vlerësojmë se nuk përmbushen kushtet e refuzimit për të ofruar shërbimin në tregun përkatës, sipas nenit 9 të Ligjit Nr. 9121/2003, sepse:

- Ndërmarrja AE Distribution SHPK nuk është e integruar vertikalisht;
- Ndërmarrja AE Distribution SHPK ka ofruar shërbimin e mirëmbajtjes së pajisjeve fiskale për ndërmarrjen Skenderi G SHPK, megjithëse kjo ndërmarrje nuk kishte përmbushur detyrimet për një periudhë 10 vjeçare dhe në mungesë të një kontrate mirëmbajtjeje në formë të shkruar.
- Midis shoqërive AE Distribution SHPK dhe Skenderi G SHPK është arritur marrëveshja për zgjidhjen e problemit, e cila u përmyll dhe me kontratën e mirëmbajtjes së pajisjeve fiskale datë 11.12.2017, gjë që do të thotë se nga ana e shoqërisë AE Distribution SHPK është ofruar normalisht asistencë për të gjitha kërkesat e ndërmarrjes Skenderi G;
- Shërbimi i çfiskalizimit, për pajisjet fiskale të tregtuara nga ish shoqëria e autorizuar “CKV NOKI” SHPK nuk kryhet nga ndërmarrja AE Distribution SHPK, për arsye teknike.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, shkronja (d), nenin 26, nenin 42 dhe nenin 43, pika (5) të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e shërbimit të mirëmbajtjes së pajisjeve fiskale për tregtimin e karburanteve, pasi nuk ka shenja të kufizimit të konkurrencës, në bazë të nenit 9 të Ligjit Nr. 9121/2003.
 2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 497, datë 08.02.2018

“Për hapjen e hetimit paraprak në tregun e shërbimit të kontrollit teknik të automjeteve në Republikën e Shqipërisë”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 08.02.2018, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Shqyrtimi i relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm mbi monitorimin e realizuar pranë pikës së kontrollit teknik të automjeteve të shoqërisë SGS Albania SHA.

Baza Ligjore: Nenet 8, 9, 24, shkronja (d), neni 26 dhe neni 42 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar (Ligji Nr. 9121/2003). Neni 12 i Rregullores “Për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës”. Neni 4 i Rregullores “Për procedurat hetimore të Autoritetit të Konkurrencës”. Ligjin Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm,

VËREN SE :

Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës me date 09.01.2018 realizoi një monitorim në tregun e shërbimit të kontrollit teknik të automjeteve, i cili është treg i modelit të centralizuar (i ndare nga shërbimi i servisit), me një ndërmarrje të vetme të ofrimit të shërbimit.

Shërbimi i kontrollit teknik të automjeteve ofrohet vetëm nëpërmjet ndërmarrjes "SGS Automotive Albania" ShPK, e cila gëzon të drejta të përcaktuara nga marrëveshja e Koncesionit "Për dhënie me Koncesion të shërbimit të kontrollit teknik të detyrueshëm të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të tyre në Republikën e Shqipërisë" e nënshkruar në datë 03.09.2009.

Nga monitorimi i realizuar rezulton se në mjediset e koncesionarit janë konstatuar rrudhë të gjata të automjeteve, të cilat prisnin të realizonin kontrollin teknik të tyre.

Nga këqyrja e veprimeve të punonjësve, të cilët ofronin shërbimin e kolaudit u konstatua se për realizimin e shërbimit të kontrollit teknik të automjeteve kërkohen dokumentet e mëposhtme:

- Fotokopje e kontratës së sigurimit të detyrueshëm (TPL e brendshme). Kontrata (TPL) duhet të jetë e vlefshme në momentin e kryerjes së kontrollit të plote teknik të automjetit;
- Lejen e qarkullimit të mjetit rrugor që do të kontrollohet;
- Vërtetimin e pagesës së taksave vjetore të mjetit rrugor.

Gjithashtu u konstatua se për ofrimin e shërbimit, koncesionari i kërkonte të gjithë klientëve nënshkrimin e një "deklarate", ku klienti midis të tjerash, merrte përsipër të shkarkonte nga përgjegjësia koncesionarin për

çdo dëmtim që mund t'i ndodhte automjetit të tij brenda mjediseve të koncesionarit gjatë procesit të kontrollit teknik. Kopja e kësaj deklarate mbahej nga koncesionari dhe nuk vihej në dispozicion klientit mbas nënshkrimit.

Në pikën 3 të kësaj deklarate theksohet se "SGS nuk mban asnjë përgjegjësi, të çfarë do lloji qofte, për çdo dëmtim që mund të shkaktohet automjetit në fjalë gjatë procesit të kontrollit teknik, dëmtim i cili mund të vije si pasojë e çfarëdo problemi mekanik apo elektrik në automjet".

Komisioni i Konkurrencës me Vendimin Nr. 416, datë 18.05.2016 "Për disa rekomandime për rishikimin e tarifave dhe mbi hapjen e tregut të shërbimit të kontrollit teknik të automjeteve" i ka rekomanduar "SGS Automotive Albania" sh.p.k të rishikojë përmbajtjen e Paragrafit të Tretë, të Deklaratës-Tip, që nënshkruhet nga klientët para dorëzimit të dokumentacionit të kërkuar.

Në përfundim të monitorimit u konstatua se koncesionari "SGS Automotive Albania" Sh.p.k nuk ka marrë në konsideratë rekomandimet e dhëna nga Komisioni i Konkurrencës me Vendimin Nr. 416, datë 18.05.2016 "Për disa rekomandime për rishikimin e tarifave dhe mbi hapjen e tregut të shërbimit të kontrollit teknik të automjeteve" duke mos rishikuar përmbajtjen e Paragrafit të Tretë, të Deklaratës-Tip, që nënshkruhet nga klientët para dorëzimit të dokumentacionit të kërkuar.

Sjellja e koncesionarit "SGS Automotive Albania" Sh.p.k lidhur me detyrimin e klientëve të tij për të nënshkruar një "deklarate", ku klienti midis të tjerash, merr përsipër të shkarkojë nga përgjegjësia koncesionarin për çdo dëmtim që mund t'i ndodhte automjetit të tij brenda mjediseve të koncesionarit gjatë procesit të kontrollit teknik, mund të përbëjë kufizim të konkurrencës bazuar në nenin 9, pika 2, shkronja (ç) të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", i ndryshuar.

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të neneve 9, 24, (gërma d); 26, 42, pika 1, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e shërbimit të kontrollit teknik të automjeteve në Republikën e Shqipërisë.
2. Hetimi paraprak të përfshijë periudhën kohore nga 1 Qershor 2016 deri në 31 Dhjetor 2017;
3. Raporti i hetimit paraprak duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se 3 (tre) muaj nga dita e çeljes së këtij hetimi.
4. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 503, datë 21.03.2018

“Për një ndryshim në vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr. 490, datë 20.12.2017 “Për hapjen e hetimit paraprak në tregun e transportit ajror të udhëtarëve ndaj ndërmarrjes Austrian Airlines””

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 21.03.2018, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Për një ndryshim në vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr. 490, datë 20.12.2017 “Për hapjen e hetimit paraprak në tregun e transportit ajror të udhëtarëve ndaj ndërmarrjes Austrian Airlines”

Baza Ligjore: Neni 8, neni 9, Neni 24, shkronja (d) dhe neni 42 i Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar (Ligji Nr. 9121/2003).

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm mbi procedurën e hetimit paraprak në tregun e transportit ajror të udhëtarëve ndaj ndërmarrjes Austrian Airlines,

VËREN SE:

Komisioni i Konkurrencës me Vendimin Nr. 490, datë 20.12.2017 “Për hapjen e hetimit paraprak në tregun e transportit ajror të udhëtarëve ndaj ndërmarrjes Austrian Airlines”, ka vendosur hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e transportit ajror të udhëtarëve ndaj ndërmarrjes Austrian Airlines për periudhën kohore nga 1 Janar 2017 deri në 31 Dhjetor 2017 dhe raporti i hetimit paraprak të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se 3 (tre) muaj nga dita e çeljes së këtij hetimi.

Gjatë procedurës së hetimit paraprak u krye inspektim pranë degës në Shqipëri të ndërmarrjes Austrian Airlines AG, si dhe u kërkua informacion nga kjo ndërmarrje dhe nga Autoriteti i Aviacionit Civil (AAC).

Pas depozitimit të informacionit të kërkuar dhe përpunimit të tij, rezultoi se për të kryer një analizë më të plotë të sjelljes së ndërmarrjes Austrian Airlines duhet të kërkohet informacion shtesë nga kjo ndërmarrje dhe nga AAC.

Komisioni i Konkurrencës çmon se sigurimi i një informacioni të plotë dhe të detajuar dhe dëgjimi i të gjitha palëve të përfshira në këtë hetim, për të parë më mirë sjelljen e ndërmarrjeve në treg, është i domosdoshëm për të siguruar një vendimmarrje objektive.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 8, nenin 9, nenin 24, shkronja (d) dhe nenin 42 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr. 490, datë 20.12.2017 “Për hapjen e hetimit paraprak në tregun e transportit ajror të udhëtarëve ndaj ndërmarrjes Austrian Airlines”, pika “3”, të ndryshohet si vijon:
2. Raporti i hetimit paraprak duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se data 29 maj 2018.
3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 505, datë 29.03.2018

“Për mbylljen e hetimit paraprak në tregun e prodhimit, grumbullimit, përpunimit dhe eksportit të duhanit dhe dhënien e rekomandimit për Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 29.03.2018, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Mbyllja e hetimit paraprak në tregun e prodhimit, grumbullimit, përpunimit dhe eksportit të duhanit dhe dhënia e rekomandimit për Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Bazë ligjore: Neni 8, neni 9, neni 24 shkronja d, neni 42 dhe neni 70 i ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar. Ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit mbi hetimin paraprak në tregun e prodhimit, grumbullimit, përpunimit dhe eksportit të duhanit dhe relacionit përkatës të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës,

VËREN SE:

PROCEDURA E NDJEKUR

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të nenit 8 dhe 9, nenit 24, shkronja d dhe nenit 42, pika 1, të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës", (i ndryshuar), me anë të vendimit nr. 488, datë 05.12.2017 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prodhimit, grumbullimit, përpunimit dhe eksportit të duhanit”, vendosi të miratojë hapjen e hetimit paraprak në këtë treg, për të parë nëse ka ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës, për periudhën kohore nga 01/06/2016 deri në 30/11/2017.

Në vazhdim të procedurës, në zbatim të vendimit nr. 488, datë 05.12.2017 të Komisionit të Konkurrencës, bazuar në nenet 35 dhe 36 të ligjit nr. 9121/2003 dhe autorizimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 493, datë 06.12.2017 "Autorizim inspektorësh", inspektorët e Drejtorisë së Mbikëqyrjes së Tregjeve Prodhuese, gjatë periudhës së hetimit paraprak, proceduan me kryerjen e inspektimeve pranë ndërmarrjeve që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në tregun e prodhimit, grumbullimit, përpunimit dhe eksportit të duhanit.

Për mbledhjen e fakteve dhe të dhënave të nevojshme në lidhje me hetimin, bazuar në nenet 33 dhe 34 të ligjit nr. 9121/2003, janë kërkuar të dhëna dhe informacion nga institucionet shtetërore dhe ndërmarrjet që operojnë në tregun përkatës.

TREGU PËRKATËS

Treg përkatës i produktit do të konsiderohet tregu i prodhimit, grumbullimit, përpunimit dhe eksportit të duhanit në vend. Tregu përkatës gjeografik do të konsiderohet tregu i brendshëm, pra territori i Republikës së Shqipërisë.

ANALIZA E TREGUT

Bazuar në ligjin nr. 8691, datë 16.11.2000 “Për prodhimin dhe tregtimin e duhanit dhe të cigareve”, i ndryshuar, grumbulluesit e duhanit rregullojnë marrëdhëniet me fermerët-kultivues, duke lidhur kontratat përkatëse të prodhimit/kultivimit dhe blerjes së duhanit.

Nga informacioni i grumbulluar gjatë procedurës hetimore rezulton se:

- Ndërmarrja “Mika Korça” SHA nuk ka shlyer ende kultivuesit për prodhimin e dy viteve të fundit 2015 – 2017 në zonën e Belshit/Dumresë, e cila konsiderohet zona më e madhe e prodhimit të duhanit në vend.
- Tregu i prodhimit, grumbullimit, përpunimit dhe eksportit të duhanit ka pasur hyrje të reja dhe pjesët e tregut kanë ndryshuar, duke mos paraqitur një qëndrueshmëri të tyre.
- Gjatë vitit 2016 në treg kanë ushtruar aktivitet 4 (katër) ndërmarrje: “Mika Korça”; “Sheldia Group”; “Shelqeti Kompani”; dhe “Dumrea Tabaco”. Në vitin 2017 në treg ka hyrë ndërmarrja e re “Seke Elbasan”, e cila ka zënë një pjesë të konsiderueshme të tregut të grumbullimit, por nuk ka realizuar asnjë eksport gjatë periudhës nën hetim. Gjithashtu, në vitin 2017 është licensuar edhe ndërmarrja “Albania Tabak” për të ushtruar aktivitet në tregun e grumbullimit dhe përpunimit të duhanit në vend.
- Ndërmarrja “Mika Korça” ka humbur ndjeshëm pjesën e saj të tregut dhe prej muajit prill 2017, ka ndërprerë aktivitetin e saj ekonomiko-financiar.
- Ndërmarrjet kanë aplikuar çmime blerje të ndryshme sipas kategorive të prodhuara dhe sipas cilësisë së produktit përfundimtar.

Për sa më sipër, ndërmarrja “Mika Korça” nuk është më ndërmarrja e vetme, e cila ushtron aktivitet në këtë treg duke mos zotëruar me pozitë dominuese. Tregu paraqet hyrje të ndërmarrjeve të reja duke mos vërejtur pengesa hyrjeje në tregun përkatës. Në këto kushte është rritur mundësia që fermerët prodhues të kenë mundësi zgjedhje për të shitur produktin e tyre.

Si konkluzion, pas vlerësimit të pjesëve të tregut, karakteristikave të produktit, konkurrencës potenciale, barrierave ligjore dhe krahasimit të çmimeve të produkteve, bazuar në nenin 8 të ligjit nr. 9121/2003, nuk plotësohen kriteret e pozitës dominuese nga asnjë prej ndërmarrjeve që operojnë në tregun përkatës.

PROBLEMATIKAT E TREGUT

Marrëdhëniet fermerë-grumbullues rezultojnë me problematika të shumta, të cilat konsistojnë në: vonesat në pagesa; mosrespektimin e kontratave me fermerët nga ana e ndërmarrjeve grumbulluese; grumbullimi, klasifikimi dhe vlerësimi i duhanit jashtë standarteve etj.

Ministria e Bujqësisë dhe Agjencia Kombëtare e Duhan-Cigareve për zgjidhjen e këtyre problemeve në mbështetje të fermerëve duhan-kultivues, që prej një viti ka ndërmarrë iniciativën për amendimin e ligjit që rregullon këtë fushë.

Projekt-ligji përkatës është përcjellë për mendim pranë Autoritetit të Konkurrencës në nëntor 2016, lidhur me të cilin Komisioni i Konkurrencës është shprehur me vendimin nr. 442, datë 22.11.2016 “Për disa rekomandime mbi projekt/ligjin “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr. 8691, datë 16.11.2000 “Për prodhimin dhe tregtimin e duhanit dhe të cigareve”, të ndryshuar.

Projekt-ligji nuk rezulton të jetë miratuar ende dhe problematikat e ngritura nga grupet e interesit, nga të cilat kanë marrë shkas edhe amendimet e propozuara në projekt-ligj, janë ngritur dhe janë konstatuar edhe gjatë këtij hetimi paraprak.

Me VKM nr. 37, datë 24.1.2018 "Për miratimin e programit të përgjithshëm analitik, të projekt-akteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2018", është parashikuar që nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, katërmujorin e dytë do të paraqitet për shqyrtim pranë Këshillit të Ministrave projekt/ligji "Për disa ndryshime e shtesa në ligjin nr. 8691, datë 16.11.2000 "Për prodhimin dhe tregtimin e duhanit dhe të cigareve", të ndryshuar".

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 8, nenin 24 shkronja d, nenin 26 dhe nenin 70, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Ti rekomandojë Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, që:

a) Në projekt-ligjin "Për disa ndryshime e shtesa në ligjin nr. 8691, datë 16.11.2000 "Për prodhimin dhe tregtimin e duhanit dhe të cigareve", të ndryshuar", të ketë në konsideratë:

— Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 438, datë 05.10.2016 "Mbi disa rekomandime dhe mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prodhimit, grumbullimit, përpunimit dhe eksportit të duhanit", si dhe;

— Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 442, datë 22.11.2016 "Për disa rekomandime mbi projekt-ligjin "Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr. 8691, datë 16.11.2000 "Për prodhimin dhe tregtimin e duhanit dhe të cigareve", të ndryshuar", i cili rekomandon që:

"Në projekt-ligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8691, datë 16.11.2000 "Për prodhimin dhe tregtimin e duhanit dhe të cigareve", të ndryshuar", të shtohet një dispozitë (në nenin 9 të projekt-ligjit, i cili bën ndryshime në nenin 21 të ligjit aktual, të shtohet një pikë) ku të përcaktohet bashkëpunimi i Agjencia Kombëtare e Duhan Cigares (AKDC) me Autoritetin e Konkurrencës në rastet kur dyshon për një sjellje të mundshme antikonkurruese të ndërmarrjeve që operojnë në tregun e prodhimit, grumbullimit, përpunimit dhe eksportit të duhanit."

2. Monitorimin nga ana e Autoritetit të Konkurrencës të tregut të prodhimit, grumbullimit, përpunimit dhe eksportit të duhanit, për periudhën nga data 1 dhjetor 2017 deri me 31 dhjetor 2018.

3. Mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prodhimit, grumbullimit, përpunimit dhe eksportit të duhanit, pasi në përfundim të kësaj procedure hetimore nuk u konstatuan shenja të kufizimit të konkurrencës në këtë treg, për periudhën nën hetim.

4. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 512, Datë 17.05.2018

“Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në ‘Tregun e qiradhënies të ambienteve për magazinimin dhe tregtimin e produkteve Agro-Ushqimore në qytetin e Tiranës’”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 17.05.2018, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Hapja e hetimit paraprak në tregun e qiradhënies të ambienteve për magazinimin dhe tregtimin e produkteve agro-ushqimore në qytetin e Tiranës.

Baza Ligjore: Neni 9, neni 24 shkronja d dhe neni 42, pika 1, i ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës “Mbi monitorimin në ‘tregun e qiradhënies të ambienteve për magazinimin dhe tregtimin e produkteve Agro-Ushqimore në qytetin e Tiranës’”,

VËREN SE:

Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës, bazuar në nenin 28, gërma a, të ligjit nr. 9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, në datën 02.05.2018, realizoi monitorimin në tregun e qiradhënies të ambienteve për magazinimin dhe tregtimin e produkteve Agro-Ushqimore në qytetin e Tiranës, me qëllim evidentimin nëse ka apo jo shenja të kufizimit të konkurrencës në këtë treg, në shkelje të nenit 9 të ligjit 9121/2003, i ndryshuar.

Ky treg administrohet nga shoqëria EKMA Albania Shpk, dhe është i vetmi treg i madh në qytetin e Tiranës që është furnizues edhe i pikave të pakicës për këto produkte. Në këtë treg janë të grumbulluar tregtarët e pikave të shumicës që shesin edhe me pakicë produktet agro-ushqimore por edhe produkte të tjera të konsumit të përditshëm. Shoqëria që menaxhon agro-ushqimor e përcakton vetë ambientin dhe nuk i jep mundësi tregtarit që të zgjedhë.

Gjithashtu në treg nga monitorimi rezultoi se disa tregtar ushtronin aktivitet në kamionë në ambientet e jashtme të këtij tregu, për arsye se nuk i kanë dhënë ambiente me qira. Për këto arsye kjo shoqëri mund të vendos në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë çmime të padrejta të blerjes ose shitjes ose kushte të padrejta të tregtimit që mund të bien ndesh me nenin 9 të ligjit 9121/2003.

Për sa më sipër, sjellja e ndërmarrjes që administron tregun e qiradhënies të ambienteve për magazinimin dhe tregtimin e produkteve Agro-Ushqimore në qytetin e Tiranës, mund të përbëjë kufizim, shtrembërim apo pengim të konkurrencës në kuptim të nenit 9 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 9, nenin 24 shkronja d, dhe nenin 42, pika 1, të ligjit nr. 9121, XIV / 2018

datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Hapjen e procedurës së hetimit paraprak në “Tregun e qiradhënies të ambienteve për magazinimin dhe tregtimin e produkteve Agro-Ushqimore në qytetin e Tiranës”.
2. Hetimi paraprak të përfshijë periudhën kohore nga 1.1.2017 deri në 1.5.2018.
3. Raporti i hetimit paraprak duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se 1 (një) muaj nga marrja e këtij vendimi.
4. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 514, Datë 17.05.2018

“Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e shërbimit të kontrollit teknik të detyrueshëm të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të tyre në Republikën e Shqipërisë, ndaj ndërmarrjes “SGS AUTOMOTIVE ALBANIA” SHPK”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 17.05.2018, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Hapja e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e shërbimit të kontrollit teknik të detyrueshëm të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të tyre në Republikën e Shqipërisë, ndaj ndërmarrjes “SGS AUTOMOTIVE ALBANIA” SHPK (SGS).

Baza Ligjore: Neni 8, neni 9 dhe neni 43, pika 1 e Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar (Ligji Nr. 9121/2003).

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës,

VËREN SE:

I. Procedura e ndjekur

1. Komisioni i Konkurrencës në bazë të nenit 42 të Ligjit Nr. 9121/2003, me Vendimin Nr. 497, datë 08.02.2018 “Për hapjen e hetimit paraprak në tregun e shërbimit të kontrollit teknik të automjeteve në Republikën e Shqipërisë”, vendosi hapjen e procedurës së hetimit paraprak, pasi mund të jemi përpara një abuzimi me pozitën dominuese nga ndërmarrja SGS, në kuptim të nenit 9, pika 2, gërma (ç) të Ligjit Nr. 9121/2003.
2. Në bazë të nenit 35 dhe 36 të Ligjit Nr. 9121/2003 dhe Autorizimit të Komisionit të Konkurrencës (Autorizim Inspektorësh), grupi i inspektimit, gjatë periudhës së hetimit ka kryer inspektimet e nevojshme pranë ndërmarrjes SGS.

II. Tregu përkatës

3. Tregu përkatës përfshin produktet që vlerësohen si të zëvendësueshme nga konsumatorët dhe operatorët, për sa u përket karakteristikave, çmimit dhe funksionit të tyre dhe që ofrohen ose kërkohen nga ndërmarrjet në një zonë gjeografike me kushte të njëjta konkurrence. Përkufizimi i tregut përkatës përfshin dy dimensione:
 - a) Tregu përkatës i produktit
 - b) Tregu përkatës gjeografik

4. Në përputhje me marrëveshjen koncesionare, tregu i shërbimit të kontrollit teknik të detyrueshëm të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të tyre është treg i modelit të centralizuar (i ndarë nga shërbimi i servisit), me një ndërmarrje të vetme të ofrimit të shërbimit, ku monopoli do të vazhdojë deri në vitin 2019, me mundësi rinegociimi për periudhën në vazhdim në këtë treg.
5. Tregu përkatës i produktit është tregu i shërbimit të kontrollit teknik të detyrueshëm të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të tyre.
6. Tregu përkatës gjeografik përfshin zonën në të cilën ofrohet shërbimi i kontrollit teknik të detyrueshëm të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të tyre, e cila përfshin territorin e Republikës së Shqipërisë.

III. Vlerësimi i pozitës dominuese

7. Në bazë të nenit 3, pika 5 të Ligjit Nr. 9121/2003, “Pozitë dominuese” është ajo fuqi ekonomike e mbajtur nga një ose më shumë ndërmarrje, që i jep atyre mundësinë për të penguar konkurrencën efektive në treg, duke i bërë ato të afta të veprojnë, për sa i takon ofertës ose kërkesës, në mënyrë të pavarur nga pjesëmarrësit e tjerë në treg, si konkurrentët, klientët ose konsumatorët.
8. Sipas Ligjit Nr. 9121/2003, pasja e një pozite dominuese nga një ndërmarrje në treg nuk është e ndaluar, por zotërimi i pozitës dominuese i jep ndërmarrjes një detyrim të veçantë për të mos abuzuar me këtë pozitë dominuese.
9. Një nga kriteret bazë, nga e cila fillon analiza e pozitës dominuese është pjesa e tregut që zënë ndërmarrjet në tregun përkatës. Praktikisht më të mira të vendeve të Bashkimit Evropian sugjerojnë se sa më e madhe të jetë pjesa e tregut dhe sa më e gjatë periudha që ndërmarrja zotëron një pjesë të tillë tregu, aq më e mundur është që ky element të jetë një tregues i rëndësishëm për një pozicion dominues dhe të justifikojë në rrethana të caktuara ndërhyrjen e Autoritetit.
10. Në tregun përkatës, ndërmarrja SGS është e vetme duke zotëruar 100% të pjesëve të tregut të shërbimit të kontrollit teknik të detyrueshëm të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë, gjë e cila në kuptim të nenit 8 të Ligjit Nr. 9121/2003 përbën pozitë dominuese në tregun përkatës.

IV. Vlerësimi i sjelljes së ndërmarrjes në treg

11. Lidhur me tregun përkatës, Komisioni i Konkurrencës me Vendimin Nr. 416, datë 18.05.2016 “Për disa rekomandime për rishikimin e tarifave dhe mbi hapjen e tregut të shërbimit të kontrollit teknik të automjeteve”, ndër të tjera ka vendosur të rekomandojë që ndërmarrja SGS duhet të rishikojë dhe ndryshojë përmbajtjen e paragrafit të tretë, të Deklaratës-Tip që nënshkruhet nga klientët para dorëzimit të dokumentacionit të kërkuar, duke përcaktuar në të shkaktarin e dëmit si dhe vënien e tij përpara përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar.
12. Nga inspektimi i kryer në ndërmarrjen SGS dhe nga informacioni i depozituar pranë Autoritetit të Konkurrencës, në lidhje me rekomandimin për ndryshimin e paragrafit të tretë të Deklaratës –Tip, që nënshkruhet nga klientët, përpara dorëzimit të dokumentacionit të kërkuar për testimin e mjetit, në të cilën përcaktohet përgjegjësia për dëmin e shkaktuar, rezulton se ndërmarrja SGS nuk e ka marrë në konsideratë këtë rekomandim.
13. Ndërmarrja SGS shprehet se deklarata-tip, objekt i rekomandimit, ka efekt kufizimi përgjegjësie, vetëm për dëmet, që mund të vijnë si rezultat i keqfunksionimit të mjeteve motorike, si për shembull, nga problemet elektro-mekanike, motorike apo hidraulike në automjet.

14. Klientët pa nënshkrimin e kësaj deklarate-tip të përpiluar nga ndërmarrja SGS, nuk mund të kryejnë kontrollin teknik të detyrueshëm të mjetit të tyre. Në rast të moskryerjes së kontrollit teknik të mjetit, klienti nuk mund të përdorë mjetin e tij për qarkullim dhe për këtë arsye detyrohet ta nënshkruajë këtë deklaratë-tip, sipas përmbajtjes së miratuar nga ndërmarrja me pozitë dominuese SGS.
15. Kjo sjellje e ndërmarrjes me pozitë dominuese SGS në tregun përkatës, duke detyruar klientët e saj për të nënshkruar deklaratën-tip përpara kryerjes së kontrollit teknik të detyrueshëm të mjeteve për të përjashtuar nga përgjegjësia ndërmarrjen SGS për çdo dëmtim që mund ti shkaktohet mjetit gjatë kontrollit teknik, mund të përbëjë abuzim me pozitën dominuese në kuptim të nenit 9, pika 2, gërma (ç) të Ligjit Nr. 9121/2003.
16. Gjithashtu nga inspektimi rezulton se rekomandimet e dhëna me vendimin nr. 416 date 18.05.2016 “Për disa rekomandime për rishikimin e tarifave dhe mbi hapjen e tregut të shërbimit të kontrollit teknik të automjeteve”, për hapjen e pikave të tjera të shërbimit, nuk janë zbatuar nga koncesionari SGS edhe pse të ardhurat e realizuara nga koncesionari në vite e mundësojnë një investim të tillë.
17. Për sa më sipër sjellja e koncesionarit SGS teknik, mund të përbëjë abuzim me pozitën dominuese në kuptim të nenit 9, pika 2, gërma (ç) të Ligjit Nr. 9121/2003 (i ndryshuar).

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 8, nenin 9, pika 2, gërma (ç), nenin 24, (gërma d); nenin 26 dhe nenin 43, pika 1, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e shërbimit të kontrollit teknik të detyrueshëm të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të tyre në Republikën e Shqipërisë, ndaj ndërmarrjes “SGS AUTOMOTIVE ALBANIA” SHPK;
2. Raporti i hetimit të thelluar duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se 2 (dy) muaj nga dita e çeljes së këtij hetimi.
3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 517, Datë 22.05.2018

“Rekomandime lidhur me masat rregulluese në tregun e transportit ndërkombëtar detar të udhëtarëve dhe automjeteve”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 22.05.2018, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Mbi monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të Vendimit Nr. 349 datë 19.02.2015 “Për masat rregulluese dhe rekomandimet në tregun e transportit ndërkombëtar detar të udhëtarëve dhe automjeteve” dhe Vendimit Nr.467, datë 04.07.2017 “Për marrjen e disa masave për rregullimin e konkurrencës në tregun e transportit ndërkombëtar detar të udhëtarëve dhe automjeteve në portin e Vlorës dhe mbylljen e procedurës së hetimit paraprak”, të Komisionit të Konkurrencës.

Baza Ligjore: Nenet: 24, gërma d); 26 dhe 70 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar;

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës,

VËREN SE:

1. Në zbatim të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës Nr.467, datë 04.07.2017 “Për marrjen e disa masave për rregullimin e konkurrencës në tregun e transportit ndërkombëtar detar të udhëtarëve dhe automjeteve në portin e Vlorës dhe mbylljen e procedurës së hetimit paraprak”, Sekretariati ka realizuar një monitorim të këtij tregu, si dhe zbatimin e rekomandimeve të dhëna.
2. Komisioni i Konkurrencës nëpërmjet vendimit të mësipërm ka vendosur:
 - a) Detyrimin e ndërmarrjes “Northbay Transportes Marittimos Lda”, përfaqësuar nga “Gerveni Travel” SH.P.K, të zbatojë kushte të barabarta për veprime tregtare të njëjta me palët (shoqëritë e transportit rrugor që përdorin transportin detar nga Porti i Vlorës), për t’i vendosur në gjendje të favorshme konkurrence;
 - b) Në rast të mos zbatimit të pikës 1 të dispozitivit të këtij vendimi, ndërmarrjet ndëshkohen me gjobë deri në 10 % të xhiros vjetore për shkelje të rëndë të konkurrencës në zbatim të nenit 74, pika 1, gërma c) të ligjit nr. 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (të ndryshuar);
 - c) Monitorimin e tregut të transportit ndërkombëtar detar të udhëtarëve dhe automjeteve në portin e Vlorës për periudhën nga data 04.07.2017 deri më 04.01.2018, me qëllim verifikimin e sjelljes së Ndërmarrjes “Northbay Transportes Marittimos Lda” për zbatimin e detyrimit të vendosur sipas pikës 1 të dispozitivit të këtij vendimi;

T’i rekomandojë Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, që bazuar në Vendimin e Komisionit të XIV / 2018

Konkurrencës, Nr. 349, datë 19/02/2015 “Për masat rregulluese dhe rekomandimet në tregun e transportit ndërkombëtar detar të udhëtarëve dhe automjeteve”, të realizojë:

- a) Monitorimin e zbatimit të tarifave sipas njoftimeve dhe miratimit të MTI-së për secilin traget/linjë kryesisht gjatë sezonit të lartë;
- b) Sigurimin e të dhënave të detajuara mbi të gjitha kostot reale për shërbimin që ofrojnë operatorët;
- c) Monitorimin e mbajtjes së të dhënave ditore për tarifat e aplikuara për çdo biletë të shitur, si dhe mbajtjes së rekordeve të shitjeve të biletave nga ndërmarrjet që operojnë në treg.

Mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e transportit ndërkombëtar detar të udhëtarëve dhe automjeteve në portin e Vlorës;

3. Gjatë monitorimit në lidhje me këto rekomandime, Sekretariati nëpërmjet shkresës Nr.380, datë 29.09.2017 “Kërkesë për Informacion” dhe shkresës Nr. 542, datë 29.12.2017 “Kërkesë për Informacion” drejtuar shoqërisë “Gerverni Travel” SHPK ka siguruar informacion në lidhje me çmimin e shitjes së biletave të udhëtimit për pasagjerë, grup pasagjerësh, autobusë dhe mjete të tjera për periudhën e monitorimit.
4. Gjithashtu me shkresën Nr.138, datë 22.02.2018 “Në lidhje me rekomandimet e Autoritetit të Konkurrencës” drejtuar “Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë” është kërkuar informacion lidhur me zbatimin e rekomandimeve të dhëna për këtë institucion nëpërmjet VKK Nr. 467, datë 04.07.2017 “Për marrjen e disa masave për rregullimin e konkurrencës në tregun e transportit ndërkombëtar detar të udhëtarëve dhe automjeteve në portin e Vlorës dhe mbylljen e procedurës së hetimit paraprak”. Në lidhje me këtë kërkesë të Autoritetit të Konkurrencës nuk ka ardhur asnjë përgjigje nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.
5. Autoriteti i Konkurrencës, konstaton se mungesa e marrjes së masave nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga Komisioni i Konkurrencës në tregun e transportit ndërkombëtar detar të udhëtarëve dhe automjeteve me Vendimin Nr. 349, datë 19/02/2015 “Për masat rregulluese dhe rekomandimet në tregun e transportit ndërkombëtar detar të udhëtarëve dhe automjeteve”, si dhe Vendimin Nr. 467, datë 04.07.2017 “Për marrjen e disa masave për rregullimin e konkurrencës në tregun e transportit ndërkombëtar detar të udhëtarëve dhe automjeteve në portin e Vlorës dhe mbylljen e procedurës së hetimit paraprak”, ka krijuar konfuzion në funksionimin e këtij tregu duke e bërë të vështirë zbatimin e Ligjit Nr 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, (i ndryshuar) në këtë treg.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të neneve 24, (gërma d); 26 dhe 70, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të sjellë në vëmendje të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatim Vendimin Nr. 349 datë 19.02.2015 “Për masat rregulluese dhe rekomandimet në tregun e transportit ndërkombëtar detar të udhëtarëve dhe automjeteve” dhe Vendimin Nr.467, datë 04.07.2017 “Për marrjen e disa masave për rregullimin e konkurrencës në tregun e transportit ndërkombëtar detar të udhëtarëve dhe automjeteve në portin e Vlorës dhe mbylljen e procedurës së hetimit paraprak”, të Komisionit të Konkurrencës dhe brenda 60 ditëve të raportojë pranë Komisionit të Konkurrencës për zbatimin e këtyre Vendimeve.
2. Komisioni i Konkurrencës, për ecurinë e zbatimit të këtij Vendimi do të njoftojë Komisionin e Ekonomisë dhe Financat si dhe Komisionin për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, në Kuvendin e Shqipërisë.

3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për të ndjekur zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 518, Datë 22.05.2018

“Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifar për “Ujësjetllës Kanalizime Skrapar” SHA”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 22.05.2018, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifar për Ujësjetllës Kanalizime Skrapar SHA.

Baza Ligjore: Neni 24, gërma d) dhe f); neni 26; neni 69 dhe 70 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” (i ndryshuar).

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifar për Ujësjetllës Kanalizime Skrapar SHA,

VËREN SE:

Enti Rregullator i Ujit nëpërmjet shkresave nr. 117 prot., datë 20.02.2018 dhe nr. 110/2 prot, datë 30.04.2018, informon Autoritetin e Konkurrencës se me vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 9, datë 16.02.2018 ka filluar procedurën për shqyrtimin e aplikimit për ndryshim tarife të shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Skrapar SHA, e cila ka propozuar të aplikojë tarifa të unifikuara për zonën pas riorganizimit.

Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i informacionit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifar si dhe projekt-vendimit përkatës “Mbi miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë për shoqërinë Ujësjetllës Kanalizime Skrapar SHA”, rezultoi se:

Tarifat aktuale që aplikon Ujësjetllës Kanalizime Skrapar SHA për ujin e pijshëm për konsum publik janë miratuar me Vendimin nr. 10, datë 15.03.2010 të KKRR-së. Sipas UK niveli i tarifave në fuqi në raport me koston totale është i ulët.

Për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, aktualisht për konsumatorët familjar, shoqëria aplikon tarifa të diferencuara për zonën ekzistuese (Çorovodë, 27 lek/m³) dhe zonën shtesë (Poliçan, 37 lek/m³), tarifa këto të miratuara nga ERRU.

Nëpërmjet aplikimit UK Skrapar propozon unifikim të tarifave për të gjithë zonën sipas riorganizimit. Në këtë mënyrë, për konsumatorin familjar, në zonën ekzistuese tarifa rritet me XX lek/m³, duke pësuar një rritje prej XX%, ndërsa për zonën e re që shërbehet nga Ujësjetllësi Poliçan, tarifa zvogëlohet me XX lek/m³, duke pësuar një ulje prej XX% të tarifës.

Për konsumatorët jo familjar (buxhetor, privat) tarifa pëson një rritje prej XX% (buxhetor) dhe XX% (privat).

Për ujin e përdorur UK Skrapar aktualisht aplikon një tarifë prej 8 lek/m³ për të tre kategoritë e konsumatorëve, tarifë e cila propozohet të rritet në XX lek/m³, duke pësuar një rritje prej XX%.

Për zonën rurale pa matës, tarifa fikse për klientët familjar pa matës do të pësojë një rritje prej XX%. Për konsumatorët nga burimet alternative (kroje, sistem me vetërrjedhje) UK propozon një rritje nga XX në XX lek/muaj/klient (rreth XX%), me argumentimin e kostove shtesë që duhet të mbulojë UK për klorifikimin e ujit, si dhe riparimet eventuale të defekteve të cilat konsumatorët e këtyre fshatrave nuk janë në gjendjet t'i realizojnë vetë.

Nga analiza e bërë bazuar në metodologjinë për vendosjen e tarifave, lidhur me treguesit e performancës, për secilën prej tyre janë vendosur objektiva të arritshme sipas ERRU-së për vitin 2018, duke synuar përmirësimin e performancës së shërbimeve të ofruara.

Niveli i mbulimit të kostove O&M të UK është rreth 48%, duke vendosur ndërmarrjen në vështirësi financiare. Për pasojë, kjo ndërmarrje ka ende nevojë, për subvencione.

Ndërmarrja UK Skrapar nuk ka mundur të bëjë një ndarje veç e veç dhe sipas zonave të kostove të shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm nga shërbimi i kanalizimeve të ujërave të ndotura. Në këto kushte ERRU në analizën ekonomike financiare të saj ka marrë në konsideratë kostot totale së bashku për të dy shërbimet e ofruara.

Ndarja e kostove të këtyre shërbimeve do të siguronte një analizë më të saktë dhe vendosje të tarifave më të drejta. Për vlerësimin e kostove së arritshme të një ndërmarrjeje UK, rregullatori mund të përdor si bazë kostot e zonave (UK) të krahasueshme, duke siguruar edhe një arritje të fitimeve të arsyeshme. Kjo do të sjell gjithashtu vendosjen e tarifave në nivele minimale, duke siguruar që konsumatorët do të paguajnë çmimin e duhur për produktin dhe shërbimin që u ofrohet.

Duke qenë se niveli i kostove për vitin 2018 mbetet në të njëjtat nivele me ato të vitit 2017, duke mos pasur një rritje të tyre, subvencionet që do të përfitojë kjo ndërmarrje për mbulimin e kostove të O&M, si dhe investimet për përmirësimin e rrjetit të ujësjellësit, duhet të jenë transparente, të përshtatshme, efikase e fitimprurëse, dhe të nxitin reduktimin e kostove nga niveli aktual si dhe përdorimin në mënyrë efektive të burimeve ujore.

Nga ana tjetër informacioni mbi aplikimin për ndryshimin e tarifave nuk është bërë transparent në faqen e ERRU-së, duke mos u marrë në konsideratë rekomandimi i dhënë nga AK me anë të Vendimit Nr. 492, datë 28.12.2017 “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit dhe UKT në lidhje me ndryshimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimin e ujërave të ndotura”, pika I, gërma e).

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenet: 24, gërma d) e f); 69 dhe 70 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” (të ndryshuar), me propozim të Sekretariatit,

VENDOSI:

1. Të mos pranojë propozimin e bërë nga ERU për UK Skrapar, sipas shkresave nr. 117 prot., datë 20.02.2018 dhe nr. 110/2 prot, datë 30.04.2018, sepse dokumentacioni i paraqitur është i paplotë dhe i pamjaftueshëm për të realizuar vlerësimin e këtij rregullimi në kuadrin e reformës rregullatore sipas ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.
2. Tarifat që do të miratohen nga ERU për UK Skrapar të jenë të orientuara drejt kostos së shërbimeve për të cilat ato aplikohen, kosto të cilat duhet të jenë të nevojshme për marrjen e këtyre shërbimeve.
3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 520, Datë 31.05.2018

“Për dhënien e rekomandimeve për metodologjinë e përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 31.05.2018, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Mbi vlerësimin e procedurës për rishikimin e Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, miratuar me vendimin nr. 201, datë 04.12.2017, të Bordit të ERE”.

Baza Ligjore: Neni 24, shkronja d dhe f, neni 69 dhe 70 i ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës “Mbi vlerësimin e procedurës për rishikimin e Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, miratuar me vendimin nr. 201, datë 04.12.2017, të Bordit të ERE”,

VËREN SE:

Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës, bazuar në nenin 69 dhe 70 të ligjit nr. 9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, realizoi vlerësimin mbi ndryshimet e propozuara në Metodologjinë e përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, miratuar me vendimin nr. 201, datë 04.12.2017, të Bordit të ERE”.

Ndryshimi i propozuar në formulën për llogaritjen e çmimit përfundimtar për klientët e FMF, konsiston në përcaktimin e qartë të kostove administrative dhe një koeficienti për kthimin e riskut, i cili do përcaktohet për vitin, si dhe zgjatjen e afatit të shërbimit për klientët e FMF nga 60 dite në 2 vjet

Ndarja e OSHEE dhe krijimi i tre shoqërive të reja aksionere: Furnizimi i Shërbimit Universal, Furnizuesi i Tregut të Lirë dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do të krijojë kushtet për përcaktimin më të qartë të detyrave edhe ndarjen e kostove për çdo shoqëri duke mundësuar përcaktimin e qartë të shpenzimeve operative/administrative për çdo kWh të furnizuar nga FSHU që më tej çon në përcaktimin e qartë të kostove për FMF.

Qëllimi kryesor është alokimi i shpenzimeve administrative nga OSHEE për aktivitetin e FMF dhe përcaktimi i kostove për disbalancat për klientët e FMF.

Gjithashtu, neni 3 i Ligjit nr. 7/2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 43/2015, “Për sektorin e Energjisë Elektrike”, amendoi nenin 86 të Ligjit nr. 43/2015 duke përcaktuar se: “Klienti fundor që furnizohet nga furnizuesi i mundësisë së fundit dhe që në kuptim të nenit 109, të këtij ligji, del për herë të parë në treg të

liberalizuar, është i detyruar të lidhë një kontratë furnizimi me një furnizues të ri, brenda 2 viteve nga fillimi i kontratës së furnizimit nga furnizuesi i mundësisë së fundit.

Zgjatja e afatit të shërbimit për klientët e FMF nga 60 dite në 2 vjet krijon mundësinë për furnizuesin e FMF të parashikimit dhe planifikimit të sasisë së energjisë së blerë për një periudhë afatgjate dhe me çmime të favorshme.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24 shkronja d dhe f, nenin 69 dhe 70, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. T’i rekomandojë Entit Rregullator të Energjisë që në metodologjinë e përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit të marri në konsideratë që:
 - a) Kostot administrative për llogaritjen e çmimit të furnizuesit të mundësisë së fundit të jenë të arsyeshme, aktuale dhe transparente;
 - b) Çdo rishikim i çmimeve afatgjata (vjetore) të bëhet mbi bazën e të dhënave reale, të cilat duhet të jenë transparente duke siguruar një çmim jo diskriminues.
2. ERE të informojë Autoritetin e Konkurrencës mbi zbatimin e këtij rekomandimi sipas pikës 1 brenda 90 ditësh.
3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM
Nr. 522, Datë 07.06.2018

“Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifar për “Ujësjellës Gramsh” SHA”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 07.06.2018, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifar për Ujësjellës Gramsh SHA.

Baza Ligjore: Neni 24, germa d) dhe f); neni 26; neni 69 dhe 70 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” (i ndryshuar).

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifar për Ujësjellës Gramsh SHA,

VËREN SE:

Enti Rregullator i Ujit nëpërmjet shkresave nr. 117 prot., datë 20.02.2018 dhe nr. 247/2 prot, datë 30.04.2018, informon Autoritetin e Konkurrencës se me vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 8, datë 16.02.2018 ka filluar procedurën për shqyrtimin e aplikimit për ndryshim tarife të shoqërisë Ujësjellës Gramsh SHA, e cila ka vendosur të aplikojë për zonat e reja të njëjtin nivel tarifar që aplikon në zonën ekzistuese.

Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i informacionit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifar si dhe projekt-vendimit përkatës “Mbi miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë për shoqërinë Ujësjellës Gramsh SHA”, rezultoi se:

Gjatë vitit 2017 Ujësjellës Gramsh SHA, në zonat e reja të shërbimit, ka aplikuar tarifat ekzistuese të shoqërisë miratuar me Vendimin e KKRR “Mbi tarifat e ujit për konsum publik për shoqërinë Ujësjellës Gramsh Sha”, konkretisht prej 32 lekë/m³ uji i pijshëm, dhe 60 lekë tarifa fikse për mirëmbajtje rrjeti, për konsumator familjar.

Kërkesa e shoqërisë “Ujësjellës Gramsh” SHA nuk synon rritje të nivelit të tarifave por vetëm miratim nga ERRU për vendosjen dhe aplikimin e tyre sipas tarifave ekzistuese edhe për zonat e reja të shërbimit që janë transferuar pranë kësaj shoqërie.

Nga analiza e bërë bazuar në metodologjinë për vendosjen e tarifave, lidhur me treguesit e performancës, për secilën prej tyre janë vendosur objektiva të arritshme sipas ERRU-së për vitin 2018, duke synuar përmirësimin e performacës së shërbimeve të ofruara.

Nga analiza ekonomiko financiare rezulton se ndërmarrja Ujësjellës Gramsh SHA ka një bilanc pozitiv me rreth 4.8 milion lekë, dhe është një shoqëri e cila edhe pas riorganizimit arrin të mbulojë kostot e operim mirëmbajtjes në masën 100% dhe ato totale 86%.

ERRU ka gjykuar se shoqëria për vitin 2018 duhet të mbajë kostot në nivelin e vitit 2017, vit gjatë të cilit ajo ka mbuluar kostot edhe për pjesën e zgjeruar të zonës së shërbimit, duke mos marrë parasysh propozimin e shoqërisë për kosto më të larta. Nëse gjatë vitit 2018 do të mund të realizohet i njëjti nivel kostosh me atë të vitit 2017, *treguesi i mbulimit të kostove totale do të jetë 92%, ndërsa ai i mbulimit të O&M do të jetë 104%*.

ERRU gjykon se Ujësjetllës Gramsh ka ende nevojë, për subvencione për mbulimin e kostove totale. Gjithashtu ndërmarrja ka nevojë për investime emergjente dhe afat mesme, pasi rrjeti është shumë i amortizuar, sidomos në disa zona në të cilat mjaft asete kanë dalë jashtë përdorimit.

Tarifat nuk duhet të tejkalojnë kostot e tyre, duke shmangur fitimin monopol të ndërmarrjes. Rregullatori duhet të stimuloj uljen e këtyre kostove, arritjen e fitimeve të arsyeshme, si dhe vendosjen e tarifave në nivele minimale, duke siguruar që konsumatorët të paguajnë çmimin e duhur për produktin dhe shërbimin që u ofrohet.

Duke qenë se niveli i kostove për vitin 2018 mbetet në të njëjtat nivele me ato të vitit 2017, subvencionet që do të përfitojë kjo ndërmarrje për mbulimin e kostove, si dhe investimet për përmirësimin e rrjetit të ujësjetllës, duhet të jenë sa më transparente, të përshtatshme, efikase e fitimprurëse, dhe të nxitin reduktimin e kostove nga niveli aktual si dhe përdorimin në mënyrë efektive të burimeve ujore.

Nga ana tjetër informacioni mbi aplikimin për ndryshimin e tarifave nuk është bërë transparent në faqen e ERRU-së, duke mos u marrë në konsideratë rekomandimi i dhënë nga AK me anë të Vendimit Nr. 492, datë 28.12.2017 “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit dhe UKT në lidhje me ndryshimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimin e ujërave të ndotura”, pika I, gërma e).

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenet: 24, germa d) e f); 69 dhe 70 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” (të ndryshuar), me propozim të Sekretariatit,

VENDOSI:

I. T’i rekomandojë Entit Rregullator të Ujit si vijon:

1. Në projekt-vendimin “Mbi miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë për shoqërinë Ujësjetllës Gramsh SHA”, në pjesën e rekomandimeve të dhëna ndërmarrjes Ujësjetllës Gramsh të shtohet një pikë ku të përcaktohet:
 - a) Detyrimi i ndërmarrjes Ujësjetllës Gramsh SHA për të bërë sa më transparente subvencionet që do të përfitojë për mbulimin e kostove, si dhe investimet për përmirësimin e rrjetit të ujësjetllës, duke i përdorur ato në mënyrë sa më të përshtatshme, efikase e fitimprurëse, me qëllim reduktimin e kostove nga niveli aktual dhe përdorimin në mënyrë efektive të burimeve ujore.
2. Tarifat të jenë të orientuara drejt kostos së shërbimeve për të cilat ato aplikohen, duke siguruar që konsumatorët të paguajnë çmimin e duhur për produktin dhe shërbimin që u ofrohet.
3. ERRU të publikojë dhe bëjë transparente brenda 30 ditëve nga dalja e këtij vendimi të gjithë informacionin mbi aplikimin për ndryshimin e tarifave duke marrë në konsideratë rekomandimin e dhënë nga AK me anë të Vendimit Nr. 492, datë 28.12.2017 të Komisionit të Konkurrencës.

II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 523, Datë 07.06.2018

“Për hapjen e hetimit paraprak në tregun e tregëtimit të produkteve ushqimore të cilat mbartin markën “Conad” në Republikën e Shqipërisë, konkretisht ndaj ndërmarrjes “Conad Albania” SHPK”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 07.06.2018, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Shqyrtimi i Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm mbi monitorimin e realizuar pranë disa supermarketeve “Conad”.

Baza Ligjore: Nenet: 8, 9, 24, gërma d); 26, 42, pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar (Ligji Nr. 9121/2003).

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës,

VËREN SE:

Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës, në zbatim të nenit 28, të Ligjit 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”- i ndryshuar, dhe duke marrë shkas nga një kërkesë për informacion (RFI), në rrjetin OECD-GVH/RCC, ku shkëmbehet eksperiencia ndërkombëtare ndërmjet vendeve anëtare, ku ka pasur interesim lidhur me rastin ku rrjetet e supermarketeve kanë pozitë dominuese dhe mund të abuzojnë me pozitën dominuese, realizoi një monitorim në datë 10.5.2018 në rrjetin e supermarketeve “Conad”.

Gjatë monitorimit rezultoi se rrjeti i supermarketeve “Conad”, funksionon nëpërmjet shoqërisë “Conad Albania” SHPK, si shoqëri qendrore dhe si distributor i vetëm në Shqipëri për importin e tregtimin me shumicë të produkteve me markë “Conad” dhe sipas pretendimeve të përfaqësuesit të shoqërisë “Conad Albania SHPK” ka edhe një marrëveshje me shoqërinë italiane “Conad Adriatico Societa Cooperativa”, për të drejtën e markës “Conad”, reklamimin e produkteve si dhe mallrat/produktet që janë të detyrueshme për tu tregtuar nën këtë markë.

Në Shqipëri operojnë rreth 40 (dyzet) markete “Conad”, ku 11 (njëmbëdhjetë) prej tyre administrohen nga shoqëria “Food Trade” SHPK (ndërmarrje me ortak të përbashkët me “Conad Albania” SHPK), ndërsa pjesa tjetër e marketeve administrohen nëpërmjet kontratave “franchising” nga bashkëpunëtorë të tjerë.

Edhe pse marketet veprojnë si entitete juridik të pavarur, vendimet në lidhje me sasinë, çmimin e shitjes dhe fushatat e marketingut përcaktohen vetëm nga shoqëria “Conad Albania” SHPK.

Sjellja e ndërmarrjes “Conad Albania” SHPK, si shoqëri qendrore dhe si distributor i vetëm në Shqipëri për importin e tregtimin me shumicë të produkteve me markë “Conad”, mund të përbëjë kufizim të konkurrencës bazuar në nenin 9 pika 2, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” (i ndryshuar).

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të neneve 9, 24, (gërma d), 42, pika 1, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e tregëtimit të produkteve ushqimore të cilat mbartin markën “Conad” në Republikën e Shqipërisë, konkretisht ndaj ndërmarrjes “Conad Albania” SHPK;
2. Hetimi paraprak të përfshijë periudhën kohore nga 1 Janar 2017 deri në 30 Prill 2018;
3. Raporti i hetimit paraprak duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se 3 (tre) muaj nga dita e çeljes së këtij hetimi.
4. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM
Nr. 525, Datë 14.06.2018

“Për mbylljen e hetimit paraprak në tregun e transportit ajror të pasagjerëve ndaj ndërmarrjes Austrian Airlines dhe dhënien e disa rekomandimeve”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 14.06.2018, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Mbyllja e procedurës së hetimit paraprak në tregun e transportit ajror të pasagjerëve ndaj ndërmarrjes Austrian Airlines dhe dhënia e disa rekomandimeve..

Baza Ligjore: Neni 8, Neni 9, Neni 24, shkronja (d), neni 26, neni 43, pika (5), neni 70 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar (Ligji Nr. 9121/2003).

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit të hetimit paraprak në tregun e transportit ajror të pasagjerëve ndaj ndërmarrjes Austrian Airlines; relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm mbi raportin e hetimit paraprak,

VËREN SE:

I. Procedura e ndjekur

1. Komisioni i Konkurrencës bazuar në konkluzionet e vlerësimit të ankesave, në mbështetje të nenit 9, dhe nenit 42 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, si dhe nenit 12 të Rregullores “Për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës” dhe nenit 4 të Rregullores “Për procedurat hetimore të Autoritetit të Konkurrencës”, me anë të Vendimit Nr. 490, datë 20.12.2017 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e transportit ajror të udhëtarëve ndaj ndërmarrjes Austrian Airlines”, vendosi hapjen e procedurës së hetimit paraprak për të parë nëse ka ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës. Periudha e hetimit e përcaktuar nga Komisioni i Konkurrencës në Vendimin e mësipërm është nga 1 Janar 2017 deri në 31 Dhjetor 2017.
2. Në bazë të nenit 35 dhe 36 të Ligjit Nr. 9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar dhe Autorizimit të Komisionit të Konkurrencës Nr. 423/2 datë 20.12.2017 “Autorizim Inspektorësh”, grupi i inspektimit , gjatë periudhës së hetimit ka kryer inspektim në ndërmarrjen “Austrian Airlines”.
3. Për mbledhjen e fakteve dhe të dhënave të nevojshme në lidhje me hetimin, bazuar në nenet 33 dhe 34 të Ligjit Nr. 9121/2003, është kërkuar informacion nga ndërmarrja Austrian Airlines, Dega në Shqipëri e Austrian Airlines AG dhe nga Autoriteti i Aviacionit Civil.

II. Tregu Përkatës

4. Për përcaktimin e tregut të shërbimit të transportit ajror të pasagjerëve, përdoret përqasja e çiftit pikë origjine/pikë destinacioni (O&D). Sipas këtij vlerësimi, çdo kombinim i pikës së origjinës dhe pikës së destinacionit, i parë nga këndvështrimi i zëvendësueshmërisë së kërkesës nga konsumatori, konsiderohet

si treg me vete. Për të vlerësuar se kur një çift O&D formon një treg përkatës produkti, merren parasysh jo vetëm linjat direkte ndërmjet dy aeroporteve, por edhe alternativa të tjera që shihen si zëvendësues të afërt me këto linja.

5. Niveli i zëvendësueshmërisë së fluturimeve indirekte me fluturimet direkte varet kryesisht nga kohëzgjatja e fluturimit. Si rregull i përgjithshëm, sa më i gjatë fluturimi, aq më i lartë është probabiliteti që fluturimet indirekte të përbëjnë një alternativë konkurruese në raport me fluturimet direkte.
6. Sa i përket rrugëve të shkurtra, Komisioni Evropian ka marrë në konsideratë se fluturimet indirekte zakonisht nuk përbëjnë një alternativë konkurruese për fluturimet direkte, pasi konsumatorët në të vërtetë preferojnë fluturime direkte.
7. Tregu përkatës i produktit përfshin shërbimin e transportit ajror të pasagjerëve në linjën direkte Tiranë-Vjenë dhe anasjelltas.
8. Duke marrë në konsideratë fluturimet direkte dhe ato indirekte mund të themi se për rrugët e shkurtra, megjithëse ekzistojnë alternativa të ndryshme për të realizuar fluturimet e tyre nga vendi i origjinës (Tirana) me destinacion (Vjenën), nuk ka zëvendësueshmëri nga ana e kërkesës.
9. Lidhur me zëvendësueshmërinë nga ana e ofertës, kompanitë ajrore i kanë të përcaktuara itineraret e fluturimit, pra hapësira ajrore është e ndarë midis linjave të ndryshme që operojnë, prandaj në këtë kuptim mund të themi që nuk kemi zëvendësueshmëri nga ana e ofertës.
10. Zona gjeografike e shërbimit të transportit ajror për qëllim të këtij hetimi është territori i Republikës së Shqipërisë.

III. Struktura e Tregut

11. Në linjën direkte Tiranë - Vjenë (TIA-VIE) , Vjenë - Tiranë (VIE-TIA) sipas përcaktimit të tregut përkatës, Austrian Airlines operon e vetme.
12. Nga vlerësimi i faktorëve që ndikojnë në hyrjen e aktorëve të rinj në këtë treg rezulton se hyrja në këtë treg kërkon kushte specifike të veçanta, të cilat janë të njëjta me kushtet e kompanive ajrore të vendeve të Bashkimit Evropian. Bazuar në Kodin Ajror, çdo operator duhet të pajiset me një licencë operimi që lëshohet nga AAC. Për përfitimin e kësaj licence, operatori ajror duhet të plotësojë disa kritere. Pra, tregu përkatës ka barriera të larta hyrjeje.
13. Duke marrë parasysh: pjesën e tregut, pengesat e hyrjes në treg, fuqinë kundërvepruese të blerësve dhe karakteristikat e tjera të tregut përkatës, rezulton se në mbështetje të nenit 3, pika 5 dhe nenit 8 të Ligjit Nr. 9121/2003, ndërmarrja Austrian Airlines AG ka pozitë dominuese në linjën direkte Tiranë – Vjenë dhe anasjelltas.

IV. Analiza e Sjelljes së Ndërmarrjes Austrian Airlines

IV.1. Sjellja në lidhje me çmimin e vendosur

14. Analiza e sjelljes së ndërmarrjes në lidhje me çmimin e shitjes biletave ka për qëllim të vlerësojë nëse ndërmarrja vendos në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë çmime të padrejta blerje, shitje ose kushte të tjera të padrejta tregtimi. Për këtë arsye, janë vlerësuar çmimet mesatare dhe çmimet e biletave sipas klasit të fluturimit dhe taksat, por nga ana e ndërmarrjes nuk disponohet një shifër që t'i korrespondojë termit kosto mesatare përkatësisht për biletat Tiranë – Vjenë dhe anasjelltas.
15. Struktura e çmimit përbëhet nga tarifa neto dhe taksat (Tax + YQ) ku taksat janë taksa të vendosura në Shqipëri si taksa të sigurimit të aeroportit në të dy vendet, të shërbimit të pasagjerit, të cilat ndryshojnë në varësi të shtetit, si dhe taksa që mbulon shpenzimet për karburant dhe sigurinë për kompaninë ajrore, e

cila ndryshon në varësi të klasit të rezervimit.

16. Taksat përfaqësojnë deri 25% të çmimit total të biletës. Tarifa mesatare e çmimit të biletave Tiranë - Vjenë dhe anasjelltas për vitin 2016 është 156 Euro, ndërsa për vitin 2017 kjo tarifë është 161 euro. Rritja e lehtë e çmimit mesatar të biletave nga 2016 në 2017 sipas ndërmarrjes Austrian Airlines vjen nga rritja e kërkesave në fluturim për këtë linjë.
17. Nga krahasimi i çmimit të biletave të avionit me vendet e rajonit për udhëtime vajtje-ardhje rreth datave 4 deri në 11 qershor drejt të njëjtit destinacion, Vjenës me të njëjtën linjë ajrore Austrian Airlines, për nisje nga Tirana është 190 Euro, përkatësisht 7.7 % më i lartë se mesatarja e vendeve të rajonit (pa Shqipërinë). Prishtina rezulton të jetë vendi me çmimin e biletave më të lartë në rajon me 198 Euro, ose 12.3 % më të lartë se mesatarja. Çmimin më të lirë të biletave drejt Vjenës e ka Shkupi (160 Euro), ose 9.3 % më lirë se mesatarja e rajonit. Ndërsa Mali i Zi e ka çmimin pothuajse sa mesatarja e rajonit. Gjithashtu duhet marrë parasysh se Shqipëria dhe Kosova kanë vetëm një aeroport, Maqedonia dhe Mali i Zi kanë nga dy aeroporte, ndërsa Kroacia ka tetë aeroporte.
18. Linja ajrore Austrian Airlines ofron udhëtim direkt për në Vjenë (pa ndalesë), ndërsa linjat e tjera që e ofrojnë këtë mundësi janë udhëtime jo direkte (me një ndalesë) dhe në rastin tonë janë të pazëvendësueshme. Pra udhëtimi direkt me Austrian Airlines mbetet alternativa më e mirë për konsumatorët duke qenë se është linjë direkte dhe nuk ka humbje kohe për ta. Gjithashtu duhet patur parasysh se në formimin e çmimit duhen marrë në konsideratë dhe taksat aeroportuale dhe çmimi i karburantit të avionëve që janë të ndryshme në vende të ndryshme.
19. Në bazë të nenit 11 të Kodit Ajror, përcaktohet qartë se çmimet e transportit ajror vendosen lirisht nga tregu dhe transportuesit ajrorë informojnë publikun për të gjitha tarifat ajrore për pasagjerët, postën dhe ngarkesat. Në këtë nen përcaktohet dhe detyrimi për AAC që të marrë të gjitha masat e nevojshme për parandalimin e tarifave dhe praktikave diskriminuese, çmimeve abuzivisht të larta si rezultat i një pozite dominuese dhe çmimeve abuzivisht shumë të ulëta.
20. Për të bërë të zbatueshme kontrollin e tarifave shumë të ulëta apo shumë të larta që aplikohen nga transportuesit ajror me pozitë dominuese në treg ndaj pasagjerëve, në zbatim të këtij neni të Kodit Ajror, Ministri duhet të miratojë rregullore për përcaktimin e rregullave të hollësishme.
21. Lidhur me miratimin e akteve nënligjore nga ana e Ministrit i është kërkuar informacion AAC me shkresën Nr. 67 Prot., datë 29.01.2018. Sipas përgjigjes së AAC nga ana e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë është miratuar vetëm Udhëzimi Nr. 17, datë 02.09.2010 “Mbi rregullat e zbatueshme të operimit në fushën e shërbimeve ajrore”. Ndërsa lidhur me ekzistencën e ndonjë metodologjie për llogaritjen e kostove të ndërmarrjeve, për krahasimin me çmimet abuzivisht të larta dhe praktikat diskriminuese, AAC në përgjigjen e saj shprehet se nuk ka një metodologji e tillë.
22. Pra, për të parandaluar tarifat dhe praktikat diskriminuese, çmimet abuzivisht të larta si rezultat i një pozite dominuese dhe çmimet abuzivisht shumë të ulëta, AAC duhet të kryejë analizën e çmimeve të aplikuara nga transportuesi ajror me pozitë dominuese në treg, siç është rasti i ndërmarrjes Austrian Airlines. Pas kryerjes së analizës së çmimit të aplikuar nga ndërmarrja me pozitë dominuese, AAC duhet të vlerësojë nëse kjo ndërmarrje aplikon çmime shumë të larta apo shumë të ulëta në treg. Siç përmendëm edhe më lart, AAC nuk disponon një metodologji për të kryer këtë vlerësim. Gjithashtu, edhe në Udhëzimin e Ministrit Nr. 17, datë 02.09.2010 “Mbi rregullat e zbatueshme të operimit në fushën e shërbimeve ajrore”, nuk është parashikuar rasti i aplikimit të çmimeve abuzivisht të larta apo çmimeve abuzivisht shumë të ulëta, si rezultat i një pozite dominuese të ndërmarrjes në treg.

IV.2. Vendosja e kushteve të pafavorshme konkurrence

23. Fakti që ndërmarrja ka pozitë dominuese nuk është e ndaluar në këndvështrimin e praktikës së Komisionit Evropian dhe gjykimit nga gjykatat. Megjithëse pozita dominuese nuk është e ndaluar, një sipërmarrës që zë një pozitë të tillë ka një përgjegjësi të veçantë për sjelljen e tij.
24. Në bazë të informacionit të depozituar nga ndërmarrja Austrian Airlines, rezulton se kjo ndërmarrje ka kryer disa herë shitje të biletave mbi kapacitetin e avionit, duke sjellë si pasojë anulimin e udhëtimit për personat mbi kapacitet. Kjo sjellje e ndërmarrjes Austrian Airlines është hasur edhe në ankesat e paraqitura nga pasagjerët pranë Autoritetit të Konkurrencës. Duke kryer shitje të biletave mbi kapacitetin e avionit, ndërmarrja Austrian Airlines në momentin e paraqitjes së pasagjerëve pranë sporteleve të saj në aeroport për të kryer check-in, pa njoftim paraprak iu komunikon se nuk mund të udhëtojnë sipas biletave të prera dhe linjës përkatëse, duke kryer në këtë mënyrë një diskriminim midis pasagjerëve.
25. Pra, ndërmarrja Austrian Airlines, për shkak të pozitës së saj dominuese në treg, duhet të jetë sa më transparente me pasagjerët e saj dhe t'i informojë ata (paraprakisht kur është e mundur) për anulimin e fluturimit, ndryshimin e orarit etj. Gjithashtu, ndërmarrja Austrian Airlines, si i vetmi transportues ajror për linjën direkt Tiranë – Vjenë dhe anasjelltas, duhet të minimizojë sa më shumë tregtimin e biletave mbi kapacitetin e avionit, sidomos gjatë sezonit të lartë, për të shmangur ndonjë sjellje të mundshme antikonkurrese në treg, e cila i vendos pasagjerët në kushte të pafavorshme konkurrence.
26. Transportuesi ajror (Austrian Airlines) duhet t'i sigurojë pasagjerëve që pranë kontrollit të biletave (check-in desk) dhe pranë portës së hyrjes (boarding gate) të kenë një njoftim të lexueshëm dhe të qartë lidhur me të drejtat e tyre, i cili duhet të ekspozohet në mënyrë të dallueshme për pasagjerët.
27. Duke qenë se ndërmarrja Austrian Airlines është me pozitë dominuese në tregun përkatës, duke operuar e vetme në linjën direkte, fuqia kundërvepruese e pasagjerëve është e vogël për t'u marrë në konsideratë dhe potenciali i një hyrje të re në treg siç tregohet edhe nga madhësia e tregut përkatës dhe madhësia e pengesave të hyrjes është e ulët, ndërmarrja ka detyrim të veçantë për sjelljen e saj ndaj pasagjerëve për të mos i vendosur në gjendje të pafavorshme konkurrence, prandaj është e nevojshme mbikëqyrja e sjelljes së ndërmarrjes në vazhdimësi për të analizuar kushtet e tregut për zhvillimin e konkurrencës së lirë dhe efektive në kuptim të nenit 28 të Ligjit Nr. 9121/2003.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 8, nenin 9, nenin 24, shkronja (d), nenin 26, nenin 28, nenin 43, pika (5), nenin 70 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Mbylljen e procedurës së hetimit paraprak ndaj ndërmarrjes Austrian Airlines;
2. Austrian Airlines, ndërmarrja me pozitë dominuese në tregun përkatës, e cila ka një detyrim të veçantë për t'u sjellë në treg ndaj pasagjerëve të saj, për të mos i vendosur ata në kushte të pafavorshme konkurrence, në zbatim të Kodit Ajror dhe Udhëzimit Nr. 1, datë 26.02.2013 “Për kompensimin dhe asistencën e pasagjerëve në rastin e mospranimit në bord të avionit dhe anulimit ose vonesës gjatë fluturimeve”, duhet:
 - a) Të sigurojë që pranë kontrollit të biletave (check-in desk) dhe pranë portës së hyrjes (boarding gate) të ketë një njoftim të lexueshëm dhe të qartë, i cili duhet të ekspozohet në mënyrë të dallueshme për pasagjerët, ku të përmbahet teksti: *“Nëse juve ju refuzohet hipja në avion ose nëse fluturimi juaj anulohet ose vonohet të paktën dy orë, pyesni te kontrolli i biletave për rregulloren ku shprehen të drejtat tuaja, veçanërisht të drejtat që kanë të bëjnë me kompensimin dhe asistencën”;*

- b) T'i paraqesë çdo pasagjeri të dëmtuar nga refuzimi i hipjes në avion ose anulimi i fluturimit një njoftim me shkrim ku ti bëhet e ditur e drejta e kompensimit dhe e asistencës, sipas përcaktimeve të Udhëzimit Nr. 1, datë 26.02.2013;
 - c) Çdo pasagjeri të dëmtuar nga vonesa prej të paktën 2 orësh, ti paraqesë një njoftim të ngjashëm ku të evidentohet e drejta për kompensim dhe t'i vihet në dispozicion formulari i ankesës;
 - d) T'i sigurojë çdo pasagjeri në një formë të shkruar informacion të hollësishëm për kontaktim me organin kompetent;
 - e) Të minimizojë sa më shumë të jetë e mundur tregtimin e biletave mbi kapacitetin e avionit, për të shmangur ndonjë sjellje të mundshme antikonkurruese në treg dhe në mënyrë të veçantë gjatë sezonit të lartë.
3. Në rast të mos përmbushjes së detyrimeve të përcaktuara në pikën (II) të këtij vendimi, ndërmarrja Austrian Airlines ndëshkohet me gjobë deri në 10 % të xhiros vjetore për shkelje të rëndë të konkurrencës në zbatim të nenit 74, pika 1, gërma (c) të Ligjit Nr. 9121/2003.
4. Monitorimin e sjelljes së ndërmarrjes Austrian Airlines që operon në tregun e transportit ajror për një periudhë 1 vjeçare, duke raportuar pranë Autoritetit të Konkurrencës çdo 4 muaj në lidhje me çmimet që ka aplikuar, numrin e ankesave që ka patur, raste të overbooking.
5. Autoritetit të Aviacionit Civil në zbatim të Kodit Ajror dhe Udhëzimit Nr. 1, datë 26.02.2013 "Për kompensimin dhe asistencën e pasagjerëve në rastin e mospranimit në bord të avionit dhe anulimit ose vonesës gjatë fluturimeve", t'i rekomandohet që brenda një afati 90 ditor:
- a) Të kryejë analizën e çmimeve të aplikuara nga transportuesit ajrorë me pozitë dominuese në treg, për të parandaluar tarifat dhe praktikat diskriminuese, çmimet abuzivisht të larta si rezultat i një pozite dominuese dhe çmimet abuzivisht shumë të ulëta.
 - b) Të hartojë një metodologji për llogaritjen e kostove të ndërmarrjeve për krahasimin e çmimeve abuzivisht të larta dhe praktikave diskriminuese.
 - c) Të kërkojë nga të gjithë transportuesit ajrorë që të sigurojnë të gjithë informacionin e nevojshëm dhe të qartë për pasagjerët, i cili duhet të ekspozohet në një mënyrë të dallueshme për pasagjerët.
 - d) Të kërkojë nga organi menaxhues i aeroportit të sigurojë që informacioni i përgjithshëm mbi të drejtat e udhëtarëve të shfaqet në mënyrë të qartë dhe të dukshme brenda aeroportit me qëllim që të sigurojë që pasagjerët e pranishëm në aeroport të informohen për anulimin e fluturimit të tyre dhe për të drejtat e tyre.
6. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 527, Datë 14.06.2018

“Për dhënie rekomandimi Entit Rregullator të Energjisë lidhur me kontratën tip për shitblerje të energjisë elektrike ndërmjet OSHEE dhe PPE”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 14.06.2018, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Energjisë mbi ndryshimet e propozuara nga OSHEE SH.A lidhur me kontratën tip për shitblerje të energjisë elektrike ndërmjet OSHEE SH.A dhe prodhuesve me përparësi të energjisë elektrike.

Baza Ligjore: Neni 24, germa d) dhe f); neni 26; neni 69 dhe 70 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” (i ndryshuar).

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit mbi ndryshimet e propozuara nga OSHEE SH.A lidhur me kontratën tip për shitblerje të energjisë elektrike ndërmjet OSHEE SH.A dhe prodhuesve me përparësi të energjisë elektrike,

VËREN SE:

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është depozituar shkresa e ERE me nr. 289 prot., datë 29.03.2018, nëpërmjet së cilës kërkohet mendimi i Autoritetit të Konkurrencës mbi vendimin e Bordit të ERE nr.74, dt. 26.03.2018 mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e disa shtesave dhe ndryshimeve të propozuara nga shoqëria OSHEE SH.A në “kontratën tip për shitblerje të energjisë elektrike ndërmjet OSHEE SH.A dhe prodhuesve me përparësi të energjisë elektrike”.

Në vijim lidhur me ndryshimet e propozuara si më sipër, Shoqata Shqiptare e Energjisë së Rinovueshme (AREA) ka përcjell pranë AK-së komentet e saj në lidhje me sugjerimet e OSHEE për ndryshime në kontratën tip të shitblerjes së energjisë për prodhuesit me prioritet, protokolluar pranë AK-së me nr. 144/2 prot, datë 31.05.2018.

Nga shqyrtimi i shtesave dhe ndryshimeve të propozuara, rezulton se:

Kontratat e shitblerjes së energjisë elektrike ndërmjet OSHEE SH.A dhe prodhuesve me përparësi të energjisë elektrike do të lidhen me një afat të gjatë prej 15 vjetësh dhe me një çmim të përcaktuar nga ERE, çmim i cili nuk do të ndryshojë për periudhën e kontratës.

Kjo mënyrë përcaktimi bie në kundërshtim me vetë periudhën një vjeçare të miratimit të çmimeve nga ERE, konkretisht sipas vendimit nr. 120, datë 27.07.2017 "Mbi përcaktimin e çmimeve të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla gjeneruese fotovoltaike me kapacitet të instaluar deri ne 2 mW dhe eolike me kapacitet te instaluar deri ne 3 mW". Gjithashtu kjo është pasqyruar edhe në nenin 11 “Çmimi” të kontratës tip, pikën shtesë (pika 4), ku përcaktohet shprehimisht se: “ERE përcakton dhe miraton me vendim brenda vitit aktual çmimin e shitjes së energjisë për vitin pasardhës”.

Nga vlerësimi i vlerësimi i legjislacionit përkatës rezulton se:

Ligji i ri 7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme” parashikon skema mbështetjeje për PPE sipas Kontratës për Diferencë, të cilat do të kenë një kohëzgjatje maksimale prej 15 vjetësh. Kontratat për diferencë do të jepen nëpërmjet një procesi konkurrues. Mbështetja jepet në formën e një shpërblimi për arritjen e çmimit të caktuar, si një shtesë mbi çmimin e referencës. Masat mbështetëse për prodhimin e energjisë elektrike nga burime të rinovueshme, në çdo rast jepen në përputhje me legjislacionin në fuqi për ndihmën shtetërore.

Mbështetja sipas kontratës për diferencë nuk zbatohet për prodhuesit me përparësi: me kapacitet të instaluar të energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla gjeneruese fotovoltaike deri në 2 mw dhe me kapacitet të instaluar deri në 3 mw për energjinë e erës. Çmimi i blerjes së energjisë elektrike nga këta prodhues me përparësi, në bazë të nenit 10, pika 3 të Ligjit nr. 7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, caktohet nga ERE.

ERE ka detyrimin e përcaktimit të çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era, në përputhje me metodologjinë e miratuar me VKM nr. 369, datë 26.04.2017, “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era”, në përputhje me çmimin e mesatarizuar për vitin 2017, sipas parashikimeve të kësaj metodologjie.

Sipas pikës 2 të Vendimit të ERE nr. 120, duke filluar nga viti 2018, ERE, në bazë të grumbullimit të të dhënave, përsa i përket kostove reale të investimit, për investimet në vijim, nëse rezultojnë të ndryshme nga parashikimet e VKM nr. 369 datë 26.4.2017, “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era”, merr përsipër t’i propozojë MEI përmirësimin dhe rishikimin e kësaj VKM-je.

Bazuar sa më sipër duke qenë se mënyra e përcaktimit të çmimit dhe afatet e kontratave të shitblerjes së energjisë midis OSHEE dhe PPE janë të përcaktuara paraprakisht në ligj, VKM-në për miratimin e metodologjisë si dhe vendimet e ERE, me argumentimet përkatëse të konsideruara të qëndrueshme për fazën fillestare të fillimit të funksionimit të burimeve të energjisë së rinovueshme nga dielli dhe era, nevojitet një pasqyrim më i qartë i këtyre kushteve në kontratë.

Për sa i përket çmimit të shitblerjes së energjisë elektrike, ai nuk mund të jetë i pandryshueshëm për gjithë periudhën e kontratës, maksimumi 15 vjet, pasi kjo jo vetëm që bie në kundërshtim me vetë periudhën një vjeçare të miratimit të çmimeve sipas metodologjisë së miratuar me VKM nr. 369 datë 26.4.2017, si dhe vendimit të ERE nr. 120, datë 27.07.2017 “Mbi përcaktimin e çmimeve të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla gjeneruese fotovoltaike me kapacitet të instaluar deri në 2 mw dhe eolike me kapacitet të instaluar deri në 3 mw”, por mund të përbëjë rrisht për konkurrencën në treg.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenet: 24, germa d) e f); 69 dhe 70 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrotjtjen e Konkurrencës” (të ndryshuar), me propozim të Sekretariatit,

VENDOSI:

1. T’i rekomandojë Entit Rregullator të Energjisë, si vijon:

- a) Në kontratën e shitblerjes së energjisë midis OSHEE dhe PPE të pasqyrohen drejt parashikimet ligjore lidhur me afatin e kontratave dhe rregullimin e çmimit duke e orientuar atë drejt kostove reale të investimeve, bazuar në kthimin e arsyeshëm të vlerës së tyre, dhe me një kohëzgjatje të arsyeshme.

2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 531, Datë 25.06.2018

“Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes EKMA Albania SHPK, në tregun e qiradhënies së ambienteve për magazinimin dhe tregtimin e produkteve Agro-Ushqimore në qytetin e Tiranës”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 25.06.2018, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Shqyrtimin e “Raportit mbi hetimin paraprak në tregun e qiradhënies së ambienteve për magazinimin dhe tregtimin e produkteve Agro-Ushqimore në qytetin e Tiranës”.

Baza Ligjore: Neni 9, neni 24, shkronja d, neni 26 dhe neni 43, pika 1, i ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit mbi hetimin paraprak në tregun e qiradhënies së ambienteve për magazinimin dhe tregtimin e produkteve Agro-Ushqimore në qytetin e Tiranës,

VËREN SE:

I. Procedura e ndjekur

1. Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës, bazuar në nenin 28, germa a, të ligjit Nr. 9121/2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", i ndryshuar, në datën 02.05.2018, realizoi monitorimin në tregun e qiradhënies së ambienteve për magazinimin dhe tregtimin e produkteve Agro-Ushqimore në qytetin e Tiranës, me qëllim evidentimin nëse ka apo jo shenja të kufizimit të konkurrencës në këtë treg, në shkelje të nenit 9 të ligjit 9121/2003, i ndryshuar.
2. Në përfundim të monitorimit, Komisioni i Konkurrencës bazuar në nenin 9, nenin 24 shkronja d, dhe nenin 42, pika 1, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës" (i ndryshuar), me Vendimin Nr. 512, datë 17.05.2018 vendosi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e qiradhënies së ambienteve për magazinimin dhe tregtimin e produkteve Agro-Ushqimore në qytetin e Tiranës, për periudhën kohore nga 1.1.2017 deri në 1.5.2018, për të vlerësuar nëse ka ose jo shenja të kufizimit të konkurrencës, sipas parashikimeve të Ligjit Nr. 9121/2003.
3. Në zbatim të vendimit të mësipërm të Komisionit të Konkurrencës, bazuar në nenet 35 dhe 36 të Ligjit Nr. 9121/2003 dhe Autorizimit të Komisionit të Konkurrencës Nr. 327, datë 22.05.2018 "Autorizim inspektorësh", Inspektorët e Autoritetit, gjatë periudhës së hetimit paraprak proceduan me kryerjen e inspektimeve pranë ndërmarrjes EKMA Albania SHPK, e cila ushtron veprimtarinë e saj në tregun e qiradhënies së ambienteve për magazinimin dhe tregtimin e produkteve Agro-Ushqimore në qytetin e Tiranës.

4. Për mbledhjen e fakteve dhe të dhënave të nevojshme në lidhje me hetimin, bazuar në nenin 34 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", i ndryshuar, gjatë periudhës së hetimit paraparak është kërkuar informacion nga Bashkia Tiranë me anë të shkresës nr. 365 prot, datë 05.06.2018.

II. Analiza e konkurrencës

II.1. Tregu përkatës

5. Në zbatim të Ligjit Nr. 9121 datë 28.07.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", i ndryshuar, tregu përkatës përfshin tregun e produkteve dhe tregun gjeografik.
6. Dhënia me qira e ambienteve, magazinave dhe vendeve me qëllim tregtimin e produkteve agro ushqimore në qytetin e Tiranës ushtrohet nga ndërmarrja EKMA Albania SHPK, e cila operon e vetme në këtë treg. Në këto kushte për tregtarët e shumicës nuk ka një alternativë tjetër për të tregtuar produktet e tyre, si rrjedhojë nuk ka zëvendësueshmëri nga ana e kërkesës.
7. *Tregu përkatës të produktit do të konsiderojmë shërbimin e qiradhënies së ambienteve me qëllim magazinimin dhe tregtimin me shumicë të produkteve Agro-Ushqimore në qytetin e Tiranës.*
8. Zona gjeografike e shërbimit të qiradhënies së ambienteve për magazinimin dhe tregtimin me shumicë të produkteve agro-ushqimore është territori i qytetit të Tiranës, për pasojë *tregu përkatës gjeografik në rastin tonë përfshin qytetin e Tiranës.*

II.2 Vlerësimi i Pozitës Dominuese

9. Sipas Ligjit, pasja e një pozite dominuese nga një ndërmarrje në treg nuk është e ndaluar, por zotërimi i pozitës dominuese i jep ndërmarrjes një detyrim të veçantë për të mos abuzuar me këtë pozitë dominuese.
10. Nga hetimi rezulton se ndërmarrja EKMA Albania operon e vetme, pra ka pozitë dominuese përsa i përket pjesëve të tregut.
11. Referuar Udhëzimit Nr. 11, datë 2.7.2014 "Për vendndodhjen dhe kushtet e tjera të tregjeve të shitjes me shumicë" të Ministrit të Bujqësisë dhe Vendimit të Këshillit Bashkiak Tiranë Nr.19, datë 09.04.2015 "Për miratimin e kriterëve për vendndodhjen dhe kushtet e tjera të tregjeve të produkteve agro - ushqimore të shitjes me shumicë në Bashkinë e Tiranës", kriteret e vendosura për vendndodhjen dhe kushtet e tjera të tregjeve të produkteve agro - ushqimore të shitjes me shumicë në Bashkinë e Tiranës kanë shërbyer si barriera hyrëse për ndërmarrjet e interesuara për të operuar në këtë treg. Gjithashtu pozita e konsoliduar e ndërmarrjes EKMA Albania SHPK në treg, qëndrueshmëria e pjesëve të tregut në vite (duke zotëruar 100% të tregut përkatës si e vetmja ndërmarrje), si dhe investimet që duhen për ndërtimin e këtyre tregjeve, përbëjnë barriera të larta në hyrje në tregun përkatës.
12. Sipas bilancit të ndërmarrjes, vlerës së shitjeve në tregun përkatës, ndërmarrja EKMA Albania ka fuqi ekonomike e financiare, e cila mund të shkaktojë kufizime të mundshme të konkurrencës në tregun përkatës.
13. Nisur nga pjesa e tregut, pengesat e hyrjes në treg, fuqia kundërvepruese e blerësve, fuqia ekonomike dhe financiare e ndërmarrjes dhe karakteristikat e tjera të tregut përkatës, rezulton se në mbështetje të nenit 3, pika 5 dhe nenit 8 të Ligjit Nr. 9121 datë 28.07.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", i ndryshuar, si dhe Udhëzimit "Për vlerësimin e pozitës dominuese dhe abuzimit me pozitën dominuese", ndërmarrja EKMA Albania SHPK ka pozitë dominuese në shërbimin e dhënies me qira të ambienteve për magazinimin dhe tregtimin me shumicë të produkteve Agro-Ushqimore në qytetin e Tiranës.

II.3 Sjellja e ndërmarrjes në treg

14. Analiza e sjelljes së ndërmarrjes në tregun e dhënies me qira të ambienteve për magazinimin dhe tregtimin e produkteve Agro-Ushqimore në qytetin e Tiranës, ka për qëllim të vlerësojë nëse ndërmarrja vendos në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë çmime të padrejta blerje, shitje ose kushte të tjera të padrejta tregtimi.
15. Çmimi standard për magazinat e dhëna me qira është 1200 lekë/m², të cilat përbëjnë XX % të numrit total të magazinave që ka në dispozicion tregu Agro - Ushqimor. Një numër prej XX magazinash apo XX% të totalit të magazinave kanë një çmim prej 1000 lekë/m², XX magazina kanë një çmim prej 1300 lekë/m², ndërsa XX magazina ose XX% e tyre kanë çmime nga 1350 – 1500 lekë/m². Për sa më sipër çmimet e ambienteve të dhëna me qira variojnë nga 1000 në 1500 lekë/m² dhe varen nga vendi/pozicioni i magazinës, kërkesë-oferta, marrëdhëniet kontraktore me qiramarrësin.
16. Tregu ka dhe vende për furgonat dhe kamionat dhe stenda bananeje, të cilat kanë çmim të përcaktuar, përkatësisht janë XX vende për furgonat në magazinë me një çmim prej 70,000 lekë/muaj, XX vende për furgonat jashtë me një çmim prej 50,000 lekë/muaj, XX vende kamionash jashtë me një çmim prej 60,000 lekë/muaj dhe XX stenda bananesh me një çmim prej 50,000 lekë/muaj.
17. Ndërmarrja EKMA ALBANIA SHPK jep me qira ambientet për magazinimin dhe tregtimin e produkteve Agro-Ushqimore nëpërmjet kontratave të lidhura me tregtarët e këtyre produkteve.
18. Kushtet e kontratës janë të detyrueshme për tu zbatuar nga qiramarrësi dhe variojnë nga çmimi i qirasë, i cili ndryshon sipas kushteve dhe vendndodhjes së ambienteve të marra me qira. Ndryshim ka dhe në kushtin e garancisë (nga 1 në 3 muaj), dhe penaliteteve (nga 1,000 lekë për çdo ditë vonesë në 10,000 lekë penalitet fikse), të cilat gjithashtu variojnë në varësi të ambientit, formës së tregtimit (furgon, kamion, stendë, magazinë), etj.
19. Në kontratë janë parashikuar garancitë dhe penalitetet e sipërcituara, ndërsa për pjesën e detyrimeve të qiradhënësit nuk parashikohet asnjë formë kompensimi për qiramarrësin. Kontrata nuk parashikon asnjë afat për njoftim të qiramarrësit në rastet kur qiradhënësi prish kontratën dhe e nxjerr qiramarrësin nga tregu, duke vepruar në mënyrë të njëanshme. Zgjidhja e njëanshme e kësaj kontrate nga ana e qiradhënësit e bën të vështirë mbrojtjen e qiramarrësit, duke ndikuar drejtpërdrejtë në marrëdhënien dhe kushtet ndërmjet tyre.
20. Sa më sipër, kushtet e përcaktuara në kontratë janë kushte që sigurojnë dhe japin garanci vetëm për qiradhënësin, ndërsa për qiramarrësin nuk jepet asnjë garanci në rast të prishjes së njëanshme të kontratës nga ana e qiradhënësit, ndërmarrjes EKMA Albania SHPK. Kontrata vjen si rezultat i faktit që është i vetmi treg shumice që operon në Tiranë, duke mos siguruar asnjë mbrojtje për qiramarrësin ndaj asnjë forme abuzimi të mundshëm nga ndërmarrja që zotëron tregun.
21. Për organizimin dhe funksionimin e tregut nuk ka një rregullore të mirëpërcaktuar dhe miratuar, mbi bazën e së cilës të mund të monitorohet sjellja e ndërmarrjes me pozitë dominuese që vepron e vetme në tregun e qiradhënies së ambienteve për magazinimin dhe tregtimin e produkteve Agro-Ushqimore në qytetin e Tiranës.
22. Mbajtja e një pozite dominuese e ngarkon ndërmarrjen me një përgjegjësi të veçantë, për sjelljen e saj, veçanërisht në vendosjen në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të çmimeve të padrejta apo të kushteve të tjera të padrejta të tregtimit; kufizimin e prodhimit, tregjeve ose zhvillimit teknik; zbatimin e kushteve të pabarabarta për veprime tregtare të njëjta me palët, duke i vendosur ato në gjendje të pafavorshme konkurrence; vendosjen e kushteve për lidhjen e kontratave me palët e tjera, që këto të fundit të pranojnë detyrime shtesë, të cilat, për vetë natyrën e tyre ose sipas praktikave tregtare, nuk kanë lidhje me objektin e kontratave në fjalë.

Referuar analizës së tregut të qiradhënies së ambienteve për magazinimin dhe tregtimin e produkteve Agro-Ushqimore në qytetin e Tiranës, rezulton se sjellja e ndërmarrjes me pozitë dominuese EKMA Albania SHPK, mund të përbëjë abuzim me pozitën dominuese referuar nenit 9 të Ligjit Nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, me pasoja për konkurrencën në treg.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 9, nenin 24 shkronja d, nenin 26 dhe nenin 43, pika 1, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Hapjen e Procedurës së Hetimit të Thelluar ndaj ndërmarrjes "EKMA Albanian" SHPK, në tregun e qiradhënies së ambienteve për magazinimin dhe tregtimin e produkteve Agro-Ushqimore në qytetin e Tiranës.
 2. Hetimi i Thelluar do të përfshijë periudhën kohore nga 01.01.2017 deri në 01.05.2018.
 3. Raporti i hetimit të thelluar duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se data 31 Korrik 2018.
 4. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e këtij vendimi të gjitha palëve të interesuara.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 538, Datë 20.07.2018

“Për disa rekomandime për rritjen e konkurrencës në tregun e shërbimit të transportit ajror në Republikën e Shqipërisë”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 20.07.2018, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Shqyrtimi i Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm mbi monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të Komisionit të Konkurrencës.

Baza ligjore: Nenet: 24, gërma d); 26 dhe 70 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës,

VËREN SE:

1. Bazuar në ligjin nr. 9312, datë 11.11.2004 “Për ratifikimin e marreveshjes së koncesionit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe shoqërisë koncesionare "Tirana Airport Partners" SHPK, për ndertimin, vënien në punë, operimin dhe mirëmbajtjen e Aeroportit Ndërkombëtar "Nënë Tereza", Tiranë dhe për dhënien e disa stimuljeve kësaj shoqërie koncesionare”, Aeroporti Ndërkombëtar i Tiranës (TIA), është aeroporti i vetëm në Republikën e Shqipërisë me anë të cilit operojnë shoqëritë ajrore të fluturimit të licensuara për realizimin e transportit ajror të pasagjerëve.
2. Me anë të ligjit nr. 55/2016 “Për ratifikimin e ndryshimit të marrëveshjes së koncesionit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe shoqërisë koncesionare “Tirana Airport Partners” SHPK, për ndertimin, vënien në punë, operimin dhe mirëmbajtjen e Aeroportit Ndërkombëtar “Nënë Tereza”, Tiranë, ratifikuar me ligjin nr. 9312, datë 11.11.2004, kompania koncesionare në varësi të përmbushjes së kushteve dhe detyrimeve nga Qeveria Shqiptare të përcaktuara në këtë Amendament, ka shprehur vullnetin të heqë dorë, në masën e përcaktuar në këtë Amendament, nga e drejta e ekskluzivitetit për fluturimet ndërkombëtare (kargo dhe pasagjerë).
3. Në këmbim të heqjes dorë të ekskluzivitetit palët në marrëveshje bien dakord se klauzola 2.2 “Afati” do të amendohet dhe do të lexohet si më poshtë:
 - a) Koncesioni jepet për një afat kohor prej 22 (njëzet e dy) vitesh, duke filluar nga data e fillimit (Afati i koncesionit). Në rast se ndonjë aeroport apo aeroporte, përveç Aeroportit të Kukësit, fillon operimin (për fluturime tregtare (që për këtë qëllim do të thotë data në të cilën kryhet fluturimi i parë tregtar) në Republikën e Shqipërisë përpara datës 23 prill 2025 (operimi i një aeroporti të ri tregtar), afati i koncesionit do të zgjatet dhe zgjatja e afatit të koncesionit nuk do të tejkalojë limitin maksimal prej 4.5 (katër pikë pesë) vite në total).

4. Komisioni i Konkurrencës pasi ka vlerësuar se në këndvështrimin e konkurrencës, TIA ka pozicion monopol në ofrimin e shërbimeve aeroportuale dhe se tarifën e aeroportit TIA janë më të larta se të njëjtat tarifa të krahasuara me vendet e rajonit, nëpërmjet vendimit nr. 308, datë 21.02.2014 “Për disa rekomandime për rritjen e konkurrencës në tregun e shërbimit të transportit ajror”, ka vendosur t’i rekomandojë OSHA që:
 - a) Në zbatim të pikës 19. 2, gërma (a), të Kontrates se Koncesionit të Aeroportit Ndërkombëtar në cilësinë e Organit Shtetror të Autorizuar dhe në bashkëpunim me shoqërinë koncensionare të rishikojnë Pagesat për Shërbimet e Aeroportit siç parashikohet çdo tre vjet.
 - b) Për shkak të pozicionit të kompanisë koncensionari si i vetmi ofrues i shërbimeve ndërkombëtare të transportit të pasagjerëve, OSHA të hartojë dhe aprovojë një metodologji/rregullore për vendosjen e tarifave të aeroportit, si edhe tarifën të jenë të orientuara drejt kostos.
5. Gjithashtu, me anë të VKK 391, datë 24.12.2015 “Për disa rekomandime në lidhje me draft amendamentin e Marrëveshjes së Koncesionit të lidhur me datë 15 Tetor 2004 ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Tirana International Aeroport SHPK”, Komisioni i Konkurrencës në pikën 3 të tij ka kërkuar edhe njëherë nga OSHA zbatimin e vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr.308, datë 21.02.2018 “Për disa rekomandime për rritjen e konkurrencës në tregun e shërbimit të transportit ajror”.
6. Referuar deklaratës për shtyp të publikuar në datë 02.07.2018 në faqen zyrtare të internetit të “Tirana International Airport”, TIA informon se: “ TIA dëshiron të rikonfirmojë se vazhdon të zbatojë tarifën e miratuara me ligj nga Qeveria Shqiptare që në vitin 2005 – vit kur filloi koncensionimi – dhe këto tarifa nuk janë rritur asnjëherë”.
7. Nga sa më sipër, konstatohet se OSHA dhe Koncesionari nuk kanë zbatuar detyrimin ligjor të parashikuar në pikën 19. 2, gërma (a), të Kontrates se Koncesionit, si dhe nuk kanë marrë në konsideratë rekomandimet e dhëna nga Autoriteti i Konkurrencës lidhur me rishikimin e pagesave për shërbimet e Aeroportit, siç parashikohet çdo tre vjet, si dhe hartimin dhe aprovimin e metodologjive/rregulloreve për vendosjen e tarifave të aeroportit, të cilat duhet të jenë të orientuara drejt kostos duke kufizuar konkurrencën në zbatim të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, (i ndryshuar) në këtë treg.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të neneve 24, (gërma d); 26 dhe 70 pika 2, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", i ndryshuar,

VENDOSI:

1. T’i rekomandojë Këshillit të Ministrave, që t’i kërkojë Organit Shtetëror të Autorizuar (OSHA):
 - a) Në zbatim të pikës 19. 2, gërma (a), të Kontrates se Koncesionit të Aeroportit Ndërkombëtar në cilësinë e Organit Shtetror të Autorizuar dhe në bashkëpunim me shoqërinë koncensionare të rishikojnë Pagesat për Shërbimet e Aeroportit siç parashikohet çdo tre vjet.
 - b) Për shkak të pozicionit të kompanisë koncensionari si i vetmi ofrues i shërbimeve ndërkombëtare të transportit të pasagjerëve, OSHA të hartojë dhe aprovojë një metodologji/rregullore për vendosjen e tarifave të aeroportit, si edhe tarifën të jenë të orientuara drejt kostos.
2. T’i kërkojë Komisionit të Ekonomisë dhe Financave dhe Komisionit për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, mbështetjen Tuaj për të bërë të mundur zbatimin e rekomandimeve të këtij Vendimi.
3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 541, Datë 04.09.2018

“Për një ndryshim në vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr. 531, datë 25.06.2018 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes "EKMA Albania" SHPK, në tregun e qiradhënies së ambienteve për magazinimin dhe tregtimin e produkteve Agro-Ushqimore në qytetin e Tiranës””

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 04.09.2018, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Për një ndryshim në vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr. 531, datë 25.06.2018 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes "EKMA Albania" SHPK, në tregun e qiradhënies së ambienteve për magazinimin dhe tregtimin e produkteve Agro-Ushqimore në qytetin e Tiranës”.

Baza Ligjore: Neni 9, Neni 24, shkronja (d), neni 26 dhe neni 43 i Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar (Ligji Nr. 9121/2003).

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm mbi procedurën e hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes "EKMA Albania" SHPK, në tregun e qiradhënies së ambienteve për magazinimin dhe tregtimin e produkteve Agro-Ushqimore në qytetin e Tiranës,

VËREN SE:

- I.** Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të Ligjit Nr. 9121/2003, me anë të Vendimit Nr. 531, datë 25.06.2018 "Mbi hapjen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes "EKMA Albania" SHPK, në tregun e qiradhënies së ambienteve për magazinimin dhe tregtimin e produkteve Agro-Ushqimore në qytetin e Tiranës", vendosi hapjen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes "EKMA Albania" SHPK, në tregun e qiradhënies së ambienteve për magazinimin dhe tregtimin e produkteve Agro-Ushqimore në qytetin e Tiranës, për periudhën kohore nga 01.01.2017 deri në 01.05.2018. Sipas pikës 3 të këtij vendimi, Raporti i hetimit të thelluar duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se data 31 Korrik 2018.
- II.** Në zbatim të vendimit të mësipërm të Komisionit të Konkurrencës, bazuar në nenet 35 dhe 36 të Ligjit Nr. 9121/2003 dhe Autorizimit të Komisionit të Konkurrencës Nr. 327, datë 22.05.2018 "Autorizim inspektorësh", u kryen inspektime pranë ndërmarrjes EKMA Albania SHPK.
- III.** Për mbledhjen e fakteve dhe të dhënave të nevojshme në lidhje me hetimin, bazuar në nenet 33 dhe 34 të Ligjit nr. 9121/2003 janë kërkuar të dhëna dhe informacion nga: Bashkia Tiranë dhe Ndërmarrja "EKMA Albania" SHPK.
- IV.** Koha e mbetur në dispozicion është e pamjaftueshme për përpunimin, vlerësimin dhe kryerjen e analizave të thelluara lidhur me sjelljen së ndërmarrjes EKMA Albania SHPK në tregun e qiradhënies së ambienteve

për magazinimin dhe tregtimin e produkteve Agro-Ushqimore në qytetin e Tiranës, duke bërë të pamundur përfundimin e procedurave dhe dorëzimin e raportit të hetimit të thelluar brenda afatit.

- V. Komisioni i Konkurrencës çmon se realizimi i plotë i procedurave të hetimit të thelluar me qëllim analizimin e sjelljes së ndërmarrjes EKMA Albania SHPK, është i domosdoshëm për të siguruar një vendimarrje objektive.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 9, nenin 24, shkronja (d), nenin 26 dhe nenin 43 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr. 531, datë 25.06.2018 "Mbi hapjen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes "EKMA Albania" SHPK, në tregun e qiradhënies së ambienteve për magazinimin dhe tregtimin e produkteve Agro-Ushqimore në qytetin e Tiranës", pika "3", të ndryshohet si vijon:

“3. Raporti i hetimit të thelluar duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se data 12 Tetor 2018.”

2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM
Nr. 542, Datë 04.09.2018

“Për marrjen e masave të përkohshme për rivendosjen e konkurrencës në tregun e qiradhënies së ambienteve për magazinimin dhe tregtimin e produkteve agro-ushqimore në qytetin e Tiranës”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 04.09.2018, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Shqyrtimi i “Relacionit për marrjen e masës së përkohshme ndaj ndërmarrjes “EKMA ALBANIA” SHPK në tregun e qiradhënies së ambienteve për magazinimin dhe tregtimin e produkteve Agro-Ushqimore në qytetin e Tiranës”.

Bazë ligjore: Neni 9 pika 1, 24, shkronja (d), neni 26, neni 44, pika 1 dhe 2, dhe neni 61, shkronja d), të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar (Ligji Nr. 9121/2003),

Ligjin Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës për marrjen e masës së përkohshme ndaj ndërmarrjes “EKMA ALBANIA” SHPK në tregun e qiradhënies së ambienteve për magazinimin dhe tregtimin e produkteve Agro-Ushqimore në qytetin e Tiranës”.

VËREN SE:

I. Procedura e ndjekur:

1. Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës, bazuar në nenin 28, germa a, të ligjit Nr. 9121/2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", i ndryshuar, realizoi një monitorim në tregun e qiradhënies së ambienteve për magazinimin dhe tregtimin e produkteve Agro-Ushqimore në qytetin e Tiranës, me qëllim evidentimin nëse ka apo jo shenja të kufizimit të konkurrencës në këtë treg, në shkellje të nenit 9 të ligjit 9121/2003, i ndryshuar.
2. Në përfundim të monitorimit, Komisioni i Konkurrencës bazuar në nenin 9, nenin 24 shkronja d, dhe nenin 42, pika 1, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës" (i ndryshuar), me Vendimin Nr. 512, datë 17.05.2018 vendosi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e qiradhënies së ambienteve për magazinimin dhe tregtimin e produkteve Agro-Ushqimore në qytetin e Tiranës.
3. Në përfundim të hetimit paraprak Komisioni i Konkurrencës konkludoi se: sjellja e ndërmarrjes me pozitë dominuese EKMA Albania SHPK, në tregun e qiradhënies së ambienteve për magazinimin dhe tregtimin e produkteve Agro-Ushqimore në qytetin e Tiranës, mund të përbëjë abuzim me pozitën dominuese referuar nenit 9 të Ligjit Nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, me pasoja për konkurrencën në treg.
4. Për sa më sipër, Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të Ligjit Nr. 9121/2003, me anë të Vendimit Nr.

531, datë 25.06.2018 vendosi hapjen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes "EKMA Albania" SHPK, në tregun e qiradhënies së ambienteve për magazinimin dhe tregtimin e produkteve Agro-Ushqimore në qytetin e Tiranës.

5. Në zbatim të vendimit të mësipërm të Komisionit të Konkurrencës, bazuar në nenet 35 dhe 36 të Ligjit Nr. 9121/2003 dhe Autorizimit të Komisionit të Konkurrencës Nr. 327, datë 22.05.2018 "Autorizim inspektorësh", u kryen inspektime ndërmarrjes EKMA Albania SHPK.
6. Për mbledhjen e fakteve dhe të dhënave të nevojshme në lidhje me hetimin, bazuar në nenet 33 dhe 34 të Ligjit nr. 9121/2003 janë kërkuar të dhëna dhe informacion nga: Bashkia Tiranë dhe Ndërmarrja "EKMA Albania" SHPK.

II. Analiza e konkurrencës

II.1 Tregu përkatës

7. Në zbatim të Ligjit Nr. 9121 datë 28.07.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", i ndryshuar, tregu përkatës përfshin tregun e produkteve dhe tregun gjeografik.
8. Dhënia me qira e ambienteve, magazinave dhe vendeve me qëllim tregtimin e produkteve agro-ushqimore në qytetin e Tiranës ushtrohet nga ndërmarrja EKMA Albania SHPK, e cila operon e vetme në këtë treg. Në këto kushte për tregtarët e shumicës nuk ka një alternativë tjetër për të tregtuar produktet e tyre, si rrjedhojë nuk ka zëvendësueshmëri nga ana e kërkesës.
9. Treg përkatës të produktit do të konsiderojmë shërbimin e qiradhënies së ambienteve me qëllim magazinimin dhe tregtimin me shumicë të produkteve Agro-Ushqimore në qytetin e Tiranës.
10. Zona gjeografike e shërbimit të qiradhënies së ambienteve për magazinimin dhe tregtimin me shumicë të produkteve agro-ushqimore është territori i qytetit të Tiranës, për pasojë *tregu përkatës gjeografik në rastin tonë përfshin qytetin e Tiranës*.

II.2 Vlerësimi i Pozitës Dominuese

11. Sipas Ligjit, pasja e një pozite dominuese nga një ndërmarrje në treg nuk është e ndaluar, por zotërimi i pozitës dominuese i jep ndërmarrjes një detyrim të veçantë për të mos abuzuar me këtë pozitë dominuese.
12. Nga hetimi rezulton se ndërmarrja EKMA Albania operon e vetme, pra ka pozitë dominuese përsa i përket pjesëve të tregut.
13. Referuar Udhëzimit Nr. 11, datë 2.7.2014 "Për vendndodhjen dhe kushtet e tjera të tregjeve të shitjes me shumicë" të Ministrit të Bujqësisë dhe Vendimit të Këshillit Bashkiak Tiranë Nr.19, datë 09.04.2015 "Për miratimin e kriterëve për vendndodhjen dhe kushtet e tjera të tregjeve të produkteve agro - ushqimore të shitjes me shumicë në Bashkinë e Tiranës", kriteret e vendosura për vendndodhjen dhe kushtet e tjera të tregjeve të produkteve agro - ushqimore të shitjes me shumicë në Bashkinë e Tiranës kanë shërbyer si barriera hyrëse për ndërmarrjet e interesuara për të operuar në këtë treg. Gjithashtu pozita e konsoliduar e ndërmarrjes EKMA Albania SHPK në treg, qëndrueshmëria e pjesëve të tregut në vite (duke zotëruar 100% të tregut përkatës si e vetmja ndërmarrje), si dhe investimet që duhen për ndërtimin e këtyre tregjeve, përbëjnë barriera të larta në hyrje në tregun përkatës.
14. Sipas bilancit të ndërmarrjes, vlerës së shitjeve në tregun përkatës, ndërmarrja EKMA Albania ka fuqi ekonomike e financiare, e cila mund të shkaktojë kufizime të mundshme të konkurrencës në tregun përkatës.
15. Nisur nga pjesa e tregut, pengesat e hyrjes në treg, fuqia kundërvepruese e blerësve, fuqia ekonomike dhe financiare e ndërmarrjes dhe karakteristikat e tjera të tregut përkatës, rezulton se në mbështetje të nenit 3,

pika 5 dhe nenit 8 dhe 9 të Ligjit Nr. 9121 datë 28.07.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", i ndryshuar, si dhe Udhëzimit "Për vlerësimin e pozitës dominuese dhe abuzimit me pozitën dominuese", ndërmarrja EKMA Albania SHPK ka pozitë dominuese në shërbimin e dhënies me qira të ambienteve për magazinimin dhe tregtimin me shumicë të produkteve Agro-Ushqimore në qytetin e Tiranës, pozitë e cila i krijon ndërmarrjes mundësinë që të maksimizojë fitimet duke vendosur çmime eksessive, të cilat nuk justifikojnë vlerën ekonomike të produktit.

II.3 Vlerësimi i Sjelljes së ndërmarrjes EKMA ALBANIA SHPK

II.3.1 Sjellja në lidhje me çmimin

16. Analiza e sjelljes së ndërmarrjes në tregun e dhënies me qira të ambienteve për magazinimin dhe tregtimin e produkteve Agro-Ushqimore në qytetin e Tiranës, ka për qëllim të vlerësojë nëse ndërmarrja vendos në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë çmime të padrejta blerje, shitje ose kushte të tjera të padrejta tregtimi.
17. Çmimi standard për magazinat e dhëna me qira është XXXX lekë/m², të cilat përbëjnë XX % të numrit total të magazinave që ka në dispozicion tregu Agro - Ushqimor. Një numër prej XX magazinash apo XX % të totalit të magazinave kanë një çmim prej XXXX lekë/m², XX magazina kanë një çmim prej XXXX lekë/m², ndërsa XX magazina ose XX % e tyre kanë çmime nga XXXX – XXXX lekë/m². Për sa më sipër çmimet e ambienteve të dhëna me qira variojnë nga XXXX në XXXX lekë/m².
18. Ndërmarrja EKMA Albania duke abuzuar me pozitën e saj dominuese në treg ka maksimizuar fitimet nëpërmjet vendosjes së çmimeve eksessive. Konkretisht, për vitin e fundit financiar 2017 ndërmarrja ka një fitim në vlerë absolute para tatimit prej XXX,XXX,XXX lekë dhe normë fitimi prej XX%. Normat e fitimeve të ndërmarrjes EKMA Albania SHPK, reflektojnë mungesën e konkurrencës në treg. Normat bruto të fitimeve të kësaj ndërmarrjeje janë tepër të larta. Krahasuar me ndërmarrjen Cela - P SHPK, e cila zotëron tregun Agro - Ushqimor në qytetin e Elbasanit, ndërmarrja EKMA Albania SHPK ka një normë fitimi dy herë më të lartë se ndërmarrja Cela - P SHPK.
19. Një tregues tjetër i sjelljes abuzive të ndërmarrjes EKMA Albania SHPK është edhe përqindja e shlyerjes së investimit. Nga pasqyrat financiare të kompanisë vlera totale e investimit është XXX,XXX,XXX lekë, nga ku rezulton se përqindja e shlyerjes së investimit është XX % për vitin 2017 , pra nisur nga këto të dhëna ndërmarrja EKMA Albania SHPK pret ta shlyejë investimin në harkun e XX viteve. Sipas Udhëzimit Nr.5, datë 30.01.2006 "Për tatimin mbi të ardhurat" , i ndryshuar, pika 3.7 shlyerja e vlerës të objekteve është 5 % në vit gjë që do të thotë se investimi total duhet të shlyhet për 20 vjet.
20. Tregu agro ushqimor zhvillon veprimtarinë funksionale të tij në një sipërfaqe prej XXX m². Sipas llogaritjeve të bëra mbi bazën e dokumenteve të ndërmarrjes EKMA Albania SHPK rezulton se çmimi për metër katror në muaj të objektit në pronësi të ndërmarrjes është XXX lekë/m².
21. Krahasuar me të dhënat e siguruar nga ndërmarrjet Eco Market SHPK dhe Conad Albania SHPK që operojnë në tregun e dhënies me qira të ambienteve për magazinim dhe tregtim, të cilat ndodhen në të njëjtën zonë gjeografike me tregun Agro - Ushqimor të qytetit të Tiranës, rezulton se çmimi i ndërmarrjes EKMA Albania SHPK është XXX % më i lartë se i ndërmarrjes Eco Market SHPK dhe XXX % më i lartë se i ndërmarrjes Conad Albania SHPK dhe ky është një tregues tjetër i abuzimit me pozitën dominuese të ndërmarrjes EKMA Albania SHPK.
22. Një tjetër sjellje antikonkurruese e EKMA Albania SHPK lidhet me çmimin e energjisë i cili i faturohet kësaj ndërmarrjeje (sipas faturave të lëshuara nga OSHEE) me çmim XX lekë/kWh, me TVSH. Sasia e matur e energjisë shpërndahet nga EKMA Albania SHPK sipas sasive të harxhuara për çdo ambient me një çmim prej XX lekë/kWh, me TVSH, bazuar kjo në faturat analitike të administruara në ambientet e

ndërmarrjes EKMA Albania. E njëjta sjellje vihet re dhe në mënyrën e faturimit të ujit.

23. Kjo sjellje e ndërmarrjes me pozitë dominuese mund të përbëjë abuzim me fuqinë e saj monopolistike kundrejt tregtarëve qiramarrës të ambienteve të kësaj ndërmarrjeje, duke u imponuar atyre çmime dhe kushte të padrejta tregtimi dhe duke i detyruar ata të paguajnë një çmim më të shtrenjtë të energjisë elektrike nga ai që duhet të paguajnë realisht sipas faturave të lëshuara nga OSHEE.
24. Këto kushte detyruese shtesë dhe njëkohësisht të padrejta që i imponohen tregtarëve qiramarrës, i vendos ata në kushte të pafavorshme konkurrence të lirë dhe efektive në treg, me pasoja të rënda antikonkurruese të cilat reflektohen drejtpërdrejt te çmimet e produkteve agro-ushqimore, duke bërë që konsumatorët shqiptar të paguajnë një çmim më të shtrenjtë, krahasuar me çmimet e një tregu konkurrues.

II.3.2 Sjellja kontraktore e ndërmarrjes EKMA ALBANIA

25. Ndërmarrja EKMA ALBANIA SHPK jep me qira ambientet për magazinimin dhe tregtimin e produkteve Agro-Ushqimore nëpërmjet kontratave të lidhura me tregtarët e këtyre produkteve.
26. Ndërmarrja EKMA ALBANIA SHPK e cila ka një pozitë dominuese në treg, dhe është e vetme në ofrimin e shërbimit për dhënie me qira të ambienteve për magazinim dhe tregtim e produkteve agro-ushqimore në qytetin e Tiranës, nuk zbaton ligjet dhe zakonet e mira tregtare, sepse në kontratat e qirasë së lidhura midis saj si qiradhënëse, dhe tregtarëve si qiramarrës zbatohen kushte të padrejta dhe imponuese tregtimi.
27. Këto kontrata përmbajnë kushte imponuese vetëm për njërën palë të kontratës – qiramarrësin, i bën të pavlefshme kushtet e përgjithshme të këtyre kontratave, që sjellin një humbje ose dëmtim të shpërpjesëtuar të interesave të palës kontraktuese, posaçërisht kur ato ndryshojnë në mënyrë thelbësore nga parimet e barazisë e të paanësisë të shprehura në dispozitat e Kodit Civil që rregullojnë marrëdhëniet kontraktuale.
28. Në referencë të ligjit nr.9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, ndërmarrjet të cilat ndodhen në pozite dominuese kanë detyrimin për tu sjellë në një formë të caktuar në mënyrë që mos pengojnë, kufizojë apo shtrembërojnë konkurrencën në treg.
29. Ndërmarrja EKMA ALBANIA SHPK ndryshe nga sa parashikohet më sipër, nëpërmjet “kontratës tip” të qirasë të aplikuar për qiramarrësit që operojnë në këtë treg agro-ushqimor, vendos kushte diskriminuese dhe të padrejta tregtimi.
30. “Kontrata tip” e qirasë, aplikuar nga ndërmarrja EKMA ALBANIA SHPK bien në kundërshtim me nenin 9, pika 2, gërma a), c) dhe ç) të ligjit nr.9121/2003, ku megjithëse afati i kontratës është 1 (një) vjeçar, ndërmarrja EKMA ALBANIA SHPK e detyron qiramarrësin të negociojë muaj për muaj për çmimin e saj, duke krijuar paqëndrueshmëri financiare për qiramarrësin dhe duke e vendosur këtë të fundit në kushte të pafavorshme konkurrence, si dhe duke e detyruar të paguaj një garanci të vlefshme me pagesën e 2 muajve, pa u marrë përsipër, as edhe një gjë nga ana e qiradhënësit.
31. Ndërmarrja "EKMA ALBANIA" SHPK, për shkak të pozitës së saj dominuese i transferon shërbimet, të cilat sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.19, datë 09.04.2015 duhet të sigurohen nga vetë ndërmarrja, tek qiramarrësi, duke abuzuar, dhe duke u shkaktuar këtyre të fundit dëm ekonomik, si dhe duke i detyruar të pranojnë detyrime shtesë të cilat për vetë natyrën e tyre nuk kanë lidhje me objektin e kontratës në fjalë.

Për sa më sipër, Komisioni i Konkurrencës duke patur parasysh që ndërmarrja EKMA ALBANIA ka një pozitë dominuese në treg dhe është e vetme në ofrimin e shërbimit për dhënie me qira të ambienteve për magazinim dhe tregtimin e produkteve agro-ushqimore në qytetin e Tiranës, e cila:

- Aplikon çmime shumë të larta qiraje krahasuar me mesataren e zonës gjeografike;
- Çmimet e aplikuara i mundësojnë shoqërisë një normë fitimi shumë të lartë prej XX%;

- Çmimet e qirasë të aplikuara nga ndërmarrja sjellin pasoja për konsumatorin final, duke rritur koston produkteve agro – ushqimore të cilat tregtohen nëpërmjet këtij tregu;
- Vendos çmime dhe kushte të padrejta tregtimi dhe duke i detyruar tregtarët qiramarrës të paguajnë një çmim më të shtrenjtë të energjisë elektrike nga ai që duhet të paguajnë realisht sipas faturave të lëshuara nga OSHEE, si dhe UKT;
- Nëpërmjet “kontratës tip” të qirasë të aplikuar për qiramarrësit që operojnë në këtë treg agro-ushqimor, ndërmarrja EKMA ALBANIA vendos kushte diskriminuese dhe të padrejta tregtimi;
- Aplikon kontrata të cilat përmbajnë kushte imponuese vetëm për njërën palë të kontratës – qiramarrësin, i bën të pavlefshme kushtet e përgjithshme të këtyre kontratave, që sjellin një humbje ose dëmtim të shpërpjesëtuar të interesave të palës kontraktuese;
- Detyron qiramarrësin të negociojë muaj për muaj për çmimin e saj, duke krijuar paqëndrueshmëri financiare për qiramarrësin dhe duke e vendosur këtë të fundit në kushte të pafavorshme konkurrence, si dhe duke e detyruar të paguaj një garanci të vlefshme me pagesën e 2 muajve, pa u marrë përsipër, as edhe një gjë nga ana e qiradhënësit.

Konkludon se, referuar kësaj sjelljeje të ndërmarrjes EKMA ALBANIA SHPK në tregun e qiradhënies të ambienteve për magazinimin dhe tregtimin e produkteve Agro-Ushqimore në Qytetin e Tiranës, ndodhemi përballë një situatë urgjence, për shkak të rrezikut të kryerjes së një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm për konkurrencën në këtë treg, pasi ka të ngjarë të ketë shkelje të nenit 9 të Ligjit Nr. 9121/2003.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 8, nenin 9, nenin 24 shkronja d, nenin 26, nenin 44, dhe nenin 61, pika d) dhe dh), të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

Ndalimin e abuzimit me pozitën dominuese të shoqërisë EKMA ALBANIA SHA;

1. Marrjen e masës së përkohshme ndaj ndërmarrjes EKMA ALBANIA SHPK me qëllim rivendosjen e konkurrencës në tregun e qiradhënies së ambienteve për magazinimin dhe tregtimin e produkteve agro-ushqimore në qytetin e Tiranës, konkretisht:
 - a. Hartimin e kontratave të qirasë bazuar në dispozitat e Kodit Civil (për kontratën e qirasë) për të vendosur palët e saj, qiramarrësin dhe qiradhënësin në kushte të barabarta kontraktuale në zbatim të ligjit dhe zakoneve të mira tregtare.
 - b. Qiradhënësi të aplikojë çmime të arsyeshme të orientuara drejt koston dhe çmimit mesatar të qirasë të zonës gjeografike;
 - c. Qiradhënësi të jetë transparent në detajimin e zërave dhe vlerave përkatëse që përfshihen në faturën e qirasë së ambientit;
 - d. Ndërmarrja EKMA ALBANIA SHPK të ndalojë menjëherë faturimin mbi çmimin ligjor të miratuar nga institucionet kompetente (faturuar nga OSHEE dhe UKT);
 - e. Çmimi i qirasë të negociohet në fillim të lidhjes së kontratës dhe të jetë i qëndrueshëm deri në përfundim të afatit të kontratës, në favor të qiramarrësit, duke lejuar atë të krijojë një qëndrueshmëri financiare.
2. Ndërmarrja EKMA ALBANIA SHPK, brenda afatit 30 ditor nga marrja dijeni e vendimit të Komisionit

të Konkurrencës të paraqesë pranë Autoritetit të Konkurrencës Kontratën e rishikuar të qirasë, në zbatim të pikave të mësipërme.

3. Në rast se ndërmarrja EKMA ALBANIA SHPK nuk ndërpret shkeljen e nenit 9 të ligjit nr. 9121/2003 dhe nuk vepron në përputhje me detyrimet dhe brenda afateve të përcaktuara në këtë vendim, Komisioni i Konkurrencës vendos gjoha periodike deri në 5 % të xhiros mesatare ditore të vitit financiar paraardhës, deri sa ndërmarrja EKMA ALBANIA të veprojë në përputhje me këtë vendim, në zbatim të nenit 76, pika 1, germa (a) dhe (c) të Ligjit Nr. 9121/2003.
4. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi, njoftimin e palëve të interesuara, si dhe njoftimin e OSHEE-së dhe UKT- së lidhur me faturimin e energjisë elektrike dhe ujit nga ana e ndërmarrjes EKMA ALBANIA SHPK.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 547, Datë 24.09.2018

“Për dhënien e rekomandimeve për rritjen e konkurrencës gjatë procesit për dixhitalizimin e transmetimeve audiovizive”.

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 24.09.2018, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Mbi monitorimin e tregut të tregtimit të dekodereve DVB-T2.

Baza ligjore: Neni 24, shkronja d dhe f, neni 70 i ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës “Mbi monitorimin e tregut të tregtimit të dekodereve DVB-T2”,

VËREN SE:

Nisur nga situata e krijuar në tregun e tregtimit të dekodereve, (aparateve marrës dixhital) DVB-T2, si detyrim i zbatimit të Strategjisë së kalimit të plotë nga transmetimet analoge në transmetimet numerike (dixhitale), e cila ka njoftuar fikjen e sinjalit të transmetimeve analoge audiovizive nga televizionet kombëtare apo ato lokale e rajonale, më datë 10 shtator 2018, për qarqet Tiranë dhe Durrës, Autoriteti i Konkurrencës ka realizuar një monitorim në ndërmarrjet që operojnë në këtë treg si dhe pikat e shitjes së autorizuar prej tyre.

Nga monitorimi i tregut u konstatua se në datat 10-11 Shtator 2018, në disa pika tregtimi të kompanive “Digitalb” SHA dhe “Tring” SHA janë krijuar rradhë të gjata të qytetarëve të cilët kërkonin të pajiseshin me dekoder DVB-T2, edhe pse tregu i ofrimit të dekodereve është i gjerë, pra kjo paisje mund të blihet edhe në pika të tjera të tregtimit të pajisjeve elektroshtëpiake, përvec atyre të platformave dixhitale (Digitalb dhe Tring);

Kjo situatë, sipas vetë njoftimit të AMA-s shpërndarë më datë 13.09.2018, ka ardhur si pasojë e mungesës së informimit të publikut për mundësitë që ofronte tregu i paisjeve elektronike për përmbushjen e kërkesave të tyre.

Publiku ishte i painformuar lidhur me karakteristikat e dekodereve të përcaktuara me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.480, datë 03.06.2015, mundësinë e të gjitha këtyre dekodereve për të ofruar shërbimin e transmetimit numerik si dhe tregun e ofrimit të tyre.

Për sa më sipër, fushata informuese e realizuar nga AMA nuk ia ka arritur qëllimit të paralajmërojë dhe sqarojë publikun për mënyrën e tregtimit të dekodereve dhe funksionimit të dixhitalizimit të transmetimit të kanaleve;

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24 shkronja d dhe f, neni 70, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. T'i rekomandojë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA);
 - a. Rritjen e sensibilizimit ndaj opinionit publik, nëpërmjet fushatave informuese duke informuar publikun se tregu i shitjes së dekoderave DVB-T2 është treg i hapur dhe këto dekodera mund të sigurohen në cdo pikë shitje të paisjeve elektronike;
 - b. Të gjithë dekoderat DVB-T2, të loguara ose jo nga platformat dixhitale ose operatorë të tjerë, të transmetojnë pa pagesë të gjitha programet ekzistuese analoge (kombëtare ose rajonale) duke ruajtur strukturën ekzistuese të tregut mediatik.
2. Monitorimin e tregut të importit dhe shitjes me shumicë dhe pakicë të dekoderave nga ana e Autoritetit të Konkurrencës deri në kalimin përfundimtar nga transmetimi analog në transmetimin numerik (dixhital).
3. AMA të informojë Autoritetin e Konkurrencës mbi zbatimin e këtij rekomandimi sipas pikës I të këtij vendimi brenda 45 ditësh nga marrja në dijeni.
4. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 550, Datë 04.10.2018

“Për dhënien e rekomandimeve për Kodin e Rrjetit mbi Rregullat e Ndërveprimit dhe Shkëmbimit të të Dhënave, propozuar nga operatori i kombinuar i gazit natyror Albgaz SHA”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 04.10.2018, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Hapja e procedurës së Hetimit të Përgjithshëm në Shërbimin Spitalor

Baza ligjore: Neni 24, shkronja d, dhe neni 26 i Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës “Mbi vlerësimin e procedurës për miratimin e Kodin e Rrjetit mbi Rregullat e Ndërveprimit dhe Shkëmbimit të të Dhënave, propozuar nga operatori i kombinuar i gazit natyror Albgaz SHA” nga ERE”,

VËREN SE:

Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës, bazuar në nenin 69 dhe 70 të ligjit nr. 9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, realizoi vlerësimin e procedurës për miratimin e Kodin e Rrjetit mbi Rregullat e Ndërveprimit dhe Shkëmbimit të të Dhënave, propozuar nga operatori i kombinuar i gazit natyror Albgaz SHA” të nisur nga Bordi i ERE me vendimin nr. 197, datë 03.09.2018.

Operatori i Kombinuar i Gazit Natyror “Albgaz” SHA, ka adaptuar/përshtatur Kodin -e Rrjetit mbi Rregullat e Ndërveprimit dhe Shkëmbimit të të Dhënave, i cili do të do të shqyrtohet dhe miratohet nga ERE.

Kjo Rregullore themelon një kod të rrjetit që specifikon rregullat mbi ndërveprimin dhe shkëmbimin e të dhënave si dhe rregulla të harmonizuara për aktivitetin e sistemeve të transmetimit të gazi dhe zbatohet për pikat e interkonjeksionit midis Palëve Kontraktuese në Komunitetin e Energjisë.

Duke qënë se Operatorit të Kombinuar të Gazit Natyror “Albgaz” SHA i lind e drejta për të aplikuar për shqyrtimin dhe miratimin e këtij Kodi pasi: Shoqëria “Albgaz” SHA, është e licencuar në aktivitetin e Transmetimit të dhe Shpërndarjes së Gazit Natyror; Është certifikuar Operatori i Kombinuar i Gazit Natyror “Albgaz” SHA, në përputhje me nenet 37, 59, 68, dhe 80 të Ligjit Nr. 102/2015, “Për Sektorin e Gazit Natyror” dhe neni 9, pika 6, të Direktivës 73/2009 të Komunitetit të Energjisë (EC); “Albgaz” SHA, gëzon statusin e vëzhguesit pranë ENTSO-G, Rrjetit European të Operatorëve të Transmetimit të Gazit Natyror.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24 shkronja d dhe f, nenin 69 dhe 70, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. T'i rekomandojë Entit Rregullator të Energjisë që Kodi i Rrjetit mbi Rregullat e Ndërveprimit dhe Shkëmbimit të të Dhënave, propozuar nga operatori i kombinuar i gazit natyror Albgaz SHA të transpozohet pa ndryshuar tekstin apo strukturën e tij sipas parashikimeve të Vendimit nr. 2018/02/PHLG-EnC, datë 12.01.2018 të Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë të Komunitetit të Energjisë dhe Rregullores së Bashkimit European (BE) nr. 715/2009.
 2. ERE të informojë Autoritetin e Konkurrencës mbi zbatimin e këtij rekomandimi sipas pikës 1 brenda 90 ditësh.
 3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 552, Datë 04.10.2018

“Për hapjen e procedurës së Hetimit të Përgjithshëm në Shërbimin Spitalor”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 04.10.2018, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Hapja e procedurës së Hetimit të Përgjithshëm në Shërbimin Spitalor

Baza ligjore: Neni 24, shkronja d, dhe neni 26 i Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”,

Ligji Nr. 44/2015 datë 30.04.2015 “Kodit të Procedurës Administrative në RSH”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi Studimin në shërbimin spitalor,

VËREN SE:

Sekretariati i Autoritetit të konkurrencës në zbatim të nenit 28 të Ligjit 9121 datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, ka realizuar një studim në tregun e shërbimeve spitalore. Studimi u mbështet në gjetjet e raportit të ekspertit “Konkurrenca në Shërbimin Shëndetësor” dhe u fokusua në katër çështjet kryesore:

1. Konkurrenca në sektorin e shëndetësisë nëpërmjet rritjes së shërbimeve shëndetësore, e cila do të vlerësohej përmes indikatorëve makro të sektorit të shëndetësisë dhe kryesisht në shërbimin spitalor. Informacioni i ardhur nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ishte i mangët duke e bërë të pamundur vlerësimin e treguesve global të zhvillimit të konkurrencës në shërbimin shëndetësor.
2. Politikat qeverisëse në sigurimin e shërbimit spitalor e fokusuar në konkurrencën mes shërbimit privat dhe shtetëror në drejtim të cilësisë së shërbimit. Elementi kryesor në këtë analizë ishte vlerësimi i koncesioneve apo partneritetit publik/ privat, duke analizuar llojet e shërbimeve të përfshirë në këtë formë shërbimi, efektet në nivelin e cilësisë si dhe ndikimin që kanë sjelle në konkurrencën në treg këto kontrata.

Nga analiza e informacionit të depozituar u konstatua se janë lidhur kontrata koncesionare për 3 shërbime; Koncesioni i Check-Up, me objekt “Për kontrollin mjekësor bazë 35-70 vjeç nëpërmjet një seti analizash të miratuara si dhe vizita mjekësorë, Koncesioni “Për ofrimin e shërbimeve të integruara të furnizimit të setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikal steril, furnizimin me materiale mjekësorë steril njëpërdorimshëm në sallat kirurgjikale” dhe Koncesioni i Dializës, me objekt ofrimin e shërbimit të dializës sa më pranë vendbanimit të të sëmurit me insuficiencë renale kronike.

3. Në lidhje me çështjen e konkurrencës nëpërmjet sistemeve të referimit dhe ofrimin të shërbimeve u konstatua se Fondi i Sigurimeve të Detyrueshme të Kujdesit Shëndetësor financon katër paketa

shërbimesh; paketën e shërbimit të dializës, paketën e shërbimit të kardiologjisë, paketat e shërbimit të transplantit të veshkës dhe paketën e shërbimit të implantit koklear.

Përfituesi më i madh i fondeve buxhetore është QSUT dhe Spitali Amerikan. Të dy këta ofrues ofrojnë të njëjtat shërbime, por referuar numrit të rasteve të trajtuara vihet re qartë që Spitali Amerikan është i orientuar drejt shërbimit të dializës, kurse QSUT drejt shërbimeve të kontrollit të zemrës. Shërbimi i transplantit të veshkës është ofruar vetëm nga Spitali Amerikan.

4. Në lidhje me çështjen e fundit që ka të bëjë me vlerësimin e përqendrimeve të tregut, apo marrëveshjet vertikale dhe horizontale mes spitaleve privatë, rezulton se Spitali Amerikan është përfituesi i XXX% të shoqërisë DiaVita SHPK, shoqëri e kontraktuar në shërbimin e dializës nëpërmjet kontratës së koncesionit. Gjykojmë që pjesa e madhe e tregut në shërbimin e dializës së Spitalit Amerikan mund të jetë e influencuar nga struktura aksionare mes dy shoqërive dhe niveli i ndikimit të kësaj mbivendosje aksionesh kërkon një analizë më të thelluar të kontratës së koncesionit dhe impaktit në treg të saj.

Pas vlerësimit të gjetjeve, është e vështirë të konkludohet për konkurrencën në shërbimin shëndetësor në drejtim të rritjes së cilësisë së shërbimit dhe efikasitetit ekonomike pasi çështjet e mësipërme kanë nevojë për një trajtim më të thelluar dhe më gjithëpërfshirës.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, gërma d dhe nenit 41, pika 1 e Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, (i ndryshuar),

VENDOSI:

1. Hapjen e Hetimit të Përgjithshëm në Shërbimin Spitalor
2. Hetimi do të përfshijë periudhën kohore nga 1 janar 2016 deri në 30 shtator 2018.
3. Raporti i Hetimit të Përgjithshëm duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se 6 (gjashtë) muaj nga dita e çeljes së këtij hetimi.
4. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe për njoftimin e palëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 558, Datë 08.10.2018

“Mbi vlerësimin e projekt-vendimit të Entit Rregullator të Ujit lidhur me aplikimin për ndryshimit të nivelit tarifor për “Ujësjetllës Kanalizime Vau i Dejës” SHA”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 08.10.2018, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Miratimi i projekt-aktit normativ, të nxjerra nga Komisioni Kombëtar Rregullator i ERRU-së, për miratimin e tarifave për Ujësjetllës Kanalizime Vau i Dejës SHA.

Baza ligjore: Neni 24, gërma d) dhe f); neni 26; neni 69 dhe 70 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” (i ndryshuar).

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit mbi vlerësimin nga Autoriteti i Konkurrencës, i projekt aktit normativ, të nxjerra nga Komisioni Kombëtar Rregullator i ERRU-së, për miratimin e tarifave për Ujësjetllës Kanalizime Vau i Dejës SHA,

VËREN SE:

Enti Rregullator i Ujit nëpërmjet shkresës nr. 431 prot., datë 02.10.2018, informon Autoritetin e Konkurrencës se me vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 30, datë 27.04.2018 ka filluar procedurën për shqyrtimin e aplikimit për ndryshim tarife të shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Vau i Dejës SHA, e cila ka propozuar me anë të projekt- vendimit, të aplikojë tarifa të unifikuara për zonën pas riorganizimit.

Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i informacionit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor (*unifikim tarife në të gjithë zonën e shërbimit*) si dhe projekt-vendimit përkatës “Mbi miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë për shoqërinë Ujësjetllës Kanalizime Vau i Dejës SHA”, rezultoi se:

Aplikimi i metodologjisë për ndryshimin e tarifave ka filluar me analizën e kostove të operimit dhe mirëmbajtjes, të cilat duhet të jenë të justifikueshme, si dhe në analizën e performancës e cila tregon rritje të tarifave në mënyrë graduale në vitet në vazhdim, duke patur orientimin drejt kostove për ofrimin e këtij shërbimi.

Tarifat aktuale që aplikon shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Vau i Dejës SHA për ujin e pijshëm për konsum publik nuk janë miratuar nga ERRU, por UK Vau i Dejës SHA është mbështetur tek Vendimi nr. 47 datë 26.12.2011,” Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik” të KKRR-së të UK Shkodër Fshat SHA.

Shoqëria UK “Librazhd- Prrrenjas” SHA aplikon për herë të parë metodologjinë për vendosjen e tarifave për shërbimet e furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimit të ujërave të ndotura bazuar në vendimin Nr.42 datë 09.12.2015 të KKRR-së, konkretisht në analizën e kostove dhe të ardhurave për shërbimet e ofruara, ku janë bazuar këto tarifa të reja të cilat priten të miratohen.

Për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, aktualisht për konsumatorët familjar, unifikohet çmimi i faturimit të shërbimit të ujit të pishëm për të gjithë zonën.

Shoqëria UK Vau Dejës SHA prezanton në raport koston totale të nivelit të tarifave në fuqi, i cili është i ulët, dhe argumenton rritja e tyre, e cila nuk është abuzive, por bazohet në vendosjen e tarifave të drejta të shitjes në kushtet e tregtimit të drejtpërdrejtë apo të tërthortë.

Nga ana e UK Vau i Dejës SH.A janë përcaktuar dhe objektivat për treguesit e performancës të cilat në vitin 2019 dhe që rezultojnë në:

- Zgjerimin e zonës së shërbimit me që nivelin e shërbimit është në nivele të ulta të shtrirjes së shërbimit duke synuar investimet fizike në të ardhmen
- Evidentimin e aseteve të kanalizimeve të ujërave të ndotura
- Legalizimin e lidhjeve të paligjshme për të ulur kostot e përballimit të shpenzimeve të cilat janë të larta.
- Shoqëria duhet të pajiset me matësa të mëdhenj në burime dhe rezervuare.
- Duhet të ndërtoj një organigramë me përshkrimë përkatëse për çdo pozicion, si dhe të hartojë një program ku të parashikohen numëri i punonjësve për operim dhe mirëmbajtjen e sistemit të KUN.
- Hartimi i një plani biznesi 5 vjeçar, për të gjithë zonën e shërbimit, duke mbajtur në konsideratë humbjet fizike, masat për kontrollin dhe disiplinimin e konsumatorëve abuziv dhe lidhjeve të paligjshme.

Referuar vlerësimit të KKRR-së, është gjetur e pajustificuar vendosja e e tarifës afrofe për shërbimin e KUZ për konsumatorët publik dhe privat gjë e cila është reflektuar dhe në draft vendimin e aktit normativ të ERRU-së për këtë ndërmarrje.

Referuar treguesve të performancës financiare rezulton se mbulimi i kostove operative do të rritet XXX% në vitin 2019 kundrejt XXX% aktualisht.

Do të realizohet një furnizim me ujë rreth XXX orë në ditë nga XXX orë që është aktualisht. Rritjen e nivelit të arkëtimeve të ujit pa të ardhura nga XXX% që është mesatarja në XXX% në vitin 2019.

Nga ana e shoqërisë UK Vau i Dejës SH.A janë përcaktuar dhe objektivat për treguesit e performancës të cilat në vitin 2019 parashikohen të përmbushen brenda kufijëve të shërbimeve mjaft problematike siç janë performanca financiare që mbulon vetëm XXX% të kostove direkte të operimit dhe mirëmbajtjes, hartimin e një plani biznesi 5 vjeçar, për të gjithë zonën e shërbimit, duke mbajtur në konsideratë humbjet fizike, masat për kontrollin dhe disiplinimin e konsumatorëve abuziv dhe lidhjeve të paligjshme.

Mbulimi me ujë i ofrohet vetëm XXX banorëve kundrejt XXX banorëve që është popullësia. Konsumatorët që faturohen nga ky shërbim janë XXX% familjarë dhe XXX% prej tyre janë publik dhe privat. Faturimi ka qënë më shumë me vlerësim pa përdorur matësa.

— **Mbulimi me kanalizime** nuk ka qënë faturuar sepse pothuajse XXX% mbulohen me gropa septike dhe aplikimi i tarifave për vitin 2018 të cilat janë tarifa të larta konsideruar zonat më të afërta si Shkodra, kur Vau i Dejës ofrimin e shërbimit të kanalizimit nuk e ka realizuar ende, popullësia ka gropat septike në shërbim të saj.

— **Niveli i matjes** aktualisht është XXX% në 2017 dhe pas instalimit të matësave për të cilat po punohet mendohet që në 2019 rreth XXX%.

— **Uji pa të ardhura** parashikohet që në vitin 2018 të bëhet pothuajse në të njëjtat nivele me vitin 2017 (XXX%), sepse ka humbje vjetore administrative dhe rreth XXX% e tyre janë humbje teknike.

— **Norma e arkëtimit** parashikohet të rritet nga XXX% në 2017 në XXX% në vitin 2019, pasi shoqëria ka një plan veprimi lidhur me informimin publik, vendosjen e qendrave të pagesave pranë zonave të tyre të banimit, me qëllimin e rritjes së kreditimit.

— **Kohëzgjatja e furnizimi të ujit** nuk parashikohet të përmirësohet pasi nuk ka sasi të mjaftueshme uji që mund t'i shërbej më shumë se XXX orë ujë në ditë, megjithatë parashikohet të përmirësohet në XXX orë për vitin 2019.

— **Efikasiteti i stafit** është ende në nivele aktuale XXX punonjës për XXX lidhje të UK dhe do të mbetet i tillë deri në vitin 2019.

ERRU shprehet gjithashtu se tarifat e propozuara janë në përputhje me parimin e rregullatorit mbi përballueshmërinë që fatura e llogaritur me tarifat e reja të mos jetë më shumë se XXX% të shpenzimeve mujore të një familjeje sipas të dhënave të INSTAT.

ERRU konsideron të arritshëm objektivat mbi treguesit e performancës duke dhënë dhe rekomandimet e mëposhtme për UK Vau i Dejës:

- Shoqëria duhet të forcojë përpjekjet për zgjerimin e zonave të mbuluara me shërbimet e FU dhe KUN për të garantuar akses për sa më shumë banorë në zonën e saj të shërbimit. Për këtë kërkohen investime të konsiderueshme fizike që shoqëria dhe aksionerët duhet të shtojnë përpjekjet për sigurimin e tyre.
- Shoqëria duhet të evidentojë asetet e kanalizimeve të ujërave të ndotura dhe t'i përfshijë në regjistrat kontabël të saj (ose bashkisë), si edhe të vlerësojë nevojat për fonde investimesh për ndërtimin e KUN.
- Shoqëria duhet të intensifikojë punën për zbulimin dhe legalizimin e lidhjeve të paligjshme.
- Të pajisen me matësa të mëdhenj pikat kyçe të sistemit të furnizimit me ujë, që nga burimet (puse dhe/ose kaptazhe), stacionet e pompimit, depot dhe në disa pika kyçe të rrjeteve shpërndarëse.
- Shoqëria duhet të ndërtojë një organigramë me përshkrimet përkatëse për çdo pozicion, si edhe një program për të ardhmen ku të parashikohet dhe numri i duhur edhe për operimin dhe mirëmbajtjen e sistemit KUN.
- Gjithashtu XXX% e popullsisë shërbehët me burime alternative (puse), pra sasia e ujit të derdhur nuk mund të matet, por gjithësesi aplikimi i një tarife fikse për shkarkimin e ujërave të ndotura do të ishte një zgjidhje e domosdoshme që duhet të konsiderohet sa më shpejt për të respektuar parimin që “ndotësi paguan” në funksion të mbrojtjes së burimeve ujore dhe të mjedisit në përgjithësi.
- Shoqëria të hartojë një plan biznesi XXX vjeçar i cili në aplikimin e ardhshëm të jetë i përditësuar, tek i cili të analizohet dhe parashikohet ulja e kostove, nevojat për investime dhe rritja e përqindjes së mbulimit me ujë dhe KUN.

Për sa më sipër, rritja e tarifave duhet të bëhet gradualisht në vitet në vazhdim, me kusht që çdo rritje të pasqyrohet me përmirësime të performancës së shërbimeve. Tarifat e reja duhet të jenë të orientuara drejt kostos së shërbimeve për të cilat ato aplikohen, kosto të cilat duhet të jenë të nevojshme për marrjen e këtyre shërbimeve.

Realizimi i investimeve për përmirësimin e rrjetit të ujësjellësit, duhet të jetë transparent, i përshtatshëm, efikas, fitimprurës, dhe të nxitin reduktimin e kostove nga niveli aktual si dhe përdorimin në mënyrë efektive të burimeve ujore ashtu edhe në ofrimin cilësor të shërbimit.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenet: 24, gërma d) e f); 69 dhe 70 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” (të ndryshuar), me propozim të Sekretariatit,

VENDOSI:

1. Projekt-akti normativ për miratimin e tarifave të UK Vau i Dejës SH.A, nuk bie në kundërshtim me ligjin nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, pasi nuk krijon barriera kufizuese të cilat sjellin pasoja për konkurrencën në treg.
 2. T’i rekomandojë Entit Rregullator të Ujit si vijon:
 - a) Në projekt-vendimin “Mbi miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe ujërat e ndotura për ndërmarrjen Ujësjiellës Vau i Dejës SH.A”, në pjesën e rekomandimeve të dhëna ndërmarrjes UK Vau i Dejës SH.A , të shtohen edhe rekomandimet e mëposhtme:
 - i. Tarifat që do të miratohen nga ERRU për UK Vau i Dejës SHA, duhet të jenë të orientuara drejt kostos së shërbimeve për të cilat ato aplikohen, duke verifikuar të gjithë ofruesit e shërbimit me matës dhe pamatës, me linjë të ofrimit të shërbimit nga UK Vau i Dejës SHA dhe ata që furnizohen me burime të tjera alternative, kosto të cilat duhet të jenë të nevojshme për marrjen e këtyre shërbimeve.
 - ii. Ndërmarrja UK Vau i Dejës SHA gjatë hartimit të planit XXX vjeçar duhet të mbajë në konsideratë ndarjen e kostove të shërbimit të furnizimit me ujë të përshtatshme nga shërbimi i kanalizimeve të ujërave të ndotura, pasi kjo do të sigurojë një analizë më të saktë dhe vendosje të tarifave më të drejta për ofrimin e secilit shërbim, evidentimin e aseteve të shërbimit të KUN dhe numërin e abonentëve që mbulohen nga ky shërbim, në kushtet e ekzistencës së një sistemi të tillë në këtë zonë që është shumë i kufizuar.
 - iii. Ndërmarrja UK Vau i Dejës SH.A të bëjë sa më transparente investimet për përmirësimin e rrjetit të ujësjiellës, duke i përdorur ato në mënyrë sa më të përshtatshme, efektive e fitimprurëse, me qëllim reduktimin e kostove nga niveli aktual dhe përdorimin në mënyrë efektive të burimeve ujore.
 - iv. Evidentimit nga ana e ndërmarrjes të një data baze të të gjithë abonentëve në zonat urbane /rurale, që përdorin burime alternative furnizimi me ujë, me qëllim faturimin sa më transparent të tyre dhe ofrimin e shërbimit sa më cilësor (klorifikim, mirëmbajtje).
 - v. Rivlerësimin e numrit të lidhjeve me/pa matës sipas popullsisë në zonat urbane dhe rurale që janë aktualisht, për shkak të reduktimit të numërit të tyre në këto zona, si edhe rillogaritjen e të dhënave financiare në vazhdim duke mbajtur në konsideratë gjendjen reale të abonentëve.
 3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM
Nr. 560, Datë 15.10.2018

“Për mbylljen e procedurës së hetimit paraprak ndaj ndërmarrjes “Conad Albania” SHPK në tregun e tregimit të produkteve ushqimore të cilat mbartin markën “Conad” në Republikën e Shqipërisë dhe vendosjen e disa detyrimeve”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 15.10.2018, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Mbyllja e procedurës së hetimit paraprak në tregun e tregimit të produkteve ushqimore të cilat mbartin markën “Conad” në Republikën e Shqipërisë, konkretisht ndaj ndërmarrjes “Conad Albania” SHPK (Conad Albania) dhe vendosjen e disa detyrimeve.

Baza ligjore: Neni 4, neni 5, neni 6, neni 7, neni 8, neni 9, neni 24, shkronja (d), neni 26, neni 43, pika (5) dhe neni 45 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar (Ligji Nr. 9121/2003).

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit të hetimit të hetimit paraprak në tregun e tregimit të produkteve ushqimore të cilat mbartin markën “Conad” në Republikën e Shqipërisë dhe konkretisht ndaj ndërmarrjes Conad Albania dhe relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm mbi raportin e hetimit paraprak,

VËREN SE:

I. Procedura e ndjekur

1. Komisioni i Konkurrencës me Vendimin Nr. 523, datë 07.06.2018, ka vendosur, hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e tregimit të produkteve ushqimore të cilat mbartin markën “Conad” në Republikën e Shqipërisë, konkretisht ndaj ndërmarrjes Conad Albania.
2. Në bazë të nenit 35 dhe 36 të Ligjit Nr. 9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar dhe Autorizimit të Komisionit të Konkurrencës Nr. 384 datë 14.06.2018 “Autorizim Inspektorësh”, grupi i inspektimit, gjatë periudhës së hetimit ka kryer inspektim në ndërmarrjen “Conad Albania” SHPK dhe ndërmarrjet e integruara vertikalisht me ndërmarrjen Conad.
3. Për mbledhjen e fakteve dhe të dhënave të nevojshme në lidhje me hetimin, bazuar në nenet 33 dhe 34 të Ligjit Nr. 9121/2003 janë kërkuar të dhëna dhe informacion nga: ndërmarrja Conad Albania, INSTAT dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

II. Kontrata e nëndelegimit

4. Ndërmarrja “Conad Adriatico Societa Cooperativa”, e cila ka në pronësi të plotë markat “Conad”; “Margherita”; “Todis il Discount Conad”; “Conad Leclerc” dhe “Conad City”, i ka dhënë të drejtën e ekskluzivitetit ndërmarrjes “Conad Albania” SHPK, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë me anë të Kontratës së nëndelegimit e datës 29.02.2012, me qëllim që të lidhë marrëveshje për llogari të vet me shitësit individual dhe që i përkasin ndërmarrjes Conad Albania.
5. Ndërmarrja Conad Albania është distributori kryesor i produkteve Conad në Shqipëri, të cilat shpërndahen

në drejtim të rrjetit të dyqaneve, sipas porosisë së tyre, të cilët kanë marrëveshje kontraktuale, ose siç është përcaktuar paraprakisht dhe në mënyrë periodike bashkërisht nga palët.

6. Ndërmjet ndërmarrjes Conad Albania dhe klientëve të saj janë lidhur Kontrata Franchising dhe Furnizimi. Referuar këtyre kontratave të Franchizës të lidhur nga ndërmarrja Conad Albania, me cilësinë e Franchisdhënësit dhe klientëve të saj me cilësinë e Franchismarrësit, rezulton se në to janë vendosur kushte në lidhje me mobilimin e aktivitetit në përputhje me projektin e përgatitur nga dhënësi i kontratës, brenda kufirit maksimal të shpenzimeve të konkorduara me franchisëmarrësin dhe gjithashtu të mbajë aktivitetin në gjendje perfekte duke i dhënë franchisëdhënësit të drejtën të kontrollojë ambientin me qëllim që të verifikoj respektimin e të gjitha tipareve dalluese dhe cilësore të nevojshme për përdorimin e markës.
7. Sipas detyrimit të furnizimit në pikën 4 të kontratës, franchismarrësi merr përsipër të furnizohet ekskluzivisht nga Conad Albania, ose nga furnizues që kanë lidhur një kontratë me Conad Albania, për të gjitha produktet e asortimentet e këtij të fundit.

III. Analiza e konkurrencës

III.1 Tregu përkatës

8. Tregu përkatës përfshin produktet që vlerësohen si të zëvendësueshme nga konsumatorët ose klientët e tjerë, për sa u përket karakteristikave, çmimit dhe funksionit të tyre dhe që ofrohen ose kërkohen nga ndërmarrjet në një zonë gjeografike me kushte të njëjta konkurrence, zonë kjo e cila veçohet nga zonat e tjera kufizuese. Përkufizimi i tregut përkatës përfshin dy dimensione: a) Tregun e produkteve dhe b) Tregun gjeografik
9. Kriteret për përcaktimin e tregut përkatës janë: zëvendësueshmëria nga ana e kërkesës, zëvendësueshmëria nga ana e ofertës, konkurrenca potenciale dhe barrierat e hyrjes në treg.
10. Zëvendësueshmëria në anën e kërkesës nënkupton nëse ndërmarrja në ofrimin e një produkti, do të rriste çmimin e këtij produkti, çfarë mundësish kanë konsumatorët të zëvendësojnë përdorimin e këtij produkti me një tjetër. Produkti/shërbimi që analizohet krahasohet me produkte të tjerë, nëse ato mund të zëvendësohen nga ana e konsumatorit. Nëse konsumatorët mund të zëvendësojnë produktin e ofruar me një produkt apo produkte të tjera, këto të fundit duhet të përfshihen në tregun përkatës.
11. Zëvendësueshmëria në anën e ofertës, nënkupton që, nëse ndërmarrja Conad Albania, do të rriste çmimin e produktit/shërbimit për një periudhë kohe jo tranzitore, a do të kishte presion nga ofrues të tjerë të mundshëm të këtij produkti? Ndërmarrje të tjera, të cilat nuk ofrojnë produktet në fjalë, mund të zhvendosin burimet e tyre në drejtim të ofrimit të këtyre produkteve.
12. ***Tregu përkatës i produktit*** përkufizohet si tregu i shitjes me pakicë i produkteve ushqimore dhe mallrave të konsumit që kanë qëllim furnizimin ditor dhe të rastit të familjeve nëpërmjet formateve të dyqaneve të paspecializuara si dyqanet në afërsi të lagjes, supermarketeve dhe hipermarketeve.
13. ***Tregu përkatës gjeografik*** përfshin zonën në të cilën ndërmarrjet janë përfshirë në ofertën dhe kërkesën e shërbimit, në të cilën kushtet e konkurrencës janë mjaftueshëm homogjene. Për analizimin e këtij rasti Treg Gjeografik konsiderohet tregu i brendshëm, pra territori i Republikës së Shqipërisë.

IV. Struktura e Tregut

14. Tregu i shitjes me pakicë i ushqimeve dhe mallrave të konsumit është i formuar kryesisht nga dyqane të mesëm e të vegjël dhe të pavarur nga njëri tjetri, duke patur kështu karakteristikat e një tregu kryesisht tradicional. Tregtia me pakicë në format modern përfaqëson rreth XXX% të tregut me pakicë dhe është kryesisht prezente nëpërmjet formatit të supermarketeve dhe dyqaneve të vogla. Tregu i shitjes me pakicë në Shqipëri konsiderohet si një treg i vogël, por me tendencë pozitive zhvillimi.

15. Konkurrenti kryesor në tregun përkatës është “SPAR Albania” që përfaqëson XXX% të pjesës së tregut. Kjo ndërmarrje ka rritur shitjet krahasuar me vitin 2016 me XXX%. Si rezultat i rritjes së aktivitetit është rritur dhe pjesa e tregut që përfaqëson me XXX% krahasuar me vitin 2016. Ndërmarrja nën hetim, Conad Albania, zotëron XXX% të pjesës së tregut, i cili ka rënë lehtësisht krahasuar me vitin 2016, me rreth XXX% më pak, kur tregu i shitjes me pakicë është rritur me XXX% në vitin 2017.

V. Vlerësimi i pozitës dominuese

16. Sipas nenit 8 të Ligjit 9121/2003 një nga kriteret bazë për vlerësimin e pozitës dominuese është pjesa e tregut që zënë ndërmarrjet. Sipas Udhëzimit të Tregut Përkatës, miratuar me Vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr. 76, datë 07.04.2008, parashikohet se vlerësimi për nga treguesi i të ardhurave është kriteri bazë për llogaritjen e pjesëve të tregut. Llogaritja e pjesëve të tregut për nga të ardhurat e realizuara është tregues më i saktë dhe i rëndësishëm për një reflektim më të mirë të pozicionit dhe të fuqisë së çdo ndërmarrjeje në treg.
17. Për të përcaktuar sa më saktë pjesën e tregut që zënë ndërmarrjet në tregun përkatës është përpunuar informacioni: i sjellë nga Conad Albania, i administruar nga faqja web e QKB-së dhe informacioni i dërguar nga INSTAT.
18. Nga vlerësimi i pjesës së tregut si kriteri kryesor i përcaktimit të pozitës dominuese rezultoi se: tregu është dinamik me rritje totale të volumit të tregut me XXX%; në treg ushtrojnë aktivitet shumë konkurrentë; konkurrenti kryesor në tregun përkatës është ndërmarrja Spar që përfaqëson XXX% të pjesës së tregut dhe ka rritje krahasuar me vitin 2016 me XXX%; ndërmarrja nën hetim Conad Albania përfaqësohet me XXX% të pjesës së tregut, i cili ka rënë lehtësisht krahasuar me vitin 2016 me XXX%, duke u renditur si konkurrenti i dytë në treg; konkurrenti i tretë, Eco Market, ka pësuar një rritje të lehtë tregu; tregu karakterizohet nga një indeks i ulët i shkallës së përqendrimit; në treg janë hedhur disa marka ndërkombëtare.
19. Pra për sa i përket pjesës së tregut, rritjes së pjesëve të tregut të konkurrentit më të madh, rritjes të konkurrentëve më të vegjël, apo hyrjeve dhe daljeve të ndërmarrjeve nga tregu, mund të themi që tregu i shitjes së produkteve ushqimore është dinamik sepse ka shumë hyrje dhe dalje të ndërmarrjeve, pjesë tregu të vogla dhe jo statike, ndërmarrja nën hetim që zvogëlon pjesën e tregut dhe një ndërmarrje me fuqi të rëndësishme kundërvepruese ndaj ndërmarrjes nën hetim. Gjithashtu, bazuar në kriterin e pjesës së tregut mund të thuhet se asnjë ndërmarrje nuk zotëron pozitë dominuese, pasi ndërmarrja nën hetim është shumë e vogël dhe nën kufirin për ta analizuar për pozitë dominuese.
20. Nisur nga pjesa e tregut, pengesat e hyrjes në treg, fuqia kundërvepruese e blerësve dhe fuqia ekonomike financiare, rezultojnë se në mbështetje të nenit 3, pika 5 dhe nenit 8 të Ligjit Nr. 9121/2003, por dhe nga praktikatat me të mira të së drejtës evropiane të konkurrencës, ndërmarrja Conad Albania nuk ka pozitë dominuese, pra mund të themi që nuk jemi para rastit të një abuzimi të mundshëm me pozitën dominuese.

VI. Analiza e Sjelljes së Ndërmarrjes

VI.1. Sjellja në lidhje me vendosjen e çmimeve

21. Ndërmarrja Conad Albania funksionon në dy lloj formash: 1) si furnizues i të gjithë rrjeteve të marketeve me “Logon Conad”; dhe 2) si edhe furnitor i hoteleve, restoranteve dhe kafeve (HoReKa). Si rezultat kemi ndërmarrje të integruar vertikalisht me “Food Trade” dhe lidhje vertikale me blerësit (franchising).
22. Ndërmarrja Conad Albania u shet supermarketeve me markën Conad, të cilat përbëjnë XXX% të shitjeve për vitin 2017, dhe një pjesë e vogël e shitjeve të mallrave e barazvlefshme me XXX% të shitjeve totale të vitit 2017, përbëhet nga shitjet drejt klientëve të tjerë, të cilët nuk kanë kontratë me Conad, por blejnë sipas nevojave të tyre. Këta klientë duhet të jenë të pajisur me NUIS dhe në përgjithësi janë të sektorit

HORECA (Hotel/Restorant/Catering) ose markave të vogla.

23. Nga inspektimet e realizuara tek ndërmarrja Conad Albania më datë 10.07.2018 u konstatua se rekomandohen çmime të këshilluara në një kohë kur supermarketet janë të pavarura në vendimmarrjet e tyre.
24. Në përgjigje të kërkesës për informacion nga ndërmarrja Conad Albania është administruar fatura me numër serie XXX ku jepet vlefë totale e produktit pa TVSH, por edhe çmimi i shitjes i këshilluar dhe marzhi teorik, i cili varion sipas produkteve.
25. Gjatë inspektimeve të realizuara përgjatë procedurës hetimore tek zinxhiri i supermarketeve Conad u konstatua nëpërmjet faturave të shitjes elektronike me nr. XXX e datës 10.07.2018 (faturë oferte), fatura XXX e datës 06.07.2018, dhe fatura Nr. XXX, datë 07.07.2018, se këshillohen çmimet e rishitjes. Përfaqësuesit e ndërmarrjeve në tregun e poshtëm deklaruan se çmimi nga ndërmarrja Conad Albania, vjen i këshilluar, por jo i fiksuar, sipas një variacioni grafik, të cilin jo gjithmonë e marrin në konsideratë. Sipas deklaratave të tyre gjatë inspektimeve në përgjigje të pyetjes sa të pavarur dhe vendimmarrës janë në lidhje me të gjithë treguesit e produktit të marketingut, sasi, çmim, fushatë promovionale, deklarojnë se kanë pavarësi dhe liri për të vendosur mbi çmimet e këshilluara.
26. Për të vlerësuar mekanizmin e formimit të kostos, çmimit të rekomanduar dhe çmimit të aplikuar faktikisht, përgjatë zinxhirit të furnizimit për artikuj kryesorë të markës Conad dhe jo Conad është përpunuar dhe analizuar informacioni i sjellë nga ndërmarrja Conad Albania. Të dhënat e përpunuara analizojnë artikujt kryesorë të markës Conad dhe jo Conad me të gjithë elementët e formimit të çmimit të shitjes përgjatë zinxhirit të furnizimit që nga blerja nga Conad Albania, kostot e përgjithshme të Conad Albania, çmimin e shitjes, marzhin neto, çmimin e shitjes tek rrjeti, koston e përgjithshme me supermarketet, vlerat në pikë shitje me çmime të rekomanduara, dhe çmimin e aplikuar faktikisht në supermarket.
27. Çmimet e aplikuara në fakt (për produktet e markës Conad) nga ndërmarrja Food Trade, krahasuar me çmimet e rekomanduara nga Conad Albania rezultojnë të njëjta për të gjitha produktet e marra në analizë. Ndërmarrja Food Trade është e integruar vertikalisht si aksioner i përbashkët me ndërmarrjen Conad Albania, me XXX% të të gjitha shitjeve të Conad Albania ose XXX% të tregut përkatës.
28. Çmimet e aplikuara në fakt nga blerësit e tjerë si Pronatyrë (afiluar partner) krahasuar me çmimet e rekomanduara nga Conad Albania rezultojnë të ndryshme kryesisht më pak për të gjitha produktet kryesore të shportës.
29. Nga vlerësimi dhe analizimi i këtij mekanizmi rezulton çmimi i shitjes me Tvsh dhe marzhinat e shitjes, rekomandohet nga ana e ndërmarrjes Conad Albania, por nga verifikimi i çmimeve të këshilluara me çmimet e aplikuara në fakt, gjatë procedurës së hetimit, rezultoi se ka raste që çmimet e aplikuara të jenë më të ulta, se ato të rekomanduara.
30. Mbajtja e çmimit të rishitjes (RPM), që do të thotë vendosjen indirekte të një çmimi rishitje që të shikohet nga blerësi, trajtohen si kufizime në objekt të nenit 4 të Ligjit Nr. 9121/2003. Gjatë procedurës hetimore, ndërmarrja Conad Albania në përgjigje të konstatimit të grupit të inspektimit dërgoj argumente të efikasitetit të mundshme që vjen si rezultat i çmimeve të këshilluara dhe treguan që çmimet e këshilluara janë në dobi të konsumatorëve përfundimtarë.
31. *Nga analiza e konkurrencës të efekteve mbi konkurrencën dhe konsumatorët nëse përmbushen kushtet e neneve 5 dhe 6 të Ligjit Nr. 9121/2003, rezulton se:*
 - 1) Pjesa e tregut prej XXX% tregon se pozicioni i furnizuesit është i dobët për të shkaktuar efekte negative në treg. Ndërsa pjesa e tregut të blerësit më të madh ku ai shet produktet e tij (ndërmarrja Food Trade) që zë XXX% të tregut ku ai shet produktet e tij në tregun e shitjes me pakicë. Pra edhe furnizuesi dhe

blerësi kanë një pjesë tregu të vogël për të shkaktuar kufizime vertikale në tregun e rrjedhjes së sipërme dhe të poshtme.

- 2) Edhe pse marrëveshja për RPM përfshihet në kufizimet e konkurrencës në marrëveshjet midis jo konkurrentëve, nga analiza rezulton se: Nga vlerësimi i mbajtjes së çmimit të rishitjes në shumicën e produkteve të afiluar është aplikuar çmim më i ulët se ai i rekomanduar; Çmimet e aplikuara në fakt (për produktet e markës Conad) nga ndërmarrja Food Trade, i cili është i integruar vertikalisht si aksioner i përbashkët me Conad Albania, krahasuar me çmimet e rekomanduara nga Conad Albania, rezultojnë të njëjta për të 10 produktet e marra në analizë, por kjo përfaqëson rreth XXX% të të gjithë tregut të shitjes me pakicë; Çmimet e aplikuara në fakt nga blerësit e tjerë si Pronatyrë (afiluar partner) krahasuar me çmimet e rekomanduara nga Conad Albania rezultojnë të ndryshme kryesisht më pak për të gjitha produktet kryesore të shportës dhe përfaqësojnë më pak se XXX% të tregut përkatës; Kontrata e franshizes nuk ka asnjë detyrim që të aplikohen çmimet e rekomanduara nga ndërmarrja Conad Albania.
- 3) Nga analiza e konkurrencës (analiza e performancës së ndërmarrjes Conad Albania me ndërmarrjen e integruar vertikalisht) dhe vlerësimit të efekteve të kufizimeve që rezultojnë nga kufizimet vertikale, kryesisht nga ruajtja e çmimit të rishitjes (RPM), rezultoi se: ndërmarrja në marxhinalizimin në të dy nivelet e integritimit vertikal ka realizuar një normë fitimi prej XXX% nga ndërmarrja Conad Albania dhe XXX% nga ndërmarrja Food Trade ose gjithsej XXX%, çfarë tregon se çmimet e këshilluara nuk kanë çuar në rritje të çmimit të konsumatorit përfundimtar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të nenit 4, nenit 5, nenit 6, nenit 8, nenit 9, nenin 24, shkronja (d), nenin 26, nenin 28, nenin 43, pika (5) dhe nenin 45 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrotjtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Mbylljen e procedurës së hetimit paraprak ndaj ndërmarrjes “Conad Albania” SHPK.
2. Ndërmarrja “Conad Albania” SHPK, për të shmangur çdo kufizim të konkurrencës nga aplikimi i përcaktimi i çmimeve të rishitjes, duhet të marrë masat si vijon:
 - a) të mos aplikojë në faturat e shitjeve (brenda sistemit software dhe jashtë sistemit software), çmime të këshilluara dhe marzhin teorik;
 - b) të mos monitorojë çmimet e rishitjes, për të shmangur çdo sjellje antikonkurrese lidhur me mbajtjen e çmimit të rishitjes apo koordinimin e sjelljes për fiksimin e çmimit përfundimtar të shitjes;
 - c) brenda 60 ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi të informojë Autoritetin e Konkurrencës lidhur me masat e marra për zbatimin e rekomandimit të mësipërm.
3. Në rast të mos përmbushjes së detyrimeve të përcaktuara në pikën (II) të këtij vendimi, ndërmarrja “Conad Albania” SHPK ndëshkohet me gjobë deri në 10 % të xhiros vjetore për shkelje të rëndë të konkurrencës në zbatim të nenit 74, pika 1, gërma (c) të Ligjit Nr. 9121/2003.
4. Monitorimin e sjelljes së ndërmarrjes “Conad Albania” SHPK për një periudhë 1 vjeçare.
5. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 562, Datë 25.10.2018

“Për vendosje gjobe dhe detyrime ndaj ndërmarrjes “SGS Automotive Albania” SHPK në tregun e shërbimit të kontrollit teknik të detyrueshëm të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të tyre në Republikën e Shqipërisë dhe dhënien e disa rekomandimeve”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 25.10.2018, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Për konstatimin e abuzimit me pozitën dominuese, vendosje gjobe dhe detyrime ndaj ndërmarrjes “SGS Automotive Albania” SHPK (SGS) në tregun e shërbimit të kontrollit teknik të detyrueshëm të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të tyre në Republikën e Shqipërisë dhe dhënien e disa rekomandimeve për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE).

Baza ligjore: Neni 24, shkronja (d), neni 26, neni 8, neni 9, pika 2 gërmat (a) dhe (ç), neni 45, neni 70, neni 74, pika 1, gërma (a) dhe neni 75, pika 1 e ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar (ligji nr. 9121/2003).

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit të hetimit të thelluar në tregun e shërbimit të kontrollit teknik të detyrueshëm të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të tyre në Republikën e Shqipërisë dhe relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës;

VËREN SE:

I. Procedura e ndjekur

1. Komisioni i Konkurrencës në bazë të nenit 42 të Ligjit Nr. 9121/2003, me Vendimin Nr. 497, datë 08.02.2018 “Për hapjen e hetimit paraprak në tregun e shërbimit të kontrollit teknik të automjeteve në Republikën e Shqipërisë”, vendosi hapjen e procedurës së hetimit paraprak, pasi mund të jemi përpara një abuzimi me pozitën dominuese nga ndërmarrja SGS.
2. Në përfundim të hetimit paraprak, Komisioni i Konkurrencës konkludoi se sjellja e ndërmarrjes me pozitë dominuese SGS në tregun përkatës, mund të përbëjë abuzim me pozitën dominuese në kuptim të nenit 9, pika 2, gërma (ç) të Ligjit Nr. 9121/2003.
3. Për sa më sipër, Komisioni i Konkurrencës në bazë të nenit 43 të Ligjit Nr. 9121/2003, me Vendimin Nr. 514, datë 12.06.2018 “Për hapjen e hetimit të thelluar në tregun e shërbimit të kontrollit teknik të automjeteve në Republikën e Shqipërisë”, vendosi hapjen e procedurës së hetimit të thelluar, pasi mund të jemi përpara një abuzimi me pozitën dominuese nga ndërmarrja SGS, në kuptim të nenit 9, pika 2, gërma (ç), të Ligjit Nr. 9121/2003.
4. Për mbledhjen e fakteve dhe të dhënave të nevojshme në lidhje me hetimin, bazuar në nenet 33 dhe 34 të Ligjit nr. 9121/2003 janë kërkuar të dhëna dhe informacion nga: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe ndërmarrja SGS.

5. Në bazë të nenit 35 dhe 36 të Ligjit Nr. 9121/2003 dhe Autorizimit të Komisionit të Konkurrencës (Autorizim Inspektorësh), grupi i inspektimit, gjatë periudhës së hetimit ka kryer inspektimet e nevojshme pranë ndërmarrjes SGS.
6. Në përfundim të procedurës hetimore, me shkresën Nr. 377/3 Prot., datë 13.09.2018, raporti i hetimit të thelluar iu dërgua ndërmarrjes SGS, duke e ftuar që të depozitonte me shkrim prapësimet lidhur me konkluzionet e raportit, si dhe çdo dokument tjetër të nevojshëm. Në vijim të kësaj shkrese, pranë Autoritetit të Konkurrencës u depozituan pretendimet e ndërmarrja SGS Nr. 1048 Prot., datë 15.10.2018.

II. Kontrata e Koncesionit

7. Ndërmarrja SGS gëzon dhe zbaton të gjitha të drejtat dhe detyrimet që lindin nga Kontrata e Koncesionet “Për dhënien me Koncesion të shërbimit të kontrollit teknik të detyrueshëm të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të tyre në Republikën e Shqipërisë”, e cila ka për objekt “Financimin, ndërtimin, pronësinë, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e shërbimit të kontrollit teknik të detyrueshëm të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të tyre në Republikën e Shqipërisë.
8. Koncesioni është dhënë për një periudhë prej XXX vitesh nga Data Efektive dhe përfundon në ditën e përvjetorit të XXX-të të Datës Efektive dmth nga XXX deri në XXX. Sipas kontratës, “pas një periudhe XXX vjeçare, për një zgjatje të mundshme të periudhës së Koncesionit, duke patur parasysh se Autoriteti Kontraktues mund të kërkojë zgjatjen e afatit në rastin e ekzistencës së interesit publik”, tregon se Koncesionari është pranë periudhës së rishikimit të afatit të kontratës.
9. Në mënyrë që klientët të përmbushin detyrimet e përcaktuara në Kodin Rrugor të Republikës së Shqipërisë, neni 79, dhe standardet e përcaktuara në “Manualin e Kontrollit Teknik të Automjeteve” nga Ministria së Punëve Publike Transportit dhe Telekomunikacionit (sot MIE), si dhe rregulloret ndërkombëtare në fushën e sigurisë rrugore, çdo automjet i regjistruar dhe që qarkullon në territorin e Republikës së Shqipërisë duhet t’i nënshtrohet kontrollit teknik periodik, sipas intervaleve dhe afateve të përcaktuara nga ligji. Kontrolli teknik periodik do të kryhet për të gjitha mjetet me motor të transportit rrugor, pasi të jetë kryer më parë kontrolli i përgjithshëm vjetor sipas udhëzimeve që nxjerr Ministria që mbulon veprimtarinë përkatëse.
10. Në bazë të pikës 3.4.1 të Kontratës Koncesionare, Koncesionari do të ketë të drejtën ekskluzive në lidhje me Shërbimin gjatë Periudhës Koncesionare dhe në përputhje me Manualin e Kontrollit të Mjeteve. Në përfundim të Periudhës Koncesionare, Koncesionari do t’i kthejë Autoritetit Kontraktues përdorimin e QKT Ekzistuese, si dhe do t’i transferojë pa pagesë Autoritetit Kontraktues pronësinë mbi QKT e Re, QKTL si dhe mbi të gjitha Pajisjet Elektromekanike dhe Kompjuterike (si ato të QKT Ekzistuese ashtu dhe ato të QKT të Re si dhe QKTL).
11. Pranë Autoritetit Kontraktues (MIE) është ngritur Njësia e Zbatimit të Projektit Koncesionar, e cila duhet të monitoroj dhe kontrolloj periodikisht dhe vazhdimisht Koncesionarin lidhur me kushtet e zbatimit të Koncesionit në formën që do ta gjykojnë të përshtatshme dhe të arsyeshme.
12. Sipas përkufizimeve të dhëna në Kontratën Koncesionare, “Shërbimi i Kontrollit Teknik të Detyrueshëm të Mjeteve Rrugore me Motor dhe Rimorkiove të tyre” ose “Shërbimi” do të thotë shërbimi ekskluziv që do të ofrojë Koncesionari në përputhje me këtë Kontratë, duke përjashtuar certifikimet dhe kontrollet për mjetet shtetërore që në përputhje me praktikën qeveritare në fuqi në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate i nënshtrohen kontrollit nga Ministria e Brendshme dhe Ministria e Mbrojtjes, kurse “Klient” do të thotë personi që paraqitet me një mjet me motor dhe/ose rimorkio për kryerjen e Shërbimit të Kontrollit të Detyrueshëm Teknik të Mjeteve Rrugore me Motor dhe Rimorkiove të tyre pavarësisht nëse është pronari i një mjeti të tillë apo jo.

III. Roli dhe ndërhyrja e Autoritetit të Konkurrencës

13. Lidhur me tregun e shërbimit të kontrollit teknik të detyrueshëm të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të tyre në Republikën e Shqipërisë, Autoriteti i Konkurrencës, pasi ka kryer vlerësimin e këtij tregu ka dhënë disa rekomandime për Autoritetin Kontraktues dhe ndërmarrjen SGS, si vijon:

13.1 Vendimi Nr. 312, datë 18.04.2014 “Për disa rekomandime në lidhje me funksionimin e tregut të shërbimit të kontrollit teknik të automjeteve” në të cilën është vendosur:

1. “T”i rekomandojë Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës:

- Në periudha afatshkurtër të kërkojë nga SGS të krijojë më shumë se një mundësi për zgjedhjen e konsumatorit për kryerjen e kontrollit të detyrueshëm teknik vjetor të automjeteve në qytetin e Tiranës.
- Në periudha afatgjatë të shikohet mundësia e ofrimit të kontrollit teknik të automjeteve nga disa operatorë.
- Të kërkojë shprehjen e mendimit të Autoritetit të Konkurrencës në zbatim të nenit 69-70 të Ligjit, pasi të marrë studimin e tregut nga koncensionari në lidhje me mënyrën e funksionimit të shërbimit të kontrollit teknik të detyrueshëm;
- Të marrë parasysh direktivën e re të BE-së lidhur me rregullat e reja për koncesionet duke zbatuar parimin e transparencës dhe të përcaktojnë kriterin e “tenderit me avantazhin më të mirë ekonomik” përgjatë procedurave të prokurimit, ku autoritetet publike do t’i mëshojnë rëndësisë mbi cilësinë, pasojave mbi mjedisin, aspekteve sociale ose risive, si dhe duke pasur parasysh çmimin si dhe jetëgjatësinë-ciklin-koston e asaj çfarë prokurohet për tu dhënë si e drejtë ekskluzive ose e veçantë.”.

13.2 Vendimi Nr. 416, datë 18.05.2016 “Për disa rekomandime për rishikimin e tarifave dhe mbi hapjen e tregut të shërbimit të kontrollit teknik të automjeteve.” në të cilën është vendosur:

2. “T”u rekomandojë palëve kontraktore të koncensionit, Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, si dhe ndërmarrjes koncensionare “SGS Automotive Albania” SHPK, që:
- Para ndryshimit të tarifave të shërbimit që pritet të ndodhin në muajin Shtator 2016, palët duhet të paraqesin pranë Autoritetit të Konkurrencës, informacionet përkatëse mbi analizën ekonomike për vendosjen e këtyre tarifave të reja.
 - SGS duhet të rishikojë dhe ndryshojë përmbajtjen e paragrafit të tretë, të Deklaratës-Tip që nënshkruhet nga klientët para dorëzimit të dokumentacionit të kërkuar, duke përcaktuar në të shkaktarin e dëmit si dhe vënien e tij përpara përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar.
 - Ministria e Transportit dhe e Infrastrukturës duhet të marrë masa për hapjen e këtij tregu për konkurrencën, sipas praktikave dhe standardeve më të mira ndërkombëtare pas përfundimit të periudhës koncesionare.”.

IV. Tregu Përkatës

14. Tregu përkatës përfshin produktet që vlerësohen si të zëvendësueshme nga konsumatorët dhe operatorët, për sa u përket karakteristikave, çmimit dhe funksionit të tyre dhe që ofrohen ose kërkohen nga ndërmarrjet në një zonë gjeografike me kushte të njëjta konkurrence. Përkufizimi i tregut përkatës përfshin dy dimensione:

- c) Tregu përkatës i produktit
- d) Tregu përkatës gjeografik

15. Tregu përkatës i produktit⁸ përcaktohet si: *“Një treg përkatës i produktit përfshin të gjitha ato mallra dhe/ose shërbime të cilat vlerësohen si të këmbyeshme ose të zëvendësueshme nga konsumatori, për arsye të karakteristikave të prodhimit, çmimeve dhe qëllimit të përdorimit të tyre”*. Kriteret për përcaktimin e tregut përkatës janë: zëvendësueshmëria nga ana e kërkesës, zëvendësueshmëria nga ana e ofertës, konkurrenca potenciale dhe barrierat e hyrjes në treg.
16. Në përputhje me Kontratën Koncesionare, tregu i shërbimit të kontrollit teknik të detyrueshëm të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të tyre është treg i modelit të centralizuar (i ndarë nga shërbimi i servisit), me një ndërmarrje të vetme të ofrimit të shërbimit, ku monopoli do të vazhdojë deri në 3 Shtator 2019, me mundësi rinegociimi për periudhën në vazhdim në këtë treg.
17. Pra, referuar sa më sipër, tregu përkatës i produktit është shërbimi i kontrollit teknik të detyrueshëm të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të tyre.
18. Tregu përkatës gjeografik përfshin zonën në të cilën ndërmarrjet janë përfshirë në ofertën dhe kërkesën e shërbimit, në të cilën kushtet e konkurrencës janë mjaftueshëmrisht homogjene. Zona gjeografike e shërbimit të kontrollit teknik të detyrueshëm të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të tyre është territori i Republikës së Shqipërisë.
19. Si përfundim, tregu përkatës është shërbimi i kontrollit teknik të detyrueshëm të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë.

V. Vlerësimi i Pozitës Dominuese

20. Në bazë të nenit 3, pika 5 të Ligjit Nr. 9121/2003, “Pozitë dominuese” është ajo fuqi ekonomike e mbajtur nga një ose më shumë ndërmarrje, që i jep atyre mundësinë për të penguar konkurrencën efektive në treg, duke i bërë ato të afta të veprojnë, për sa i takon ofertës ose kërkesës, në mënyrë të pavarur nga pjesëmarrësit e tjerë në treg, si konkurrentët, klientët ose konsumatorët.
21. Sipas Ligjit Nr. 9121/2003, pasja e një pozite dominuese nga një ndërmarrje në treg nuk është e ndaluar, por zotërimi i pozitës dominuese i jep ndërmarrjes një detyrim të veçantë për të mos abuzuar me këtë pozitë dominuese.
22. Një nga kriteret bazë, nga e cila fillon analiza e pozitës dominuese është pjesa e tregut që zënë ndërmarrjet në tregun përkatës. Praktikën më të mira të vendeve të Bashkimit Evropian sugjerojnë se sa më e madhe të jetë pjesa e tregut dhe sa më e gjatë periudha që ndërmarrja zotëron një pjesë të tillë tregu, aq më e mundur është që ky element të jetë një tregues i rëndësishëm për një pozicion dominues dhe të justifikojë në rrethana të caktuara ndërhyrjen e Autoritetit⁹.
23. Në tregun përkatës, ndërmarrja SGS zotëron XXX% të pjesëve të tij, pasi në zbatim të Kontratës Koncesionare ka ekskluzivitetin e ofrimit të shërbimit të kontrollit teknik të detyrueshëm të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë.
24. Edhe nga analiza e kriterëve të tjera të vlerësimit të pozitës dominuese, sipas nenit 8 të Ligjit Nr. 9121/2003, rezulton se ndërmarrjes SGS i është dhënë një e drejtë ekskluzive për ofrimin e shërbimit të kontrollit teknik të detyrueshëm të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe në treg nuk mund të ushtrojë veprimtari asnjë ndërmarrje tjetër, si dhe nuk ka asnjë konkurrent potencial në tregun përkatës. Gjithashtu klientët e ndërmarrjes SGS nuk kanë asnjë fuqi kundërvepruese ndaj kësaj ndërmarrjeje, pasi kryerja e kontrollit teknik të mjeteve rrugore me motor

⁸Bazuar në Udhëzimin “Për përcaktimin e Tregut Përkatës” neni 3, pika 7, i Ligjit 9121/2003.

⁹Komunikim nga Komisioni. Udhëzim mbi sjelljet përjashtuese, lidhur me zbatueshmërinë e nenit 82 -Guidance on the Commission's enforcement priorities in applying Article 82 of the EC Treaty to abusive exclusionary conduct by dominant.

dhe rimorkiove të tyre është një shërbim i detyrueshëm sipas Kodit Rrugor dhe në territorin e Republikës së Shqipërisë kryhet vetëm nga ndërmarrja SGS.

25. Si përfundim, ndërmarrja SGS është e vetme në tregun përkatës, duke zotëruar XXX% të pjesëve të tregut të shërbimi i kontrollit teknik të detyrueshëm të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë, gjë e cila në kuptim të nenit 8 të Ligjit Nr. 9121/2003 përbën pozitë dominuese në tregun përkatës.

VI. Vlerësimi i sjelljes së ndërmarrjes në treg

26. Ndërmarrja nën hetim SGS është me pozitë dominuese në tregun e shërbimit të kontrollit teknik të detyrueshëm të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë, në kuptim të nenit 8 të Ligjit Nr. 9121/2003, duke qenë e vetmja ndërmarrje në ofrimin e këtij shërbimi. Pasja e pozitës dominuese në kuptim të Ligjit Nr. 9121/2003 nuk është e ndaluar, por ndërmarrja që e zotëron këtë pozitë nuk duhet ta përdorë këtë pozitë për të abuzuar ndaj konkurrentëve apo klientëve të saj.
27. Siç e kemi përmendur edhe më sipër, ndërmarrja SGS në tregun përkatës nuk ka konkurrentë të tjerë, pasi është e vetme në ofrimin e këtij shërbimi në territorin e Republikës së Shqipërisë. Atëherë sjelljen e ndërmarrjes me pozitë dominuese SGS do ta vlerësojmë në lidhje me kushtet dhe shërbimin që u ofron klientëve të saj.

a. Deklarata Tip

28. Nga inspektimet e kryera në ndërmarrjen SGS rezulton se klientët për të marrë shërbimin e kontrollit teknik pranë QKT-ve të kësaj ndërmarrjeje duhet të paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm:
- Fotokopje e kontratës së sigurimit të detyrueshëm (TPL e brendshme), kontratë e cila duhet të jetë e vlefshme në momentin e kryerjes së kontrollit të plotë teknik të automjetit;
 - Lejen e qarkullimit, për mjetin që do të kontrollohet;
 - Vërtetimin e pagesës së taksës vjetore të mjetit rrugor;
 - Nënshkrimi i një “Deklaratës-tip” nga ana e klientit, e kërkuar nga ana e koncesionarit duke marrë përsipër të heqë nga përgjegjësia çfarëdo dëmtimi (elektrik apo mekanik, në paragrafin e 3-të deklarates) që mund t’i ndodhë automjetit në territorin/mjedisin e koncesionarit, gjatë procesit të kontrollit teknik. Kjo kopje mbahet nga koncesionari dhe nuk i vihet në dispozicion klientëve pas nënshkrimit të tij.
29. Komisioni i Konkurrencës me Vendimin Nr. 416 datë 18.05.2016 “Për disa rekomandime për rishikimin e tarifave dhe mbi hapjen e tregut të shërbimit të kontrollit teknik të automjeteve” i ka rekomanduar ndërmarrjes SGS: “1.2.Koncesionari duhet të rishikojë dhe ndryshojë përmbajtjen e paragrafit të tretë, të Deklaratës-Tip që nënshkruhet nga klientët para dorëzimit të dokumentacionit të kërkuar, duke përcaktuar në të shkaktarin e dëmtit si dhe vënien e tij përpara përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar.”.
30. Në lidhje me këtë rekomandimin nga inspektimet e realizuara pranë ndërmarrjes SGS, rezultoi se kjo ndërmarrje nuk e ka marrë në konsideratë dhe vazhdon të kërkojë nga klientët e saj nënshkrimin e Deklaratës-tip, e cila në pikën 3 të saj parashikon si vijon:
- “SGS nuk mban asnjë përgjegjësi, të çfarëdo lloji qoftë, për çdo dëmtim që mund t’i shkaktohet automjetit në fjalë gjatë procesit të kontrollit teknik, dëmtim i cili mund të vijë si pasojë e çfarëdo problem mekanik apo elektrik në automjet”.*

31. Ndërmarrja SGS mund të nënshkruajë rregullisht kontratën e sigurimit për përgjegjësinë profesionale me operatorët e sigurimeve në Republikën e Shqipërisë për mbulimin e dëmit të shkaktuar nga punonjësit e saj gjatë ushtrimit të kontrollit të automjeteve, por ekzistenca e kësaj deklarate-tip, pika tre e saj, bën të mundur lënien e fajit tek klientët që e nënshkruajnë këtë deklaratë për dëmet që u shkaktohen makinave nga pajisjet, përveç punonjësve, në momentin e testimit të tyre.
32. Klientët pa nënshkrimin e kësaj deklarate-tip të përpiluar nga ndërmarrja SGS, nuk mund të kryejnë kontrollin teknik të detyrueshëm të mjetit të tyre. Në rast të moskryerjes së kontrollit teknik të mjetit, klienti nuk mund të përdorë mjetin e tij për qarkullim dhe për këtë arsye detyrohet ta nënshkruajë këtë deklaratë-tip, sipas përmbajtjes së miratuar nga ndërmarrja me pozitë dominuese SGS. Pra, ndërmarrja me pozitë dominuese SGS, për ofrimin e shërbimit të kontrollit teknik për të cilin është ofruesi i vetëm në Republikën e Shqipërisë, vendos kushte shtesë ndaj klientëve të saj në kuptim të nenit 9, pika 2, gërma (ç) të Ligjit Nr. 9121/2003.
33. Kjo sjellje e ndërmarrjes me pozitë dominuese SGS në tregun e shërbimit të kontrollit teknik të detyrueshëm të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë, duke detyruar klientët e saj për të nënshkruar deklaratën-tip përpara kryerjes së kontrollit teknik të detyrueshëm të mjeteve për të përjashtuar nga përgjegjësia ndërmarrjen SGS për çdo dëmtim që mund ti shkaktohet mjetit gjatë kontrollit teknik, përbën abuzim me pozitën dominuese në kuptim të nenit 9, pika 2, gërma (ç) të Ligjit Nr. 9121/2003.

b. Kushtet e Ofrimit të Shërbimit

34. Referuar fluksit të mjeteve që u drejtohen QKT-vë për të kryer kontrollin teknik të detyrueshëm, rezulton se muaji Dhjetor është me fluksin me të lartë, me XXX mjete në vitin 2016 dhe XXX mjete në vitin 2017.
35. Nga të dhënat e dërguara nga MIE, rezulton se nga ana e përfaqësuesve të Njesisë së Zbatimit të Projektit Koncesionar, në muajin Dhjetor 2017, në zbatim të nenit 12 të Kontratës Koncesionare, janë ushtruar kontrole dhe monitorime pranë QKT-ve dhe janë përpiluar raporte përmbledhës mbi gjetjet e monitorimit të kryer prej NJZPK pranë disa QKT-ve të ndërmarrjes SGS, si dhe masat që duhet të merren për parregullsitë e vërejtura.
36. Referuara raporteve të monitorimit të NJZPK, rezulton se pavarësisht se QKT përballeshin me një fluks të madh mjetesh të cilat i nënshtroheshin kontrollit teknik, nga ana e Koncesionarit nuk vireshin në përdorim Qendrat e Kontrollit Teknik të Lëvizshme (QKTL), të cilat nisur dhe nga vetë karakteristika kryesore e tyre, që është lëvizshmëria për t'u përdorur në vende të ndryshme, mund të instaloheshin pranë atyre QKT-ve të cilat shfaqeshin me problematiket sa i përket fluksit të madh të automjeteve që do t'i nënshtroheshin kontrollit teknik. Në këtë mënyrë, QKTL do të ishin një zgjidhje për zbutjen e fluksit të automjeteve për kontroll teknik, duke ndikuar kështu në mbarëvajtjen e punëve pranë QKT-ve, dhe duke zbatuar kështu edhe një kusht themelor kontraktual.
37. Në lidhje me QKTL-të, sipas konstatimeve të kryera nga NJZPK, rezulton se ato nuk janë përdorur në asnjë rast, dhe nuk janë të plotësuara me të gjithë elementet e nevojshëm për kryerjen e kontrollit të plotë të mjeteve, sipas përcaktimeve të manualit teknik. Gjatë kontrollit të kryer pranë QKT-së Tirana 2, pranë së cilës ishin stacionuar 3 QKTL-të, rezulton se, këto QKTL nuk ishin të pajisura me të gjithë pajisjet e domosdoshme për kryerjen e të gjitha kontrolleve të parashikuara në Udhëzimin nr. 2, datë 11.03.2010 "Mbi kontrollin teknik të mjeteve rrugore", duke bërë që Koncesionari të mos ketë përmbushur detyrimin për mirëmbajtjen dhe mbi të gjitha mbajtjen e tyre në një gjendje funksionale gjatë orarit të punës. Aq më tepër që, me gjithë konstatimet e vetë koncesionarit për fluksin e madh dhe të papërbalueshëm në periudha të caktuara gjatë vitit dhe në zona të caktuara, rezulton se, Koncesionari nuk ka vënë në përdorim këto QKTL.

38. Pra, ndërmarrja me pozitë dominuese SGS, megjithëse është në dijeni të fluksit të madh të mjeteve që duhet të kryejnë kontrollin teknik të detyrueshëm në periudha të caktuara të vitit, nuk i ka vënë asnjëherë në përdorim QKTL-të për të shmangur radhët e gjata dhe për të ofruar kushte të kënaqshme për ofrimin e shërbimit për klientët e saj.
39. Ndërmarrja SGS duke qenë e vetme në tregun e shërbimit të kontrollit teknik të detyrueshëm të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë nuk ka konkurrentë potencial në këtë treg, pasi në bazë të kontratës koncesionare ka ekskluzivitetin e këtij shërbimi për të gjithë periudhën e koncesionit dhe klientët e saj nuk kanë fuqi kundërvepruese sepse në rast të moskryerjes së kontrollit teknik të mjetit, ata nuk mund të përdorin mjetin e tyre për qarkullim, pasi rrezikojnë penalizimin në bazë të Kodit Rrugor.
40. Ndërmarrja SGS, duke qenë e vetme në treg dhe pa konkurrentë potencialë të cilët mund të preknin pozitën e saj në tregun përkatës, megjithëse është në dijeni të fluksit të mjeteve që kërkojnë të kryejnë kontrollin teknik të detyrueshëm sipas ligjit, sipas raporteve të monitorimit të NJZPK nuk ka vënë asnjëherë në punë QKTL-të sipas parashikimeve të Kontratës Koncesionare për të ulur fluksin pranë QKT-ve me fluks më të lartë dhe për të shmangur radhët e gjatë të klientëve të saj, gjë e cila i vendos ata (klientët) përpara kushteve të padrejta të tregtimit nga ana e SGS-së, në kuptim të nenit 9, pika 2, gërma (a) e ligjit Nr. 9121/2003.
41. Kjo sjellje e ndërmarrjes me pozitë dominuese SGS në tregun e shërbimit të kontrollit teknik të detyrueshëm të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë, duke i vendosur klientët e saj përpara kushteve të padrejta të tregtimit, përbën abuzim me pozitën dominuese në kuptim të nenit 9, pika 2, gërma (a) të ligjit Nr. 9121/2003.
42. Si përfundim, referuar analizës së tregut të shërbimit të kontrollit teknik të detyrueshëm të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë, rezulton se ndërmarrja me pozitë dominuese SGS, për periudhën nën hetim (1 Qershor 2016 deri në 31 Dhjetor 2017), ka vendosur kushte shtesë dhe të padrejta tregtimi ndaj klientëve të saj, gjë e cila, në zbatim të nenit 9, pika 2, gërma (a) dhe (ç) të ligjit nr. 9121/2003, përbën abuzim me pozitën dominuese, me pasojë të rënda për konkurrencën në treg.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të nenit 8, nenit 9, pika 2 gërmat (a) dhe (ç), nenit 24, shkronja (d), nenit 26, nenit 43, pika 5, nenit 45, pika 1, nenit 70, nenit 74, pika 1, gërma (a) dhe nenit 75, pika 1, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar dhe Rregullores së Autoritetit të Konkurrencës “Për gjobat dhe lehtësimin prej tyre”:

VENDOSI:

1. Konstatimin e abuzimit me pozitën dominuese të ndërmarrjes “SGS Automotive Albania” SHPK në tregun e shërbimit të kontrollit teknik të detyrueshëm të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë ;
2. Gjykitjen e ndërmarrjes “SGS Automotive Albania” SHPK për shkelje të konkurrencës, konkretisht të nenit 9, pika 2, gërmat (a) dhe (ç), të Ligjit Nr. 9121/2003, në masën 5.69 % të xhiros totale të ndërmarrjes për vitin paraardhës financiar (2017), përkatësisht në shumën XXX (XXX) Lekë;
3. Detyrimin e ndërmarrjes “SGS Automotive Albania” SHPK për të ndaluar shkeljen e konkurrencës dhe brenda 45 ditëve të marrë masat e nevojshme, si vijon:

- a) Të zbatohet në mënyrë të menjëhershme detyrimin ligjor për ofrimin e shërbimit cilësor, të kënaqshëm, duke vënë në përdorim QKTL-të pranë QKT-ve me fluksin më të madh të klientëve;
 - b) Të vendoset në funksionim 100% të kapacitetit të të gjitha QKT-ve dhe QKTL-ve;
 - c) Heqjen e pikës tre nga Deklarata–Tip që nënshkruhet nga klientët para dorëzimit të dokumentacionit të kërkuar;
 - d) Hartimi i një plani për rishikimin e rishpërndarjes së posteve të ofrimit të shërbimit, me qëllim rritjen e efikasitetit dhe ngritjen e nivelit të shërbimit, në kuptimin që në ato QKT ku postet janë të papërdorura, apo në një nivel të ulët përdorimi, të mund të sillen drejt QKT-ve ku ka fluks më të lartë;
 - e) Të hartohet një plan masash për ofrimin dhe përmirësimin e shërbimit në tregun e kontrollit teknik për automjetet, me kushte më të mira tregtimi në përputhje me kontratën, dhe të njoftohet pranë Autoritetit të Konkurrencës;
4. T'i rekomandohet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë si vijon:
- a) Liberalizimin e tregut në drejtim të ofrimit të këtij shërbimi, duke përfshirë edhe ofrimin e shërbimit të servisit, sikurse pjesa më e madhe e vendeve të BE e ofron.
 - b) Për kohën e vazhdimin të këtij koncensionari, brenda një afati prej 90 ditëve:
 - i. të miratohet një rregullore për funksionimin dhe monitorimin e Koncensionarit SGS, ku të jenë përcaktuar në mënyrë të detajuar të gjitha procedurat, shërbimet që ofrohen nga ana e Tij,
 - ii. miratimin e planit të investimeve vjetore, me qëllim që shërbimi të jetë cilësor dhe t'i përgjigjet trendeve të zhvillimit, për rritjen e fluksit të mjeteve çdo vit si edhe shpërndarjes së popullsisë.
 - c) Rishikimin e manualit teknik dhe sidomos të afatit të testimit të mjeteve për t'u pajisur me çertifikatën e kontrollit teknik
 - d) Plotësimi i akteve ligjore dhe nënligjore duke përcaktuar qartë rolin e organeve shtetërore në lidhje me marrëdhëniet midis ndërmarrjes Koncesionare, që ka në menaxhim dhe administrim infrastrukturën e QKT-ve dhe mënyra e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve midis tyre nga organet rregullatorë.
5. Mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e shërbimit të kontrollit teknik për automjetet në Republikën e Shqipërisë.

Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 564 Datë 25.10.2018

“Për hapjen procedurës së hetimit paraprak ndaj Federatës Shqiptare të Futbollit në lidhje me aktivitetin ekonomik që zhvillon”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 25.10.2018, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Hapja procedurës së hetimit paraprak në tregun e veprimtarive ekonomike që zhvillohen nga Federata Shqiptare e Futbollit.

Baza ligjore: Neni 4, neni 8, neni 9 dhe neni 42 i Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar (Ligji Nr. 9121/2003).

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës;

VËREN SE:

1. Rregullat e funksionimit dhe të organizimit të sportit në Republikën e Shqipërisë përcaktohen në Ligjin Nr. 79/2017 “Për Sportin” dhe në bazë të nenit 3, pika 6 të këtij ligji “Federata sportive” është personi juridik, që krijohet në formën e shoqatës, anëtarë të së cilës janë shoqatat sportive, shoqëritë sportive dhe klubet sportive që ushtrojnë veprimtari në një sport të caktuar, dhe që ka për qëllim organizimin, zhvillimin, promovimin, kontrollin, rregullimin dhe përhapjen e një sporti të caktuar në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.
2. Detyrat e federatave janë përcaktuar në nenin 18 të këtij ligji dhe asnjë person juridik, privat ose publik, nuk mund të ushtrojë asnjë nga kompetencat ekskluzive të federatës, vetëm nëse ato i janë dhënë zyrtarisht prej saj.
3. Në bazë të statutit, FSHF-ja është person juridik, shoqatë, e cila përfaqëson bashkimin vullnetar të shoqatave dhe klubeve sportive të futbollit në Republikën e Shqipërisë, të cilat veprojnë në përputhje me dispozitat e Kodit Civil, Ligjit Nr. 8789, datë 27.05.2001 “Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse”, Ligjit Nr. 79/2017 “Për Sportin”, dhe akte të tjera ligjore e nënligjore që drejtojnë këtë aktivitet.
4. FSHF-ja, sipas nenit 51 të statutit, zhvillon veprimtarinë futbollistike në Republikën e Shqipërisë nëpërmjet organizimit të garave me shtrirje kombëtare, rajonale apo lokale. Struktura e garave ndërtohet gjithashtu në përputhje me cilësinë sportive, gjininë, moshën, llojin e futbollit dhe marrëdhënien profesionale.
5. Në nenin 55 të statutit, përcaktohet se FSHF-ja dhe anëtarët e tij janë pronarët origjinale të të gjitha të drejtave që dalin nga garat dhe ngjarje të tjera që vijnë nga juridiksioni respektiv i tyre. Këto të drejta përfshijnë, midis të tjerash, çdo lloj të drejtë financiare, audiovizuale dhe regjistrim në radio, të drejtat e riprodhimit dhe transmetimit, të drejtat e medias, të drejtat e marketingut dhe reklamave dhe të drejtat

për jo-materiale si emblemat dhe të drejtat që dalin mbi bazën e ligjit shqiptar për të drejtat e autorit.

6. Ligji Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, në nenin 2, pika 1, gërma (a) përcakton se ky ligj zbatohet për ndërmarrjet dhe grupimet e ndërmarrjeve, të cilat, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, ndikojnë ose mund të ndikojnë në treg.
7. Referuar përkufizimit të nenit 3, pika 1, të Ligjit Nr. 9121/2003, “Ndërmarrje” është çdo person fizik ose juridik, privat a publik, që kryen veprimtari ekonomike. Si ndërmarrje konsiderohen edhe organet e administratës qendrore e vendore, si dhe entet ose institucionet publike, kur kryejnë veprimtari ekonomike.
8. Sipas përkufizimit të nenit 3, pika 3, të Ligjit Nr. 9121/2003, “Veprimtari ekonomike” është veprimtaria prodhuese, tregtare, financiare ose profesionale, që shoqërohet me blerjen dhe shitjen e mallrave dhe/ose me ofrimin apo përfundimin e shërbimeve.
9. Në bazë të nenit 26 të Kodit Civil, persona juridikë privatë janë shoqëritë, shoqatat, fondacionet dhe entet e tjera me karakter privat, të cilat e fitojnë personalitetin juridik në mënyrën e caktuar nga ligji.
10. FSHF-ja si organizatore e veprimtarive sportive është pronare e të drejtës së transmetimit të veprimtarisë futbollistike, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë me konkurrim publik. Me veprimtari futbollistike do të kuptohet kampionati kombëtar i futbollit “Kategoria Superiore”, kampionati kombëtar i “Kategoria e Parë” dhe “Kupa e Shqipërisë”.
11. Në Bashkimin Evropian ekziston një praktikë e gjerë mbi ndërhyrjen e Konkurrencës për të rregulluar tregun në sektorin e sportit të futbollit, pasi konsiderohen subjekte që i nënshtrohen ligjit të konkurrencës, si subjekte që zhvillojnë aktivitet ekonomik.
12. Vendimi i Komisionit Evropian në rastin *Bosman* (Rasti C-415/93) luajti një rol domethënës në zhvillimin e konkurrencës në sektorin e sportit. Vendimi konfirmoi se sporti është subjekt i të gjitha Traktateve të KE në lidhje me aktivitetet ekonomike që gjeneron. Aktivitetet ekonomike konsiderohen: shitja e biletave, transferimi i lojtarëve, shpërndarja e artikujve komercialë, lidhja e kontratave të reklamave dhe sponsorizimit, shitjen e të drejtave të transmetimit.
13. Komisioni Evropian i Konkurrencës në rastin e Bundesligës Gjermane, vuri në dukje se shitja ekskluzive e të drejtave të transmetimit komercial nga Shoqata e Ligës mund të kufizojë konkurrencën mes klubeve dhe kompanive në divizionin e parë dhe të dytë Gjerman. Në këtë rast u vendosen angazhime për Shoqatën e Ligës për futjen e konkurrencës në marketingun e Bundesligës së parë dhe të dytë duke zvogëluar qëllimin dhe kohëzgjatjen e marrëveshjeve të ardhshme të marketingut për të siguruar një procedurë transparente dhe jodiskriminuese të marketingut. Ato përmirësojnë aksesin e përmbajtjes për operatorët e TV, radio dhe mediave të reja, sigurojnë se të gjitha të drejtat janë duke u vënë në dispozicion të tregut dhe në këtë mënyrë kontribuojnë në inovacion dhe në zbutjen e tendencave të përqendrimit në tregjet e mediave.
14. Komisioni Evropian i Konkurrencës sqaroi se pavarësisht nga forma e tyre ligjore, klubet janë ndërmarrje brenda kuptimit të ligjit të konkurrencës, për shkak se ato angazhohen në një shumëllojshmëri aktivitetesh ekonomike si shitja e biletave për ndeshjet, transferimin e lojtarëve, shitjen e mallrave, përfundimin e marrëveshjeve të reklamimit dhe sponsorizimit, dhe shitjen e të drejtave të transmetimit.
15. Vendimi i Gjykatës Evropiane të Drejtësisë në rastin *Walrave* përcaktoi se Ligji i Bashkimit Evropian zbatohet për sportet, përderisa praktika përbën një aktivitet ekonomik brenda Bashkimit. (Rasti 36/74) Gjykata e Drejtësisë së Komunitetit Evropian thekson se duke patur parasysh objektivat e Komunitetit, praktikat e sportit i nënshtrohen ligjit të Komunitetit vetëm për atë sa ajo përbën një aktivitet ekonomik brenda kuptimit të nenit 2 të Traktatit.

16. Në bazë të ligjit 79/2017 “Për sportin”, FSHF është entiteti i vetëm të cilit shteti i ka deleguar të drejtën e organizimit dhe zhvillimit të veprimtarive sportive, kombëtare e ndërkombëtare në sportin e futbollit. Konform këtij ligji, FSHF si organizatore e vetme e veprimtarive sportive, është pronare e të drejtës së transmetimit të veprimtarisë futbollistike brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, me konkurrim publik.
17. FSHF, bazuar sa më sipër ka realizuar procedurën e konkurrimit publik, më datë 12.04.2018, me objekt “Shitje e të drejtës së transmetimit të ndeshjeve të kampionatit Kategoria Superiore dhe Kupa e Shqipërisë, për territorin e Republikës së Shqipërisë”.
18. Nga kjo procedurë vërehet se nga 6 kompani të ftuara, vetëm 2 të tilla kanë paraqitur ofertat e tyre dhe njëra prej të cilave pa dokumentacionin e plotësuar, dhe si rezultat në procedurën e konkurrimit ka marrë pjesë vetëm një kompani. Kjo situatë sjell dyshime se nuk ka patur procedurë konkurruese, si dhe kriteret në procedurën e prokurimit mund të jenë përjashtuese për ndërmarrje të tjera. Gjithashtu, afati 4 vjeçar për shitjen e kësaj të drejte mund të përbëjë kufizim të konkurrencës, për faktin se ky është një afat i cili i krijon potencialisht kompanisë fituese, ekskluzivitetin afat gjatë në tregun e transmetimit audioviziv.
19. Gjithashtu një situatë tjetër, e cila sjell dyshim, është ajo e ngritur në median e shkruar dhe të audiovizive lidhur me shqetësimet e ngritura mbi aplikimin e çmimeve e biletave të cilat nga më të lartat në rajon, jo fleksibël dhe pothuajse në nivelin e vendeve më të zhvilluara ekonomikisht. E gjitha kjo ndikon në pjesëmarrjen e ulet të sportdashësve në stadium gjë që bie ndesh me qëllimin e FSHF-së në rritjen e popullaritetit të këtij sporti dhe mbështetjes të Ekipit Kombëtar.
20. Referuar sa më sipër, rezulton se FSHF kryen aktivitet ekonomik lidhur me: shitjen e të drejtave të transmetimit; shitjen e biletave; transferimin e lojtarëve; shpërndarjen e artikujve komercialë; lidhjen e kontratave të reklamave dhe sponsorizimit i cili sipas parashikimeve të Ligjit Nr. 9121/2003 dhe sipas praktikës së BE-së dhe vendeve anëtare të saj, përfshihet në objektin e veprimtarisë dhe fushën e zbatimit të Ligjit Nr. 9121/2003.
21. Përveç aktiviteteve të zakonshme ekonomike, FSHF-së i janë dhënë edhe disa të drejta ekskluzive nga shitja e të cilave gjenerohen të ardhura dhe për shkak të këtij ekskluziviteti FSHF-ja zotëron pozitë dominuese në kuptim të nenit 8 të Ligjit Nr. 9121/2003.
22. Për sa më sipër, realizimi i procedurave të konkurrimit publik të realizuara nga FSHF për shitjen e të drejtave të transmetimit me afate 4-vjeçare si dhe përcaktimi i kriterëve të kësaj procedure sjell dyshime për kufizime të mundshme të konkurrencës referuar neneve 4 dhe 9 të ligjit.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4, nenin 8, nenin 9 dhe nenin 42 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Hapjen e procedurës së hetimit paraprak ndaj Federatës Shqiptare të Futbollit në lidhje me aktivitetin ekonomik që zhvillon për periudhën Janar 2015 – Dhjetor 2018;
 2. Raporti i hetimit paraprak duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se 3 (tre) muaj nga dita e çeljes së këtij hetimi.
 3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 567, Datë 07.11.2018

“Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes “EMS-Albanian Port Operator” SHPK, në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkimit dhe aktivitetet e lidhura me to, për mallrat rifuxho në Terminalin Lindor të Portit të Durrësit dhe dhënien e disa rekomandimeve”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 07.11.2018, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Mbyllja e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes “EMS-Albanian Port Operator” SHPK, në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkimit dhe aktivitetet e lidhura me to, për mallrat rifuxho në Terminalin Lindor të Portit të Durrësit dhe dhënien e disa rekomandimeve për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Autoritetin Potual Durrës (APD) dhe ndërmarrjen “EMS-Albanian Port Operator” SHPK.

Baza ligjore: Neni 24, shkronja (d), neni 26, neni 8, neni 43 dhe neni 70 i Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar (Ligji Nr. 9121/2003).

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit të hetimit të thelluar në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkimit dhe aktivitetet e lidhura me to, për mallrat rifuxho në Terminalin Lindor të Portit të Durrësit dhe relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës;

VËREN SE:

I. Procedura e ndjekur

1. Bazuar në ankesën e paraqitur pranë Autoritetit të Konkurrencës nga ndërmarrja “Albanian Stevedoring Company” SHPK (ASC) kundrejt ndërmarrjeve: “EMS Albanian Port Operator (EMS APO)” SHPK; “German Albanian Logistic Agency” SHPK (GALA); dhe “EMS Shipping & Trading” GmbH (EMS), filluan procedurat për vlerësimin e ankesës në zbatim të Ligjit Nr. 9121/2003.
2. Pas shqyrtimit të raportit mbi vlerësimin e ankesës së ndërmarrjes ASC dhe relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, në mbështetje të nenit 42, pika 1, neni 9 dhe neni 24, gërma (d), të Ligjit Nr. 9121/2003, Komisioni i Konkurrencës me Vendimin Nr. 450, datë 28.02.2017 vendosi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkimit dhe aktivitetet e lidhura me to për mallrat rifuxho në Terminalin Lindor të Portit të Durrësit.
3. Gjithashtu, Komisioni i Konkurrencës vlerësoi se mund të ndodhemi përballë një situatë urgjence të parashikuar në nenin 44 të Ligjit Nr. 9121/2003, për shkak të rrezikut të kryerjes së një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm për konkurrencën, pasi ka të ngjarë të ketë shkelje të nenit 9 (abuzimi me pozitën dominuese) të këtij ligji. Bazuar në këtë vlerësim Komisioni i Konkurrencës me Vendimin Nr. 451, datë 28.02.2017 vendosi marrjen e masave të përkohshme për rivendosjen e konkurrencës në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkimit dhe aktivitetet e lidhura me to për mallrat rifuxho në Terminalin Lindor të Portit të Durrësit.

Durrësit, ndaj ndërmarrjes EMS APO.

4. Në përfundim të hetimit paraprak Komisioni i Konkurrencës konkludoi se: sjellja e ndërmarrjes me pozitë dominuese EMS APO, duke vendosur kushte të padrejta tregtimi dhe refuzuar aksesin në facilitetet e infrastrukturës që disponon ndaj ndërmarrjeve stivadore, në zbatim të nenit 9, pika 2, gërma (a) dhe (c) të Ligjit Nr. 9121/2003, mund të përbëjë abuzim me pozitën dominuese, me pasoja të rënda për konkurrencën në treg.
5. Për sa më sipër, Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të Ligjit Nr. 9121/2003, me anë të Vendimit Nr. 477, datë 12.10.2017 vendosi hapjen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes EMS APO, në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkimit dhe aktivitetet e lidhura me to, për mallrat rifuxho në Terminalin Lindor të Portit të Durrësit.
6. Për mbledhjen e fakteve dhe të dhënave të nevojshme në lidhje me hetimin, bazuar në nenet 33 dhe 34 të Ligjit Nr. 9121/2003 janë kërkuar të dhëna dhe informacion nga: Ministria e Transporteve dhe Infrastrukturës (sot Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë), Autoriteti Portual Durrës (APD) dhe ndërmarrjeve EMS APO, GALA, ASC, Liburnet-1, Egnatia-1.
7. Në bazë të nenit 36, të Ligjit Nr. 9121/2003 dhe Autorizimit të Komisionit të Konkurrencës Nr. 92 Prot., datë 01.03.2017 “Autorizim Inspektorësh”, u kryen inspektime pranë ndërmarrjeve që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkimit dhe aktivitetet e lidhura me to, për mallrat rifuxho në Terminalin Lindor të Portit të Durrësit.
8. Në përfundim të procedurës hetimore, me shkresën Nr. 506 Prot., datë 07.12.2017, raporti i hetimit të thelluar ju dërgua: MIE, APD dhe ndërmarrjeve EMS APO, ASC, Liburnet-1, Egnatia-1, duke i ftuar që të depozitonin me shkrim prapësimet lidhur me konkluzionet e raportit, si dhe çdo dokument tjetër të nevojshëm. Në vijim të kësaj shkrese, pranë Autoritetit të Konkurrencës u depozituan parashtrime nga ndërmarrjet EMS APO dhe ASC, si dhe nga APD.
9. Në zbatim të nenit 39 të Ligjit Nr. 9121/2003, Komisioni i Konkurrencës realizoi seancë dëgjimore me ndërmarrjen EMS APO më datë 12.01.2018, gjatë të cilës ndërmarrja paraqiti prapësimet e saj lidhur me raportin e hetimit. Gjithashtu, Komisioni i Konkurrencës realizoi seancë dëgjimore edhe me APD më datë 19.01.2018 dhe MIE më datë 07.03.2018. Gjithashtu, MIE pas seancës dëgjimore, me shkresën Nr. 2908/2 Prot., datë 19.03.2018, depozitoi në rrugë shkresore vlerësimin e saj lidhur me raportin e hetimit të thelluar.
10. Autoriteti i Konkurrencës në vazhdim të procedurave, me anë të Kërkesës për Informacion Nr. 506/16 Prot., datë 08.05.2018 kërkoi nga APD vënien në dispozicion të korrespondencës së plotë lidhur me ankesat për moslejimin e ushtrimit të aktivitetit në Terminalin Lindor të Portit të Durrësit, të depozituara pranë APD nga ndërmarrjet stivadore: “Albanian Stevedoring Company”, “Egnatia 1” dhe “Liburnet 1”, për periudhën 2016-2017.
11. APD me shkresën Nr. 2051/1 Prot., datë 19.06.2018 (protokolluar pranë Autoritetit të Konkurrencës me Nr. 506/17 Prot., datë 21.06.2018), dërgoi pranë Autoritetit të Konkurrencës informacionin e kërkuar.
12. Për të monitoruar situatën aktuale në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkimit dhe aktivitetet e lidhura me to për mallrat rifuxho në Terminalin Lindor të Portit të Durrësit, inspektorët e Autoritetit të Konkurrencës realizuan inspektime më datë 12.09.2018 pranë ndërmarrjeve stivadore: ASC, Liburnet 1 dhe Egnatia 1, ku u mbajtën dhe procesverbalet përkatëse “Për marrje shpjegimesh për fakte dhe dokumente që lidhen me objektin dhe qëllimin e hetimit”.
13. Sipas shpjegimeve të dhëna nga ndërmarrjet që ushtrojnë veprimtari stivadore: ASC, Liburnet 1 dhe Egnatia 1, rezulton se ato nuk ushtrojnë veprimtari pranë Terminalit Lindor të Portit Durrës, pasi nuk kanë pasur klientë për të ofruar shërbimet e tyre pranë këtij terminali dhe, për këtë arsye gjatë kësaj kohe, nuk

kanë pasur kontakte me ndërmarrjen EMS APO. Këto ndërmarrje ushtrojnë veprimtari vetëm pranë Terminalit Perëndimor të Portit Durrës.

14. Në përfundim të procedurës, Komisioni i Konkurrencës më datë 04.10.2018, organizoi një seancë dëgjimore me përfaqësuesit e MIE, APD dhe ndërmarrjes EMS APO.

II. Rregullimi i Tregut

15. Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë rregullon marrëdhëniet juridike, ekonomike dhe shoqërore në fushën e detarisë, duke vendosur rregulla mbi të drejtat dhe detyrimet e subjekteve që ushtrojnë veprimtari detare dhe kanë përgjegjësi ligjore mbi hapësirën detare.
16. Referuar nenit 3 të Kodit detar, janë subjekte të së drejtës detare personat fizike ose juridike, publike ose private, vendas ose të huaj, të cilët realizojnë veprimtarinë në fushën e detarisë. Gjithashtu, subjektet detare mund të jenë drejtues të veprimtarisë në fushën e detarisë, pronarë të mjeteve ose të mjediseve detare dhe ushtrues të veprimtarive në fushën e detarisë, zotërues, jo pronarë të mjeteve dhe të veprimtarive të fushës së detarisë, të punësuar ose përfitues nga kjo veprimtari.
17. Në nenin 8 të Kodit Detar janë përcaktuar dhe cilat janë veprimtaritë detare, ku një prej tyre është dhe veprimtaria në porte detare (pika b).
18. Në bazë të nenit 10, pika 1 të Kodit Detar: “Veprimtaria në fushën e detarisë dhe shërbimet portuale kryhen nga subjekte të licencuara, me cilësitë e nevojshme të personave fizikë ose juridikë që janë regjistruar si të tillë.”.
19. Sipas nenit 31 të Kodit Detar, Autoriteti Portual realizon drejtimin administrativ të veprimtarisë në fushat e detarisë dhe të zonës detare përkatëse, si dhe bashkërendon marrëdhëniet me organet shtetërore dhe veprimtaria e tij rregullohet me ligj të veçantë.
20. Referuar nenit 82 të Kodit Detar, shërbimet portuale përfshijnë rimorkimin, ngarkim-shkarkimin, magazinimin, transportin, mbrojtjen nga zjarri, shërbimin e shpëtimit dhe çdo lloj veprimtarie tjetër që lidhet me mbërritjen dhe nisjen e mjeteve lundruese, si dhe me lëvizjen e pasagjerëve e të mallrave brenda dhe jashtë porteve. Shërbimet portuale kryhen nga subjekte publike ose private të licencuara dhe përzgjedhja e tyre bëhet mbi baza konkurrimi dhe lidhja e kontratës bëhet nga Administrata Detare. Kontratat për veprimtari jo kryesore lidhen nga Autoriteti Portual.
21. Administrata Detare përcakton rregullat e përgjithshme të shërbimeve portuale, ndërsa Autoriteti Portual përcakton rregullat e shërbimeve për portin përkatës. Drejtimi dhe kontrolli i Shërbimeve Portuale kryhet nga Autoriteti Portual.
22. Ligji Nr. 9130, datë 08.09.2003 “Për Autoritetin Portual”, ka si objekt përcaktimin e formës së organizimit, i rregullave të funksionimit dhe të administrimit, i marrëdhënieve me operatorët, me organet shtetërore dhe të përfaqësimit të autoritetit portual.
23. Në nenin 4 të Ligjit Nr. 9130/2003, ndër të tjera, janë dhënë përkufizimet e mëposhtme:
 - “Autoriteti portual” është personi juridik, që përfaqëson interesat publikë dhe administron pronën publike të përcaktuar me ligj. Ai krijohet dhe ushtron përgjegjësitë e veta brenda territoreve të porteve të hapura të Republikës së Shqipërisë.
 - “Operator i autorizuar në port” është personi që ka një kontratë koncesioni ose të marrjes me qira nga autoriteti portual përkatës, i cili detyrohet të ofrojë dhe të sigurojë shërbime tregtare në atë port, si dhe të grumbullojë të ardhura në emër të tij dhe të autoritetit portual.

- “Operator i portit” është personi që ka një kontratë të vlefshme, licencë ose koncesion me autoritetin portual, i cili është i detyruar të ofrojë dhe të sigurojë shërbime tregtare në atë port.
- “Përdorues i portit” është personi që zhvillon veprimtarinë tregtare në port.

24. Në bazë të nenit 22 të Ligjit Nr. 9130/2004, Autoriteti portual, nëpërmjet drejtorit ekzekutiv, bashkërendon dhe administron veprimtarinë portuale për transportin e mallrave, lundrimin (drejtimin e anijeve), transportin e pasagjerëve, ngarkimin dhe shkarkimin e mallrave, magazinimin e mallrave, që bëhen prej tij ose prej sektorit privat, i cili lidh dhe kontrata në emër të Autoritetit Portual.
25. Sipas nenit 35 të Ligjit Nr. 9130/2004, Autoriteti Portual cakton tarifat për:
- a) anijet, mjetet e transportit dhe personat që përdorin portin;
 - b) ngarkimin e mallrave në anije, shkarkimin e tyre, tregtimin detar brenda kufijve të portit ose magazinimin në port;
 - c) shërbimet që sigurohen nga autoriteti portual ose nga një operator i autorizuar, ose ndonjë të drejtë të dhënë prej tij, në lidhje me portin.
26. Tarifat dhe interesat, të përcaktuara sipas këtij ligji, për anijet dhe ngarkesat paguhen nga zotëruesi ose personi që e ka në ngarkim anijen ose mallin dhe mbliidhen nga autoriteti portual ose nga një operator i autorizuar. Kur cakton tarifat, autoritetit portual ose operatorit të autorizuar nuk i lejohet të shkelë barazinë e subjekteve përdoruese.
27. Organizimi dhe funksionimi i administratës detare të Republikës së Shqipërisë, në zbatim të detyrimeve të vendosura nga aktet ligjore, kombëtare dhe ndërkombëtare, në fushën e detarisë, përcaktohen në Ligjin Nr. 10109, datë 02.04.2009 “Për Administratën Detare të Republikës së Shqipërisë”.
28. Në bazë të nenit 5 të Ligjit 10109/2009, Ministri përgjegjës për transportin është autoriteti më i lartë i administratës detare të Republikës së Shqipërisë dhe për ushtrimin e këtij autoriteti krijohet dhe funksion Drejtoria e Përgjithshme Detare, në varësi të tij.

III. Tregu Përkatës

29. Tregu përkatës përfshin produktet që vlerësohen si të zëvendësueshme nga konsumatorët dhe operatorët, për sa u përket karakteristikave, çmimit dhe funksionit të tyre dhe që ofrohen ose kërkohen nga ndërmarrjet në një zonë gjeografike me kushte të njëjta konkurrence. Përkufizimi i tregut përkatës përfshin dy dimensione:
- e) Tregu përkatës i produktit
 - f) Tregu përkatës gjeografik

III.1 Tregu përkatës i produktit

30. “Terminal Lindor Durrës” (TLD) është i përcaktuar si një nga facilitetet e portit të Durrësit që konsiston dhe përbëhet nga kalata Nr. 10 dhe kalata Nr. 11 dhe zonat dhe sheshet korresponduese të operacioneve, trafikut dhe të depozitimit pas këtyre kalatave dhe që do të zhvillohet në përputhje me masterplanin e Portit të Durrësit.
31. Referuar informacionit të dërguar nga APD me shkresën Nr. 792/1 Prot., datë 27.04.2017 dhe masterplanit të miratuar për Portin e Durrësit, Terminali Lindor, për shkak të karakteristikave të tij, është i destinuar për përpunimin e mallrave rifuxho. Shërbimi i përpunimit të mallrave gjenerale/përgjithshme, kryhet në

Terminalin Perëndimor të Portit të Durrësit, gjithashtu ky shërbim, në bazë të Kontratës Koncesionare, lejohet të kryhet edhe në Terminalin Lindor.

32. Në bazë të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës Nr. 477, datë 12.10.2017, hetimi i thelluar është hapur në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkimit dhe aktivitetet e lidhura me to, për mallrat rifuxho në Terminalin Lindor të Portit të Durrësit.
33. Referuara sa më sipër, tregu përkatës i produktit përfshin ofrimin e shërbimeve stivadore për mallrat rifuxho (minerale, qymyr, likuide (lëngje), etj) nga ndërmarrjet e licencuara për ngarkimin, shkarkimin, depozitimin, transportimin, përpunimin dhe aktivitete të tjera të lidhura me to.

III.2 Tregu përkatës gjeografik

34. Bazuar në masterplanin e miratuar dhe kontratën koncesionare, përpunimi i ngarkesave rifuxho nga të gjithë operatorët stivadorë të licencuar/autorizuar kryhet pranë Terminalit Lindor të Portit Durrës, nga të cilat, ndërmarrja koncesionare EMS APO, operon vetëm pranë këtij Terminali.
35. Referuar sa më sipër, tregu përkatës gjeografik vlerësohet zona gjeografike e Terminalit Lindor të Portit të Durrësit.

IV. Analiza e Tregut

36. Porti i Durrësit përbëhet nga 4 (katër) terminale, përkatësisht: Terminali i Trageteve; Terminali i Kontenierëve; Terminali Lindor dhe Terminali Perëndimor; si dhe facilitetet portuale për çdo terminal. Në Portin e Durrësit përpunohen mallrat e përgjithshme, drithëra, kontenierë, tragete, minerale, etj.
37. Porti i Durrësit sipas shpjegimeve të përfaqësuesve të MIE dhe në bazë të Ligjit Nr. 9130, datë 08.09.2003 “Për Autoritetin Portual”, është “Port administrues toke” (Landlord Port) ku autoriteti portual është administrues vetëm i infrastrukturës dhe nuk përfshihet në operacionet e shërbimeve dhe të pajisjeve. Pra, Autoriteti Portual ka rolin e administruesit të portit dhe në bazë të kontratave ju kalon të tretëve kryerjen e shërbimeve brenda zonës së portit.
38. Terminali Lindor, në bazë të kontratës së koncesionit, menaxhohet dhe administrohet nga ndërmarrja EMS APO, e cila është poseduesja dhe administruesja e vetme e të gjithë infrastrukturës dhe faciliteteve të këtij terminali. Çdo përdorues porti për të marrë shërbimet nga ky terminal, duhet patjetër të ketë akses në infrastrukturën dhe facilitetet që ofron ky terminal.
39. Referuar Dokumenteve të Konkurrimit të procedurës së dhënies me koncesion, Terminali Lindor do të zhvillohet në terminalin ekzistues Lindor i përbërë nga kalatat 10 dhe 11 dhe sheshet përkatëse në Portin e Durrësit, siç është përshkruar në “Përshkrimi i Fasiliteteve”, dhe sipas kufijve të përcaktuar në Masterplanin e miratuar nga Këshilli i Ministrave në VKM me Nr. 546, datë 28.05.2009.
40. Në bazë të licencave dhe autorizimeve të lëshuara nga organet shtetërorë, 4 (katër) janë ndërmarrjet që ofrojnë shërbimin e përpunimit të ngarkesave rifuxho dhe gjenerale në Portin e Durrësit. Nga të cilat, 3 (tre) stivadorë të licencuar nga APD për ofrimin e shërbimit të përpunimit të këtyre ngarkesave në Terminalin Lindor dhe Perëndimor, përkatësisht “Albanian Stevedoring Company” SHPK; “Egnatia-1” SHPK dhe “Liburnet-1” SHPK, kurse koncesionari EMS APO i pajisur me Autorizim nga Drejtoria e Përgjithshme Detare e ofron këtë shërbim vetëm pranë Terminalit Lindor, ku është dhe poseduesi i të gjitha faciliteteve të këtij terminali.

V. Vlerësimi i Pozitës Dominuese

41. Koncesionari EMS APO është posedues dhe administrues i vetëm i infrastrukturës dhe faciliteteve të Terminalit Lindor, duke qenë 100% dominues në tregun e rrjedhës së sipërme (operim, menaxhim dhe

administrim i infrastrukturës), gjithashtu ofron shërbime në tregun e rrjedhës së poshtme të përpunimit të ngarkesave (shërbime stivadore), gjë e cila e bën këtë ndërmarrje të integruar vertikalisht në të dy nivelet e tregut.

42. Koncesionari EMS APO është posedues dhe administrues i vetëm i infrastrukturës dhe faciliteteve të Terminalit Lindor të Portit Durrës, duke zotëruar 100% të pjesëve të këtij tregu, duke filluar nga marrja në dorëzim e terminalit (15 korrik 2013) për gjithë periudhën e koncesionit dhe në kuptim të nenit 8 të Ligjit Nr. 9121/2003, vlerësohet me pozitë dominuese në tregun e rrjedhës së sipërme (upstream market).
43. Për vitin 2013, pas fillimit të menaxhimit të TLD nga ndërmarrja EMS APO në korrik 2013, vërehet se ndërmarrja e vetme që ka shtruar aktivitetin në tregun e shërbimeve stivadore në TLD për ngarkim shkarkimin e mallrave rifuxho ka qenë ndërmarrja ASC, e cila ka realizuar një volum prej XXX ton materiale të përpunuara.
44. Për vitin 2014 sasia totale e mallrave rifuxho të përpunuara në kalatën lindore ka qenë XXX ton, pjesën më të madhe të ofrimit të shërbimeve stivadore e ka kryer ndërmarrja ASC me rreth XX% (XXX ton) të produkteve të tregut përkatës, e ndjekur nga ndërmarrja Liburnet-1 me rreth XX % (XXX ton) të këtij tregu dhe ndërmarrja EMS APO me një pjesë në më pak se XX% (XXX ton) të tregut.
45. Për sa i përket të dhënave për vitin 2015, volumi total i mallrave rifuxho të përpunuara në kalatën lindore rezultoi XXX ton, pra më e ulët se ajo e vitit 2014. Gjithashtu, edhe pjesët e tregut kanë ndryshuar, si rezultat, ndërmarrja ASC ka ulur pjesën e tregut nga XX% në vitin paraardhës në XX% gjatë këtij viti, e njëjta situatë vlen edhe për ndërmarrjen Liburnet-1, ku pjesët e saj të tregut kanë pësuar rënie nga XX% në XX% (në sasi rënie është nga XXX ton në vitin 2014, në XXX Ton në vitin 2015), ndërsa ndërmarrja EMS APO ka pasur rritje të pjesëve të tregut nga më pak se XX% në rreth XX% (e shprehur në sasi nga XXX Ton në vitin 2014, në XXX Ton për vitin 2015).
46. Gjatë vitit 2016 situata në përpunimin e mallrave rifuxho në kalatën lindore të Portit të Durrës ndryshon tërësisht, ku jo vetëm sasia e mallrave rifuxho ka pësuar rënie me vitet paraardhëse, por edhe pjesët e tregut kanë ndryshuar tërësisht, tashmë të gjithë mallrat rifuxho të përpunuara në terminalin lindor gjatë vitit 2016 (XXX ton) janë përpunuar nga ndërmarrja EMS APO, pra ndërmarrjet e tjera nuk kanë ushtruar fare aktivitet për përpunimin e mallrave rifuxho në këtë terminal.
47. E njëjta situatë vlen edhe për periudhën Janar – Shkurt 2017, ku vërehet se në kalatën lindore të Portit të Durrësit aktivitetin e përpunimit të mallrave rifuxho e ka ushtruar vetëm ndërmarrja EMS APO.
48. Duke filluar nga 23 Shtatori 2015, ndërmarrja EMS APO ka marrë autorizim nga Drejtoria e Përgjithshme Detare për të ofruar shërbimin e ngarkimin shkarkimit të mallrave rifuxho në terminalin lindor dhe nga muaji Nëntor 2015 deri në përfundim të periudhës hetimore, pranë Terminalit Lindor këto shërbime janë kryer vetëm nga koncesionari EMS APO, duke zotëruar 100% të këtij tregu.
49. Nga vlerësimi i pozitës dominuese dhe pjesëve të tregut përkatës të shërbimit të ngarkim shkarkimit të mallrave rifuxho, në tregun gjeografik përkatës, zonën e Terminalit Lindor të Portit Durrës, ndërmarrja EMS APO, e cila zotëron 100 % të tregut të rrjedhës së sipërme, nga nëntori 2015 deri në shkurt 2017 zotëron gjithashtu 100% të tregut të rrjedhës së poshtme të ngarkim shkarkimit të mallrave rifuxho (stivadore) pranë këtij terminali, dhe në kuptim të nenit 8 të Ligjit Nr. 9121/2003, vlerësohet me pozitë dominuese në tregun e rrjedhës së poshtme (downstream market) të ofrimit të shërbimeve stivadore për mallrat rifuxho pranë Terminalit Lindor të Portit Durrës.

V.2 Vlerësimi i Sjelljes së Ndërmarrjes EMS APO

50. Vlerësimi i sjelljes së ndërmarrjes EMS APO, e integruar vertikalisht dhe me pozitë dominuese në të dy nivelet e tregut, është bazuar në raport me qëndrimet e saj ndaj konkurrentëve në tregun e shërbimit të

ngarkim shkarkimit të mallrave rifuxho në Terminalin Lindor të Portit Durrës për periudhën hetimore.

V.2.1 Sjellja ndaj Ndërmarrjeve Stivadore

51. Ndërmarrja ASC, si rezultat i një procedure konkurrimi të zhvilluar nga APD, është shpallur fituese dhe ka lidhur “Kontratën Marrëveshje/Licencë për kryerjen e shërbimeve të ngarkim-shkarkimit në Portin e Durrësit”, Nr. 5947, datë 21.07.2009 me Autoritetin Portual Durrës (APD). Objekti¹⁰ i kësaj kontrate është: ngarkimi dhe shkarkimi i anijeve, si dhe aktivitetet e lidhura me të, të tilla si stivimi, depozitimi, transportimi, etiketimi, lidhja, numërimi, pritja dhe lëvrimi i ngarkesave, siç përcaktohet në Termat e Referencës dhe shtojcat e kësaj Marrëveshje licencë/shërbim, në Portin e Durrësit, në çdo kalatë të përcaktuar të stivadorit, në llogari të pronarit të anijes, ngarkesës, ose automjetit, cilido që të jetë rasti.
52. Ndërmarrja “Liburnet 1” SHPK, ka filluar aktivitetin për ofrimin e shërbimeve stivadore¹¹ që në vitin 2005. Kjo shoqëri si rezultat procedurave të konkurrimit të zhvilluara nga APD, ka lidhur Kontratë Licencë “Për Masën e Shërbimeve të Ngarkim-Shkarkimit në Portin e Durrësit” Nr. 363, datë 31.05.2005 (të ndryshuar), për kryerjen e shërbimeve të ngarkim-shkarkimit në Portin e Durrësit me APD.
53. Referuar shkresës së APD Nr. 1959 Prot., datë 19.06.2015 “Amendament i kontratës së shërbimeve të ngarkim shkarkimit të mallrave në Portin e Durrësit”, rezulton se Këshilli Drejtues i APD me Vendimin Nr. 23, datë 01.06.2015 ka rinovuar kontratën me ndërmarrjen Liburnet 1, duke e zgjatur periudhën e Kontratës Licencë edhe për 10 vjet, deri në 31 Maj 2025.
54. Pas dhënies me koncesion ndërmarrjes EMS APO të “Menaxhimit, operimit dhe mirëmbajtjes së Terminalin Lindor në Portin e Durrësit”, ndërmarrja Liburnet 1 nënshkroi më datë 1 Prill 2014 Kontratë Marrëveshje për kryerjen e shërbimeve të ngarkim shkarkimit në terminalin lindor në Portin Durrësit me ndërmarrjen EMS APO me kohëzgjatje deri në 31 Maj 2015.
55. Ndërmarrja “Egnatia-1” SHPK, ka filluar aktivitetin e saj në Portin e Durrësit që nga viti 2005 sipas Kontratës Licencë me APD Nr. 362 Prot., datë 31.05.2005 me objekt ngarkim-shkarkimin e anijeve në Portin e Durrësit për mallrat gjenerale dhe rifuxhove (vetëm drithërat). Me amendamentin e kontratës/licencë më datë 22.05.2015, kontrata është rinovuar për një periudhë 10 vjeçare deri më 31 Maj 2025.
56. Pas dhënies me koncesion të Terminalit Lindor të Portit Durrës, APD me shkresën Nr. 1692 Prot, datë 01.07.2013 sqaron shoqërinë Egnatia 1 se do të vazhdojë të ketë të drejtën e kryerjes së shërbimeve të ngarkim-shkarkimit në TL kundrejt kushteve të operimit të rëna dakord me Shoqërinë Koncesionare. Nisur nga shkresat e APD dhe kërkesa e MPPT dt. 28.08.2013, ndërmarrja EMS APO ka ftuar stivadorin Egnatia 1 për bashkëpunim në kryerjen e shërbimeve të ngarkim-shkarkimit, si dhe dy stivadorët e tjerë.
57. Ndërmarrja Egnatia 1 nuk ka pranuar të bashkëpunojë me ndërmarrjen EMS APO, pasi, sipas saj, kushtet e ofruara nga koncesionari ishin të ndryshme nga ato të vendosura në kontratën/licencë me APD.
58. Referuar Protokollit të Dorëzimit Nr. 1810, datë 12.07.2013, të nënshkruar mes APD dhe EMS APO, parashikohet si vijon: “Pa kufizuar të drejtën e Operatorit EMS APO për të ofruar vetë shërbimet e ngarkimit dhe shkarkimit në Terminal, ky Operator mund të bashkëpunojë vetëm me shoqëritë e ngarkim-shkarkimit të cilat janë aktualisht të licencuara. Kushtet e bashkëpunimit të përcaktohen nga palët në përputhje me kontratën e koncesionit.”.
59. Ministri i MIE me shkresën Nr. 3567/1 Prot., datë 28.08.2013, e fton ndërmarrjen EMS APO të bashkëpunojë me shoqëritë e ngarkim-shkarkimit deri në skadimin e afatit të kontratave licencë që ata

¹⁰ Sipas nenit 12 të Kontratës së Sipërpërmendur,

¹¹ Burimi: Ekstrakti Historik i regjistrit tregtar për të dhënat e subjektit “Liburnet 1” SHPK, shkarkuar nga faqja zyrtare e QKB www.qkr.gov.al; si dhe procesverbali i mbajtur me këtë subjekt.

kishin lidhur me APD përpara datës së Kontratës së Koncesionit.

60. Si përfundim, referuar sa më sipër, rezulton se ndërmarrja EMS APO ka lidhur kontrata bashkëpunimi me ndërmarrjet ASC, datë 17.09.2013; dhe Liburnet 1, datë 01.04.2014, ndërkohë që ky bashkëpunim është refuzuar nga ndërmarrja Egnatia 112.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të nenit 8, nenit 24, shkronja (d), nenit 26, nenit 43, pika 5, dhe nenit 70 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. T’i rekomandojë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, që brenda një afati 90 ditor, të marrë masat si vijon:
 - a) Verifikimin dhe vlerësimin e pajtueshmërisë së funksionimit aktual të shërbimit të ngarkim-shkarkimit të mallrave në port (si kategori e shërbimeve portuale) me kuadrin ligjor rregullator përkatës në fuqi, dhe, plotësimin e bazës ligjore/nënligjore (nëse do rezultojë e nevojshme) për funksionimin e duhur të tregut të shërbimit të ngarkim-shkarkimit të mallrave në port.
 - b) Angazhimin e strukturave përkatëse për hartim, konsultim dhe finalizim të një draft kontrate me objekt sigurimin e shërbimit të ngarkim-shkarkimit (përfshirë shërbimin stivador) nga operatorë portualë të licencuar, draft i cili të konsultohet më pas edhe me palët e tjera të interesuara.
2. Autoriteti Portual Durrës, brenda 90 ditëve duhet të marrë masa për:
 - a) Miratimin e një rregulloreje për funksionimin e Terminalit Lindor të Portit Durrës, ku të jenë përcaktuar, ndër të tjera:
 - i. Procedurat për sigurimin e shërbimeve që ofrohen nga ana e Koncesionarit EMS APO;
 - ii. Funksionimi i agentit detar dhe atij spedicioner, si përfaqësues respektivë të pronarit/çarteruesit të mjetit lundrues dhe pronarit të mallrave në raport me të drejtën për të përzgjedhur operatorin e licencuar stivador;
 - iii. Marrëdhënia midis koncesionarit, përdoruesit të portit, agentit detar dhe ndërmarrjeve stivadore;
 - iv. Detyrimi i APD për mbajtjen e grafikut të çarterimit të vinçave (në pronësi të koncesionarit) dhe ngarkim-shkarkimit të mallrave sipas kërkesave të përdoruesve të portit dhe parimit të mosdiskriminimit (*first come first serve* - siç parashikohet edhe në Kontratën e Koncesionit).
 - b) Draft Rregullorja përpara miratimit të dërgohet paraprakisht për mendim pranë Autoritetit të Konkurrencës.
3. Ti rekomandojë ndërmarrjes “EMS-Albanian Port Operator” SHPK, me pozitë dominuese në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkimit dhe aktivitetet e lidhura me to, për mallrat rifuxho në Terminalin Lindor të Portit të Durrësit, që gjatë ushtrimit të aktivitetit të saj në tregun përkatës:
 - a) Të aplikojë kushte tregtimi të barabarta për veprime tregtare të njëjta ndaj ndërmarrjeve me të cilat hyn në marrëdhënie kontraktore;
 - b) Në lidhjen e kontratave me palët e tjera të mos vendosë kushte/detyrime shtesë, të cilat për vetë natyrën e tyre ose sipas praktikave tregtare, nuk kanë lidhje me objektin e kontratave në fjalë;

¹² Burimi, shkresë e EMS APO, Nr. 267 Prot., datë 16.09.2015.

- c) Mënyra e përpunimit të anijeve të kryhet sipas parimit *“kush hyn i pari, shërbehet i pari”*;
 - d) Të respektojë të drejtën e barazisë për përdoruesit e portit që do të kryejnë shërbime nëpërmjet terminalit lindor të Portit të Durrësit, duke vendosur kushte të barabarta për veprime tregtare të njëjta;
 - e) T’u ofrojë shërbimet e saj të gjitha ndërmarrjeve me të njëjtat kushte teknike dhe financiare;
 - f) Të depozitojë paraprakisht pranë Autoritetit të Konkurrencës për miratim çdo draft kontratë që mendon të lidhë me ndërmarrjet stivadore të licencuara.
4. Në rast të mos përmbushjes së detyrimeve të përcaktuara në pikën (3) të këtij vendimi, ndërmarrja “EMS-Albanian Port Operator” SHPK ndëshkohet me gjobë deri në 10 % të xhiros vjetore për shkelje të rëndë të konkurrencës në zbatim të nenit 74, të Ligjit Nr. 9121/2003.
5. Monitorimin e sjelljes së ndërmarrjes “EMS-Albanian Port Operator” SHPK për një periudhë 1 (një) vjeçare. Gjatë periudhës së monitorimit, ndërmarrja “EMS-Albanian Port Operator” SHPK duhet të raportojë çdo 3 (tre) muaj pranë Autoritetit të Konkurrencës të dhëna lidhur me ecurinë e zbatimit të këtij vendimi dhe marrëdhëniet me palët e treta.
6. Mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkim dhe aktivitetet e lidhura me to, për mallrat rifuxho në Terminalin Lindor të Portit të Durrësit.
7. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 569, Datë 15.11.2018

“Për shqyrtimin e kërkesës së ndërmarrjes “Conad Albania” SHPK për revokimin e vendimit Nr. 560, datë 15.10.2018 të Komisionit të Konkurrencës”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 15.11.2018, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Shqyrtimi i kërkesës së ndërmarrjes “Conad Albania” SHPK (Conad) për revokim të Vendimit Nr. 560, datë 15.10.2018 të Komisionit të Konkurrencës.

Baza ligjore: Nenet: 24, gërma d) dhe 46 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar (Ligji Nr. 9121/2003);

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës;

VËREN SE:

1. Pranë Autoritetit të Konkurrencës, më datë 30.10.2018, ndërmarrja Conad ka depozituar kërkesën për ndryshimin e pjesshëm të vendimit të Komisionit të Konkurrencës Nr. 560, datë 15.10.2018 “Për mbylljen e procedurës së hetimit paraprak ndaj ndërmarrjes “Conad Albania” SHPK në tregun e tregtimit të produkteve ushqimore të cilat mbartin markën “Conad” në Republikën e Shqipërisë dhe vendosjen e disa detyrimeve”, përkatësisht në pikën 2, shkronja a) dhe b), duke qenë se të gjitha të dhënat tregojnë që raportet tregtare të Conad ndodhen në kushtet e lejuara për këtë kategori raporti tregtar e nuk cenojnë konkurrencën.
2. Nga shqyrtimi i kërkesës së ndërmarrjes Conad, evidentohet se asnjë nga faktet dhe provat që kanë çuar në marrjen e Vendimit të Komisionit të Konkurrencës Nr. 560, datë 15.10.2018 nuk kanë ndryshuar, si dhe ndërmarrja Conad në kërkesën e saj për revokim nuk ka paraqitur asnjë argument dhe provë mbështetëse (dokument) në favor të saj.
3. Të dhënat e përdorura për marrjen e Vendimit Nr. 560, datë 15.10.2018, të Komisionit të Konkurrencës nuk kanë ndryshuar dhe vazhdojnë të rezultojnë të sakta.
4. Referuar nenit 46 të Ligjit Nr. 9121/2003, revokimi i këtij Vendimi mund të kryhet nga Komisioni i Konkurrencës vetëm kur përmbush të paktën njërin nga 3 (tre) kushtet e përcaktuara në këtë nen.
5. Si përfundim, duke mos përmbushur asnjë prej kushteve të parashikuara në nenin 46 të Ligjit Nr. 9121/2003, për revokimin e një vendimi të Komisionit të Konkurrencës, kërkesa e ndërmarrjes Conad, për revokimin e Vendimit të Komisionit të Konkurrencës Nr. 560, datë 15.10.2018, është e pabazuar në ligj dhe prova.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të neneve 24, (gërma d) dhe 46, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës së ndërmarrjes Conad për revokimin e pikës 2, shkronja a) dhe b) të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës Nr. 560, datë 15.10.2018 “Për mbylljen e procedurës së hetimit paraprak ndaj ndërmarrjes “Conad Albania” SHPK në tregun e tregtimit të produkteve ushqimore të cilat mbartin markën “Conad” në Republikën e Shqipërisë dhe vendosjen e disa detyrimeve”, si të pabazuar në ligj dhe prova.
2. Lënien në fuqi të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës Nr. 560, datë 15.10.2018 “Për mbylljen e procedurës së hetimit paraprak ndaj ndërmarrjes “Conad Albania” SHPK në tregun e tregtimit të produkteve ushqimore të cilat mbartin markën “Conad” në Republikën e Shqipërisë dhe vendosjen e disa detyrimeve”.
3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 572, Datë 22.11.2018

“Për vendosje gjobe dhe detyrime ndaj ndërmarrjes “EKMA Albania” SHPK, në tregun e qiradhënies së ambienteve për magazinimin dhe tregtimin e produkteve Agro - Ushqimore në qytetin e Tiranës”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 22.11.2018, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Për konstatimin e abuzimit me pozitën dominuese, vendosje gjobe dhe detyrime ndaj ndërmarrjes “EKMA Albania” SHPK, në tregun e qiradhënies së ambienteve për magazinimin dhe tregtimin e produkteve Agro - Ushqimore në qytetin e Tiranës.

Baza ligjore: Neni 24, shkronja (d), neni 26, neni 8, neni 9, pika 2 gërmat (a), (c) dhe (ç), neni 74, pika 1, gërma (a), neni 75, pika 1 dhe neni 76, pika 1, gërma (a) dhe (c) të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar (Ligji Nr. 9121/2003).

Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të raportit mbi hetimin e thelluar ndaj ndërmarrjes “EKMA Albania” SHPK, në tregun e qiradhënies së ambienteve për magazinimin dhe tregtimin e produkteve Agro - Ushqimore në qytetin e Tiranës; relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës; pretendimeve të paraqitura nga ndërmarrja “EKMA Albania” SHPK lidhur me “Raportin e hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes “EKMA Albania” SHPK, në tregun e qiradhënies së ambienteve për magazinimin dhe tregtimin e produkteve Agro - Ushqimore në qytetin e Tiranës”, depozituar me anë të shkresës Nr. 365/12 Prot., datë 31.10.2018,

VËREN SE:

I. Procedura e ndjekur:

1. Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës, bazuar në nenin 28, gërma a, të Ligjit Nr. 9121/2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", i ndryshuar, realizoi një monitorim në tregun e qiradhënies së ambienteve për magazinimin dhe tregtimin e produkteve Agro - Ushqimore në qytetin e Tiranës, me qëllim evidentimin nëse ka, apo jo shenja të kufizimit të konkurrencës në këtë treg, në shkelje të nenit 9 të Ligjit 9121/2003, i ndryshuar.
2. Në përfundim të monitorimit, Komisioni i Konkurrencës bazuar në nenin 9, nenin 24 shkronja d, dhe nenin 42, pika 1, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës" (i ndryshuar), me Vendimin Nr. 512, datë 17.05.2018 vendosi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e qiradhënies së ambienteve për magazinimin dhe tregtimin e produkteve Agro - Ushqimore në qytetin e Tiranës.

3. Në përfundim të hetimit paraprak Komisioni i Konkurrencës konkludoi se: sjellja e ndërmarrjes me pozitë dominuese “EKMA Albania” SHPK në tregun e qiradhënies së ambienteve për magazinimin dhe tregtimin e produkteve Agro - Ushqimore në qytetin e Tiranës, mund të përbëjë abuzim me pozitën dominuese referuar nenit 9 të Ligjit Nr. 9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, me pasoja për konkurrencën në treg.
4. Për sa më sipër, Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të Ligjit Nr. 9121/2003, me anë të Vendimit Nr. 531, datë 25.06.2018 vendosi hapjen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes “EKMA Albania” SHPK, në tregun e qiradhënies së ambienteve për magazinimin dhe tregtimin e produkteve Agro - Ushqimore në qytetin e Tiranës, ndryshuar me Vendimin Nr. 541, datë 04.09.2018.
5. Në zbatim të Vendimit të mësipërm të Komisionit të Konkurrencës, bazuar në nenet 35 dhe 36 të Ligjit Nr. 9121/2003 dhe Autorizimit të Komisionit të Konkurrencës Nr. 327, datë 22.05.2018 "Autorizim inspektorësh", u kryen inspektime pranë ndërmarrjes “EKMA Albania” SHPK si dhe pranë disa tregtarëve të shumicës, të cilët ushtrojnë aktivitetin e tyre në ambientet e tregut Agro - Ushqimor Tiranë.
6. Për mbledhjen e fakteve dhe të dhënave të nevojshme në lidhje me hetimin, bazuar në nenet 33 dhe 34 të Ligjit Nr. 9121/2003 janë kërkuar të dhëna dhe informacion nga: Bashkia Tiranë dhe ndërmarrja “EKMA Albania” SHPK.
7. Nga vlerësimi i sjelljes së ndërmarrjes “EKMA Albania”, SHPK gjatë realizimit të procedurave të hetimit të thelluar rezultoi se:
 - Ndërmarrja “EKMA Albania” SHPK operon e vetme në tregun e qiradhënies së ambienteve për magazinimin dhe tregtimin e produkteve Agro - Ushqimore në qytetin e Tiranës, pra ka pozitë dominuese për sa i përket pjesëve të tregut;
 - Ndërmarrja vendos çmime dhe kushte të padrejta tregtimi, duke i detyruar tregtarët qiramarrës të paguajnë një çmim më të shtrenjtë të energjisë elektrike nga ai që duhet të paguajnë realisht sipas faturave të lëshuara nga OSHEE, si dhe UKT;
 - Nëpërmjet “kontratës tip” të qirasë të aplikuar për qiramarrësit që operojnë në këtë treg Agro - Ushqimor, ndërmarrja “EKMA Albania” SHPK vendos kushte diskriminuese dhe të padrejta tregtimi;
 - Aplikon kontrata, të cilat përmbajnë kushte imponuese vetëm për njërën palë të kontratës – qiramarrësin, duke i bërë të pavlefshme kushtet e përgjithshme të këtyre kontratave, që sjellin një humbje ose dëmtim të shpërpjesëtuar të interesave të palës kontraktuese;
 - Detyron qiramarrësin të negociojë muaj për muaj për çmimin e saj, duke krijuar paqëndrueshmëri financiare për qiramarrësin dhe duke e vendosur këtë të fundit në kushte të pafavorshme konkurrence, si dhe duke e detyruar të paguaj një garanci të vlefshme me pagesën e 2 muajve, pa u marrë përsipër, as edhe një gjë nga ana e qiradhënësit;
 - Kjo ndërmarrje aplikon çmime shumë të larta qiraje krahasuar me mesataren e zonës gjeografike;
 - Çmimet e aplikuar i mundësojnë shoqërisë një normë fitimi shumë të lartë, prej 76.1%.
8. Në këto kushte, Komisioni i Konkurrencës vlerësoi se mund të ndodhemi përballë një situatë urgjence të parashikuar në nenin 44 të Ligjit Nr. 9121/2003, për shkak të rrezikut të kryerjes së një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm për konkurrencën, pasi ka të ngjarë të ketë shkelje të nenit 9 (abuzimi me pozitën dominuese) të këtij Ligji. Për këtë arsye Komisioni i Konkurrencës me Vendimin Nr. 542, datë 04.09.2018 ka vendosur marrjen e masave të përkohshme për rivendosjen e konkurrencës në tregun e qiradhënies së

ambienteve për magazinimin dhe tregtimin e produkteve Agro - Ushqimore në qytetin e Tiranës, ndaj ndërmarrjes “EKMA Albania” SHPK.

9. Kundër Vendimit të mësipërm të Komisionit të Konkurrencës Nr. 542, datë 04.09.2018, ndërmarrja “EKMA Albania” ka paraqitur Kërkesëpadi pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, padi e cila është pranuar, dhe AK rezervon të drejtën e ankimit.
10. Me shkresën Nr. 365/9 Prot., datë 17.10.2018 “Raporti i hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes “EKMA Albania” SHPK, në tregun e qiradhënies së ambienteve për magazinimin dhe tregtimin e produkteve Agro - Ushqimore në qytetin e Tiranës”, i është njoftuar ndërmarrjes “EKMA Albania” SHPK.
11. Me anë të shkresës Nr. 365/12 Prot., datë 31.10.2018 ndërmarrja “EKMA Albania” SHPK ka paraqitur pretendimet e saj ndaj Raportit të hetimit të thelluar të Autoritetit të Konkurrencës ndaj ndërmarrjes “EKMA Albania” SHPK, në tregun e qiradhënies së ambienteve për magazinimin dhe tregtimin e produkteve Agro - Ushqimore në qytetin e Tiranës”.

II. Analiza e konkurrencës

II.1 Tregu përkatës

12. Në zbatim të Ligjit Nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, tregu përkatës përfshin tregun e produkteve dhe tregun gjeografik.
13. Dhënia me qira e ambienteve, magazinave dhe vendeve me qëllim tregtimin e produkteve Agro - Ushqimore në qytetin e Tiranës ushtrohet nga ndërmarrja EKMA Albania SHPK, e cila operon e vetme në këtë treg. Në Shqipëri ekzistojnë dhe tregje të tjera të shitjes me shumicë të produkteve bujqësore që janë të pozicionuara në Elbasan, Divjakë, Lushnjë dhe Shkodër. Për shkak të largësisë që këto tregje kanë nga Tirana nuk janë një alternativë e konsiderueshme për konsumatorët e qytetit të Tiranës, pasi nuk janë njëlloj të arritshme prej tyre. Në këto kushte për tregtarët e shumicës nuk ka një alternativë tjetër për të tregtuar produktet e tyre, si rrjedhojë nuk ka zëvendësueshmëri nga ana e kërkesës. *Pra, tregu përkatës të produktit do të konsiderojmë shërbimin e qiradhënies së ambienteve me qëllim magazinimin dhe tregtimin e produkteve Agro - Ushqimore.*
14. Zona gjeografike e shërbimit të qiradhënies së ambienteve për magazinimin dhe tregtimin e produkteve Agro - Ushqimore në Tiranë është territori i qytetit të Tiranës. Megjithëse në Shqipëri ekzistojnë dhe tregje të tjera për tregtimin e produkteve Agro - Ushqimore, për shkak të largësisë gjeografike nga Tirana, në rastin tonë, ato konsiderohen si të pazëvendësueshme, prandaj *tregu përkatës gjeografik në rastin tonë përfshin qytetin e Tiranës.*
15. **Tregu përkatës do të konsiderojmë tregun e qiradhënies së ambienteve me qëllim magazinimin dhe tregtimin e produkteve Agro – Ushqimore në qytetin e Tiranës.**

II.2 Vlerësimi i Pozitës Dominuese

16. Sipas Ligjit, pasja e një pozite dominuese nga një ndërmarrje në treg nuk është e ndaluar, por *zotërimi i pozitës dominuese i jep ndërmarrjes një detyrim të veçantë për të mos abuzuar me këtë pozitë dominuese.*
17. Bazuar në Ligjin Nr. 9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, për të përcaktuar ekzistencën e pozitës dominuese të ndërmarrjes “EKMA Albania” SHPK janë marrë në konsideratë kriteret e nenit 8 të Ligjit, si më poshtë:

(a) Pjesa e tregut, sipas së cilës rezulton se ndërmarrja “EKMA Albania” SHPK operon e vetme, pra ka pozitë dominuese për sa i përket pjesëve të tregut, duke zotëruar 100% të tregut përkatës (tregut të

qiradhënies së ambienteve për magazinimin dhe tregtimin e produkteve Agro - Ushqimore në qytetin e Tiranës);

- (b) Pengesat në hyrje në tregun përkatës. Në tregun përkatës nuk ka pengesa ligjore të drejtpërdrejta për hyrjen në treg pasi ndërmarrjet, të cilat përmbushin kriteret e nevojshme sipas Udhëzimit Nr. 11, datë 2.7.2014 "Për vendndodhjen dhe kushtet e tjera të tregjeve të shitjes me shumicë" të Ministrit të Bujqësisë dhe Vendimit të Këshillit Bashkiak Tiranë Nr.19, datë 09.04.2015 "Për miratimin e kriterëve për vendndodhjen dhe kushtet e tjera të tregjeve të produkteve Agro - Ushqimore të shitjes me shumicë në Bashkinë e Tiranës", janë të lira të hyjnë në treg. Por, pozita e konsoliduar e ndërmarrjes "EKMA Albania" SHPK në treg, qëndrueshmëria e pjesëve të saj të tregut në vite (duke zotëruar 100% të tregut përkatës si e vetmja ndërmarrje prej rreth tre vitesh), si dhe investimet që duhen për ndërtimin e këtyre tregjeve, përbëjnë barriera të larta në hyrje në tregun përkatës (barriera ekonomike);
- (c) Konkurrenca potenciale. Ndërmarrja "EKMA Albania" SHPK nuk ka konkurrentë në tregun përkatës, pasi shërbimi i qiradhënies së ambienteve për magazinimin dhe tregtimin me shumicë të produkteve Agro - Ushqimore në qytetin e Tiranës realizohet vetëm nga një ndërmarrje, përkatësisht "EKMA Albania" SHPK. Aktualisht nuk ka asnjë ndërmarrje tjetër që e ofron këtë shërbim sipas kushteve të përcaktuara;
- (d) Fuqia kundërvepruese e konsumatorëve dhe blerësve. Në rastin tonë tregtarët (si qiramarrës të ambienteve për tregtim dhe magazinim) nuk zotërojnë fuqi kundërvepruese për t'u marrë në konsideratë dhe nuk kanë mundësi për të kaluar drejt qiradhënësve të tjerë, përderisa nuk ka të tillë në tregun përkatës;
- (e) Fuqia ekonomike dhe financiare e ndërmarrjes. Referuar pasqyrave financiare të ndërmarrjes për vitin 2017, vlerës së shitjeve në tregun përkatës, ndërmarrja "EKMA Albania" SHPK rezulton të ketë një fitim në vlerë absolute prej 380,589,313 lekë dhe normë fitimi prej 76.1% para tatimit, ndërsa pas tatimit me një fitim në vlerë absolute prej 323,440,321 Lekë dhe normë fitimi prej 64.7 %. Për vitin 2016 ndërmarrja "EKMA Albania" SHPK ka patur një normë fitimi prej 75.4% para tatimit, dhe 64.1 % pas tatimit. Norma e lartë e fitimit e kësaj ndërmarrjeje është një tregues i fuqisë ekonomike e financiare të saj.

18. Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 3, pika 5, ku përcaktohet se: "Pozitë dominuese" është ajo fuqi ekonomike e mbajtur nga një ose më shumë ndërmarrje që i jep atyre mundësinë për të penguar konkurrencën efektive në treg, duke i bërë ato të afta të veprojnë, për sa i takon ofertës ose kërkesës, në mënyrë të pavarur nga pjesëmarrësit e tjerë në treg, si konkurrentët, klientët ose konsumatorët", nenit 8 të Ligjit Nr. 9121 datë 28.07.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", i ndryshuar, si dhe Udhëzimit "Për vlerësimin e pozitës dominuese dhe abuzimit me pozitën dominuese", nisur nga pjesa e tregut, pengesat e hyrjes në treg, konkurrenca potenciale, fuqia kundërvepruese e blerësve, fuqia ekonomike dhe financiare e ndërmarrjes dhe karakteristikat e tjera të tregut përkatës, **rezulton se ndërmarrja "EKMA Albania" SHPK ka pozitë dominuese në tregun e shërbimit të dhënies me qira të ambienteve për magazinimin dhe tregtimin me shumicë të produkteve Agro - Ushqimore në qytetin e Tiranës.**

II.3 Vlerësimi i Sjelljes së ndërmarrjes "EKMA Albania" SHPK

II.3.1 Sjellja në lidhje me çmimin

19. Analiza e sjelljes së ndërmarrjes në tregun e dhënies me qira të ambienteve për magazinimin dhe tregtimin e produkteve Agro - Ushqimore në qytetin e Tiranës, ka për qëllim të vlerësojë nëse ndërmarrja vendos në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë çmime të padrejta blerje, shitje ose kushte të tjera të padrejta tregtimi.

20. Referuar çmimeve të aplikuara nga ndërmarrja “EKMA Albania” SHPK rezulton se: çmimi standard për magazinat e dhëna me qira është XXX lekë/m², të cilat përbëjnë 81 % të numrit total të magazinave që ka në dispozicion tregu Agro - Ushqimor. Një numër prej 13 magazinash apo 7 % të totalit të magazinave kanë një çmim prej XXX lekë/m², 15 magazina kanë një çmim prej XXX lekë/m², ndërsa 7 magazina ose 4 % e tyre kanë çmime nga XXX – XXX lekë/m². Për sa më sipër çmimet e ambienteve të dhëna me qira variojnë nga XXX në XXX lekë/m².
21. Ndërmarrja “EKMA Albania” SHPK duke abuzuar me pozitën e saj dominuese në treg ka maksimizuar fitimet nëpërmjet vendosjes së çmimeve ekseseve. Konkretisht, për vitin e fundit financiar 2017 ndërmarrja ka një fitim në vlerë absolute para tatimit prej 380,589,313 lekë dhe normë fitimi prej 76.1%. Norma e lartë e fitimit të ndërmarrjes “EKMA Albania” SHPK, reflekton mungesën e konkurrencës në treg.
22. Për të vlerësuar sjelljen e ndërmarrjes nën hetim janë marrë në analizë treguesit financiarë të një ndërmarrjeje që ka të njëjtën natyrë dhe objekt veprimtarie, atë të ofrimit të shërbimit të qirasë së ambienteve për magazinimin dhe tregtimin me shumicë të produkteve Agro - Ushqimore, por që operon në një treg gjeografik të ndryshëm, konkretisht qyteti i Elbasanit. Krahasuar me ndërmarrjen “Cela – P” SHPK, e cila zotëron tregun Agro - Ushqimor në qytetin e Elbasanit, ndërmarrja “EKMA Albania” SHPK ka një normë fitimi prej 76.1 %, e cila është rreth dy herë më e lartë se norma e fitimit të ndërmarrjes “Cela – P” SHPK prej 35.89 %.
23. Nga pasqyrat financiare të kompanisë vlera totale e investimit është XXX lekë, nga ku rezulton se përqindja e shlyerjes së investimit është 36.3 % për vitin 2017. Pra nisur nga këto të dhëna ndërmarrja “EKMA Albania” SHPK supozohet se ka shlyer investimin në harkun e tre viteve. Këto të dhëna, janë një evidencë e qartë, e shfrytëzimit të pozitës monopol në tregun përkatës, nga ndërmarrja “EKMA Albania” SHPK, dhe vënien e tregut në inefficencë.
24. Për të vlerësuar nivelin e çmimeve të qirave në zonën gjeografike ku ndodhet tregu Agro - Ushqimor janë marrë në analizë çmimet e qirave të ndërmarrjeve që operojnë në të njëjtën zonë gjeografike me ndërmarrjen “EKMA Albania” SHPK, por me tjetër objekt veprimtarie, pra treg përkatës të ndryshëm të produktit. Krahasuar me të dhënat e siguruara nga ndërmarrjet “Eko Market” SHPK dhe “Conad Albania” SHPK, të cilat rezultojnë të kenë marrë me qira ambiente për magazinim dhe tregtim, të cilat ndodhen në të njëjtën zonë gjeografike me tregun Agro - Ushqimor të qytetit të Tiranës, rezulton se çmimi i qirasë (XXX Lekë/m²) që aplikon ndërmarrja “EKMA Albania” SHPK është 74.2 % më i lartë se çmimi i qirasë që paguan ndërmarrja “Eko Market” SHPK (XXX Lekë/m²) dhe 89.3 % më i lartë se ai i paguar nga ndërmarrja “Conad Albania” SHPK (XXX Lekë/m²). Analiza e mësipërme krahasimore është tregues i nivelit shumë të lartë të çmimit të aplikuar nga ndërmarrja nën hetim, sjellje që vjen si pasojë e abuzimit me pozitën dominuese nga kjo e fundit.
25. Një tregues i sjelljes abuzive të ndërmarrjes “EKMA Albania” SHPK lidhet me çmimin e energjisë, i cili i faturohet kësaj ndërmarrjeje (sipas faturave të lëshuara nga OSHEE) me çmim 13,2 lekë/kWh, me TVSH. Sasia e matur e energjisë shpërndahet nga “EKMA Albania” SHPK sipas sasive të harxhuara për çdo ambient me një çmim prej 20,2 lekë/kWh, me TVSH, bazuar kjo në faturat analitike të administruara në ambientet e ndërmarrjes “EKMA Albania” SHPK, pra duke detyruar qiramarrësit të pranojnë detyrime shtesë, duke paguar një çmim më të lartë se ai i miratuar nga organet shtetërore.
26. E njëjta sjellje vihet re dhe në mënyrën e faturimit të ujit, i cili i faturohet kësaj ndërmarrjeje (Faturë UKT Mars 2018), vetëm me tarifë shërbimi prej 240 lekë në total (konsumi në m³ për muajin Mars 2018, sipas faturës përkatëse është 0), ndërkohë që tregtarët qiramarrës faturohen (nëpërmjet faturës së qirasë) me një tarifë prej 360 lekë/m³.

27. Për sa më sipër, tregtari qiramarrës nuk vihet në dijeni të sasisë së harxhuar të energjisë elektrike dhe ujit, pasi fatura që i lëshohet atij nga ndërmarrja “EKMA Albania” SHPK përmban vetëm vlerën totale, nën zërin e "qirasë së ambientit", dhe nuk është e detajuar me të gjitha zërat e shpenzimeve që mbart realisht (pra nuk përfshin si zëra të veçantë shpenzimet për energji elektrike, ujë dhe pastrim).
28. ***Kjo sjellje e ndërmarrjes me pozitë dominuese, “EKMA Albania” SHPK, duke u imponuar qiramarrësve çmime dhe kushte të padrejta tregtimi, si dhe duke i detyruar ata të pranojnë detyrime shtesë duke paguar një çmim më të lartë për energjinë elektrike dhe ujin nga ai që duhet të paguajnë realisht sipas faturave të lëshuara nga OSHEE dhe UKT përbën abuzim me pozitën dominuese kundrejt tregtarëve qiramarrës të ambienteve të kësaj ndërmarrjeje, në kuptim të nenit 9 të Ligjit 9121/2003.***

II.3.2 Sjellja kontraktore e ndërmarrjes EKMA ALBANIA SHPK

29. Ndërmarrja “EKMA Albania” SHPK jep me qira ambientet për magazinimin dhe tregtimin e produkteve Agro - Ushqimore nëpërmjet kontratave të lidhura me tregtarët e këtyre produkteve.
30. Në tregun Agro - Ushqimor të qytetit të Tiranës, i cili administrohet nga ndërmarrja “EKMA Albania” SHPK nuk ka një rregullore të mirë përcaktuar dhe miratuar për organizimin dhe mirëfunksionimin e tregut, mbi bazën e së cilës të mund të monitorohet sjellja e ndërmarrjes me pozitë dominuese që vepron e vetme në tregun e qiradhënies së ambienteve për magazinimin dhe tregtimin e produkteve Agro - Ushqimore në qytetin e Tiranës.
31. Ndërmarrja “EKMA Albania” SHPK, e cila është e vetme në ofrimin e shërbimit për dhënie me qira të ambienteve për magazinimin dhe tregtimin e produkteve Agro - Ushqimore në qytetin e Tiranës, nuk zbaton ligjet dhe zakonet e mira tregtare, sepse në kontratat e qirasë të lidhura midis saj si qiradhënëse dhe tregtarëve si qiramarrës zbatohen kushte të padrejta dhe imponuese tregtimi.
32. Këto kontrata, të cilat përmbajnë kushte imponuese vetëm për njërën palë të kontratës – “qiramarrësin”, i bëjnë të pavlefshme kushtet e përgjithshme të këtyre kontratave, që sjellin një humbje ose dëmtim të shpërpjesëtuar të interesave të palës kontraktuese, posaçërisht kur ato ndryshojnë në mënyrë thelbësore nga parimet e barazisë e të paanësisë të shprehura në dispozitat e Kodit Civil që rregullojnë marrëdhëniet kontraktuale.
33. Në referencë të Ligjit Nr. 9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, ndërmarrjet të cilat ndodhen në pozitë dominuese kanë detyrimin për t’u sjellë në një formë të caktuar në mënyrë që të mos pengojnë, kufizojnë apo shtrembërojnë konkurrencën në treg.
34. Ndërmarrja “EKMA Albania” SHPK ndryshe nga sa parashikohet më sipër, nëpërmjet “kontratës tip” të qirasë të aplikuar për qiramarrësit që operojnë në këtë treg Agro - Ushqimor vendos kushte diskriminuese dhe të padrejta tregtimi, duke i vendosur palët në pozita të pabarabarta, ku vullneti i qiradhënësit (“EKMA Albania” SHPK) i është imponuar qiramarrësve.
35. Përmbajtja e çdo “kontrate tip qiraje” është haptazi në favor të interesave të qiradhënësit, pasi vetëm ai ka të drejta, ndërsa qiramarrësi ka vetëm detyrime, të cilat janë të pasqyruara qartë në të gjitha nenet e kontratave tip (nenet: 3,4,5, 6,7, 8;), çka bie në kundërshtim edhe dispozitat e vetë Kodit Civil, i cili rregullon kontratën e qirasë dhe parashikon shprehimisht se cilat duhet të jenë të drejtat dhe detyrat e palëve në një kontratë qiraje, respektivisht: Të drejtat dhe detyrat e qiradhënësit, nenet 805 – 811; Të drejtat dhe detyrat e qiramarrësit, nenet 812 – 826.
36. Ndërmarrja “EKMA Albania” SHPK, për shkak të pozitës së saj dominuese i transferon shërbimet, të cilat sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.19, datë 09.04.2015 duhet të sigurohen nga vetë ndërmarrja, tek qiramarrësi, duke abuzuar, dhe duke u shkakuar këtyre të fundit dëm ekonomik, si dhe duke i detyruar të pranojnë detyrime shtesë të cilat për vetë natyrën e tyre nuk kanë lidhje me objektin e kontratës në fjalë.

37. “Kontrata tip” e qirasë, aplikuar nga ndërmarrja “EKMA Albania” SHPK bie në kundërshtim me nenin 9, pika 2, gërma a), c) dhe ç) të Ligjit Nr. 9121/2003, ku megjithëse afati i kontratës është 1 (një) vjeçar, ndërmarrja “EKMA Albania” SHPK e detyron qiramarrësin të negociojë muaj për muaj për çmimin e saj, duke krijuar paqëndrueshmëri financiare për qiramarrësin dhe duke e vendosur këtë të fundit në kushte të pafavorshme konkurrence.

II.3.3 Masa e përkohshme

38. Referuar sjelljes së ndërmarrjes “EKMA Albania” SHPK në tregun e qiradhënies të ambienteve për magazinimin dhe tregtimin e produkteve Agro - Ushqimore në qytetin e Tiranës, ndodhur përballë një situatë urgjence, për shkak të rrezikut të kryerjes së një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm për konkurrencën në këtë treg, për një shkelje të mundshme të nenit 9 të Ligjit Nr. 9121/2003, Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 8, nenin 9, nenin 24 shkronja d, nenin 26, nenin 44, dhe nenin 61, pika d) dhe dh), të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, me Vendimin Nr. 542, datë 04.09.2018 ka vendosur marrjen e masave të përkohshme për rivendosjen e konkurrencës në tregun e qiradhënies së ambienteve për magazinimin dhe tregtimin e produkteve Agro - Ushqimore në qytetin e Tiranës.
39. Vendimi i Komisionit të Konkurrencës Nr. 542, datë 04.09.2018, me anë të shkresave Nr. 365/6 Prot., datë 04.09.2018 dhe Nr. 500 Prot., datë 12.09.2018, i është dërguar ndërmarrjes “EKMA Albania” SHPK, Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE), si dhe Ndërmarrjes Ujësjellës Kanalizimeve Tiranë (UKT).
40. OSHEE i është përgjigjur njoftimit të Vendimit nëpërmjet shkresave të saj Nr. 17361/1 Prot., datë 20.09.2018 dhe Nr. 17361/3 Prot, datë 02.10.2018, si dhe UKT me anë të shkresës së saj Nr. R-3633/1 Prot., datë 08.10.2018.
41. Në zbatim të Vendimit Nr. 542, datë 04.09.2018 “Për marrjen e masave të përkohshme për rivendosjen e konkurrencës në tregun e qiradhënies së ambienteve për magazinimin dhe tregtimin e produkteve Agro - Ushqimore në qytetin e Tiranës”, ndërmarrja “EKMA Albania” SHPK, nëpërmjet shkresës Nr. 365/7 Prot., datë 05.10.2018, brenda afatit 30 ditor nga marrja dijeni e këtij vendimi, ka paraqitur pranë Autoritetit të Konkurrencës kontratat tip të qirasë: draft kontratë qiraje në lidhje me ambient magazinimi me qiradhënës “EKMA Albania” SHPK; si dhe draft kontratë qiraje në lidhje me ambient tregtie me qiradhënës “EKMA Albania” SHPK.
42. Nga vlerësimi i draft kontratave tip të qirasë, në zbatim të masave të përkohshme ndaj ndërmarrjes “EKMA Albania” SHPK, dhënë me Vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr. 542, datë 04.09.2018, rezulton se: Draft – kontrata e qirasë në lidhje me ambient tregtie me qiradhënës “EKMA Albania” SHPK, si dhe draft - kontrata e qirasë në lidhje me ambient magazinimi me qiradhënës “EKMA Albania” SHPK janë hartuar në mënyrë të njëanshme në favor të qiradhënësit duke mos vendosur palët e saj, qiramarrësin dhe qiradhënësin në kushte të barabarta kontraktuale.
43. Konstatohet se nga vlerësimi i draft - kontratave të paraqitura ndërmarrja “EKMA Albania” SHPK nuk ka zbatuar pikën II.1 të dispozitivit të Vendimit Nr. 542, datë 04.09.2018 të Komisionit të Konkurrencës, pasi nuk merr në konsideratë reflektimin e dispozitave të Kodit Civil për të vendosur palët në kushte të barabarta kontraktuale.

Bazuar në konkluzionet e mësipërme, rezulton se sjellja e ndërmarrjes “EKMA Albania” SHPK në kuptim të nenit 9, pika 2, gërmat (a), (c) dhe (ç) të Ligjit Nr. 9121/2003, përbën abuzim me pozitën dominuese në tregun e qiradhënies të ambienteve për magazinimin dhe tregtimin e produkteve Agro - Ushqimore në qytetin e Tiranës.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të nenit 8, nenit 9, pika 2 gërmat (a), (c) dhe (ç), nenit 24, shkronja (d), nenit 26, nenit 43, pika 5, nenit 45, pika 1, nenit 74, pika 1, gërma (a), nenit 75, pika 1, dhe 76, pika 1, gërma (a) dhe (c) të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Konstatimin e abuzimit me pozitën dominuese të ndërmarrjes “EKMA Albania” SHPK, në tregun e qiradhënies të ambienteve për magazinimin dhe tregtimin e produkteve Agro - Ushqimore në qytetin e Tiranës.
2. Gjykitjen e ndërmarrjes “EKMA Albania” SHPK për shkelje të rëndë të konkurrencës, konkretisht të nenit 9, pika 2, gërmat (a), (c) dhe (ç) të Ligjit Nr. 9121/2003, në masën 9.99 % të xhiros së ndërmarrjes të vitit paraardhës financiar (2017), përkatësisht në shumën XXX Lekë.
3. Detyrimin e ndërmarrjes “EKMA Albania” SHPK për të ndaluar shkeljen e konkurrencës dhe brenda 30 ditëve të marrë masat e nevojshme, si vijon:
 - a) Hartimin e kontratave të qirasë bazuar në dispozitat e Kodit Civil (për kontratën e qirasë) për të vendosur palët e saj, qiramarrësin dhe qiradhënësin në kushte të barabarta kontraktuale në zbatim të ligjit dhe zakoneve të mira tregtare.
 - b) Qiradhënësi të aplikojë çmime të arsyeshme të orientuara drejt kostos dhe çmimit mesatar të qirasë të zonës gjeografike.
 - c) Qiradhënësi të jetë transparent në detajimin e zërave dhe vlerave përkatëse që përfshihen në faturën e qirasë së ambientit.
 - d) Ndërmarrja “EKMA Albania” SHPK të ndalojë menjëherë faturimin mbi çmimin ligjor të miratuar nga institucionet kompetente (faturuar nga OSHEE dhe UKT).
4. Në rast të mos përmbushjes së kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në pikën III të këtij Vendimi, ndërmarrja “EKMA Albania” SHPK ndëshkohet me gjobë deri në 10 % të xhiros vjetore për shkelje të rëndë të konkurrencës në zbatim të nenit 74, pika 1, gërma (c) të Ligjit Nr. 9121/2003.
5. Në rast se ndërmarrja “EKMA Albania” SHPK nuk ndërpret shkeljen e nenit 9 të Ligjit Nr. 9121/2003 dhe nuk vepron në përputhje me detyrimet dhe brenda afateve të përcaktuara në këtë vendim, Komisioni i Konkurrencës vendos gjoba periodike deri në 5 % të xhiros mesatare ditore të vitit financiar paraardhës, derisa ndërmarrja EKMA Albania SHPK të veprojë në përputhje me këtë vendim, në zbatim të nenit 76, pika 1, gërma (a) dhe (c) të Ligjit Nr. 9121/2003.
6. Mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e qiradhënies së ambienteve për magazinimin dhe tregtimin e produkteve Agro - Ushqimore në qytetin e Tiranës.
7. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 573, Datë 26.11.2018

“Për hapjen e procedurës së Hetimit të Përgjithshëm në Sektorin e Arsimit të Lartë”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 26.11.2018, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Hapja e procedurës së Hetimit të Përgjithshëm në Sektorin e Arsimit të Lartë,

Baza ligjore: Neni 4 dhe 9; neni 24, shkronja d, neni 26 dhe neni 41 i Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”,

Ligji nr. 44/2015 datë 30.04.2015 “Kodit të Procedurës Administrative në RSH”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit “Konkurrenca në arsimin e Lartë”,

VËREN SE:

Autoriteti i Konkurrencës në funksion të misionit për mbrojtjen e konkurrencës në treg dhe vlerësimin e tregjeve të reja ka realizuar një studim në sektorin e arsimit të lartë.

Metodologjia e ndjekur në këtë studim u bazua në metodën cilësore të kërkimit. Ajo përfshiu interpretimin e kuadrit ligjor shqiptar, analizën e dokumentacionit të administruar, intervistat, si dhe u mbështet në argumentet e paraqitura në të dhënat (statistikat) zyrtare të publikuar nga institucionet shtetërore. Çështjet kryesore ku u fokusua studimi ishin: Liberalizimi i arsimit të lartë dhe impakti në konkurrencë; Ligji i Konkurrencës në arsim; Mekanizmat për konkurrencë të lirë – tregu i studentëve;

Konkurrenca midis IAL-ve në Shqipëri, është shoqëruar me një reformë konkrete të ndërmarrë nga vetë IAL-të, për të ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në tregun e arsimit të lartë. Në themel të kësaj reforme, qëndron përshtatja e rregullave konkurruese me qëllim që ato të ofrojnë një shërbim cilësor, bazuar mbi standarde sipas elementëve të mëposhtëm:

1. *Gjithëpërfshirja*. IAL-të publike dhe private, po përpiqen të ushtrojnë veprimtarinë e tyre shoqëruar nga respektimi dhe zbatimi i parimeve dhe rregullave të konkurrencës, ku ofrimi i arsimit si shërbim të sjellë krijimin e një mjedisi për konkurrencë midis IAL-ve publike dhe/ose private. Kështu, IAL-të private të cilat në tregun e arsimit të lartë respektohen për cilësinë dhe besueshmërinë, kanë fiksuar tarifat e studimit, të cilat tashmë kanë marrë “forcën e zakonit”.
2. *Përgjegjshmëria*. IAL-të publike dhe private të cilat duan të kenë “fizionominë e tyre” në harmoni me “Strategjinë Kombëtare të Arsimit të Lartë” dhe me nevojat e zhvillimit ekonomik e shoqëror të vendit, po respektojnë dhe zbatojnë rregulltat e konkurrencës në funksion të rritjes së cilësisë së shërbimit për studentët. Kështu, në “garën” midis tyre, IAL-të private po ofrojnë programe studimi bashkëkohorë të pazbatuara më parë në Shqipëri, po rekrutojnë stafe akademike të kualifikuara, po marrin pjesë në projekte

kërkimore shkencore, rajonale dhe Evropiane, ku në këto të fundit mund të përmendim: Programin Erasmus+, etj.

3. *Transparenca*. IAL-të publike dhe private, në ushtrimin e veprimtarisë së tyre po synojnë të jenë të hapura dhe po përpiqen të tregojnë se çfarë standardesh ato ofrojnë në funksion të cilësisë.
4. *Integriteti*. IAL-të publike dhe private, po përpiqen të bëjnë normë të veprimtarisë së tyre deklarimin e skemave financiare në drejtim të sigurimit të të ardhurave dhe të përdorimit të burimeve financiare kundrejt stafit akademik, administrativ dhe studentëve. Kërkesë kjo e parashikuar edhe në “Standardet institucionale”.
5. *Bashkëpunimi*. IAL-të po përpiqen të zhvillojnë veprimtarinë e tyre duke bashkëpunuar me të gjithë aktorët dhe faktorët e tregut që veprojnë në fushën e arsimit të lartë, përfshirë: studentë, prindër, institucione publike dhe private, dhe IAL-ve të tjera, publike ose private.

Diversiteti i IAL-ve publike dhe private ka krijuar një treg të larmishëm, ku studentët janë të lirë të zgjedhin. Zgjedhja e tyre, mbështetet në informacionin e ofruar nga mekanizmat shtetërore, veçanërisht MAS/ASCAL dhe vetë IAL-të publike ose private. Ky informacion duhet të jetë i dhënë saktë në mënyrë reale dhe transparente sepse vetëm kështu ai krijon besueshmëri dhe mundësi më të madhe zgjedhje nga studenti.

Pas vlerësimit të gjetjeve, është e vështirë të konkludohet për konkurrencën në Sektorin e Arsimit të Lartë, pasi çështjet e mësipërme kanë nevojë për një trajtim më të thelluar dhe më gjithëpërfshirës për të parë nëse ka element të cënimit të konkurrencës në kuptim të nenit 4 dhe nenit 9 të Ligjit 9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, gërma d dhe nenit 41, pika 1 e Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, (i ndryshuar),

VENDOSI:

1. Hapjen e Hetimit të Përgjithshëm në Sektorin e Arsimit të Lartë
2. Hetimi do të përfshijë periudhën kohore nga 01.01.2017 deri në përfundim të procedurave hetimore.
3. Raporti i Hetimit të Përgjithshëm duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se 6 (gjashtë) muaj nga dita e çeljes së këtij hetimi.
4. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe për njoftimin e palëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 574, Datë 26 .11.2018

“Për hapjen e procedurës së Hetimit të Përgjithshëm në Tregun e Profesioneve të Lira”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 26.11.2018, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Hapja e procedurës së Hetimit të Përgjithshëm në Tregun e Profesioneve të Lira

Baza ligjore: Neni 4, Neni 9, Neni 24, shkronja d, neni 26 dhe neni 41 i Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të përpiluar nga ekspertë të fushës mbi studimin në tregun e Shërbimeve të Noterisë & Avokatisë,

VËREN SE :

Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës në zbatim të nenit 28 të Ligjit 9121 datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, ka realizuar një studim në tregun e profesioneve të lira. Studimi u mbështet mbi praktikën më të mirë të vlerësimit të tregut të shërbimeve të noterisë & avokatisë të OECD.

Tregu i Profesioneve të Lira, si treg i rregulluar, mund të paraqesë kufizime në hyrjen dhe sjelljen profesionale. Sfida e Autoritetit të Konkurrencës është të zbulojnë këto kufizime nëse vijnë nga:

— Kuadri rregullator

— Kufizime për hyrjen dhe sjelljen profesionale

Rregullat që kufizojnë hyrjen në profesionet ligjore dhe qeverisin në mënyra të ndryshme sjelljet profesionale, janë të dyja të përfshira në ligj, së bashku me rregullat vetërregulluese lëshuar nga organet profesionale. Në lidhje me hyrjen, nuk ka vetëm kufizime cilësore (arsim, praktike mësimore dhe provime) por edhe kufizime sasiore bazuar në kriteret demografike ose gjeografike. Përveç kësaj, titujt profesional janë të mbrojtur dhe mund të kërkojnë anëtarësimi në organet profesionale. Në lidhje me sjelljen e biznesit, shpesh ka rregulla për reklamimin, format e organizimit të biznesit dhe partneritetet.

— Heqja e kufizimeve të pa nevojshme

Sfida kryesore e politikës së konkurrencës është identifikimi dhe heqja e kufizimeve të cilat janë të panevojshme ose jo proporcionale për të arritur qëllimet e interesit publik. Ligji dhe mbrojtja e konkurrencës mund të luajnë një rol të madh në këtë drejtim, duke sfiduar aktivitetin jo konkurrues ose duke mbrojtur ndryshimet në ligje dhe rregullore.

— Blerësit e informuar kundër blerësve të pa informuar

Mund të identifikohen dy kategori të gjera të blerësve. Në segmentet e tregut ku blerësit e informuar, si korporatat e mëdha ose autoritetet publike, blejnë shërbime ligjore mbi baza të rregullta. Simetritë e

informacionit mund të tejkalohen nga aftësitë e blerësit për të kuptuar dhe mekanizmat e reputacionit dhe në këto raste do të nevojiten me pak rregullime të përcaktuara për të mbrojtur blerësit.

Nga ana tjetër, në tregjet me blerës të painformuar e jo të rregullt mund të nevojitet rregullimi për parandalimin e përzgjedhjes negative. Simetria e informacionit dhe transparenca e tij e bëjnë përzgjedhjen e blerësve një zgjedhje të zgjuar.

— Të drejtat ekskluzive

Në shumicën e juridiksioneve, avokatët gëzojnë monopolin për përfaqësimin e klientëve në gjykata. Tregu për këshilla ligjore mbetet kryesisht i hapur. Për tjetërsimin ligjor të pronësisë së tokës dhe regjistrimin e transfertave në regjistrat publikë ka situata të ndryshme tjetërsimi. Noterët në disa vende gëzojnë të drejtat ekskluzive për të ofruar shërbime tjetërsuese në juridiksionin e tyre.

— Sjelljen ndaj çmimeve dhe reklamave për shërbimet ligjore.

Reklamimi dhe kufizimet e çmimeve gradualisht po hiqen në shumicën e vendeve të OECD-së. Megjithatë, në disa vende, kufizimet mbi çmimet dhe reklamat mbeten në vend.

Sipas Legjislacionit Shqiptar, profesioni i Avokatit është profesion i lirë, i vetë rregulluar, dhe i vetëdrejtuar. Avokati ushtron profesionin e tij individualisht ose në bashkëpunim me avokatë të tjerë, pasi është pajisur me lejen e ushtrimit të profesionit dhe është regjistruar në organet tatimore. Tarifat e Avokatit për dhënien e ndihmës juridike përcaktohen nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë në mbështetje të urdhrit nr.1284/3, datë 16.03.2005.

Profesioni i Noterit në Shqipëri është profesion i lirë dhe i nënshtrohet vetëm ligjit, ai licensohet nga Ministri i Drejtësisë. Leja për ushtrimin e profesionit të noterit, së bashku me të dhënat përkatëse, regjistrohen në regjistrin e noterëve pranë Ministrisë së Drejtësisë dhe në Dhomën Kombëtare të Noterisë. Numri i përgjithshëm i noterëve që ushtrojnë veprimtarinë tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë duhet të jetë në përpjesëtim të arsyeshëm me numrin e përgjithshëm të popullsisë. Tarifat e shërbimit për këtë profesion miratohen nga Ministria e Drejtësisë në mbështetje të Urdhrit nr. 279, datë 14.06.2012.

Vlerësimi i pasurive të paluajtshme, të kërkuara si kolateral për dhënien e një kredie nga një institucion krediti që ushtron veprimtarinë në Shqipëri, është i nevojshëm në rast kredi marrje pranë bankave. Procedura e marrjes së shërbimit realizohet në përputhje me kriteret e vendosura në metodologjinë e miratuar nga Këshilli i Ministrave me Vendimin nr. 658 të datës 26.09.2012 “Për Miratimin e Metodologjisë për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme në Republikën E Shqipërisë”.

Gjatë procedurave të mëparshme administrative, tregu i shërbimit të noterisë është bërë objekt vlerësimi në lidhje me shërbimin që ato ofrojnë për bankat nga ku është konstatuar një përqendrim i këtyre shërbimeve në një numër të kufizuar noterësh.

E njëjta problematike është konstatuar në shërbimin e vlerësuesve të pasurisë së paluajtshme ku shërbimi është përqendruar në pak ofrues dhe përzgjedhja e tyre behet nga bankat.

Pikërisht, mundësia për kufizime të tilla mund të jenë objekt vlerësimi në këndvështrimin e Ligjit nr, 9121/2003, duke gjetur ekuilibrim mes konkurrencën në shërbimin e noterisë, avokatisë e vlerësuesve të pasurisë dhe rritjes së cilësisë së shërbimit e efikasitetit ekonomike. Çështjet e mësipërme kanë nevojë për një trajtim më të thelluar dhe më gjithëpërfshirës dhe gjykojmë se nëpërmjet një procedure hetimore do të mund të realizojnë një vlerësim më të plotë të tregut.

Procedurat e mëtejshme do të thellojnë analizën në çështje që kanë të bëjnë me kuadrin rregullator, të drejtat ekskluzive, vlerësimin e ofertës për shërbime apo sjelljen ndaj çmimeve dhe reklamave për shërbimin e noterisë, avokatisë dhe vlerësuesve të pasurive të paluajtshme për të parë nëse ka element të çenimit të

konkurrencës në kuptim të nenit 4 dhe nenit 9 të Ligjit 9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, gërma d dhe nenit 41, pika 1 e Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, (i ndryshuar),

VENDOSI:

1. Hapjen e Hetimit të Përgjithshëm në Tregun e Profesioneve të Lira (shërbimin e noterisë, avokatisë dhe vlerësuesve të pasurive të paluajtshme).
2. Hetimi do të përfshijë periudhën kohore nga 01.01.2017 deri në përfundim të procedurave hetimore.
3. Raporti i Hetimit të Përgjithshëm duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se 6 (gjashtë) muaj nga dita e çeljes së këtij hetimi.
4. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe për njoftimin e palëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 575, Datë 03.12.2018

“Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak ndaj ndërmarrjes “Bankers Petroleum Albania” LTD në tregun e prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 03.12.2018, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Hapja e procedurës së hetimit paraprak ndaj ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania LTD (Bankers) në tregun e prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto.

Baza ligjore: Neni 8, neni 9, Neni 24, shkronja (d) dhe neni 42 i Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar (Ligji Nr. 9121/2003).

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm mbi ankesat ndaj ndërmarrjes Bankers,

VËREN SE:

1. Pranë Autoritetit të Konkurrencës ndërmarrja “Tosk Energji” SHA (Tosk) dhe “Al.Global Oil” SHA nëpërmjet Formularit të Ankesës kanë depozituar ankesën ndaj ndërmarrjes Bankers, lidhur me abuzimin me pozitën dominuese në tregun e prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto, duke kërkuar dhe marrjen e masës së përkohshme ndaj ndërmarrjes Bankers.
2. Gjatë vitit 2017, sasia totale e naftës bruto e prodhuar në Shqipëri është XXX ton, nga të cilat ndërmarrja Bankers është prodhuesi më i madh në krahasim me prodhuesit e tjerë me XXX ton.
3. Sipas sasisë totale të prodhuar në Shqipëri të naftës bruto, për vitin 2017 ndërmarrja Bankers zë rreth XXX % të tregut përkatës dhe për tre mujorin e parë të vitit 2018 zë XXX% të tregut.
4. Një nga kriteret bazë për vlerësimin e strukturës së tregut është pjesa e tregut të ndërmarrjeve në tregun përkatës. Duke marrë parasysh pjesët e tregut përkatës të ndërmarrjeve, bazuar në nenin 8 të Ligjit Nr. 9121/2003, ndërmarrja Bankers ka pozitë dominuese në tregun e prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto në Republikën e Shqipërisë.
5. Për ndërmarrjet që ushtrojnë aktivitet në tregun e përpunimit të naftës bruto dhe prodhimit të nënprodukteve të naftës, furnizimi me këtë produkt është i domosdoshëm për vazhdimin e aktivitetit të tyre, pasi mungesa e furnizimit sjell ndërprerjen e procesit teknologjik.
6. Referuar ankesave, rezulton se ndërmarrja Tosk ka marrë me nën qira Rafinerinë e Përpunimit të Naftës në Ballsh, kurse ndërmarrja “Al.Global Oil” SHA zotëron Uzinën e Përpunimit të Naftës në Fier.
7. Ndërmarrja Bankers ka lidhur me ndërmarrjen Tosk kontratën e shitjes së naftës bruto datë 01.05.2018 për furnizime për periudhën Maj- Dhjetor 2018 dhe me ndërmarrjen “Al.Global Oil” SHA kontratën e shitjes së naftës bruto datë 01.04.2018 për furnizime për periudhën Prill - Dhjetor 2018.

8. Nga provat e depozituara nga ndërmarrja “Al.Global Oil” SHA, referuar komunikimit nëpërmjet e-mail, rezulton se ndërmarrja Bankers i ka ofruar kësaj ndërmarrjeje që për periudhën Janar – Dhjetor 2019 ta furnizojë me XXX Mt naftë bruto +/- 10% në muaj.
9. Sipas ndërmarrjes “Al.Global Oil” SHA, kapaciteti maksimal përpunues mujor i saj është XXX Mt/muaj ndërkohë që ndërmarrja Bankers e furnizon me vetëm XXX Mt/vit.
10. Sipas ndërmarrjes Tosk, ajo është furnizuar me XXX MT naftë bruto, kurse nevojat e saj për furnizim janë XXX MT. Sipas ndërmarrjes Tosk, kjo mënyrë jolineare furnizimi dhe jo në sasinë e duhur ka sjellë fikjen 2 here të rafinerisë në një kohë shumë të shkurtër ku shkaku kryesor i fikjes ka qenë mosfurnizimi me lëndë të parë, naftë bruto.
11. Mos furnizimi i ndërmarrjeve që ushtrojnë aktivitet në tregun e përpunimit të naftës bruto dhe tregtimit të nënprodukteve të naftës, nga ndërmarrja me pozitë dominuese Bankers në tregun e prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto, me sasinë e nevojshme të naftës, sjell kufizimin e prodhimit të nënprodukteve të naftës nga këto ndërmarrje dhe për rrjedhojë mund të kufizojë konkurrencën në kuptim të nenit 9, pika 2, gërma (b) të Ligjit Nr. 9121/2003.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 8, nenin 9, nenin 24, shkronja (d) dhe nenin 42 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Hapjen e procedurës së hetimit paraprak ndaj ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania LTD (Bankers) në tregun e prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto;
2. Hetimi paraprak të përfshijë periudhën kohore nga 1 janar 2016 deri në 30 nëntor 2018.
3. Raporti i hetimit paraprak duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se 3 (tre) muaj nga dita e çeljes së këtij hetimi.
4. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 578, Datë 20.12.2018

“Për marrjen e masave të përkohshme në tregun e prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto ndaj ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania LTD”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 20.12.2018, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Marrja e masave të përkohshme në tregun e prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto ndaj ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania LTD (Bankers).

Baza ligjore: Neni 8, neni 9, Neni 24, shkronja (d) dhe neni 44 i Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar (Ligji Nr. 9121/2003).

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm mbi ankesën ndaj ndërmarrjes “Bankers Petroleum Albania” SHA,

VËREN SE:

1. Pranë Autoritetit të Konkurrencës ndërmarrja “Tosk Energji” SHA (Tosk) dhe “Al.Global Oil” SHA nëpërmjet Formularit të Ankesës kanë depozituar ankesën ndaj ndërmarrjes Bankers, lidhur me abuzimin me pozitën dominuese në tregun e prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto, duke kërkuar dhe marrjen e masës së përkohshme ndaj ndërmarrjes Bankers.
2. Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 42 të Ligjit Nr. 9121/2003, me vendimin Nr. 575, datë 03.12.2018, ka vendosur hapjen e procedurës së hetimit paraprak ndaj ndërmarrjes Bankers në tregun e prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto.
3. Ndërmarrja “Al.Global Oil” SHA me shkresën Nr. 607/5 Prot., datë 11.12.2018, shprehet se heq dorë nga ankesa e depozituar pranë Autoritetit të Konkurrencës, por në bazë të nenit 64, pika 4 të Kodit të Procedurave Administrative, tërheqja e një pale nuk çon në përfundimin e procedurës administrative, në rast se organi publik vlerëson se vazhdimësia e procedurës është në interes publik ose në interesin e ligjshëm të palëve të tjera.
4. Ndërmarrja Tosk shprehet se ndërmarrja Bankers ka abuzuar duke refuzuar furnizimin me naftë bruto ose duke vendosur kushte kufizuese për këtë furnizim (natyrë sasiore dhe financiare), duke sjellë si pasojë humbje të larta financiare për ankuesin, që përfshijnë edhe kosto në lidhje me rindezjen e rafinerisë së Ballshit, për shkak të fikjes së saj prej mos furnizimit të mjaftueshëm me naftë bruto.
5. Meqenëse në ankesat e depozituara nga ndërmarrjet është kërkuar dhe marrja e masave për përkohshme për ndërmarrjen Bankers, Autoriteti i Konkurrencës më datë 11.12.2018 realizoi një seancë dëgjimore me ndërmarrjen Bankers dhe Tosk, të cilat paraqitën pretendimet e tyre përpara Komisionit të Konkurrencës.
6. Përfaqësuesit e ndërmarrjes Bankers, gjatë seancës dëgjimore, pretenduan se sipas Ligjit Nr. 7746, datë 28.07.1993 “Për hidrokarburet (kërkimi dhe prodhimi)”, i ndryshuar (Ligji për hidrokarburet), kontraktori

ka të drejtë t'u shesë i lirë blerësve më të përshtatshëm naftën bruto që ka prodhuar dhe në kontratë nuk ka të parashikuar ndonjë prioritet lidhur me blerësit. Bankers prodhon rreth XXX MT naftë bruto në vit dhe një pjesë shkon për eksport, sipas kontratave me blerësit ndërkombëtarë dhe Tosk nuk është e vetmja rafineri në vend. Në materialet e depozituara nuk ka të dhëna lidhur me sasinë e naftës bruto të eksportuar nga Bankers për vitin 2018.

7. Gjithashtu, ndërmarrja Bankers me shkresën Nr. 1384/1 Prot., datë 17.12.2018 ka depozituar argumentet dhe provat e saj lidhur me marrjen e masës së përkohshme nga Autoriteti i Konkurrencës. Sipas ndërmarrjes Bankers ajo gëzon të drejta të plota dhe të pakushtëzuara, konform detyrimeve kontraktore, për të tregtuar me palë të treta naftën bruto që prodhon dhe mbi të cilën gëzon pronësi, ju ka ofruar çmim të njëjtë, blerësve në tregun kombëtar dhe ndërkombëtar.
8. Referuar provave të depozituara, rezulton se ndërmarrja Bankers ka nënshkruar më datë 10.12.2018 kontratën e shitjes së naftës bruto me ndërmarrjen "Al.Global Oil" SHA, për periudhën 1 Janar 2019 – 31 Dhjetor 2019 dhe sasia mujore e naftës bruto që ndërmarrja Bankers do të furnizojë ndërmarrjen "Al.Global Oil" SHA për vitin 2019 është minimumi XXX MT +/- 10% dhe maksimumi XXX MT +/- 10%.
9. Gjithashtu, ndërmarrja Bankers ka nënshkruar më datë 05.10.2018 kontratë për shitjen e naftës bruto midis ndërmarrjeve Bankers dhe Cepsa Trading S.A.U (Cepsa), për periudhën 1 Janar 2019 – 31 Dhjetor 2021 dhe sasia mujore e naftës bruto që ndërmarrja Bankers do të furnizojë ndërmarrjen Cepsa gjatë kohëzgjatjes së kontratës është minimumi XXX MT +/- 10% dhe maksimumi XXX MT +/- 10%.
10. Pas seancës dëgjimore, me shkresën Nr. 607/9 Prot., datë 13.12.2018, ndërmarrja Tosk ka depozituar si provë shtesë kontratën e draftuar nga Bankers për vitin 2019, e cila është dërguar më datë 12.12.2018. Kjo draft kontratë është depozituar si provë edhe nga ndërmarrja Bankers.
11. Sipas draftit të ri të kontratës të propozuar nga Bankers, sasia mujore e naftës bruto që Bankers do të furnizojë Tosk për vitin 2019 është minimumi XXX MT +/- 10% dhe maksimumi XXX MT +/- 10%, kurse sipas kontratës që është aktualisht në fuqi, sasia mujore e naftës bruto ka qenë XXX MT.
12. Ndërmarrja Tosk pretendon nuk është furnizuar me sasinë e nevojshme me naftë bruto dhe shpërndarje/alokim të furnizimit në shkelje të nevojës për furnizim të saj, gjë e cila fut në kolaps funksionimin e rafinerisë së Ballshit, e cila ka nevojë për furnizim ditor prej XXX ton në ditë. Sasia e furnizuar aktualisht nga Bankers, rezulton të jetë totalisht e pamjaftueshme për të mundur ndezjen e rafinerisë së Ballshit, kjo e fundit operon vetëm në kushtet e një furnizimi linear dhe periodik gjatë një muaji. Mos furnizimi sipas grafikut të rënë dakord, depozituar nga ndërmarrja Tosk gjatë seancës dëgjimore, në sasinë e nevojshme, me lëndën e parë (si input thelbësor) nga ana e Bankers, e cila është thuajse monopol në prodhimin e naftës bruto, sjell në mënyrë të përshkallëzuar, daljen jashtë tregut të ndërmarrjes Tosk.
13. Sipas sasisë totale të prodhuar në Shqipëri të naftës bruto, për vitin 2017 ndërmarrja Bankers zë rreth XXX% të tregut përkatës dhe për tre mujorin e parë të vitit 2018 zë XXX% të tregut.
14. Duke marrë parasysh pjesët e tregut përkatës të ndërmarrjeve, bazuar në nenin 8 të Ligjit Nr. 9121/2003, ndërmarrja Bankers ka pozitë dominuese në tregun e prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto në Republikën e Shqipërisë.
15. Për ndërmarrjet që ushtrojnë aktivitet në tregun e përpunimit të naftës bruto dhe prodhimit të nënprodukteve të naftës, furnizimi me këtë produkt është i domosdoshëm për vazhdimin e aktivitetit të tyre, pasi mungesa e furnizimit sjell ndërprerjen e procesit teknologjik.
16. Referuar ankesës së ndërmarrja Tosk, rezulton se ajo ka marrë me nën qira Rafinerinë e Përpunimit të

Naftës në Ballsh dhe ka lidhur me ndërmarrjen Bankers kontratën e shitjes së naftës bruto datë 01.05.2018 për furnizime për periudhën Maj - Dhjetor 2018, për një sasi nafte bruto prej XXX MT/muaj, +/- 10% në muaj.

17. Sipas ndërmarrjes Tosk, ajo është furnizuar me XXX MT naftë bruto, kurse nevojat e saj për furnizim janë XXX MT. Sipas ndërmarrjes Tosk, kjo mënyrë jolineare furnizimi dhe jo në sasinë e duhur ka sjellë fikjen 2 here të rafinerisë në një kohë shumë të shkurtër ku shkaku kryesor i fikjes ka qenë mos furnizimi me lëndë të parë, naftë bruto. Referuar parashtrimeve të depozituara pranë Autoritetit të Konkurrencës gjatë seancës dëgjimore të datës 11.12.2018, ndërmarrja Tosk kërkoi furnizimin e menjëhershëm me naftë bruto nga Bankers për Tosk me një sasi prej XXX ton në ditë dhe gjithsesi jo më pak se XXX ton në muaj.
18. Mos furnizimi i ndërmarrjeve që ushtrojnë aktivitet në tregun e përpunimit të naftës bruto dhe tregtimit të nënprodukteve të naftës, nga ndërmarrja me pozitë dominuese Bankers në tregun e prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto, me sasinë e nevojshme të naftës, sjell kufizimin e prodhimit të nënprodukteve të naftës nga këto ndërmarrje dhe për rrjedhojë mund të kufizojë konkurrencën në kuptim të nenit 9, pika 2, gërma (b) të Ligjit Nr. 9121/2003.
19. Lidhur me rafineritë vendase, UPN Fier dhe KPTHN Ballsh, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore me shkresën Nr. 4266 Prot., datë 17.05.2017, drejtuar ndërmarrjes Bankers, shprehet se: “Në mënyrë që këto rafineri të funksionojnë me një kapacitet të plotë, nevojitet një furnizim prej më shumë se XXX MT në muaj. AKBN konstaton se aktualisht Bankers Petroleum ka dedikuar vetëm (30-40%) të prodhimit të saj mujor, ndërsa pjesa më e madhe e prodhimit eksportohet jashtë territorit të Shqipërisë. Eksportimi i pjesës më të madhe të naftës së prodhuar nga kompania Bankers ka vendosur në një situatë të vështirë operacionale e financiare rafineritë vendase, ku si pasojë, UPN Fier nuk është në funksion prej më shumë se 7 muajsh, ndërsa KPTHN Ballsh po punon me një kapacitet minimal, duke sjellë për pasojë që shumica e punonjësve të trajtohen me asistencë. Kjo rrezikon të çojë drejt falimentimit rafineritë vendase.....”.
20. Në bazë të nenit 3 të Ligjit për hidrokarburet, të gjitha depozitimet e hidrokarbureve që ekzistojnë në gjendjen e tyre natyrore në shtresë, që shtrihen brenda juridiksionit të Shqipërisë, duke përfshirë zonat detare, janë pronë ekskluzive e shtetit shqiptar, i cili përfaqësohet nga Ministria përkatëse dhe të gjitha këto burime do të përdoren për dobinë e popullit shqiptar. Në bazë të marrëveshjes hidrokarbure të ndërmarrjes Bankers, ajo ka të drejtë të marrë, transportojë, disponojë dhe eksportojë lirshëm pjesën e tij të naftës, por nuk ka të drejtën e pronësisë ndaj hidrokarbureve në shtresë në zonën e projektit.
21. Gjithashtu, referuar nenit 673, të Kodit Civil, përcaktohet se: “Një ndërmarrje që zë një pozitë dominuese në treg, është e detyruar të kontrakttojë me cilindo që kërkon një detyrim, i cili bën pjesë në objektin e veprimtarisë.”.
22. Si përfundim, bazuar në nenin 44 të Ligjit Nr. 9121/2003, vlerësojmë se jemi përpara një rasti urgjence, pasi mos furnizimi me sasinë e nevojshme të produktit naftë bruto nga ndërmarrja me pozitë dominuese Bankers për ndërmarrjen Tosk dhe ndërmarrjet e tjera që ushtrojnë aktivitet në tregun e përpunimit të naftës bruto, të cilat nuk mund të vazhdojnë të ushtrojnë aktivitet në mungesë të këtij produkti, sjell ndërprerjen e aktivitetit të tyre dhe nxjerrjen nga tregu i përpunimit të naftës bruto dhe prodhimit të nënprodukteve të naftës. Nxjerrja nga tregu e ndërmarrjeve që ushtrojnë aktivitet në tregun e përpunimit të naftës bruto dhe prodhimit të nënprodukteve të naftës është një dëm i rëndë dhe i pariparueshëm për konkurrencën dhe ka të ngjarë të ketë shkelje të nenit 9 të Ligjit Nr. 9121/2003.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 8, nenin 9, nenin 24, shkronja (d) dhe nenin 44 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Marrjen e masës së përkohshme ndaj ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania LTD në tregun e prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto, si vijon:
 - a) Ndërmarrja Bankers Petroleum Albania LTD detyrohet që të respektojë të gjitha kontrata e lidhura me ndërmarrjen Tosk dhe të gjitha ndërmarrjet e tjera që ushtrojnë aktivitet në tregun e përpunimit të naftës bruto dhe prodhimit të nënprodukteve të naftës në territorin e Republikës së Shqipërisë;
2. Masa e përkohshme merret për një periudhë kohore deri në përfundim të procedurës hetimore;
3. Në rast të moszbatimit të vendimit për masa të përkohshme të cituara në pikën (1) të këtij vendimi, ndërmarrja Bankers Petroleum Albania LTD ndëshkohet me gjobë deri në 10 % të xhiros vjetore për shkelje të rëndë të konkurrencës në zbatim të nenit 74, pika 1, gërma b) të Ligjit Nr. 9121/2003;
4. Në rast të moszbatimit të masave të përkohshme brenda afateve të përcaktuara në këtë vendim, Komisioni i Konkurrencës vendosë gjoba periodike deri në 5 % të xhiros mesatare ditore, deri sa ndërmarrja Bankers Petroleum Albania LTD të veprojë në përputhje me vendimin për masat e përkohshme, në zbatim të nenit 76, pika 1, gërma b) të Ligjit Nr. 9121/2003;
5. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIME ME OBJEKT – PËRQENDRIME

VENDIM

Nr. 494, datë 24.01.2018

**“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të plotë të shoqërisë
MAK ALBANIA SHPK nga shoqëria KASTRATI SHA”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 24.01.2018, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Shqyrtimin e raportit të Sekretariatit mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet blerjes së kuotave të shoqërisë MAK ALBANIA SHPK nga shoqëria Kastrati SHA.

Baza Ligjore: Ligji Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, neni 24, germa d, nenet 2, 10 - 12, dhe neni 16 dhe Kreu IV “Procedurat për kontrollin e përqendrimeve” nenet 53 - 64, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe formulari i thjeshtuar “Për njoftimin e përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë, mbi njoftimin e përqendrimit mbi përfitimin e kontrollit të plotë të shoqërisë MAK ALBANIA SHPK nga shoqëria Kastrati SHA

VËREN SE:

Transaksioni dhe përqendrimi

Në datën 18 janar 2018, Autoriteti i Konkurrencës ka marrë njoftimin e transaksionit të realizuar në bazë të “Marrëveshjes për blerje aksionesh” midis ortakëve të shoqërisë MAK ALBANIA SHPK (Heritage Glory Albania, Z. Fawzi M.A. Alkhaurafi, Z. Loay MA Alkharafi) dhe shoqërisë KASTRATI SHA

Marrëveshja ka si objekt përfitimin e kontrollit të plotë të shoqërisë MAK ALBANIA SHPK nga shoqëria KASTRATI SHA, në mënyrë të drejtpërdrejte, me anë të përfitimit të 100% të kuotave të shoqërisë.

Palët në transaksion

Blerësi, shoqëria Kastrati SHA, është shoqëri aksionare e cila vepron sipas ligjeve të shtetit shqiptar, me NUIS K21711502V e themeluar në datë 30.05.2002, me objekt krijimin, instalimin dhe vënien në shfrytëzim të impianteve, stacioneve, reparteve, linjave për tregtimin e hidrokarbureve brenda e jashtë vendit, import-eksport dhe tregti me shumice e naftës, gazit, etj. Për ushtrimin e aktivitetit të grumbullimit, demolimit dhe shitblerjes së skrapit, hekurishteve dhe mbeturinave të tyre etj. tregti me shumicë dhe pakicë të artikujve industrialë etj.

Shitësit:

Heritage Glory Albania, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e cila ekziston nën Ligjet e Ishujve Cayman e themeluar më datë 08.04.2009. Kjo shoqëri zotëron 97.98% të të kuotave kapitalit të shoqërisë MAK ALBANIA SHPK,

Z. Fawzi M.A. Alkhaurafi, shtetas kuvajtian, me banim në Kuvajt i cili zotëron 1.01 % të kuotave të kapitalit të shoqërisë MAK ALBANIA SHPK,

Z. Loay MA Alkharafi, shtetas kuvajtian, me banim në Kuvajt, i cili zotëron 1.01 % të kuotave të kapitalit të shoqërisë MAK ALBANIA SHPK. Kuota e prej 1.01% është e zotëruar bashkërisht nga të tetë trashëgimtarët.

Targeti, MAK ALBANIA SHPK, është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e cila vepron sipas ligjeve të shtetit shqiptar, me NUIS J61821059A e themeluar në datë 18.05.1994, me objekt “Zhvillimi i veprimtarive private tregtare në fushën e ndërtimeve të ndryshme me karakter turistik, industrial social, ndërtim banesash, etj. Gjithashtu, objekt i veprimtarisë së saj do të jete: (i) veprimtari tregtare të import eksportit, të turizmit; veprimtari ndërtuese, administruuese, menaxhuese të një hoteli turistik të një niveli të lartë si dhe të hoteleve të tjera në të ardhmen sipas marrëveshjeve të interesit për çdo rast të veçantë; veprimtari ndërtimor objekteve social-kulturore; veprimtari tregtare lidhur me pronësi të paluajtshme në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi; veprimtari të ndryshme tregtare të shitjes, qiradhënies e qiramarrjes, pjesëmarrjes në shoqëri të tjera tregtare-krijimit të shoqërive të tjera; veprimtari financiare, bankare, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi, si dhe veprime agjenti, ndërmjetësimi e speditacioni; veprimtari akomodimi turistik, agjenci udhëtimesh turistike, aktivitet transporti.

Sipas Marrëveshjes së nënshkruar Blerësi dëshiron të blejë dhe Shitësi do të shesë të gjitha aksionet e shoqërisë në përputhje me termat dhe kushtet e marrëveshjes së firmosur.

Në varësi të kushteve dhe sipas kushteve të kësaj Marrëveshjeje, shitësit shesin dhe blerësi blen të gjitha aksionet në pronësi të shitësit që përben 100% të kapitalit aksionar të shoqërisë së bashku me të gjithë të drejtat titujt dhe/ose interesat e bashkangjitur.

Pas transferimit të titujve të aksioneve të shitësit, Blerësi behet aksionar i vetëm i shoqërisë dhe Shitësit humbasin çdo të drejtë pronësie, të drejta mbi dividendin ose të drejta të tjera që rrjedhin nga pronësia mbi kapitalin aksionar të kompanisë.

Çmimi i blerjes është XXX EURO.

Xhiro për vitin 2016

Palët në transaksion janë shoqëri të cilat veprojnë në territorin e Shqipërisë dhe referuar pasqyrave financiare të vitit 2016 të depozituara prej tyre, rezulton që:

Xhiro totale në tregun e brendshëm është XXX¹³ Lekë

— KASTRATI SHA XXX Lekë

— MAK ALBANIA SHPK XXX Lekë

Palët në transaksion plotësojnë kriteret e xhiros së përcaktuar në nenin 12, pika 1, germa a) të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.

Analiza e konkurrencës

Përcaktimi i Tregut Përkatës

¹³ Burimi: Pasqyrat financiare / 2016 Kastrati SHA dhe MAK ALBANIA SHPK

Referuar nenit 3, pika 7, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, si edhe Udhëzimit Nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, përcaktimi “treg përkatës”, përfshin dy komponentë:

- tregu përkatës i produktit, dhe
- tregu përkatës gjeografik.

Sipas objekti të aktivitetit të shoqërisë TARGET, transaksioni ndodh në tregun e hoteleri –turizmit dhe vendin e ushtrimit të aktivitetit të shoqërisë është Sheraton Tirana Hotel and Tour, Njësia Administrative Nr. 5, Sheshi Italia Tirane,

- **Tregu përkatës i produktit:** Referuar Udhëzuesit “Për përcaktimin e tregut përkatës”, si dhe sa më sipër, treg përkatës në analizën e përqendrimit të ndodhur është konsideruar ‘tregu i hotelierisë’.
- **Tregu përkatës gjeografik:** Për analizimin e këtij rasti treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i qyteti i Tiranës.

Vlerësimi i konkurrencës

Tregu i hoteleve segmentohet në disa klasa referuar kategorisë, normave dhe standarteve të komfortit. Klasa I-rë përfshin kategorinë e hoteleve më 5 – yje por pa i segmentuar në tipet si deluxe, grand etj., klasa II-të përfshin kategorinë e hoteleve me 4 yje, dhe klasa III-të kategoritë e hoteleve me 3 yje.

Nga informacionet e marra nga Shoqata Shqiptare e Turizmit (ATA), në zonën e Tiranës dhe Golemit numërohen rreth 280 njësi hotelesh, nga të cilët vetëm 210 njësi janë të vlerësuara sipas një sistemi standart që në rastin konkret kanë qenë yjet e Booking¹⁴. Referuar kapaciteteve, këto përbëjnë rreth 4465 dhoma dhe numërojnë rreth 10229 shtretër.

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur kapacitetet në dhoma dhe shtretër për hotelet mbi tre Yje në qytetin e Tiranës.

Nr.	HOTELI	KATEGORIA E YJEVE	KAPACITETI DHOMA	KAPACITETI SHTRETËR
1	ROGNER HOTEL	5 Yje	138	272
2	SHERATON HOTEL	5 Yje	151	171
3	TIRANA INTERNATIONAL HOTEL	4 yje	170	300
4	GRAND HOTEL	4 yje	34	66
5	DIPLOMAT HOTEL	4 yje	14	26
6	SKY HOTEL	4 yje	38	47
7	AIRPORT TIRANA HOTEL	4 yje	17	50
8	LIRIA HOTEL	4 yje	22	22
9	CITY HOTEL	3 Yje	14	16
10	SEVEN HOTEL	3 Yje	15	26
11	LIVIA HOTEL	3 Yje	20	24
12	FIRENZE HOTEL	3 yje	7	13
13	EUROPA HOTEL	3 Yje	16	22
14	CAPITAL HOTEL	3 Yje	29	35
15	NOBEL HOTEL	3 yje	9	12

Burimi: ATA, të dhënat i përkasin vitit 2016

Sikurse vërehet nga tabela, Hotel Sheraton është klasifikuar si një hotel, me pesë Yje, dhe për shkak të vendndodhjes gjeografike është një hotel që konkurrohet nga Hotel Tirana, Hotel Rogner dhe së fundmi edhe nga Hotel Plaza. Sipas kapaciteteve të shtretërve, Hotel Sheraton Tirana, renditet e treta në nivelin e hoteleve mbi tre Yje, duke u renditur pas Hotel Tirana dhe Hotel Rogner.

Sipas dokumentacionit të depozituar, shoqëria KASTRATI SHA zotëron paketën kontrolluese tek shoqëria AUTO STAR ALBANIA, Mercedes Benz, me 100% të kuotave të shoqërisë, e cila është një shoqëri e cila

¹⁴ booking.com - Faqe interneti e specializuar për rezervimin e hoteleve online në të gjithë botën.

ushtron veprimtari në tregun e importi, eksport dhe tregtim me shumicë apo pakicë të të gjitha llojeve të mjeteve motorike duke përfshirë importin e auto veturave, mjeteve të transportit të pasagjerëve, kamionëve dhe transportierëve të tij.

Pala blerëse (KASTRATI SHA) nuk zotëron kontroll mbi shoqëri që ushtrojnë aktivitet në tregun e hotelerisë dhe Komisioni i Konkurrencës konstaton se ky përqendrim nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti si rezultat i krijimit, ose forcimit të pozitës dominuese.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 56 pika 1, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, (i ndryshuar),

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të plotë të shoqërisë MAK ALBANIA SHPK nga shoqëria Kastrati SHA”
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 496, datë 08.02.2018

“Mbi përftimin e kontrollit të plotë të shoqërisë Buse Gaz S.r.l. nga Messer Belgium N.V. në mënyrë të drejtpërdrejte dhe të tërthortë nëpërmjet shoqërisë së kontrolluar tërësisht prej saj Messer Romania S.r.l.”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 08.02.2018, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Shqyrtimin e raportit të Sekretariatit mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përftimit të kontrollit të plotë të shoqërisë Buse Gaz S.r.l. nga Messer Belgium N.V. në mënyrë të drejtpërdrejte dhe të tërthortë nëpërmjet shoqërisë së kontrolluar tërësisht prej saj Messer Romania S.r.l.

Baza Ligjore: Ligji Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, neni 24, germa d, nenet 2, 10 - 12, dhe neni 16 dhe Kreu IV “Procedurat për kontrollin e përqendrimeve” nenet 53 - 64, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe formulari i thjeshtuar “Për njoftimin e përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë, mbi njoftimin e përqendrimit nëpërmjet përftimit të kontrollit të plotë të shoqërisë Buse Gaz S.r.l. nga Messer Belgium N.V. në mënyrë të drejtpërdrejte dhe të tërthortë nëpërmjet shoqërisë së kontrolluar tërësisht prej saj Messer Romania S.r.l.,

VËREN SE:

Transaksioni dhe përqendrimi

Në datën 22 dhjetor 2017, Autoriteti i Konkurrencës ka marrë njoftimin e transaksionit të realizuar në bazë të “Marrëveshjes për Transferimin e Kuotave” e nënshkruar më datë 24 Nëntor 2017. Marrëveshja është lidhur midis Messer Romania Gaz S.r.l dhe Messer Belgium N.V. / Buse KSV GMBH & CO. KG dhe ka si objekt përftimin e kontrollit të plotë të shoqërisë Buse Gaz S.r.l. nga Messer Belgium N.V. në mënyrë të drejtpërdrejte dhe të tërthortë nëpërmjet shoqërisë së kontrolluar tërësisht prej saj Messer Romania S.r.l., me anë të përftimit të 100% të kuotave.

Palët në transaksion

Messer Romania Gaz S.r.l: (“Messer RO”) në cilësinë e Blerësit, është një shoqëri rumune, me seli kryesore të ndodhur në adresën: “Str. Delea Veche nr.24, Corp A, floor 3, 024102 Bukuresht, sector 2”. Fusha kryesore e veprimtarisë¹⁵ së shoqërisë është: (i) prodhim produkteve kimike bazë, prodhimi plehrave kimike dhe i

¹⁵ Burimi, Akti i Themelimit të Shoqërisë i cili disponohet në dosjen e rastit pranë Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë.
XIV / 2018

produkteve të azotit; prodhimi i materialeve plastike dhe i materialeve prej kauçuku sintetik, në trajtat e lëndës së parë; me veprimtari kryesore - prodhimi gazeve industriale; etj.

Messer Belgium N.V, në cilësinë e Blerësit të dytë, është një shoqëri belge, me seli në adresën: “Haven 1053, Nieuwe Weg 1, 2070 Zwijndrecht”. Objekti kryesor i aktivitetit¹⁶ të shoqërisë është prodhimi i gazeve industriale

Blerësit, janë pjesë e Messer Group, një grup ndërkombëtar shoqërisht aktive në mbarë botën në prodhimin dhe shpërndarjen e gazeve industriale, mjekësore dhe të veçanta si dhe në shërbimet e lidhura me këto produkte. Në Shqipëri, Messer Group është e pranishme nëpërmjet shoqërisë shqiptare të kontrolluar Messer Albagaz SHPK, aktive në furnizimin e gazeve industriale.

Messer Albagaz sh.p.k, është një shoqëri e vendosur në Tiranë. Shoqëria është e përfshirë në prodhimin, shitjen dhe shpërndarjen e gazrave teknike, mjekësore dhe të veçanta, si dhe shitjen e pajisjeve dhe pjesëve të këmbimit në lidhje me biznesin kryesor.

Buse KSW GmbH & CO. KG është një shoqëri gjermane, me seli në adresën: “Sprudelstrasse 3, D-53557 Bad Honningen”. Fusha kryesore e veprimtarisë së shoqërisë është: (i) prodhimi i produkteve kimike bazë, i plehrave kimike dhe i produkteve të azotuara, prodhimi i materialeve plastike dhe i kauçikut sintetik, në formën e lëndëve të para; dhe me objekt kryesor (ii) prodhimi i gazeve industriale, etj.

Buse Gaz S.r.l në cilësinë e shoqërisë Target, është një shoqëri Rumune, me seli në adresën “Str. Drum intre Tarlale 102-115, sector 3”. Fusha kryesore e veprimtarisë¹⁷ së shoqërisë është: (i) prodhimi i produkteve kimike bazë, i plehrave kimike dhe i produkteve të azotuara, prodhimi i materialeve plastike dhe i kauçikut sintetik, në formën e lëndëve të para; dhe me objekt kryesor (ii) prodhimi i gazeve industriale; (iii) prodhim, përpunim, procesim, paketim, shitjen dhe shpërndarjen e gazeve industriale si dhe shitjen dhe shpërndarjen e gazeve të veçanta, qiradhënien, shitjen dhe shpërndarjen e cilindrave, cisternave dhe rimorkiove të gazit, në territorin e Rumanisë, etj.

Shoqëria Buse Gas S.r.l, nuk është prezente në Shqipëri, ajo zotërohet në masën 100% nga shoqëria gjermane Buse KSW GmbH & Co.KG.

Xhiro për vitin 2016

Xhiro totale në tregun ndërkombëtar është XXX¹⁸ Lekë:

- Messer Belgium N.V.: XXX Lekë
- Messer Romania Gaz S.r.l.: XXX Lekë
- Buse Gaz S.r.l.: XXX Lekë

Xhiro totale në tregun e brendshëm është XXX Lekë:

- Messer Albagaz SHPK: XXX Lekë.

Palët në transaksion plotësojnë kriteret e xhiros së përcaktuar në nenin 12, pika 1, germa a) të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrotjtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.

Analiza e konkurrencës

¹⁶ Burimi, Akti i Themelimit të Shoqërisë i cili disponohet në dosjen e rastit pranë Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë.

¹⁷ Burimi, Akti i Themelimit të Shoqërisë i cili disponohet në dosjen e rastit pranë Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë.

¹⁸ Burimi: Formulari i Njoftimit të Përqendrimit

Përcaktimi i Tregut Përkatës

Grupi Messer, si prodhues i gazeve industriale ofron një portofol produktesh i cili përfshin gaze si oksigjeni, azoti, argoni, dioksidi i karbonit, hidrogjeni, helium, gaze speciale, gaze mjekësore dhe një varietet të gjerë gazesh të përzierë.

Messer Belgium N.V. „një shoqëri e së drejtës belge, është pjesë e Grupit Messer. Objekti kryesor i aktivitetit të saj është prodhimi i gazeve industriale. XXX

Messer Belgium nuk ushtron aktivitet dhe nuk realizon xhiro në Shqipëri.

Messer Romania S.r.l., një shoqëri e së drejtës rumune, është pjesë e Grupit Messer. Objekti kryesor i aktivitetit të saj është prodhimi i gazeve industriale. Kjo shoqëri është prezentë kryesisht në Rumani.

Messer Romania nuk ushtron aktivitet dhe nuk realizon xhiro në Shqipëri.

Messer Grup është prezent në Shqipëri nëpërmjet shoqërisë së kontrolluar prej tij Messer Albagaz SHPK dhe është aktive në furnizimin e gazeve industriale, përkatësisht të oksigjenit, azotit, argonit, dioksid karboni, acetilen, gaze mbrojtës së saldimit, gaze ushqimore¹⁹, gaze të pastra dhe të veçantë, helium, hidrogjen dhe produkte dhe materiale mjekësore (pajisje për terapi me oksigjen dhe pajisje kriogjene)²⁰.

Buse Gaz S.r.l. është një shoqëri rumune aktiviteti i së cilës konsiston në prodhimin, përpunimin, procesimin, paketimin, shitjen dhe shpërndarjen e gazeve industriale si dhe shitjen dhe shpërndarjen e gazeve të veçanta, qiradhënien, shitjen dhe shpërndarjen e cilindrave, cisternave dhe rimorkiove të gazit, në territorin e Rumanisë.

Buse Gaz S.r.l. nuk ushtron aktivitet dhe nuk realizon xhiro në Shqipëri.

Referuar nenit 3, pika 7, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, si edhe Udhëzimit Nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, përcaktimi “treg përkatës”, përfshin dy komponentë:

— tregu përkatës i produktit; dhe

— tregu përkatës gjeografik.

Për sa më sipër meqenëse transaksioni nuk sjell asnjë efekt mbi konkurrencën në tregun shqiptar, tregu përkatës i produktit është lënë në përcaktimin e tij më të gjerë.

— **Tregu përkatës i produktit:** Referuar Udhëzuesit “Për përcaktimin e tregut përkatës”, si dhe sa më sipër, treg përkatës në analizën e përqendrimit të ndodhur është konsideruar ‘gazet industriale’.

— **Tregu përkatës gjeografik:** Për analizimin e këtij rasti treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Vlerësimi i konkurrencës

Referuar të dhënave të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, rezulton se volumi i gazeve industriale të importuar në vendin tonë për vitin 2016 ka qenë 10 265 967 kg, importuar nga 69 ndërmarrje importuese.

Tabela 1: Pjesët e tregut të ndërmarrjeve në tregun e gazeve industriale për vitin 2016

XXX

¹⁹ Gazet më të përdorur në industrinë agroushqimore si: dioksid karboni, azoti, oksigjeni dhe argoni.

²⁰ Burimi: Rasti ‘Messer Hungarogaz Kft. / Air Liquide Hungary Ipari Gaztermelo Kft.’, viti 2015

Konkurenti kryesor në këtë treg është ndërmarrja GTS Gazra Teknike Shqiptare SHPK me XX% të tregut, më pas vjen ndërmarrja Messer Albagaz SHPK me XX% të tregut, Coca-Cola Bottling Shqipëria SHPK me XX% të tregut, ndërmarrja Jovan Filo Gas SHPK me XX% të tregut dhe ndërmarrja LIMAK INSAAT SANAYI ve TICARET ANON me XX% të tregut. Në zërin “Të tjera” janë përfshirë gjithsej 64 ndërmarrje importuese me pjesë tregu më të vogël se XX%.

Buse Gaz S.r.l. nuk ushtron aktivitet në tregun shqiptar dhe si rrjedhojë nuk kemi mbivendosje të aktiviteti të palëve në tregun përkatës së produktit në territorin e Republikës së Shqipërisë. Struktura e tregut të gazeve industriale në vendin tonë do të mbetet e njëjtë si para transaksionit. Pjesët e tregut dhe fuqia e Messer Albagaz pas realizimit të përqendrimit nuk do pësoj asnjë ndryshim.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 56 pika 1, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, (i ndryshuar),

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të plotë të shoqërisë Buse Gaz S.r.l. nga Messer Belgium N.V. në mënyrë të drejtpërdrejte dhe të tërthortë nëpërmjet shoqërisë së kontrolluar tërësisht prej saj Messer Romania S.r.l.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 501, datë 15.03.2018

Mbi shitjen dhe transferimin e aksioneve të Bankës NBG Albania SHA, nga Banka Kombëtare e Greqisë S.A tek Banka Amerikane e Investimeve SHA

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 15.03.2018, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Shqyrtimin e raportit të Sekretariatit mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet shitjes dhe transferimit të aksioneve të Bankës NBG Albania SHA, nga Banka Kombëtare e Greqisë S.A tek Banka Amerikane e Investimeve SHA.

Baza Ligjore: Ligji Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, neni 24, germa d, nenet 2, 10 - 12, dhe neni 16 dhe Kreu IV “Procedurat për kontrollin e përqendrimeve” nenet 53 - 64, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe formulari i thjeshtuar “Për njoftimin e përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë, mbi njoftimin e përqendrimit nëpërmjet shitjes dhe transferimit të aksioneve të Bankës NBG Albania SHA, nga Banka Kombëtare e Greqisë S.A tek Banka Amerikane e Investimeve SHA,

VËREN SE :

Autoriteti i Konkurrencës në datë 07.02.2018 ka marrë njoftimin në lidhje me Marrëveshjen për Shitblerjen e Aksioneve të ndërmarrjes Banka NBG Albania SHA, të zotëruara 100% nga Banka Kombëtare e Greqisë S.A, tek Banka Amerikane e Investimeve SHA.

Blerësi: Banka Amerikane e Investimeve SHA, krijuar dhe regjistruar si person juridik shqiptar me vendim e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. 20830, datë 12.02.1999, me Objekt të veprimtarisë: *Të pranojë depozita të çdo lloji me ose pa interes, të ushtrojë aktivitetin kreditues duke përfshirë kredinë e konsumit kredinë hipotekare, financimin e bizneseve dhe transaksioneve të ndryshme tregtare, të marrë hua, të blejë e të shesë për llogari të saj dhe të klientëve instrumente të tregut të parasë, të kryejë të gjitha format e pagesave në favor të klientëve sipas standardeve ndërkombëtare, të emetojë letra me vlerë të çdo lloji dhe të kryejë të gjitha llojet e veprimeve me to.*

Shitësi: Banka Kombëtare e Greqisë S.A, një shoqëri anonime e organizuar dhe që vepron sipas ligjeve të Republikës së Greqisë.

Ndërmarrja Target: Banka NBG Albania, krijuar dhe regjistruar si person juridik me vendim e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr.12847, datë 22.11.1995, me Objekt të veprimtarisë: *Të kryejë veprimtaritë për pranimin e depozitave dhe fondeve të tjera nga publiku, të gjitha format e kredi-dhënies duke përfshirë edhe kredinë konsumatorë e kredinë hipotekare; qiranë financiar, të gjitha shërbimet e pagesave dhe të transferimit*

të parave, duke përfshirë kartat e kreditit dhe të debitit, çëqet e udhëtarit, çëqet bankare dhe kartat e pagesës; ofrimin e garancive dhe marrjen e angazhimeve; tregtimin për llogari të saj ose për llogari të klientëve qoftë edhe në një këmbim valutor në një treg të vetë-organizuar etj.

Objekt i marrëveshjes mes palëve është “Shitblerjen e Aksioneve të ndërmarrjes Banka NBG Albania SHA, të zotëruara 100% nga Banka Kombëtare e Greqisë S.A, tek Banka Amerikane e Investimeve SHA”.

Në zbatim të Ligjit Nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, palët në transaksion plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenin 10 dhe 12, pika 1 të tij dhe si rrjedhojë ky transaksion ju nënshtrohet procedurës së kontrollit të përqendrimeve të parashikuara në nenet 53 – 64 të Ligjit.

Transaksioni është një bashkim me përthithje i Bankës NBG Albania SHA nga Banka Amerikane e Investimeve SHA.

VLERËSIMI I PËRQENDRIMIT

Palët në marrëveshje ushtojnë aktivitet në tregun bankar, janë konkurrentë aktual dhe referuar Udhëzimit “Për vlerësimin e marrëveshjeve horizontale” përqendrimi i synuar klasifikohet si një përqendrim horizontal.

Në zbatim të nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, dhe Udhëzimit nr.131 datë 07.12.2009 “Për vlerësimin e marrëveshjeve horizontale, përcaktimi “treg përkatës” i referohet: Tregu përkatës i produktit - konsideruar - tregu i shërbimeve bankare; dhe Tregu përkatës gjeografik – konsideruar - territori i Republikës së Shqipërisë.

Nga vlerësimi i strukturës së tregut për treguesit kryesorë të sistemit bankar; aktivet, depozitat dhe kreditë u konstatua se:

- Në tregun e aktiveve, tregu bankar në Shqipëri klasifikohet si një treg mesatarisht i përqendruar ku indeksi i Herfindahl- Hirschman (HHI) është në vlerën XXX.
- Pas përqendrimit pjesa e kombinuar e Banka Amerikane e Investimeve SHA dhe Banka NBG Albania SHA do të shkojë në XX% të totalit të aktiveve dhe Indeksi HHI do të shkojë në vlerën XXX ku Δ HHI do të jetë në vlerën XXX.
- Tregu bankar klasifikohet si mesatarisht i përqendruar në terma të depozitave ku HHI është XXX. Pas përqendrimit pjesa e kombinuar e Banka Amerikane e Investimeve SHA dhe Banka NBG Albania SHA do të shkojë në XX% të totalit të depozitave dhe Δ HHI është XXX.
- Në produktin e kredisë, tregu paraqitet me strukture mesatarisht të përqendruar ku HHI është në vlerën XXX, kurse pas përqendrimit pjesa e kombinuar e tregut të dy ndërmarrjeve Banka Amerikane e Investimeve SHA dhe Banka NBG Albania SHA do të shkojë në XX% të totalit të kredisë dhe Δ HHI është XX.

Referuar Udhëzimit “Për vlerësimin e përqendrimeve horizontale”, pika 12, në ato përqendrimet ku indeksi HHI pas përqendrimit është midis 1000 dhe 2000 dhe delta HHI është nën 250, Autoriteti nuk identifikon probleme që lidhen me konkurrencën në nivel horizontal.

Nga sa më sipër vlerësojmë se struktura e tregut bankar pas përqendrimit nuk do të përbëjë problematikë për konkurrencën në treg pasi pjesa e tregut të dy bankave është shumë e vogël.

Sipas deklaratës së palëve në njoftim, Banka Kombëtare e Greqisë S.A, aksionari i vetëm i Banka NBG Albania SHA, synon të largohet nga tregu shqiptar, si rrjedhojë e impenjimeve që ka marrë me Bankën e Greqisë dhe Bankën Qendrore Evropiane në kuadër të planit të saj të rimëkëmbjes dhe ri fokusimit strategjik. Në dy vitet e fundit Grupi NBG ka shitur filialet në Turqi, Bullgari, Serbi dhe është në proces aktiv për të

përfunduar procesin e shitjes në Shqipëri, Rumani dhe Qipro. Gjatë vitit 2018 pritet të vijojë edhe me shitjen e filialit në Maqedoni.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 56 pika 1, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, (i ndryshuar),

VENDOSI:

1. Të autorizojë shitjen dhe transferimin e aksioneve të Bankës NBG Albania SHA nga Banka Kombëtare e Greqisë S.A tek Banka Amerikane e Investimeve SHA.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 502, datë 21.03.2018

Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të Nestle USA Inc. nga Ferrero International S.A.

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 21.03.2018, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të Nestle USA Inc. nga Ferrero International S.A.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, 24, gërma d); 53-64 të ligjit nr.9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” (ligji nr. 9121/2003), i ndryshuar; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe formulari i thjeshtuar “Për njoftimin e përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pasi dëgjoi relacionin e përgatitur nga Sekretari i Përgjithshëm, bazuar në raportin e Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë, mbi njoftimin për këtë përqendrim:

VËREN SE:

Autoriteti i Konkurrencës me shkresën Nr. 85 Prot., datë 01.02.2018 ka marrë njoftimin në lidhje me një transaksion financiar që realizon blerjen e biznesit të ëmbëlsirave të Nestle USA Inc. nga Ferrero International S.A.

Blerësi: Ferrero International S.A (Ferrero), është krijuar si Shoqëri tregare, në formën e shoqërisë aksionare, sipas ligjit tregtar të shtetit të Italisë, me seli në Luksenburg. Objekti i veprimtarisë së saj është: prodhimi i çokolletës së markës Ferrero dhe produkteve të ëmbëlsirave. Është prodhuesi i 3-të më i madh i çokolletës dhe kompania e ëmbëlsirave në botë.

Shitësi: Nestle USA Inc. është krijuar si Shoqëri tregare sipas ligjit të përgjithshëm të Korporatës në shtetin e Delaware. Biznesi amerikan i ëmbëlsirave të Nestles përfaqëson rreth XX % të shitjeve të SHBA-së në grupin Nestle. Ai përfshin markave popullore lokale të çokolletës, si dhe si dhe markat lokale të ëmbëlsirave²¹

Ferrero nuk është i pranishëm në Shqipëri, por ai nëpërmjet Ferrero d.o.o., një shoqëri e themeluar sipas ligjit tregtar të Kroacisë, vepron në Shqipëri në bazë të kontratave të distribucionit/shpërndarjes, nga dy subjekte: “Inter Trade & Distribution” SHPK dhe “Kosmonte Foods Tirana” SHPK, subjekte të cilat për produktet Ferrero kanë realizuar një xhiro prej XXX Euro për vitin 2017.

VLERËSIMI I PËRQENDRIMIT

²¹ Butterfinger, Crunch, BabyRuth, 100Grand, Raisinets, Chunky, OhHenry dhe SnoCaps; SëeTarts, LaffyTaffy, Nerds, FunDip, PixyStix, Gobstopper, BottleCaps, Spree and Runts.

Në datë 16 Janar 2018, palët kanë nënshkruar Marrëveshjen për Blerjen e Aseteve ndërmjet Nestle USA Inc. dhe Ferrero International S.A.²². Kjo marrëveshje bëhet efektive bashkë me Marrëveshja e Blerjes së Pronësisë Intellektuale midis Societe Des Produits Nestle S.A, Nestec S.A (shitës të Pronësisë Intellektuale) dhe Ferrero International S.A. (Blerës të Pronësisë Intellektuale).

Ndërmarrja që shitet/targeti (Nestle USA Inc) nuk është aktive dhe nuk realizon shitje në mënyrë të drejtpërdrejtë në Shqipëri. Transaksioni i propozuar nuk do të ketë efekte në strukturën e tregut të brendshëm shqiptar dhe si pasojë, nuk ka një mbivendosje horizontale të veprimtarive ekonomike të shoqërive target dhe blerësit apo ndërmarrjeve të zotëruara nga grupi Ferrero.

Ky përqendrim nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese, dhe për këto arsye dhënia e autorizimit të këtij këtij përqendrimi është në përputhje me nenin 56, pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d), dhe nenit 56 pika 1, të ligjit nr. 9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin të realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të Nestle USA Inc. nga Ferrero International S.A.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

²² Transaksioni mbulon vetëm markat e ëmbëlsirave të fokusuara në SHBA dhe nuk përfshin produktet ikonike të pjekjes së Toll House të Nestle, një markë strategjike e rritjes, të cilën kompania do të vazhdojë të zhvillojë. Nestle mbetet plotësisht e angazhuar në rritjen e aktiviteteve të saj kryesore ndërkombëtare të ëmbëlsirave në mbarë botën, veçanërisht markën globale Kitkat.

VENDIM

Nr. 504, datë 29.03.2018

Mbi përfitim të kontrollit të shoqërisë VALTELINA SHPK nga shoqëria ALB-ERK SHPK

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 29.03.2018, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë VALTELINA SHPK nga shoqëria ALB-ERK SHPK .

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, 24, germa d); 53-64 të ligjit nr.9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” (ligji nr. 9121/2003), i ndryshuar; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe formulari i thjeshtuar “Për njoftimin e përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë, mbi njoftimin e përqendrimit nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë VALTELINA SHPK nga shoqëria ALB-ERK,

VËREN SE:

Transaksioni dhe përqendrimi

Në datën 18.01.2018, Autoriteti i Konkurrencës ka marrë njoftimin e transaksionit të realizuar me anë të “Kontratë Shitje Kuotash” (me kusht rishitje), e nënshkruar me datë 24 Tetor 2017, e cila realizon përfitim të kontrollit të drejtpërdrejtë të shoqërisë Valtelina SHPK (“Target”) nga shoqëria Alb-Erk SHPK (“Blerësi”) me anë të blerjes së 51% të kuotave të shoqërisë Valtelina SHPK.

Ky njoftim përqendrimi është bërë jashtë afatit ligjor 30 ditor siç parashikohet në nenin 12, pika 2 e Ligjit nr.9121/2003.

Palët në transaksion

Shoqëria Alb-Erk SHPK, në cilësinë e Blerësit, themeluar më datë 15.06.2009, ka objekt aktiviteti: Import-eksport, tregti me shumicë e pakicë të artikujve të ndryshëm ushqimore, kryesisht kafe, etj. ALB-ERK SHPK është aktive në tregun e importit dhe tregtimit të kafesë kokërr e papjekur dhe e papërpunuar duke zënë XX% të tregut.

Shoqëria Valtelina SHPK, në cilësinë e shoqërisë Target, themeluar më datë 26/10/1993, ka objekt aktiviteti: përpunim, paketim kafeje, import-eksport, tregtia me shumicë dhe pakicë e mallrave, sipërmarrja dhe shërbimi në fusha të ndryshme; kryerje e transaksioneve në lidhje me pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, të kryejë aktivitete publikimi dhe reklamime etj. Valtelina SHPK ushtron aktivitetin e saj kryesisht në përpunimin, paketimin e kafesë së pjekur, të bluar dhe paketuar të formave të ndryshme të markës Lori Caffè dhe zotëron rreth XX% të tregut.

Pala shitëse, 4 (katër) ortakët e shoqërisë Valtelina SHPK, janë Zj. Vjollca Hoxha, Zj. Lorela Hoxha, Zj, Sara Hoxha dhe Zj. Redia Hoxha secila zotëruese të XX% të kuotave të shoqërisë.

Transaksioni i realizuar ka të bëjë me përfitimin e kontrollit të drejtpërdrejtë, të parashikuar në nenin 10 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, dhe palët pjesëmarrëse plotësojnë nivelin e xhiros të përcaktuar në nenin 12, pika 1 të Ligjit. Për rrjedhojë ky transaksion ju nënshtroa procedurës së kontrollit të përqendrimeve të parashikuar në nenet 53 – 64 të tij.

Vlerësimi i përqendrimit

Palët në transaksion ushtrojnë aktivitetin në nivele të ndryshme të tregut të importit, përpunimit dhe ambalazhimit të kafesë dhe përqendrimi i ndodhur u klasifikua si një përqendrim vertikal. Në këndvështrimin e të drejtës së konkurrencës, integrimi i veprimtarive ekonomike ose produkteve plotësuese brenda një ndërmarrjeje të vetme, mund të sjellin efijensa të ndjeshme dhe të ketë efekte pro-konkurrese në treg. Integrimi mund të çojë në ulje të kostove të transaksionit dhe lejon një koordinim më të mirë për sa i përket dizenjimit të produkteve, organizimit të proceseve të prodhimit dhe mënyrave të përdorura të shitjes së produkteve. Po kështu, përqendrime të cilat përfshijnë produkte të së njëjtës linjë mund të sjellin përfitime të menjëhershme për klientët.

Sipas vlerësimit të strukturës së tregut ku realizohet përqendrimi, pjesa e kombinuar e tregut për palët në përqendrim shkon në nivelin e XX% të tregut përkatës. Rritja e pjesës së tregut pas përqendrimit mund të krijojë premisa për ndonjë sjellje të mundshme antikonkurrese të palëve pas përqendrimit nëpërmjet ndikimit në strukturat e tregut apo sjelljen ndaj çmimit dhe impaktin në konsumatorin final.

Pas vlerësimit konstatohet se përqendrim nuk shfaq shenja të dukshme të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d, nenit 56 pika 1 dhe nenit 73, pika 1, germa dh të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, (i ndryshuar),

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të shoqërisë Valtelina SHPK nga shoqëria Alb-Erk SHPK.
2. Vendosjen e gjobës mbi shoqërinë ALB-ERK SHPK në masën XX% e xhiros së vitit 2016 ose XXX lekë.
3. Monitorimin e tregut të importit, përpunim dhe ambalazhit të kafesë për një periudhë 6 muaj nga data e shpalljes së Vendimit.
4. Gjoka e vënë nga Autoriteti i Konkurrencës është titull ekzekutiv dhe ekzekutohet sipas dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative.
5. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 507, Datë 02.05.2018

Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet shitjes dhe transferimit të kuotës prej 100 % të shoqërisë InRE SHPK tek Z.Grigor JOTI dhe Z.Plarent KRISTO

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 02.05.2018, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet shitjes dhe transferimit të kuotës prej 100 % të shoqërisë InRE SHPK tek Z.Grigor JOTI dhe Z.Plarent KRISTO

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, 24, germa d); 53-64 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe formulari i njoftimit të përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë, mbi njoftimin e përqendrimit mbi shitjen dhe transferimin e kuotës prej 100 % të shoqërisë InRE SHPK tek Z.Grigor JOTI dhe Z.Plarent KRISTO

VËREN SE:

I. Transaksioni dhe përqendrimi

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është depozituar shkresa me Nr.442 Prot., datë 30.10.2017 “Konsultim paraprak”, ku njoftohemi lidhur me një transaksion i cili po negociohej midis shoqërisë InRE (Invest Real Estate) SHPK dhe personit fizik Z.Grigor Joti. Autoriteti i Konkurrencës i ka kthyer përgjigje shoqërisë InRE SHPK duke e njoftuar se rasti në fjalë përbën përqendrim, i cili duhet njoftuar pranë institucionit tonë.

Me shkresën Nr. 82 Prot., datë 01.02.2018 është depozituar “Shkresë Përcjellëse”, ku personi i autorizuar për përfaqësimin e Z.Grigor Joti dhe Z.Plarent Kristo ka filluar procedurat për marrjen e autorizimit të përqendrimit lidhur me transaksionin për përfitim të kontrollit të shoqërisë InRE SHPK nga blerësit Z.Grigor Joti dhe Z.Plarent Kristo. Marrëveshja përfundimtare për blerjen e kuotave të shoqërisë InRE SHPK është nënshkruar në datë 03.01.2018 dhe njoftimi i realizuar i përqendrimit është brenda afatit ligjor 30 ditor që përcakton neni 12 i Ligjit 9121/2003.

Kontrata për Shitblerjen e Kuotave të Kapitalit është nënshkruar në datë 03.01.2018 ndërmjet palëve Znj.Arjana Nocka dhe Z.Grigor Joti dhe Z.Plarent Kristo.

Shitësi është ortak i vetëm i cili zotëron kuotën me vlerë nominale XXX lekë që përfaqëson 100% të kapitalit të ndërmarrjes. Pas transferimit të pronësisë, shoqërisë InRE do të zotërohet nga ortakët Z.Grigor Joti në masën XX % dhe Z.Plarent Kristo në masën XX %.

Palët në transaksion janë:

Z.Grigor Joti (Blerësi 1), shtetas shqiptar, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, banues në Rrugën “Hafiz I.Dalliu”, nr 60, Tiranë. Z. Joti është person fizik, dhe ka kontroll direkt dhe/ose indirekt në shoqëritë si më poshtë vijon:

- InveG SHPK – kontroll i drejtpërdrejtë mbi XX % të kapitalit
- Investment Joti-Infosoft Group SHPK – kontroll i drejtpërdrejtë mbi XX % të kapitalit
- InfoSoft Systems SHPK – kontroll jo i drejtpërdrejtë mbi XX % të kapitalit
- ITD SHPK – kontroll jo i drejtpërdrejtë mbi XX % të kapitalit
- InfoSoft Business Solution SHPK – kontroll jo i drejtpërdrejtë mbi XX % të kapitalit
- InfoSoft Management Services SHPK – kontroll jo i drejtpërdrejtë mbi XX % të kapitalit
- Inter Distribution Services SHPK – kontroll jo i drejtpërdrejtë me më pak se XX % të kapitalit
- InterBrand SHPK – kontroll jo i drejtpërdrejtë mbi XX % të kapitalit
- Inter Trade & Distribution SHPK – kontroll jo i drejtpërdrejtë mbi XX % të kapitalit
- IMLS SHPK – kontroll jo i drejtpërdrejtë mbi XX % të kapitalit
- ITD Prishtine SHPK – kontroll jo i drejtpërdrejtë mbi XX % të kapitalit
- Infosoft Systems SHPK – kontroll jo i drejtpërdrejtë mbi XX % të kapitalit
- ITD Distribucija doo Skopje – kontroll i drejtpërdrejtë mbi XX % të kapitalit
- Infosoft System doo Skopje – kontroll i drejtpërdrejtë mbi XX % të kapitalit

Z. Joti, nëpërmjet shoqërive që zotëron në mënyre direkte dhe/ose indirekte, është aktiv në tregun e qiradhënies dhe pasurive të paluajtshme, në tregun e teknologjisë së informacionit dhe distribucionit të produkteve ushqimore dhe të higjienës. Veprimtaria e shoqërive të Z. Joti shtrihet në Shqipëri, Kosove dhe Maqedoni, ndërsa veprimtaria e qiradhënies dhe pasurive të paluajtshme shtrihet vetëm në Tiranë.

Z.Plarent Kristo (Blerësi 2), shtetas shqiptar, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, banues në Tiranë. Z. Kristo është person fizik dhe ka kontroll direkt dhe/ose indirekt (me më pak se XX %), bashkërisht me Z. G. Joti, në shoqëritë si më poshtë vijon:

- Inter Distribution Services SHPK – kontroll i drejtpërdrejtë me më pak se XX % të kapitalit
- InterBrand SHPK – kontroll i drejtpërdrejtë me më pak se XX % të kapitalit
- Inter Trade & Distribution SHPK – kontroll i drejtpërdrejtë me më pak se XX % të kapitalit
- IMLS SHPK – kontroll i drejtpërdrejtë me më pak se XX % të kapitalit

Z. Kristo, nëpërmjet shoqërive që zotëron në mënyre direkte dhe/ose indirekte, është aktiv në tregun e distribucionit të produkteve ushqimore dhe të higjienës. Veprimtaria e shoqërive të Z. Kristo shtrihet vetëm në Shqipëri.

Znj. Arjana Nocka (Shitësi), është shtetase shqiptare, madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar, banuese në Rrugën “Asim Vokshi” Pallati.120, Shk.1, Ap 4 Tiranë.

InRE SHPK (Targeti), është shoqëri e themeluar sipas legjislacionit të RSH, e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit më datë 23.11.2016 me NUIS L62323016Q me seli në Njësia Administrative nr.2,

Rruga “Abdi Toptani”, Torre Drin, Kati 1, Tiranë, me kapital të regjistruar dhe tërësisht të paguar prej XXX lekë që përfaqëson 100% të kapitalit të ndërmarrjes. Objekt i veprimtarisë së saj është aktiviteti i marrjes dhe dhënies me qira të pasurive të paluajtshme. Objekti fizik i qiradhënies së InRe SHPK është ndërtesa e Torre Drini, e ndarë në ambientet Business e Shopping Center dhe Business e Rezidencë. Veprimtaria e shoqërisë InRe SHPK shtrihet vetëm në Tiranë.

Transaksioni i realizuar ka të bëjë me përfitimin e kontrollit të drejtpërdrejtë, të parashikuar në nenin 10 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, dhe palët pjesëmarrëse plotësojmë nivelin e xhiros të përcaktuar në nenin 12, pika 1 të Ligjit. Për rrjedhojë ky transaksion ju nënshtrua procedurës së kontrollit të përqendrimeve të parashikuar në nenet 53 – 64 të tij.

II. Vlerësimi i përqendrimit

Transaksioni i njoftuar i shitjes dhe transferimit të kuotës prej 100 % të shoqërisë InRE SHPK tek Z.Grigor Joti dhe Z.Plarent Kristo përbën një përfitim të drejtpërdrejtë kontrolli.

Tregu i qiradhënies së pasurive të paluajtshme është një treg i gjerë. Objekti fizik i qiradhënies nga shoqëria InRe SHPK është vetëm ndërtesa e Torre Drinit, e ndarë në ambientet Business e Shopping Center dhe Business e Rezidencë.

Torre Drini është në pronësi të Investment Joti- Infosoft Group SHPK që nga viti 2013.

Ky transaksioni nuk do të sjellë asnjë ndryshim në strukturën e tregut përkatës në Shqipëri.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet shitjes dhe transferimit të kuotës prej 100 % të shoqërisë InRE SHPK tek Z.Grigor JOTI dhe Z.Plarent KRISTO.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 508, Datë 02.05.2018

“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet shitjes dhe transferimit të aksioneve të shoqërisë TURGUT OZAL EDUCATION SHA tek shoqëria BF COOPERATIEF U.A.”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 02.05.2018, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet shitjes dhe transferimit të aksioneve të shoqërisë Turgut Ozal Education SHA tek shoqëria BF Cooperatief U.A.

Baza Ligjore: Ligji Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64. Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe formulari i njoftimit të përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë, mbi njoftimin e përqendrimit mbi shitjen dhe transferimin e aksioneve të shoqërisë Turgut Ozal Education SHA tek shoqëria BF Cooperatief U.A.

VËREN SE:

I. Transaksioni dhe përqendrimi

Shoqëria Turgut Ozal Education SHA, në datën 15.12.2017, me shkresën Nr. 486/1 Prot., “Konsultim paraprak”, ka depozituar pranë Autoritetit të Konkurrencës informacion lidhur me transaksionin i cili ka tjetërsuar aksionet e shoqërisë Turgut Ozal Education SHA tek shoqëria BF Cooperatief U.A.

Nëpërmjet kësaj shkrese informohemi se Asambleja e Ortakëve të Turgut Ozal Education SHA me vendimin Nr.79, datë 06.03.2017 ka vendosur të tjetërsojë aksionet e të gjithë aksionarëve të kësaj shoqërie tek shoqëria BF Cooperatief U.A, shoqëri Holandeze.

Me shkresën Nr. 486/2 Prot., i AK, datë 20.12.2017 “Në përgjigje të kërkesës Suaj”, i jemi drejtuar shoqërisë Turgut Ozal Education SHA duke e informuar për detyrimin për plotësimin e dokumentacionit lidhur me procedurën e kontrollit të transaksionit për këtë përqendrim.

Me shkresën Nr. 486/3 Prot., i AK, datë 22.02.2018 “Shkresë përcjellëse dokumentacioni” shoqëria Turgut Ozal Education SHA ka depozituar pranë institucionit dokumentacionin lidhur me procedurën e kontrollit të transaksionit për këtë përqendrim.

Pjesë e dokumenteve të depozituara janë 4 Kontratat e Transferimit dhe Shitjes së Aksioneve të lidhura midis 4 aksionarëve të Turgut Ozal Education SHA dhe Blerësit BF Cooperatief U.A.

Palët në transaksion janë:

BF COOPERATIEF U.A. me Nr. tatimor RSIN: 857274715, regjistruar në Dhomën e Tregtisë Amsterdam me Nr. KVK: 68035942, me seli në Dukadalfweg 26, 1041 BE Amsterdam, Holandë. Shoqëria BF Cooperatief U.A. është themeluar në 9 Shkurt 2017, nga 4 themelues/aksionar. Kjo shoqëri bashkëpunimi ka për objekt të veprimtarisë së saj sigurimin e nevojave të caktuara materiale dhe ekonomike të anëtarëve të saj në bazë të marrëveshjeve të lidhura me ta.

TURGUT OZAL EDUCATION SHA me NUIS K12125004O dhe datë regjistrimi 25/09/2001 si shoqëri aksionare e themeluar në 21/05/2001, me zyrë qendrore në Autostradën Tiranë-Durrës Km 1, Rruga Pavarësia, Tiranë. Kapitali i ndërmarrjes është XXX, me numër aksionesh XXX me vlerë nominale XXX secili aksion. Objekti i aktivitetit është hapja e llojeve të ndryshme të institucioneve bazuar në qëllimin universal dhe principet themelore të arsimit, duke synuar rritjen dhe zhvillimin e nxënësve, etj. Kjo shoqëri ka si objektiv të hapë institucione parashkollore, çerdhe dhe kopshte; të hapë shkolla fillore, nëntëvjeçare dhe të mesme, të hapë universitete që përfshijnë kurse para-universitare, studime universitare në të tre ciklet.

Në mbledhjen e Përgjithshme të Anëtarëve të shoqërisë BF Cooperatief U.A. të datës XXX është vendosur blerja e shoqërisë Turgut Ozal Education SHA.

Në setin e dokumenteve të depozituara gjenden 4 Kontrata të Transferimit dhe Shitjes së Aksioneve të firmosura në XXX nga shitësit dhe blerësi të cilët kanë të njëjtët aksionarë.

Transaksioni i realizuar ka të bëjë me përfitim të kontrollit të drejtpërdrejtë, të parashikuar në nenin 10 të ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, dhe palët pjesëmarrëse plotësojmë nivelin e xhiros të përcaktuar në nenin 12, pika 1 të Ligjit. Për rrjedhojë ky transaksion iu nënshtroa procedurës së kontrollit të përqendrimeve të parashikuar në nenet 53 – 64 të tij.

II. Vlerësimi i përqendrimit

Transaksioni i njoftuar i shitjes dhe transferimit të aksioneve të Turgut Ozal Education SHA tek BF Cooperatief U.A. përbën një përfitim të drejtpërdrejtë kontrolli.

Pjesa e tregut të Turgut Ozal Education SHA në tregun e ofrimit të shërbimeve arsimore në të gjitha nivelet e arsimit në Shqipëri është XXXXX %.

BF Cooperatief U.A. nuk është prezentë në Shqipëri dhe nuk zotëron asnjë shoqëri tjetër.

Pas transaksionit nuk do të ketë asnjë ndryshim në strukturën e tregut përkatës në Shqipëri.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të shoqërisë Turgut Ozal Education SHA nga shoqëria BF Cooperatief U.A.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 510, Datë 10.05.2018

“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet shitjes dhe transferimit të kuotës prej XX % të aksioneve të INTELLIGENT APPS GMBH, nga HNH GROUP LTD tek DAIMLER MOBILITY SERVICES GMBH”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 10.05.2018, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet shitjes dhe transferimit të kuotës prej XX % të aksioneve të Intelligent Apps GmbH, nga HNH Group Ltd tek Daimler Mobility Services GmbH.

Baza Ligjore: Ligji Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64. Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe formulari i njoftimit të përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë, mbi njoftimin e përqendrimit mbi shitjes dhe transferimit të kuotës prej XX % të aksioneve të Intelligent Apps GmbH, nga HNH Group Ltd tek Daimler Mobility Services GmbH,

VËREN SE:

I. Transaksioni dhe përqendrimi

Me shkresën Nr.225 Prot., datë 03.04.2018 Autoriteti i Konkurrencës është njoftuar në lidhje me transaksionin e ndodhur midis palëve blerëse Daimler Mobility Services GmbH, pjesë e grupit Daimler AG dhe palës shitëse HNH Group Ltd, e cila zotëron aksione të Intelligent Apps GmbH.

Në datën XXX është nënshkruar Marrëveshja e Shitblerjes së Kuotave, ku HNH Group, i shet Daimler Mobility Services GmbH XX% të aksioneve që zotëron në shoqërinë Intelligent Apps GmbH.

Autoriteti i Konkurrencës me shkresën Nr. 225/1, datë 26.04.2018 ka konfirmuar marrjen e njoftimit të përqendrimit, duke informuar përfaqësuesin ligjor të Daimler AG se po fillon procedurat e kontrollit të këtij përqendrimi.

Palët në transaksion janë:

Blerësi: Daimler Mobility Services GmbH, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, pjesë e Grupit Daimler AG, me objekt të aktivitetit planifikimin, zhvillimin, funksionimin dhe marketingu i koncepteve të lëvizshmërisë, si p.sh sisteme të automatizuara për qira të makinave, rrjete lëvizshmërie për ofrimin e shërbimeve lëvizëse dhe shërbime të tjera në fushën e lëvizshmërisë ose në fusha si sigurimi ose lehtësimi i lëvizshmërisë dhe sigurimin e shërbimeve të planifikimit, këshillimit, këshillimit dhe shërbimeve të tjera në fushat e lartpërmendura.

Daimler AG₂ shoqëri aksionare, prodhues global i veturave të cilësisë shumë të lartë dhe prodhuesi më i madh në botë i mjeteve lëvizëse komerciale. Ndarjet e aktivitetit të Daimler janë veturat Mercedes-Benz; kamionët Daimler, Fugonët Mercedes Benz, Autobusët Daimler dhe Shërbimet Financiare Daimler.

Objekti i aktivitetit është shfrytëzimi i drejtpërdrejtë ose i tërthortë në fushën e zhvillimit, prodhimit dhe shpërndarjes së produkteve dhe ofrimi i shërbimeve, veçanërisht në këta sektorë:

- mjete tokësore,
- mjetet e ujit, ajrit dhe hapësirës dhe llojeve të tjera të transportit, hapësirës ajrore dhe produkteve detare;
- motorët dhe pjesët e tjera teknike;
- pajisjet elektronike, instalimet dhe sistemet;
- komunikimi dhe teknologjia e informacionit;
- shërbime financiare, agjentë të sigurimeve dhe
- menaxhimi dhe zhvillimi i pasurive të paluajtshme.

Shitësi: Hailo Network Holdings Ltd (HNH Group Ltd), kompani e themeluar sipas legjislacionit të Anglisë dhe Wellsit me adresë biznesi të regjistruar në Cannon Place, 78 Cannon Street, London, EC4N 6AF, Mbretëria e Bashkuar, regjistruar në regjistrin e shoqërive vendase me numër 074777716.

Ndërmarrja Target: Intelligent Apps GmbH, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, (Mytaxi) në Hamburg, Gjermani, me objekt të aktivitetit të shoqërisë operimin e një shërbimi taksie kombëtare dhe ndërkombëtar si dhe blerja, marketingu dhe shpërndarja e produkteve të lidhura direkt dhe indirekt me shërbimet si dhe me shërbime të ngjashme.

II. Vlerësimi i përqendrimit

Daimler është prezentë në Shqipëri përmes fushës së tij thelbësore të biznesit – shitjes së mjeteve lëvizëse (vetura, kamion dhe autobusë) nëpërmjet një distributori, por nuk ka aktivitet në Shqipëri që të ketë lidhje me tregun përkatës të shërbimit të taksive.

Intelligent Apps GmbH nuk ka aktivitet në Shqipëri.

Para transaksionit Mytaxi kontrollohet bashkërisht nga Daimler (përmes DMS) që zotëron XX% të aksioneve dhe Hailo që zotëron XX% të aksioneve. Pas transaksionit në fjalë, ku Daimler përmes Daimler Mobility Services GmbH do të përfitojë një shtesë prej XX% të aksioneve, aksionet e Daimlerit do të shkojnë në XX % kurse ato të HNH Group në nivelin prej XX%. Në këtë mënyrë aksionet e këtij të fundit kalojnë në nivelin që do ti siguronte kontrollin e përbashkët. Aksionet e Hailo bien nën XX% dhe Daimler (përmes DMS) ka të drejtën të emërojë katër anëtar të Bordit Mbikëqyrës dhe Hailo vetëm një.

Rrjedhimisht Transaksioni do të çojë në një kalim nga një kontroll i përbashkët mbi Mytaxi nga Daimler dhe Hailo, në një kontroll të vetëm nga Daimler.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet shitjes dhe transferimit të kuotës prej XX % të aksioneve të Intelligent Apps GmbH, nga HNH Group Ltd tek Daimler Mobility Services GmbH.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 511, Datë 10.05.2018

“Mbi autorizimin e përqendrimit në lidhje me përfitimën e kontrollit të përbashkët nga BMW dhe Daimler AG mbi disa shoqëri”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 10.05.2018, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të përbashkët nga BMW dhe Daimler AG mbi disa shoqëri.

Baza Ligjore: Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64. Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe formulari i njoftimit të përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë, mbi njoftimin e përqendrimit mbi përfitimën e kontrollit të përbashkët nga BMW dhe Daimler AG mbi disa shoqëri,

VËREN SE:

I. Transaksioni dhe përqendrimi

Në Autoritetin e Konkurrencës është depozituar shkresa me Nr.250 Prot., datë 17.04.2018 ku informohemi në lidhje me një përqendrim të ndodhur midis BMW dhe Daimler.

Nëpërmjet kësaj shkrese informohemi se shoqëritë, të cilat janë prodhues automjesh kanë nënshkruar në datat 27 dhe 28 mars 2018, një marrëveshje sipas të cilës do të kenë kontrollin e përbashkët mbi 6 sipërmarrje të përbashkët (*joint venture*). Këto shoqëri do të bashkojnë shërbimet që ato ofrojnë në pesë fusha të ndryshme biznesi të tilla si: qiradhënia e makinave (*car sharing*); shërbim taksi nëpërmjet aplikacioneve (*ride hailing*); shërbime parkimi, shërbimi i karikimit të automjeteve si dhe shërbime të tjera sipas kërkesave të klientëve (*on-demand*), ndërkohe që ndërmarrja e 6 (*joint venture* e 6) do të menaxhojë markat tregtare në lidhje me bizneset e mësipërme.

Pas transaksionit, dy shoqëritë do të kenë përkatësisht secila nga XX% të aksioneve dhe të drejtave të votës në të gjitha shoqëritë e krijuara.

Autoriteti i Konkurrencës me shkresën Nr. 250/1 Prot., datë 26.04.2018 i ka konfirmuar përfaqësuesit ligjor të palëve se njoftimi i përqendrimit është i saktë dhe i plotë dhe se kanë filluar procedurat e kontrollit të këtij përqendrimit. Gjithashtu është përgatitur informacioni për Komisionin dhe njoftimi për shtyp.

Palët në transaksion janë:

Daimler AG, shoqëri aksionare, është prodhues global i veturave të cilësisë shumë të lartë dhe prodhuesi më i madh në botë i mjeteve lëvizëse komerciale. Ndarjet e aktivitetit të Daimler janë veturat Mercedes-Benz; kamionët Daimler, Fugonët Mercedes Benz, Autobusët Daimler dhe Shërbimet Financiare Daimler. Është shoqëri e listuar sipas ligjit gjerman, me seli qendrore të regjistruar në Stuttgart, Gjermani që operon në zhvillimin, prodhimin dhe shitjen kryesisht të makinave për pasagjerë dhe automjeteve për qëllime tregtare, si dhe ofron shërbim financiar për automjete, duke përfshirë financimin, qiranë financiare, sigurimin dhe shërbime për menaxhimin e flotave.

Bayerische Motoren Werke Aktiengesellschaft (BMW) është një shoqëri aktive në prodhimin e motoçikletave dhe automobilave. Përveç zhvillimit, prodhimit dhe marketimit të këtyre automjeteve, BMW gjithashtu ofron shërbime financiare për klientë privatë apo biznese. Me markat BMW, Rolls Royce dhe MINI, BMW është një nga prodhuesit më të suksesshëm të makinave për pasagjerë dhe motoçikletave në nivel botëror dhe ofron gjithashtu shërbime Premium në fushën e transportit individual, me seli në Mynih Gjermani.

Marrëveshja e Biznesit është lidhur në datat XXX midis palëve:

Daimler AG (Daimler Mobility Services GmbH) dhe

BMW (BMW Intec Beteiligungs GmbH; BMW i Ventures B.V; Car2go Deutschland GmbH; Blitz 18-353 GmbH; Parkmobile Group Holding B.V; Digital Charging Solution GmbH; Moovel Group GmbH; Blitz 180354 GmbH)

BMW (duke përfshirë edhe filialet e BMW) dhe Daimler AG (duke përfshirë edhe filialet e Daimler), do të përfitojnë kontrollin e përbashkët në 6 sipërmarrje të përbashkëta / *joint venture*, duke bashkuar shërbimet e ofruara nga palët në pesë fusha të ndryshme biznesi:

- qiradhënia e makinave (car sharing);
- shërbim taksi nëpërmjet aplikacioneve (ride hailing);
- shërbime parkimi,
- shërbimi i karikimit të automjeteve si dhe
- shërbime të tjera sipas kërkesave të klientëve (on-demand)

Ndërmarrja e 6 do të menaxhojë markat tregtare në lidhje me bizneset e mësipërme.

Transaksioni i realizuar ka të bëjë me përftimin e kontrollit, të parashikuar në nenin 10, germa c), të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, dhe palët pjesëmarrëse plotësojnë nivelin e xhiros të përcaktuar në nenin 12, pika 1 të Ligjit. Për rrjedhojë ky transaksion iu nënshtrua procedurës së kontrollit të përqendrimeve të parashikuar në nenet 53 – 64 të tij.

II. Vlerësimi i përqendrimit

Transaksioni i njoftuar është përftim i kontrollit të përbashkët i shoqërisë BMW dhe Daimler mbi 6 shoqëri të përbashkëta JV me funksione të plota.

Tregu shqiptar nuk do të preket nga transaksioni i propozuar, pasi JV-at nuk kanë për qëllim të kryejnë në të ardhmen e parashikueshme ndonjë aktivitet në Shqipëri, prandaj transaksioni i propozuar nuk ka asnjë impakt për konkurrencën në tregun e brendshëm.

Pas transaksionit nuk do të ketë asnjë ndryshim në strukturën e tregut përkatës në Shqipëri.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të përbashkët nga BMW dhe Daimler AG mbi disa shoqëri.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 513, Datë 17.05.2018

“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet shitjes dhe transferimit të kuotës prej XX% të aksioneve të “TV KLAN” SHA nga Z. Ervin Gjikota tek Z. Aleksandër Frangaj”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 17.05.2018, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet shitjes dhe transferimit të kuotës prej XX% të aksioneve të “TV KLAN” SHA nga Z. Ervin Gjikota tek Z. Aleksandër Frangaj

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar. Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe formulari i njoftimit të përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë, mbi njoftimin e përqendrimit mbi shitjen dhe transferimin e kuotës prej 20% të aksioneve të “TV KLAN” SHA nga Z. Ervin Gjikota tek Z. Aleksandër Frangaj,

VËREN SE:

I. Transaksioni dhe përqendrimi

Shoqëria “TV Klan” SHA ushtron aktivitetin e saj tregtar në tregun e mediave audiovizive.

Para transaksionit shoqëria TV KLAN SHA kishte aksionarë:

- Z. Ervin Gjikota zotëronte XX% të kapitalit themeltar të shoqërisë;
- Z. Aleksandër Frangaj zotëronte XX% të kapitalit themeltar të shoqërisë;
- Znj. Alba Gina, zotëronte XX % të aksioneve të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Autoriteti i Konkurrencës është informuar se midis aksionarëve ekzistues të kësaj shoqërie, është lidhur një Kontratë për Shitblerjen e Aksioneve, mes personave fizikë, Z. Ervin Gjikota në cilësinë e shitësit dhe Z. Aleksandër Frangaj, në cilësinë e Blerësit, të cilët me anë të së cilës Z. Frangaj blen pjesën takuese që Z. Gjikota zotëronte në shoqërinë TV Klan SHA.

Z. Ervin Gjikota, një nga aksionarët e shoqërisë “TV Klan” SHA , i cili zotëronte XX% të aksioneve, i ka shitur pjesën e tij të aksioneve aksionarit tjetër, Z. Aleksandër Frangaj, i cili zotëronte XX% të aksioneve.

Pas këtij transaksioni, Z. Frangaj përfiton paketën kontrolluese të aksioneve, pasi përqindja e aksioneve të tij në shoqërinë TV Klan ndryshon nga XX % në XX %.

Palët në transaksion janë:

Blerësi: Z. Aleksandër Frangaj, shtetas shqiptar, lindur në XXX më XXX dhe banues në XXX,

Shitësi: Z. Ervin Gjikota, shtetas shqiptar, lindur në XXX më XXX dhe banues në XXX.

Ndërmarrja Target: “TV KLAN” Shoqëri aksionare, person juridik shqiptar, regjistruar pranë QKB me NIPT J71413001L, me seli në Rrugën “Aleksandër Moisiu” Tiranë. Kjo shoqëri është regjistruar më 12.02.1997 dhe është themeluar po në të njëjtën datë. Kapitali i shoqërisë është XXX, me numër aksionesh XXX, me vlerë nominale secila XXX.

II. Vlerësimi i përqendrimit

Transaksioni plotëson kriteret e përcaktuara në nenet 10 dhe 12 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar duke përbërë objekt shqyrtimi dhe vlerësimi nga Autoriteti i Konkurrencës.

TV Klan SHA është një nga pesë shoqëritë e pajisura me licencë private kombëtare për transmetime audiovizive.

— **Tregu përkatës i produktit:** Referuar Udhëzuesit “Për përcaktimin e tregut përkatës”, si dhe mbështetur në veprimtarinë e palëve, treg përkatës konsiderohet **tregu i transmetimeve audiovizive**.

— **Tregu përkatës gjeografik:** Konsiderohet territori i **Republikës së Shqipërisë**.

Sipas statistikave të Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) rezulton se shoqëria TV Klan mbulon me sinjal televiziv XX% të territorit gjeografik, XX% të popullsisë dhe XX% të zonës së autorizuar.

Referuar të ardhurave vjetore të Ofruesve të Shërbimi Mediatik Audioviziv (OSHMA) konstatohet se TV Klan zotëron XX% të tregut duke u renditur si operatori i tretë në treg pas RTSH dhe Top Channel.

Transaksioni i njoftuar përbën një përfitim të drejtpërdrejtë kontrolli të shoqërisë TV Klan SHA nga Z. A. Frangaj. Ky transaksion përfaqëson një ndryshim kontrolli brenda strukturës së aksionarëve të shoqërisë. Pas transaksionit shoqëria TV Klan do të zotërohet nga 2 aksionare. Duke qenë se Z. Frangaj nuk zotëron në mënyrë të drejtpërdrejtë paketa kontrolluese në shoqëri të tjera, në tregun e transmetimeve audiovizive, transaksioni i realizuar nuk do të sjellë asnjë ndryshim në strukturën e tregut përkatës në Shqipëri.

Si konkluzion ky përqendrim nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet shitjes dhe transferimit të kuotës prej XX% të aksioneve të “TV KLAN” SHA nga Z. Ervin Gjikota tek Z. Aleksandër Frangaj
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 519, Datë 31.05.2018

“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një shoqërie të përbashkët, “Shushica Hydropower” SHPK, nga “Trema Engineering 2” SHPK, “GR Albania” SHPK dhe “ALB-STAR” SHPK”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 31.05.2018, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një shoqërie të përbashkët “Shushica Hydropower” SHPK, nga “Trema Engineering 2” SHPK, “GR Albania” SHPK dhe “ALB-STAR” SHPK

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar. Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe formulari i njoftimit të përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë, mbi njoftimin e përqendrimit mbi krijimit të një shoqërie të përbashkët “Shushica Hydropower” SHPK, nga “Trema Engineering 2” SHPK, “GR Albania” SHPK dhe “ALB-STAR” SHPK,

VËREN SE:

I. Transaksioni dhe përqendrimi

Tre shoqëritë “Trema Engineering 2” SHPK, “GR Albania” SHPK dhe “ALB-STAR” SHPK kanë krijuar një shoqëri të përbashkët (*joint venture*) me funksione të plota, shoqërinë “Shushica Hydropower” SHPK, me synim realizimin e koncensionit për ndërtimin e kaskadës së hidrocentraleve mbi lumin Shushica.

Në këtë shoqëri të përbashkët, tre shoqëritë themeluese kanë kontrollin e përbashkët respektivisht në masat 33%, 33% dhe 34%. Këto tre shoqëri do të vënë në dispozicion të shoqërisë së re të krijuar burime teknike dhe financiare, me qëllim ushtrimin në mënyrë të pavarur të aktivitetit të gjenerimit të energjisë elektrike.

Kontrolli i qëndrueshëm mbi shoqërinë e re përfitohet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga ortakët themelues.

Referuar dokumentit “Marrëveshja për bashkimin e përkohshëm të shoqërive”, palët në marrëveshje janë:

“GR Albania” SHPK, person juridik shqiptar, i regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me nr. NIPT L01509004N, me objekt të aktivitetit: konsulencë mjedisore, përgatitja e studimeve dhe vlerësimeve mjedisore, monitorim dhe auditim i mjedisit, laborator testues për monitorimin e ujit, ajrit, tokës, zhurmave dhe vibrimeve etj.

“Trema Engineering 2” SHPK, person juridik shqiptar i regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me NUIS K21401004R, me objekt të aktivitetit: ndërtim, projektim të veprave të ndryshme.

“Alb-Star” SHPK, person juridik i regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me NUIS J62903512W. Objekti i aktivitetit është ndërtime civile, industriale, tregti import export, transport i mallrave për të tretë me qira dhe për llogari të vet brenda vendit, tregti me shumicë e ujit të pijshëm dhe e ujit industrial, transport me mjete jashtë normave për llogari të vet dhe të tretë brenda dhe jashtë vendit.

“Shushica Hydropower” SHPK, person juridik me NUIS L71729019M, regjistruar më 29.05.2017, themeluar më 17.05.2017, me kapital 100.000 lekë, me tre ortakë ku secili zotëron 33%, 33% dhe 34 % me objekt të veprimtarisë: ndërtimi i kaskadës së hidrocentraleve mbi lumin Shushicë, të tipit BOT (Ndërto-Opero-Transfero); prodhimi, transmetimi dhe shitja e energjisë elektrike të prodhuar nga kaskada e HEC mbi lumin Shushicë, shfrytëzimi dhe mirëmbajtja e kaskadës gjatë periudhës koncensionare.

II. Vlerësimi i përqendrimit

Transaksioni plotëson kriteret e përcaktuara në nenet 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar duke u bërë objekt shqyrtimi dhe vlerësimi nga Autoriteti i Konkurrencës.

Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, si edhe udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës i produktit do të konsiderohet **tregu i prodhimit dhe tregtimit të energjisë elektrike** dhe treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i **Republikës së Shqipërisë**.

“Shushica Hydropower” SHPK nuk ka filluar akoma prodhimin. Kjo shoqëri do të ketë në pronësi të saj 4 Hec-e të cilat janë Hec Drashovica, Hec Kote, Hec Gjorm dhe Hec Brataj.

Në tregun e prodhimit dhe tregtimit të energjisë elektrike, Shushica Hydropower SHPK pritet të ketë një prodhim mesatar vjetor të energjisë elektrike prej XXXX MWh, duke zotëruar XXX % të tregut.

Ky transaksion do të ketë efekte pozitive mbi konkurrencën në treg pasi pritet hyrja e një konkurenti të ri. Asnjë nga palët pjesë në këtë transaksion nuk vepron në tregun e prodhimit, tregtimit të energjisë elektrike dhe si rrjedhojë ky përqendrim nuk do të sjellë kufizim të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet krijimit të një shoqërie të përbashkët “Shushica Hydropower” SHPK, nga “Trema Engineering 2” SHPK, “GR Albania” SHPK dhe “ALB-STAR” SHPK.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM
Nr. 524, Datë 14.06.2018

**“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet ndryshimit të kontrollit në shoqërinë
SANITARY CLEANING SHPK”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 14.06.2018, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet ndryshimit të kontrollit në shoqërinë
SANITARY CLEANING SHPK.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003
“Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar. Rregullorja “Për zbatimin e procedurave
të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”
dhe formulari i njoftimit të përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të
Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë, mbi njoftimin e përqendrimit mbi ndryshimin e kontrollit në
shoqërinë SANITARY CLEANING SHPK,

VËREN SE:

I. Transaksioni dhe përqendrimi

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është depozituar shkresa me Nr. 357 Prot., datë 31.05.2018 “Njoftim mbi
Përqendrimin” ku jemi njoftuar në lidhje me Kontratën për shitjen dhe blerjen e kuotave prej XXXXX të
shoqërisë Sanitary Cleaning SHPK nga Servizi Italia S.p.A.

Blerësi: SERVIZI ITALIA S.p.A, shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit Italian, me seli në Via
“San Pietro”, nr.59 B, Cap 43019, frazione Castellina, Soragna, Itali, regjistruar në Itali në regjistrin e
Shoqërive Tregtare të Parmës me numër regjistrimi dhe identifikimi taksash 08531760158;

Shitësi: Z.Fatos Deliu, shtetas shqiptar;

Ndërmarrja Target: SANITARY CLEANING SHPK, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, shoqëri shqiptare,
themeluar më 16.12.2014 dhe regjistruar në QKB më 29.12.2014, me seli në Njësia Bashkiake Nr.6, Rruga
“Sabaudin Gabrani”, në ambientet e Spitalit Amerikan, Tiranë, Shqipëri, me numër regjistrimi NIPT
L42429004B, kapitali i shoqërisë është XXXXX Euro.

Objekti i aktivitetit të kësaj shoqërie janë: shërbimet sanitare dhe të pastrimit të ambienteve të brendshme dhe
të jashtme për objekte, biznese, pajisje etj; tregtim me shumicë dhe pakicë, import, eksport të materialeve
sanitare dhe detergjenteve si dhe çdo aktivitet tjetër i lejuar me ligj; çdo veprimtari tjetër industriale, tregtare,
financiare dhe që do të konsiderohet nga ortaku e nevojshme dhe e përshtatshme për realizimin e objektit të
shoqërisë; etj.

Marrëveshja e Shitjes dhe e Blerjes së Kuotave midis Z.Fatos Deliu në cilësinë e shitësit dhe shoqërisë Servizi Italia S.p.A në cilësinë e blerësit është nënshkruar më datë 15 maj 2018. Shitësi i shet blerësit XXX % të kuotave të shoqërisë Sanitary Cleaning SHPK, në të cilin deri në datë 15 maj ai ishte aksionar i vetëm.

II. Vlerësimi i përqendrimit

Transaksioni plotëson kriteret e përcaktuara në nenet 10 dhe 12 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar duke përberë objekt shqyrtimi dhe vlerësimi nga Autoriteti i Konkurrencës.

Referuar nenit 3, pika 7, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, si edhe Udhëzimit Nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, përcaktimi “treg përkatës” përfshin dy komponentë:

- I). tregu përkatës i produktit, dhe
- II). tregu përkatës gjeografik.

— **Tregu përkatës i produktit:** Referuar Udhëzuesit “Për përcaktimin e tregut përkatës”, si dhe mbështetur në veprimtarinë e palëve, treg përkatës do të konsiderohet tregu i shërbimeve të lavanterisë dhe pastrimit kimik dhe shërbimeve të DDD (Dezinsektim, Dezinfektim dhe Deratizim).

— **Tregu përkatës gjeografik:** Për analizimin e këtij rasti *tregu përkatës gjeografik* do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Pjesa e tregut të Sanitary Cleaning SHPK në tregun e lavanterisë, pastrimit kimik dhe shërbimeve të DDD (Dezinsektim, Dezinfektim dhe Deratizim) nuk do të pësojë asnjë ndryshim, pas transaksionit ajo do të vazhdojë të mbetet në kuotën e XX %.

Blerësi kryen aktivitet në fushën e sterilizimit kirurgjikal ndërsa Target kryen aktivitet në fushën e lavanderisë.

Ky transaksion do të ketë efekte pozitive mbi konkurrencën në treg pasi integrimi i veprimtarive ekonomike ose produkteve plotësuese brenda një shoqërie të vetme mund të sjellë efikasitet të ndjeshme ekonomike dhe të ketë efekte pro konkurruese në treg.

Si konkluzion ky përqendrim nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet ndryshimit të kontrollit në shoqërinë SANITARY CLEANING SHPK.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 528, Datë 25.06.2018

“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet shitjes dhe transferimit të kuotës prej XX% të aksioneve të Autovizion SHA tek Bolv Oil SHA”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 25.06.2018, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet shitjes dhe transferimit të kuotës prej XX% të aksioneve të Autovizion SHA tek Bolv Oil SHA.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, nenet 53-64, neni 73, pika 1 germa dh) dhe neneve 79-80 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar. Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe formulari i njoftimit të përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet shitjes dhe transferimit të kuotës prej XX% të aksioneve të Autovizion SHA tek Bolv Oil SHA,

VËREN SE:

I. Procedura dhe transaksioni

Autoriteti i Konkurrencës, me nismën e tij, ka filluar procedurën e vlerësimit të përqendrimit lidhur me transaksionin e realizuar nëpërmjet Kontratës për shitje aksionesh midis shoqërisë Bolv-Oil SHA në cilësinë e blerësit dhe 4 aksionareve; shoqërisë “Euro Trade Minerals Group” SHPK; Z. Agron Xhango; Z. Agron Shkëmbi dhe Znj. Flavia Nasufi në cilësinë e shitësit.

Kontrata e Shitjes së Aksioneve është lidhur më XXX dhe njoftimi për autorizimin e përqendrimit është bërë jashtë afatit ligjor 30 ditë siç parashikohet në nenin 12, pika 2 e Ligjit nr.9121/2003.

Në Formularin e thjeshtuar të njoftimit të përqendrimit, palët kanë deklaruar se shoqëria Autovizion SHA do të vijojë të jetë një njësi ekonomike e pavarur dhe do të vazhdojë të kryejë aktivitetin ekonomik të saj i cili është jashtë objektit ekonomik të aktivitetit të grupit Bolv Oil.

Blerësi: Bolv Oil SHA, shoqëri aksionare, e regjistruar në QKB me NIPT K32528408H, me objekt veprimtarie tregti me shumice e naftës dhe nënprodukteve të saj, operacione të ndryshme portuale, investime kapitale në fushën e ndërtimit, ndërtimin e rrugëve, kanalizimeve dhe objekteve civile dhe industriale, importi, eksporti, dhe tregtimi me shumicë i materialeve të ndërtimit, brenda e dhe jashtë vendit, transport rrugor ndërkombëtar mallrash për të tretet dhe me qira, transport rrugor kombëtar dhe ndërkombëtar të naftës, gazit, nënprodukteve përfshirë ato bio si dhe lëndë djegëse, bar-restorant, hoteleri, bar-kafe, servis automjetesh, lavazh etj.

Shitësi 1: Euro Trade Minerals Group SHPK, është regjistruar në QKB me NIPT/NUIS K92226007I. Kjo shoqëri zotëron XX% të aksioneve në ndërmarrjen Autovizion SHA të cilat i shet XXX.

Shitësi 2: Z.Agron XHANGO, zotërues i XX% të aksioneve në shoqërinë “Autovizion” SHA, shet XX% të kuotës;

Shitësi 3: Z.Agron SHKËMBI, zotërues i XX% të aksioneve, shet XX% të tyre;

Shitësi 4: Z.Flavia NASUFI, zotërues i XX% të aksioneve, shet XX% të tyre;

Ndërmarrja Target: Autovizion SHA, me NUIS K71420008L, me objekt veprimtarie blerjen dhe shitjen e automjeteve të tipit IVECO, tregtimin e pjesëve të këmbimit për automjetet e Tipit IVECO dhe import-exportin e tyre, tregtimin e karburanteve dhe lubrifikanteve dhe import - exportin e tyre, servis automjesh të ndryshme, pajisje dhe makineri të ndryshme si dhe çdo gjë që ka të bëjë me servisin e automjeteve dhe jo vetëm të tipit IVECO, tregtimin e gomave të ndryshme për automjete dhe import eksportin e tyre. transportin e mallrave dhe të lendeve djegëse dhe import eksportin e tyre, tregtimin e pajisjeve elektro-shtëpiake dhe import - eksportin e tyre, tregtimin e mallrave të ndryshme import dhe eksport të tyre, etj.

Z.Dhimitraq Ikonimi do të vijojë të mbetet aksionar i ndërmarrjes Autovizion SHA.

II. Vlerësimi i përqendrimit

Transaksioni plotëson kriteret e përcaktuara në nenet 10 dhe 12 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar duke përberë objekt shqyrtimi dhe vlerësimi nga Autoriteti i Konkurrencës.

Referuar nenit 3, pika 7, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, si edhe Udhëzimit Nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, u konsiderua se tregjet e prekura nga përqendrimi janë:

- tregu i importit të automjeteve,
- tregu i importit të pjesëve të këmbimit për automjete.
- tregu i importit të vajrave për automjete,
- tregu i importit të karburanteve (benzinë, diesel dhe gaz),

Tregu përkatës gjeografik u konsiderua territori i Republikës së Shqipërisë.

Për sa i përket tregut të importit të automjeteve, konstatohet se Autovizion SHA është *dealer* i automjeteve të markës IVECO për Shqipërinë. Nga analiza e të dhënave për tregun e importit të automjeteve na rezulton se asnjë nga ndërmarrjet palë në transaksion nuk kanë realizuar importe gjatë vitit 2017.

Në tregun e importit të pjesëve të këmbimit për automjete, rezulton se Autovizion SHA zotëron vetëm XX % të tregut. Shoqëria Bolv Oil nuk operon në këtë treg.

Tregu i importit të vajrave për automjete, rezulton se Bolv Oil SHA dhe Autovizion SHA kanë realizuar importe në këtë produkt. Pjesa e tregut e Bolv Oil është XX % dhe pjesa e tregut e Autovizion është XX %. Pas përqendrimit pjesa e kombinuar e tregut e dy shoqërive është XX % dhe indeksi HHI shkon në nivelin XX.

Për sa i përket nën tregut të importit të benzinës, Bolv Oil SHA është importues i benzinës dhe pjesa e tregut e kësaj shoqërie është XX %. Autovizion SHA nuk operon në këtë treg. Në nën tregu i importit të dieselit 10ppm, Bolv Oil SHA është importues dhe pjesa e tregut që zotëron është XX %. Autovizion SHA nuk operon

në këtë treg. Asnjë nga shoqëritë palë në marrëveshje nuk vepron në nën tregun e importit të gazit të lëngshëm të naftës.

Transaksioni mes palëve realizon mbivendosje pjesësh vetëm në tregun e importit të vajrave për automjete por treguesit e përqendrimit të tregut para dhe pas përqendrimit tregojnë që efektet e transaksionit nuk do të ndikojnë në tregun përkatës.

Si konkluzion ky përqendrim nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar:

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet shitjes dhe transferimit të kuotës prej XX% të aksioneve të Autovizion SHA tek Bolv Oil SHA.
2. Vendosjen e gjobës mbi shoqërinë BOLV OIL SHA në masën XXX lekë.
3. Kundër këtij vendimi, subjekti palë e këtij përqendrimi, ka të drejtën e ankimimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të tij.
4. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 529, Datë 25.06.2018

“Mbi ndryshimin e kontrollit të shoqërisë SPORT VISION d.o.o Podgorica, Mali i Zi nga SPORT VISION d.o.o Bijeljina, Bosnje Hercegovina”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 25.06.2018, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet ndryshimit të kontrollit të shoqërisë SPORT VISION d.o.o Podgorica, Mali i Zi nga SPORT VISION d.o.o Bijeljina, Bosnje Hercegovina.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar. Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe formulari i njoftimit të përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë, mbi njoftimin e përqendrimit mbi ndryshimin e kontrollit të SPORT VISION d.o.o Podgorica, nga SPORT VISION d.o.o Bijeljina, Bosnje Hercegovina,

VËREN SE:

I. Procedura dhe transaksioni

Autoriteti i Konkurrencës është informuar nga përfaqësuesi ligjor i shoqërisë Sport Vision d.o.o Bijeljina, në lidhje me Kontratën për përfitimin e 60% të kuotave të shoqërisë Sport Vision d.o.o Podgoricë, Mal i ZI nga shoqëria Sport Vision d.o.o Bijeljina, Bosnje Hercegovina.

Shoqëria Sport Vision doo, Podgorice është një shoqëri e re e krijuar rishtazi pas procedurës së ristrukturimit (spin off transaction) të realizuar nga shoqëria Bravera doo, Podgorice. Shoqëria Bravera doo, Podgorice, me ortak Z. Vladimir Velickoviq dhe Z. Peter Velickoviq me 50% të kuotave secili, ka transferuar tek shoqëri e re të gjithë biznesin e saj, duke përfshirë transferimin e punonjësve, aseteve, kontratat ekzistuese të qerasë dhe të gjitha të drejtat dhe detyrimet në lidhje me biznesin ekzistues.

Në datë 24 prill 2018, është lidhur kontrata “Për fitimin e një pjesë në Sport Vision doo, Podgorice”, nëpërmjet të cilës Sport Vision d.o.o. në Bosnje Hercegovina pranon të blejë nga pronarët (Z. Vladimir Velickoviq dhe Z. Peter Velickoviq) 60% të kuotave të shoqërisë Sport Vision doo, Podgorice.

II. Palët në transaksion janë:

Blerësi: Sport Vision d.o.o, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të shtetit të Bosnjë Hercegovinës, me seli në Bijeljina, Bosnje. Shoqëria zotërohet 100% nga z. Dragan Stanojlovic.

Aktiviteti i shoqërisë është import eksport, shpërndarje dhe shitje e mallrave sportivë, këpucë dhe veshje (me shumice dhe pakicë).

Shitësi 1: Z. Vladimir Velickoviq, shtetas malazez, zotërues i XX % të kuotave te shoqërisë Sport Vision d.o.o, Podgorice.

Shitësi 1: Z. Peter Velickoviq, shtetas malazez, zotërues i XX % të kuotave te shoqërisë Sport Vision d.o.o, Podgorice.

Ndërmarrja Target: Sport Vision d.o.o., shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit te shtetit të Malit të Zi, me seli në Podgoricë. Shoqëria ushtron aktivitetin në import eksport, shpërndarje dhe shitje mallrave sportivë (me shumice dhe pakicë).

Pas mbylljes së marrëveshjes shoqëria “Sport Vision doo, Podgorice do të zotërohet respektivisht me:

- XX % të kuotave nga Sport Vision doo Bijeljina, Bosnje Hercegovina;
- XX % të kuotave nga Z. Vladimir Velickoviq;
- XX % të kuotave nga Z. Peter Velickoviq.

Shoqëria Vision Sport doo, Bosnje Hercegovina kontrollon në mënyre të drejtpërdrejtë, nëpërmjet XX % të kuotave, shoqërinë IN SPORT SHPK në Shqipëri, e cila ka si objekt të veprimtarisë import-eksport dhe tregtim me shumice dhe pakicë të mallrave dhe artikujve industrial, impianteve, mjeteve, makinerive etj.

III. Vlerësimi i përqendrimit

Transaksioni plotëson kriteret e përcaktuara në nenet 10 dhe 12 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, duke përberë objekt shqyrtimi dhe vlerësimi nga Autoriteti i Konkurrencës.

Referuar nenit 3, pika 7, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, si edhe Udhëzimit Nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, u konsiderua se tregu përkatës i produktit është tregu i import, shitjes me shumicë dhe pakicë të artikujve sportiv dhe tregu përkatës gjeografik u konsiderua territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i realizuar nëpërmjet përfitimit të XX % të kuotave të shoqërisë Sport Vision doo, Podgorice nga Sport Vision doo Bijeljina, mundëson kontrollin e drejtpërdrejtë të shoqërisë dhe shtrirjen e palës blerëse edhe në territorin e Malit të Zi.

Pala blerëse dhe shoqëria Target janë shoqëri të cilat veprojnë në të njëjtin treg produkti por në tregje të veçanta gjeografike.

Shoqëria Sport Vizion doo, Bijeljina zotëron XX % të tregut të artikujve sportive në shtetin e Bosnje Hercegovinës dhe shoqëria Bravera doo Podgoricw, zë vetëm XX % të pjesës së tregut në Malin e Zi.

Në tregun shqiptar ofruesi më i madh për produktet sportive është Ballkan Sport SHPK e shpërndarë nëpërmjet rrjetit të dyqaneve INTERSPORT dhe më pas In Sport SHPK nëpërmjet dyqaneve SPORT VISION.

Sipas të dhënave në lidhje më xhiron e krijuar nga shoqëritë që veprojnë në tregun më shumicë dh e pakicë të veshjeve dhe këpucëve rezulton se In Sport SHPK zotëron rreth XX % të tregut.

Transaksioni i ndryshimit të kontrollit ndodh në shtetin e Malit të Zi dhe prek tregje gjeografike të ndryshme pa impakt mes tyre. Pjesët e tregut të palëve në tregjet gjeografike respektive do të mbetën të pandryshuara pas përqendrimit.

Si konkluzion ky përqendrim nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d, nenit 56 pika 1, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar:

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet ndryshimit të kontrollit të shoqërisë SPORT VISION d.o.o Podgorica, Mali i Zi nga SPORT VISION d.o.o Bijeljina, Bosnje Hercegovina.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 533, Datë 05.07.2018

“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të vetëm të SKY PLC nga COMCAST CORPORATION”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 05.07.2018, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të vetëm të SKY PLC nga COMCAST CORPORATION.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, gërma d, dhe nenet 53-64 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar. Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe formulari i njoftimit të përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë, mbi njoftimin e përqendrimit mbi përfitimin e kontrollit të vetëm të Sky Plc nga Comcast Corporation,

VËREN SE:

I. Procedura dhe transaksioni

Autoriteti i Konkurrencës është vënë në dijeni në lidhje me ofertën publike që shoqëria Comcast Corporation i ka bërë shoqërisë Sky Plc. Të dyja shoqëritë veprojnë në industrinë e mediave dhe teknologjisë së informacionit.

Blerësi: Comcast Corporation, është një shoqëri publike e themeluar sipas ligjeve të Pensilvania, SHBA. Comcast është një shoqëri globale e mediave dhe teknologjisë, që sjell përvojat e argëtimit dhe komunikimit për miliona njerëz nëpërmjet dy bizneseve primare: Comcast Cable dhe NBC Universal.

Comcast Corporation nuk ka filial në Shqipëri, por është aktive përmes NBC Universal (NBCU). Të ardhurat totale të Comcast Corporation në Shqipëri në vitin 2017 janë rreth XXX milion euro.

Shitësi: Sky Plc, shoqëri publike me përgjegjësi të kufizuar, që vepron sipas legjislacionit të Mbretërisë së Bashkuar. Sky Plc është kompani lider në tregun e komunikimit dhe argëtimit në Evropë. Sky u shërben përafërsisht 23 milionë klientëve në shtatë vende: Britani, Irlandë, Gjermani, Austri, Itali, Spanjë dhe Zvicër. Sky Plc ofron kanale sportive të njohura si premier League dhe Bundesliga dhe ofron ndër të tjera NFL, Sky News për transmetim lajmesh.

Sky nuk ushtron aktivitet në Shqipëri.

Blerja e Sky Plc do të zgjerohet shtrirjen e Comcast Corporation dhe do të rrisë ndikimin e tij në Mbretërinë e Bashkuar dhe kontinentin evropian.

Transaksioni plotëson kriteret e përcaktuara në nenet 10 dhe 12 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar duke përberë objekt shqyrtimi dhe vlerësimi nga Autoriteti i Konkurrencës.

II. Vlerësimi i konkurrencës

Referuar nenit 3, pika 7, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, si edhe Udhëzimit Nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, tregu përkatës i produktit konsiderohet tregu i prodhimit dhe ofrimit të shërbimeve të programeve televizive dhe tregu përkatës gjeografik konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Në lidhje me tregun e prodhimit dhe ofrimit të programeve televizive, konstatohet se aktivitetet e NBCU në Shqipëri përbëhen nga shitja e filmave të prodhuar kryesisht nëpërmjet XXX. Përmbajtjet televizive të licencuara nga NBCU zakonisht përfshijnë filma jo Shqiptar dhe seriale televizive të cilat mund të dublohen apo titrohen në shqip.

Në lidhje me tregun e ofrimit të shërbimeve me shumicë të kanaleve televizive, NBCU është aktiv në furnizimin me shumicë të kanalit të lajmeve të biznesit të CNBC në Shqipëri.

Të ardhura nga aktivitetet e shoqërisë Comcast Corporation në Shqipëri janë realizuar nga prodhimi dhe ofrimi i programeve televizive dhe konsiderohet se pjesëmarrja e tij në treg është më pak se XX %.

Transaksioni i propozuar nuk do të ketë ndikim në asnjë treg në Shqipëri.

Si konkluzion ky përqendrim nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të vetëm të SKY PLC nga COMCAST CORPORATION.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 534, Datë 05.07.2018

“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet shitjes dhe transferimit të 100% të aksioneve të shoqërisë FINAL SHA tek IUTECREDIT ALBANIA SHA”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 05.07.2018, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet shitjes dhe transferimit të 100% të aksioneve të shoqërisë Final SHA tek IuteCredit Albania SHA.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, gërma d, dhe nenet 53-64 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar. Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe formulari i njoftimit të përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë, mbi njoftimin e përqendrimit mbi shitjen dhe transferimin e 100% të aksioneve të shoqërisë Final SHA tek IuteCredit Albania SHA,

VËREN SE:

I. Procedura dhe Transaksioni

Autoriteti i Konkurrencës është njoftuar në lidhje me Marrëveshjen për Shitblerjen e Aksioneve të lidhur më datë 17.04.2018 ndërmjet palëve IuteCredit Albania SHA dhe Znj.Majlinda Demko, Z.Ali Vihaj, Z.Adrian Koni, RiverstyXX Capital, Balfin SHPK.

Nëpërmjet këtij transaksioni IuteCredit Albania SHA synon të diversifikojë portofolin e saj në fushën e kredive konsumatore dhe qirasë financiare, si dhe të rrisë numrin e operatorëve ekonomikë me të cilët ekzistojnë marrëveshje bashkëpunimi për financimin e blerjes së produkteve nëpërmjet kredive.

Blerësi: IuteCredit Albania SHA, Subjekt Financiar Jo-Bankë, i krijuar në përputhje me legjislacionin shqiptar. Kjo shoqëri ka objekt të veprimtarisë aktivitetin në fushën e operacioneve tregtare dhe financiare të mikrokredisë etj.

Shitësi 1: Znj.Majlinda Demko, person fizik;

Shitësi 2: Z.Ali Vishaj, person fizik;

Shitësi 3: Z.Adrian Koni, person fizik;

Shitësi 4: Riverstyxx Capital, shoqëri e krijuar në baze të ligjeve të Republikës së Bullgarisë;

Shitësi 5: Balfin SHPK, shoqëri tregtare e krijuar në përputhje me legjislacionin shqiptar.

Shoqëria Target: Final SHA, Subjekt Financiar Jo-Bankë, i krijuar në formën e një shoqërie aksionare në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi. Objekti i aktivitetit është qera financiare, kredi dhënie etj.

Transaksioni plotëson kriteret e përcaktuara në nenet 10 dhe 12 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar duke përberë objekt shqyrtimi dhe vlerësimi nga Autoriteti i Konkurrencës.

II. Vlerësimi i përqendrimit

Referuar nenit 3, pika 7, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, si edhe Udhëzimit Nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës i produktit konsiderohet tregu i kredisë, mikrokredisë, qirasë financiare dhe faktoringut të ofruara nga Subjektet Financiare Jobankë dhe treg përkatës gjeografik konsiderohet tregu i brendshëm, pra territori i Republikës së Shqipërisë.

Në tregun e kredisë, mikrokredisë, qirasë financiare dhe faktoringut të ofruara nga Subjektet Financiare Jo-Bankë operojnë gjithsej 22 shoqëri, ku tre shoqëritë më të mëdha zotërojnë XXX% të tregut, nëntë shoqëri kanë pjesë tregu më të vogël se XX% dhe të tjerat kanë pjesë tregu më të vogël se XX%.

Tregu gjatë vitit 2017 paraqitet i hapur (licencimi për kredi dhe mikrokredi) dhe kjo evidentohet nga hyrja e tre konkurrentëve të rinj në treg.

Shoqëria IuteCredit Albania paraqitet me një pjesë tregu të vogël (XX%), ndërkohë që shoqëria Final SHA zotëron vetëm XX% të tregut dhe për rrjedhojë edhe fuqia e saj në treg është e limituar. Pas përqendrimit, pjesa e kombinuar e tregut të dy palëve shkon në XX% e tregut dhe ndryshimi i indeksit të përqendrimit ΔHHI është 3.3.

Pas realizimit të përqendrimit fuqia ekonomike e IuteCredit Albania SHA ngelet pothuajse në të njëjtat nivele si para realizimit të transaksionit.

Në një përcaktim më të detajuar të tregut përkatës, vihet re se transaksioni nuk shkakton mbivendosje horizontale të veprimtarisë së palëve në treg pasi IuteCredit Albania SHA është e licensuar vetëm për produktin e mikrokredisë, ndërsa shoqëria Final SHA operon në treg nëpërmjet produktit të kredi dhënies dhe qirasë financiare.

Si konkluzion ky përqendrim nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet shitjes dhe transferimit të 100% të aksioneve të shoqërisë Final SHA tek IuteCredit Albania SHA.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 536, Datë 20.07.2018

“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit nga UNITED MEDIA mbi DIRECT MEDIA, MEDIA POINT, PINK BH dhe PINK MNE”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 20.07.2018, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit nga UNITED MEDIA mbi DIRECT MEDIA, MEDIA POINT, PINK BH dhe PINK MNE.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, gërma d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe formulari i njoftimit të përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë, mbi njoftimin e përqendrimit mbi përfitimin e kontrollit nga UNITED MEDIA mbi DIRECT MEDIA, MEDIA POINT, PINK BH dhe PINK MNE,

VËREN SE:

I. Transaksioni dhe përqendrimi

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është depozituar shkresa me Nr.369, datë 05.06.2018 “Përqendrimi ndërmjet United Media dhe Direct Media/Media Point, Pink BH, Pink MNE”, ku jemi njoftuar në lidhje me një transaksion për përfitim të plotë kontrolli nga shoqëritë United Media mbi Direct Media dhe Media Point.

Shitësi 1: Ascanius Netherlands B.V me seli në Hollandë;

Shitësi 2: Z. Dragan Jesic,

Shitësi 3: Pink International Company d.o.o, kompani Serbe

Shitësi 4: Z. Zeljko Mitrovic,

Shitësi 1 dhe Shitësi 2 janë shitësit e Direct Media kurse Shitësi 3 dhe Shitësi 4 janë shitësit e Pink.

Blerësi: United Media S.a.r.l është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar në mars të vitit 2014, me seli në Luksemburg. Aktiviteti i kësaj shoqërie ka të bëjë me transmetimin e kanaleve televizive, pra shoqëria është veçanërisht aktive në ofrimin e shërbimeve të këshillimit, menaxhimit dhe prokurimit të përmbajtjeve mediatike për entitete të ndryshme brenda United Group, aktiv në prodhimin dhe transmetimin sipas një orari të programuar në kanale të shpërndara për abonentët e fundit nga operatorët e telekomunikacioneve;

Direct Media d.o.o Beograd është një agjenci mediatike, e cila u ofron klientëve shërbime të integruara të komunikimit, duke përfshirë konsultimin, reklamimin, hulumtimin e planifikimit të medias, mbledhjen dhe interpretimin e informacionit të klientit, shërbimet krijuese dhe matjen dhe vlerësimin e suksesit të marketingut si dhe shërbimet e printimit. Veprimtaria kryesore e Direct Media Group janë aktivitetet e marketingut, aktivitete që lidhen me reklamimin e medias, blerja e medias, financimi i prodhimit në marrëveshje të përbashkëta.

Media Point d.o.o Beograd është një agjenci mediatike që është pjesë e grupit të Direct Media.

Grupi Direct media/Media Point është prezentë në Shqipëri përmes filialit Direct Media SHPK që zotërohet tërësisht nga Direct Media Maqedoni, që operon në fushën e marketingut dhe të reklamimeve.

Pink BH Company d.o.o Sarajevo është një kompani transmetimi Bosnjë Hercegovinë që ofron programe argëtimi dhe informimi për shikuesit e saj,

Pink MNE d.o.o Podgorica transmeton programe televizive në Malin e Zi, me mbulim kombëtar. Programet kanë një natyrë informative dhe argëtuese që ofrohen kryesisht për shikuesit malazezë.

II. Vlerësimi i përqendrimit

Transaksioni plotëson kriteret e përcaktuara në nenet 10 dhe 12 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar duke përberë objekt shqyrtimi dhe vlerësimi nga Autoriteti i Konkurrencës.

Referuar nenit 3, pika 7, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, si edhe Udhëzimit Nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, tregu përkatës i produktit u konsiderua tregu i ofrimit të shërbimeve të komunikimit të marketingut dhe blerjes të medias. Megjithatë duke marrë në konsideratë natyrën e transaksionit i cili nuk do të sjellë asnjë ndryshim në tregun shqiptar, si edhe duke iu referuar praktikës së Komisionit Evropian në çështje të ngjashme tregu përkatës i produktit është lënë i hapur. Tregu përkatës gjeografik u konsiderua territori i Republikës së Shqipërisë.

Pas realizimit të transaksionit, United Media do të ketë kontroll të plotë mbi Direct Media dhe Media Point, duke përfshirë Pink BH dhe Pink MNE si filialet e tyre.

Transaksioni i synuar nuk ka aktualisht impakt në tregun shqiptar. Si konkluzion ky përqendrim nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfuturit të kontrollit nga UNITED MEDIA mbi DIRECT MEDIA, MEDIA POINT, PINK BH dhe PINK MNE.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 537, Datë 20.07.2018

“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet shitjes dhe transferimit të aksioneve të BFSE HOLDING B.V tek shoqëria AMRYTA CAPITAL LLP.”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 20.07.2018, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet shitjes dhe transferimit të aksioneve të BFSE HOLDING B.V tek shoqëria AMRYTA CAPITAL LLP.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, gërma d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe formulari i njoftimit të përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë, mbi njoftimin e përqendrimit mbi shitjen dhe transferimin e aksioneve të BFSE HOLDING B.V tek shoqëria AMRYTA CAPITAL LLP.,

VËREN SE:

I. Transaksioni dhe përqendrimi

Shoqëria NOA SHA, me shkresën Nr 235 Prot., datë 06.04.2018 “Njoftim lidhur me ndryshimin e kontrollit të tërthortë të shoqërisë NOA SHA”, ka informuar Autoritetin e Konkurrencës lidhur me ndryshimin e kontrollit të tërthortë të kësaj shoqërie, për shkak të shitjes së aksioneve BFSE Holding B.V tek shoqëria Amryta Capital LLP.

Shitësi: BFSE Holding B.V është një kompani private me përgjegjësi të kufizuar, e cila ushtron aktivitetin si një shoqëri financiare Holding duke ofruar një gamë të gjerë shërbimesh financiare, regjistruar dhe me seli në Hollandë.

Shoqëria kontrollon në mënyre të tërthortë shoqërinë NOA SHA, e cila është shoqëri aksionare me aksionarë NOA Cooperatief U.A që zotëron XX të aksioneve dhe NOA Holdings N.V XX të aksioneve. NOA SHA është institucion financiar jo-bankë (SFJB), licencuar nga Banka e Shqipërisë dhe ka objekt të aktivitetit: të japë kredi, të kryejë pagesa dhe arkëtime, të emetojë, pranojë dhe administrojë instrumentet e pagesës, të ofrojë shërbimin e këmbimit të monedhave, të ofrojë garanci të tjera, të shërbejë si agjent financiar/rikuperues i kredive me probleme dhe konsulent, etj.

Blerësi: Amryta Capital LLP, është një partneritet me përgjegjësi të kufizuara e themeluar dhe që vepron në përputhje me legjislacionin Anglez dhe Wales, me seli në Mbretërinë e Bashkuar.

II. Vlerësimi i përqendrimit

Në datën XXX, është nënshkruar Marrëveshja për shitjen dhe blerjen e të gjithë kapitalit aksionar të emetuar të BFSE Holding BV nga Amryta Capital LLP (Blerësi). BFSE Holding B.V zotëron XX % të aksioneve të NOA Cooperatief U.A, e cila është aksionari kryesor i NOA Holdings N.V dhe kjo e fundit zotëron XX % të kuotave të shoqërisë NOA SHA.

Transaksioni i propozuar është ndryshimi i kontrollit të tërthortë të shoqërisë NOA SHA nëpërmjet shitjes dhe transferimit të aksioneve të BFSE HOLDING B.V tek shoqëria AMRYTA CAPITAL LLP.

Transaksioni plotëson kriteret e përcaktuara në nenet 10 dhe 12 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar duke përberë objekt shqyrtimi dhe vlerësimi nga Autoriteti i Konkurrencës.

Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, si edhe udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, tregu përkatës i produktit u konsiderua tregu i kredisë, mikrokredisë, qirasë financiare dhe faktoringut të ofruara nga SFJB-të dhe tregu përkatës gjeografik konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Në tregun e kredisë, mikrokredisë, qirasë financiare dhe faktoringut të ofruara nga SFJB-të operojnë gjithsej 22 ndërmarrje, tre nga të cilat zënë XX % të tregut, nëntë ndërmarrje kanë pjesë tregu më të vogël se XX % dhe dhjetë ndërmarrje të tjera kanë pjesë tregu më të vogël se XX %.

Shoqëria NOA SHA zë XX % të portofolit të kredisë, mikrokredisë, qirasë financiare dhe faktoringut të ofruara nga SFJB-të.

Transaksioni i synuar nuk do të sjellë asnjë ndryshim në tregun shqiptar të kredisë, mikrokredisë, qirasë financiare dhe faktoringut të ofruara nga SFJB-të dhe pjesa e tregut e shoqërisë NOA SHA do të mbetet e pandryshuar pas transaksionit.

Si konkluzion ky përqendrim nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet shitjes dhe transferimit të aksioneve të BFSE HOLDING B.V tek shoqëria AMRYTA CAPITAL LLP.
2. Tregu i kredisë, mikrokredisë, qirasë financiare dhe faktoringut, të ofruara nga SFJB-të, të jetë objekt monitorimi për një periudhë 1 vit nga data e shpalljes së këtij vendimi.
3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 539 Datë 24.07.2018

“Mbi ndryshimin e kontrollit të shoqërisë Hygeia Hospital Tirana SHA nga Diagnostic and Therapeutic Centre of Athens, Hygeia S.A tek American Hospital Sha.”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 24.07.2018, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet ndryshimit të kontrollit të shoqërisë Hygeia Hospital Tirana SHA nga Diagnostic and Therapeutic Centre of Athens, Hygeia S.A tek American Hospital Sha.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, gërma d, dhe nenet 53-64 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar. Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe formulari i njoftimit të përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet ndryshimit të kontrollit të shoqërisë Hygeia Hospital Tirana SHA nga Diagnostic and Therapeutic Centre of Athens, Hygeia S.A tek American Hospital SHA,

VËREN SE:

I. Transaksioni dhe përqendrimi

American Hospital, ka depozituar pranë Autoritetit të Konkurrencës njoftimin lidhur me transaksionin midis Hygeia Hospital Tirana SHA dhe American Hospital SHA, duke depozituar pranë Autoritetit të Konkurrencës dokumentacionin e nevojshëm për kryerjen e vlerësimit të këtij rasti.

Shoqëria Target: HYGEIA HOSPITAL TIRANA SHA, është një shoqëri aksionare e themeluar në Shqipëri, ku aksionar kryesor është Diagnostic and Therapeutic Centre of Athens, Hygeia S.A me 100% të aksioneve.

Blerësi: AMERICAN HOSPITAL SHA është një shoqëri aksionare e themeluar në Shqipëri, me aksionar kryesor Balkan Alliance Healthcare B.V, me 100% të aksioneve.

Shitësi: DIAGNOSTIC AND THERAPEUTIC CENTRE OF ATHENS, HYGEIA S.A, një shoqëri publike me përgjegjësi të kufizuar e themeluar sipas ligjeve të Greqisë.

II. Vlerësimi i përqendrimit

Në datë XX 2018 midis Diagnostic and Therapeutic Centre of Athens, Hygeia S.A, në cilësinë e shitësit dhe American Hospital SHA në cilësinë e Blerësit, është lidhur Kontrata për Shitjen dhe Blerjen e të gjithë Kapitalit Aksionar të emetuar të Hygeia Hospital Tirana SHA.

Shitësi ka pranuar të shesë dhe blerësi ka pranuar të blejë aksionet në këmbim të çmimit dhe sipas kushteve të Kontratës së datës XX 2018. Pas këtij transaksioni, American Hospital SHA do të zotërojë i vetëm 100% të aksioneve të Hygeia Hospital Tirana

Transaksioni plotëson kriteret e përcaktuara në nenet 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, duke përbërë objekt shqyrtimi dhe vlerësimi nga Autoriteti i Konkurrencës.

Marrja e kontrollit të shoqërisë target nga blerësi do të lejojë një planifikim më të mirë dhe rritjen e investimeve në drejtim të sjelljes së teknologjisë më të fundit të pajisjeve mjekësore në këto spitale për një shërbim edhe me profesional dhe të plotë ndaj konsumatorit shqiptar.

Referuar nenit 3, pika 7, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, si edhe Udhëzimit Nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, përcaktimi “treg përkatës” përfshin dy komponentë: tregu përkatës i produktit, dhe tregu përkatës gjeografik. Kriteret bazë të përcaktimit të tregut përkatës janë: zëvendësueshmëria nga ana e kërkesës dhe nga ana e ofertës

Nevojat për cilësi, shërbim dhe efektivitet e bën kërkesën konsumatore të orientuar si nga shërbimi shëndetësor publik ashtu edhe ndaj atij privat. Mbi këto argumente konkludojmë se dy shërbimet janë zëvendësues të njëri tjetrit nga këndvështrimi i kërkesës.

Zëvendësueshmëria nga ana e ofertës konsiston në mundësinë që ofruesit e shërbimit të jenë të aftë të këmbëjnë produktet e tyre me produktet e konkurrentëve të tjerë në treg, dmth të ofrojnë produkte zëvendësuese. Nga vlerësimi i shërbimeve të ofruara nga shërbimi shëndetësor publik dhe privat konstatohet se këto dy shërbime janë zëvendësues të plotë të njëri tjetrit.

Treg përkatës produkti do të konsiderohet tregu i shërbimeve shëndetësore ambulatorë dhe shërbimeve spitalore (kujdesi spitalor).

Duke qenë se shërbimi shëndetësor ambulator si dhe shërbimi spitalor ofrohen për pacientët nga e gjithë Shqipëria, treg përkatës gjeografik do të konsiderohet tregu i brendshëm, pra territori i Republikës së Shqipërisë.

Mbështetur në treguesit e shpenzimeve të realizuara nga spitalet publike, private dhe shërbimin ambulator, konstatohet se tregu përkatës paraqet një strukturë të përqendruar për shkak të pjesë së madhe të tregut që zotërojnë spitalet publike. Indeksi i përqendrimit të tregut HHI është në nivelin XXX dhe pjesa e tregut e dy shoqërive palë në marrëveshje është rreth XX% për American Hospital dhe XX% për Hygeia Hospital. Pas përqendrimit, pjesa e kombinuar e tregut e shoqërive palë në marrëveshje shkon në XX% dhe HHI XXX. Ndryshimi i indeksit të përqendrimit të tregut ΔHHI llogaritet të jetë XX.

Në pikën 12 të Udhëzimit “Për vlerësimin e përqendrimeve horizontale”, parashikohet se në rastet kur indeksi i përqendrimit të tregut është mbi 2000 dhe $\Delta HHI < 150$, Autoriteti mund të mos identifikojë probleme për tregun.

Nga vlerësimi i efekteve të këtij përqendrimi në gjithë shërbimin shëndetësor (privat dhe shtetëror), konstatohet se transaksioni nuk do të kishte efekte negative në konkurrencës pasi spitalet publike do të shërbenin si një konkurrentë efektiv në treg dhe për më tepër “e mira publike” do të ishte e sigurtë për kërkesën konsumatorë.

E vlerësuar në një treg më të kufizuar, siç është shërbimi spitalor privat, vihet re një përqendrim i konsiderueshëm pas transaksionit, por pjesa e vogël e tregut që zënë spitalet privatë, me pak se XX %, do të bëjë që efektet e transaksionit të jenë minimale për shërbimin shëndetësor në tërësi.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d, në nenin 56, pika 1, gërma a) dhe nenin 61 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë transferimin e 100% të aksioneve të “Hygeia Hospital Tirana SHA” nga “Diagnostic and Therapeutic Centre of Athens “Hygeia S.A.”” tek “American Hospital SHA”.
2. Shoqëria American Hospital, duhet të njoftojë pranë Autoritetit të Konkurrencës, sa herë do të ketë ndryshim të çmimit të shërbimeve.
3. Shoqëria American Hospital SHA do të jetë objekt monitorimi për një periudhë 1 vjeçare më qëllim vlerësimin e sjelljes së shoqërisë pas përqendrimit.
4. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 540, Datë 24.07.2018

“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet bashkimit të SIEMENS A.G me ALSTOM S.A”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 24.07.2018, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet bashkimit të SIEMENS A.G me ALSTOM S.A.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, gërma d, dhe nenet 53-64 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrotjtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe formulari i njoftimit të përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë, mbi njoftimin e përqendrimit mbi bashkimin e shoqërisë SIEMENS A.G me ALSTOM S.A,

VËREN SE:

I. Procedura dhe transaksioni

Në datën XXX 2018 midis palëve Alstom S.A dhe Siemens A.G është nënshkruar Marrëveshja e Kombinimit të Biznesit. Marrëveshja parashikon se Siemens A.G do të zotërojë të paktën XX% të kapitalit aksionar të Alstom S.A. Emri i shoqërisë Alstom do të bëhet “*Siemens Alstom*” me logon “Alstom Pulse” me seli në Francë.

Siemens AG, është një shoqëri e organizuar dhe ekzistuese në përputhje me ligjet Gjermane, me seli të regjistruar në Mynih dhe Berlin. Bizneset e Siemens janë të përfshira në sektorët e energjisë dhe gazit; shërbimet e prodhimit të energjisë; menaxhimi i energjisë; teknologjitë e ndërtimit; lëvizshmëria/mobiliteti; fabrika dixhitale; industritë e proceseve dhe të drejtimit; shërbimet financiare etj.

Siemens nuk operon në Shqipëri nëpërmjet ndonjë filiali të zotëruar apo dege të tij. Në vitin financiar 2016/2017 Siemens A.G ka realizuar shitje prej XXX Euro në Shqipëri. Pjesa më e madhe e shitjeve në Shqipëri janë gjeneruar përmes sektorit të energjisë dhe gazit, treg i cili nuk preket nga transaksioni i propozuar.

Alstom S.A, është një shoqëri e organizuar dhe ekzistuese sipas ligjeve të Francës. Alstom është një shoqëri aksionare e listuar në bursën Euronext të Parisit. Alstom është një lojtar global në industrinë botërore të transportit hekurudhor, duke ofruar një gamë të plotë të mjeteve lëvizëse (nga trenat me shpejtësi të lartë tek metrotë, tramvaje dhe autobusë elektronike); shërbime të personalizuar (mirëmbajtje dhe modernizim) si dhe oferta dedikuar pasagjerëve dhe infrastrukturës, lëvizshmërisë dixhitale dhe zgjidhjet e sinjalizimit.

Kjo shoqëri nuk ushtron aktivitet dhe nuk realizon shitje në Shqipëri.

Transaksioni plotëson kriteret e përcaktuara në nenet 10 dhe 12 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, duke përbërë objekt shqyrtimi dhe vlerësimi nga Autoriteti i Konkurrencës.

II. Vlerësimi i konkurrencës

Referuar nenit 3, pika 7, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, si edhe Udhëzimit Nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, tregu përkatës i produktit mund të konsiderohet tregu i furnizimit me mjete lëvizëse, sinjalizimit dhe elektrifikimit të hekurudhave. Duke qenë se transaksioni nuk pritet të ketë asnjë ndryshim në tregun shqiptar, pasi as Alstom dhe as Siemens nuk janë aktive në sektorin e mobilitetit në Shqipëri, përcaktimi i tregut përkatës të produktit do të lihet i hapur. Tregu përkatës gjeografik do të konsiderohet tregu i brendshëm, pra territori i Republikës së Shqipërisë.

Përqendrimi i propozuar ka për qëllim të bashkojë dy operatorë globalë të hekurudhave me vlera unike për klientët në nivel global dhe me potencial operativ. Kombinimi i përvojës së palëve, i ofertave të produktit plotësuese dhe shtrirja gjeografike do t’u mundësojnë palëve të investojnë në teknologjinë dixhitale të nevojshme për sfidat e lëvizshmërisë në të ardhmen në përfitim të klientëve dhe konsumatorëve përmes çmimeve më të ulëta.

Transaksioni i propozuar ka të bëjë me furnizimin e mjeteve lëvizëse, sinjalizimin dhe elektrifikimin e hekurudhave. As Siemens A.G dhe as Alstom S.A nuk janë aktive në ndonjë segment potencial të tregut përkatës të produkteve në Shqipëri dhe nuk gjenerojnë ndonjë xhiro brenda vendit në këto fusha.

Transaksioni i bashkimit të Alstom S.A me biznesin e mobilitetit të Siemens A.G nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar, kështu që në lidhje me tregun shqiptar nuk identifikohen tregje të prekura, prandaj transaksioni nuk pritet të ketë asnjë efekt në tregun shqiptar.

Si konkluzion ky përqendrim nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet bashkimit të SIEMENS A.G me ALSTOM S.A
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 543, Datë 20.09.2018

“Për mos klasifikim si përqendrim të njoftimit për transferimin e 85% të kuotave të shoqërisë CC TIRANA SHPK tek COMDATA S.p.A.”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 20.09.2018, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Njoftimi për shitjen dhe transferimin e 85% të kuotave të shoqërisë CC TIRANA SHPK tek COMDATA S.p.A.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, 15, neni 24, gërma d, dhe nenet 53-64 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar. Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe formulari i njoftimit të përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve për njoftimin e përqendrimit mbi shitjen dhe transferimin e 85% të kuotave të shoqërisë CC TIRANA SHPK tek COMDATA S.p.A.,

VËREN SE:

1. Procedura dhe Transaksioni

Autoriteti i Konkurrencës është njoftuar në lidhje me “Marrëveshjen Kuadër” midis Comdata S.p.A. dhe Sestante Holding SRL për blerjen e 85% të kuotave të CC Tirana SHPK, me shkresën nr. 330, datë 23/05/2018 (protokolluar pranë AK) marrëveshje e lidhur më datë XXX 2018 ndërmjet palëve Comdata S.p.A. dhe Sestante Holding SRL.

Blerësi: COMDATA S.p.A është një shoqëri aksionare italiane e cila kontrollohet nga Carlyle Europe Partners IV L.P.UK. Comdata S.p.A ofron shërbime “outsourcing” të proceseve të biznesit lidhur me zgjidhjet e menaxhimit të marrëdhënieve me klientët. Shërbimet e saj mbulojnë shërbime në fushën e analizës, back office, këshillimit, qendrave të kontaktit, menaxhimit të kredisë dhe shërbimeve të teknologjisë. Comdata S.p.A. aktualisht nuk operon në Shqipëri.

Shitësi: Sestante Holding SRL, një shoqëri e themeluar sipas ligjeve të Italisë, në mars 2005. Objekti i veprimtarisë së saj është mbështetje dhe asistencë teknike, për shoqëritë profesioniste, gjatë administrimit dhe vendimmarrjes organizative. Ortaku i vetëm i shoqërisë është Z. Agron Shehaj.

Shoqëria Sestante Holding SRL, sipas dokumentacionit të paraqitur pranë AK, është 100% ortake e vetme në Shoqërinë CC Tirana SHPK, e cila është shoqëria target e këtij transaksioni.

Shoqëria target: CC Tirana SHPK me aksionar 100% shoqërinë Sestante Holding Srl, është regjistruar në QKB më 05.04.2018, dhe objekti i veprimtarisë së saj është: ofrimi i të gjitha shërbimeve që lidhen me Call Centre dhe Contact Center dhe aktivitet “Back Office”, në fushën e kujdesit ndaj klientit, tele-marketingut apo

tele-selling (shitjeve nëpërmjet telefonit) inbound dhe outbound duke përfshirë gjithashtu edhe përpunimin e të dhënave të shoqërive të tjera dhe/ose enteve publike.

Nëpërmjet njoftimit të këtij transaksioni pranë AK, Shoqëria blerëse COMDATA S.p.A., synon të blejë 85% të kapitalit të Shoqërisë CC Tirana SHPK.

Nga të dhënat e dorëzuara pranë AK, rezulton se xhironja e aktivitetit të shoqërisë CC Tirana SHPK, për vitin 2018, është në vlerën 0 (zero) lekë.

Në zbatim të neneve 10, pika 1, gërma b), nenit 12, pika 1, gërma a), dhe nenit 15, pika 2, që të ndodhemi përpara një përqendrimi duhet që jo vetëm të përfitohet kontrolli i drejtpërdrejtë ose i tërthortë nga një ose më shumë ndërmarrje përmes blerjes së kuotave, por edhe xhironja e ndërmarrjeve pjesëmarrëse, duhet të jetë 7 miliardë lekë në tregun ndërkombëtar dhe xhironja e ndërmarrjes pjesëmarrëse në tregun e brendshëm duhet të jetë 200 milion lekë, por siç u evidentua më sipër xhironja e aktivitetit të shoqërisë target CC Tirana SHPK, për vitin 2018, është në vlerën 0 (zero) lekë.

Për sa më sipër, transaksioni i njoftuar pranë AK, në kuptim të ligjit 9121/2003, nuk përbën përqendrim.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d) të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të mos klasifikojë njoftimin “Për transferimin e 85% të kuotave të shoqërisë CC TIRANA SHPK tek COMDATA S.p.A”, si përqendrim, pasi ai nuk përmbush kushtet ligjore në zbatim të neneve 10, 12 dhe 15 të ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 549, Datë 27.09.2018

“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të ndërmarrjes së përbashkët “AIR ALBANIA” SHPK”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 27.09.2018, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të ndërmarrjes së përbashkët “AIR ALBANIA” SHPK.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar. Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe formulari i njoftimit të përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë, mbi njoftimin e përqendrimit mbi krijimin e ndërmarrjes të re të përbashkët “AIR ALBANIA” SHPK,

VËREN SE:

I. Procedura dhe transaksioni

Autoriteti i Konkurrencës është njoftuar nga Albcontrol SHA, lidhur me zbatimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.309, datë 16.05.2018 “Për përcaktimin e procedurave të krijimit të shoqërisë “AIR ALBANIA SHPK”, nga tre ortakët “Albcontrol” SHA, “Turk Hava Yollari A.O” dhe “MDN Investment” SHPK.

Ortaku 1: ALBCONTROL SHA, një shoqëri aksionare, 100% shtetërore me objekt të aktivitetit ofrimin e shërbimeve të navigimit (lundrimit) ajror, të nevojshëm për të garantuar sigurinë, eficientë dhe rregullshmërinë e operimit të avionëve në hapësirën ajrore dhe në aerodromet civile të Shqipërisë dhe më gjerë, të publikuara në AIP Albania, në përputhje me standardet ndërkombëtare, marrëveshjet dhe rregulloret në fushën e lundrimit ajror të ratifikuara.

Ortaku 2: MDN INVESTIMENT SHPK, është një shoqëri shqiptare me përgjegjësi të kufizuar me objekt të aktivitetit projektimin, financimin, ndërtimin, kryerjen, funksionimi si dhe menaxhimi i Aeroportit Ndërkombëtar, i cili përfshin ndër të tjera marrjen në pronësi nga shoqëria të terminalit të Ri, Zyrrave të reja të Administrimit, Qendrës së re të Ngarkesës Ajrore, Pajisjeve të reja të karburantit, rrugës së re të hyrjes së Urës së Re dhe zotërimi dhe ushtrimi i uzufruktit nga shoqëria në lidhje me zonën e koncesionit. Ofrimin e shërbimeve të transportit të udhëtareve brenda dhe jashtë vendit etj.

Ortaku 3: TURK HAVA YOLLARI A.O, një kompani që ekziston sipas ligjeve të Turqisë. Veprimtaria ekonomike e Turkish Airlines është transporti ajror i udhëtarëve, postës, kafshëve, sendeve dhe çdo lloj transporti të lidhur me to dhe për rrjedhojë: të shesë bileta në lidhje me transportin ajror, të ortakërisë dhe me

të tjerë dhe të bëj depozitime; të prodhojë dhe riparojë çdo gjë në lidhje me avionët dhe pjesë të avionëve, të sigurojë ruajtjen/mirëmbajtjen e tyre dhe në këtë drejtim të ketë depo dhe qendra rregullimi/riparimi; të administrojë mjete transporti; të themelojë, të ndërtojë dhe të vërë në punë qendra telegrafike, telefonike, energjetikë, lidhje komunikimi pa tela dhe çdo gjë lidhur me vijimin e punës me to, etj.

Shoqëria Target: AIR ALBANIA SHPK, me NUIS L82113028I, regjistruar më 13.09.2018 me tre aksionar/ortakë kryesore, Albkontrol SHA që zotëron 10% të aksioneve; MDN Investment SHPK që zotëron 41% të aksioneve dhe Turk Hava Yollari A.O që zotëron 49% të aksioneve. Objekti i aktivitetit të shoqërisë së re është kryerja e të gjitha llojeve të transportit ajror të brendshëm dhe ndërkombëtar duke përfshirë të gjitha llojet e transportit ajror për pasagjerët, postën, kafshët dhe ngarkesën për në dhe nga çdo pikë brenda dhe jashtë Shqipërisë, si dhe për të gjitha punët dhe angazhimet e tjera të rastit lidhur me to, duke përfshirë por jo kufizuar në shërbimin e furnizimit me ushqim, shërbimet në tokë dhe shërbimet në sallat e pritjeve si dhe operacione tregtare të avionëve/riparimin dhe mirëmbajtjen e avionëve.

Transaksioni plotëson kriteret e përcaktuara në nenet 10 dhe 12 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar duke përberë objekt shqyrtimi dhe vlerësimi nga Autoriteti i Konkurrencës.

II. Vlerësimi i përqendrimit

Referuar nenit 3, pika 7, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, si edhe Udhëzimit Nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, përcaktimi “treg përkatës” përfshin dy komponentë:

I). tregu përkatës i produktit, dhe

II). tregu përkatës gjeografik.

— **Tregu përkatës i produktit:** treg përkatës të produktit do të konsiderohen tregu i transportit ajror të udhëtareve dhe kargos në linjat direkte.

— **Tregu përkatës gjeografik:** Zona gjeografike e shërbimit të transportit ajror do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Shoqëria e re Air Albania SHPK do të fillojë fluturimet në linjën Tiranë-Stamboll dhe anasjelltas dhe më vonë do shtrihet në Romë, Bolonjë, Londër dhe në linjat ndërkontinentale duke plotësuar kërkesën konsumatore për zgjedhje të reja dhe duke rritur shkallën e zëvendësueshmërisë së shërbimit nga ana e ofertës.

Me fillimin e aktivitetit të kësaj shoqërie, Shteti shqiptar do të paraqitet me linjën e vet kombëtare, duke ofruar shërbim në linja të cilat me parë ofroreshin vetëm nga operatorë të huaj. Shoqëria e re pritët të sjellë efekte pozitive mbi konkurrencën në tregun e transportit ajror nëpërmjet çmimeve konkurruese dhe cilësisë së shërbimit.

Për sa më sipëri ky përqendrim nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese dhe për këto arsye propozojmë t’i kërkon Komisionit autorizimin e këtij përqendrimi në përputhje me nenin 56, pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.

Si konkluzion ky përqendrim nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet krijimit të ndërmarrjes së përbashkët AIR ALBANIA SHPK.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 554, Datë 08.10.2018

“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit nga Messer Group GmbH dhe Yeti Investments S.a.r.l mbi disa asete të Linde Aktiengesellschaft dhe Praxair Inc nëpërmjet MG Industries GmbH”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 08.10.2018, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit nga Messer Group GmbH dhe Yeti Investments S.a.r.l mbi disa asete të Linde Aktiengesellschaft dhe Praxair Inc nëpërmjet MG Industries GmbH

Baza ligjore: Ligji Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, nenet 2, 10-12, neni 24, gërma d, dhe nenet 53-64. Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe formulari i njoftimit të përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë, mbi njoftimin e përqendrimit mbi përfimin e kontrollit nga Messer Group GmbH dhe Yeti Investments S.a.r.l mbi disa asete të Linde Aktiengesellschaft dhe Praxair Inc nëpërmjet MG Industries GmbH.

VËREN SE:

I. Transaksioni dhe përqendrimi

Autoriteti i Konkurrencës është njoftuar në lidhje me transaksionin e ndodhur midis palëve MG Industries GmbH si blerësi dhe Linde Aktiengesellschaft dhe Praxair Inc si shitësit.

Marrëveshja është lidhur më 16 korrik 2018 dhe ka të bëjë me përfimin e kontrollit të përbashkët nga Messer Group GmbH dhe Yeti Investments S.a.r.l nëpërmjet MG Industries mbi disa asete të Linde Aktiengesellschaft dhe Praxair Inc.

Palët në transaksion janë:

Blerësi: MG Industries GmbH, një shoqëri private me përgjegjësi të kufizuar, e organizuar sipas ligjeve të Gjermanisë. MG Industries GmbH është krijuar si një shoqëri Joint Venture nga Messer Group GmbH dhe Yeti Investments S.a.r.l nëpërmjet kontrollit të përbashkët të ndërmarrjes.

Messer Group GmbH, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, gjermane, është një prodhues global dhe distributor i gazrave industrialë, farmaceutikë dhe të specializuar. Messer prodhon dhe furnizon oksigjen, nitrogen, argon, dioksid karboni, hidrogjen, helium, gazra për saldime inerte, gazra të specializuar, gazra për përdorim mjekësor dhe një variacion të madh miksime gazrash. Messer është prezent në tregun shqiptar nëpërmjet filialit të saj Messer Albagaz SHPK.

Shqipëri: *Messer Albagaz SHPK*, shoqëri shqiptare, me objekt të aktivitetet: prodhimi, shpërndarja dhe shitja e gazrave industrial, mjekësor dhe speciale si dhe të pajisjeve që lidhen me to, ofrimin e shërbimeve të inxhinierisë si dhe tregtimin e materialeve dhe ofrimin e shërbimeve që kanë të bëjnë me pajisjet e prerjes dhe saldimit dhe me teknologjinë e veshjes apo shkrijës si dhe kryerjen e transportit të mallrave për nevojat e veta dhe të të tretëve në Shqipëri dhe jashtë saj. Aksioner me XXX% të kuotave është Messer Tehnogas AD.

Yeti Investments S.a.r.l, është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me seli në Luksemburg, me objekt marrjen e interesave në një formë të çfarëdoshme në shoqëritë e Luksemburgut dhe të huaja, përfitimi me blerje, regjistrimi apo çdo mënyrë tjetër si dhe transferimi me shitje, këmbim apo tjetër, të aksioneve, bonove, obligacioneve etj.

Shitësit: *Linde Aktiengesellschaft* (Shitësi 1), shoqëri aksionare, shoqëri e organizuar sipas ligjeve të Republikës së Gjermanisë dhe *Praxair Inc* (Shitësi 2), korporatë e organizuar sipas ligjeve të DelaWare, SHBA.

Praxair: Furnizimi i gazrave industrialë, gazrave mjekësorë, gazrave të specializuar dhe shërbimeve të lidhura, gjithashtu dhe teknologjike e trajtimeve të sipërfaqeve

Linde: Prodhimi dhe shitja, furnizimi i garzave industrialë, gazrave mjekësorë, gazrave të specializuar dhe shërbimeve të lidhura, duke përfshirë inxhinierinë.

Transaksioni ka të bëjë vetëm me asetet dhe bizneset e Linde dhe Praxair të ndodhura në Amerikën e Veriut dhe të Jugut.

Linde dhe Praxair nuk ushtron aktivitet në tregun shqiptar.

II. Vlerësimi i përqendrimit

Transaksioni i propozuar është përfitimi i kontrollit të përbashkët nga Messer dhe Yeti mbi asetet e targetit nëpërmjet shoqërisë MG Industries.

Transaksioni i synuar nuk do të sjellë asnjë ndryshim në tregun shqiptar të gazeve industriale dhe si rrjedhojë nuk kemi mbivendosje të aktivitetit të palëve në tregun përkatës të produktit në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Struktura e tregut të gazeve industrialë në vendin tonë do të mbetet e njëjtë si para transaksionit. Pjesët e tregut të Messer Albagaz SHPK pas realizimit të përqendrimit nuk do pësojnë asnjë ndryshim.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit nga Messer Group GmbH dhe Yeti Investments S.a.r.l mbi disa asete të Linde Aktiengesellschaft dhe Praxair Inc nëpërmjet MG Industries GmbH
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 555, Datë 08.10.2018

“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit nga INA INDUSTRIJA NAFTE d.d. dhe PRVO PLINARSKO DRUSTVO d.o.o mbi PETROKEMIJA d.d”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 08.10.2018, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit nga Ina Industria Nafte d.d. dhe Prvo Plinarsko Drustvo d.o.o mbi Petrokemija d.d

Baza ligjore: Ligji Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, nenet 2, 10-12, neni 24, gërma d, dhe nenet 53-64. Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe formulari i njoftimit të përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë, mbi njoftimin e përqendrimit mbi përfimin e kontrollit nga Ina Industria Nafte d.d. dhe Prvo Plinarsko Drustvo d.o.o mbi Petrokemija d.d,

VËREN SE:

I. Transaksioni dhe përqendrimi

Autoriteti i Konkurrencës është njoftuar në lidhje me transaksionin e ndodhur midis palëve Ina Industria Nafte d.d. dhe Prvo Plinarsko Drustvo d.o.o lidhur me krijimin e një ndërmarrjeje të përbashkët Joint Venture (JV) e zotëruar në masën XX% nga secila prej tyre, e cila synon të marrë kontrollin mbi shoqërinë PETROKEMIJA.

Palët në transaksion janë:

Blerësi 1: INA-Industrije Nafte d.d është një shoqëri kroate, me objekt të aktivitetit nxjerrja e naftës bruto dhe e gazit natyror, aktivitetet e shërbimit të lidhura me nxjerrjen e naftës dhe gazit, aktivitetet e lidhura me eksplorimin, zhvillimin e vendndodhjeve të zbuluara të naftës dhe gazit, ndërtimi i sistemeve të prodhimit dhe transportit të naftës dhe gazit, duke përfshirë shërbimet e tubacioneve të transportimit, prokurimi i gazit natyror, transportimi i gazit natyror, tregtia e gazit, depozitimi i gazit, etj.

INA është pjesë e grupit MOL Hungarian Oil dhe Gas Plc e cila është një shoqëri aksionare regjistruar dhe seli në Budapestit. INA dhe MOL janë prezentë në Shqipëri nëpërmjet shoqërive të grupit CROSCO dhe Slovnaft.

Blerësi 2: Prvo plinarsko drustvo d.o.o (PPD) është një shoqëri kroate, që kryen aktivitet në fushat e importit, shitjes, furnizimit dhe shpërndarjes së gazit natyror, burimet e energjisë së rinovueshme, tregtia e produkteve të naftës, teknologjinë e informacionit dhe inovacionit për projektet e investimit dhe transportit, etj.

Shoqëria target: **PETROKEMIJA d.d** është një shoqëri kroate, që prodhon fertilizues mineralë duke përdorur lëndë të parë natyrale minerale, gaz natyror, nitrogen dhe oksigjen atmosferik. Ajo prodhon dhe shet këto fertilizues minerarë në pjesën më të madhe në Kroaci.

Petrokemija para transaksionit, kontrollohet dhe zotërohet në masën XXX % të aksioneve nga Qeveria e Kroacisë.

Petrokemija nuk ka asnjë filial ose degë në Shqipëri.

Ndërmarrja JV: **Terra Mineralna Gnojiva d.o.o**, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, shoqëri për këshillim dhe administrim. Shoqëria e ka selinë në Zagreb dhe themelohet për një kohë të caktuar. Objekti i kësaj shoqërie është blerja dhe shitja e mallit, përfaqësimi i firmave të huaja, kryerja e ndërmjetësimit në tregun vendas dhe të huaj, këshillim në lidhje me biznesin dhe administrimin, etj.

Transaksioni i propozuar përbën një ndryshim të qëndrueshëm të kontrollit të shoqërisë Petrokemija nga shoqëria JV Terra Mineralna Gnojiva d.o.o., e kontrolluar bashkërisht nga INA dhe PPD me XX% të kapitalit secila. INA dhe PPD do të fitojnë kontroll të përbashkët mbi Target-in.

Croscos dhe Slovnaft operojnë në tregje të ndryshme nga ai i shoqërisë target, Petrokemija, duke mos krijuar asnjë mbivendosje mes tyre. Croscos është një shoqëri e specializuar në shërbimet për shpimet e puseve të naftës në tokë dhe det dhe Petrokemija furnitor për produktet e fertilizuesve.

Transaksioni zhvillohet jashtë tregut shqiptar dhe nuk sjell asnjë efekt të drejtpërdrejtë në tregun vendas.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit nga INA INDUSTRIJA NAFTE d.d. dhe PRVO PLINARSKO DRUSTVO d.o.o mbi PETROKEMIJA d.d
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 556, Datë 08.10.2018

“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërive First Data Slovakia S.R.O dhe First Data Hellas Processing Services and Holdings S.A. nga shoqëria SIA S.p.A.”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 08.10.2018, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërive First Data Slovakia S.R.O dhe First Data Hellas Processing Services and Holdings S.A. nga shoqëria SIA S.p.A.

Baza ligjore: Ligji Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, nenet 2, 10-12, neni 24, gërma d, dhe nenet 53-64. Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe formulari i njoftimit të përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë, mbi njoftimin e përqendrimit mbi përfutimin e kontrollit nga Ina Industrija Naftë d.d. dhe Prvo Plinarsko Drustvo d.o.o mbi Petrokemija d.d,

VËREN SE:

I. Procedura dhe Transaksioni

Autoriteti i Konkurrencës është njoftuar në lidhje me Marrëveshjen për shitjen dhe blerjen e të gjitha interesave të pjesëmarrjes së FD Slovakia dhe të gjithë kapitalit aksionar të emetuar nga FD Hellas. Marrëveshja lidhet midis First Data Holding Hollandë në cilësinë e zotëruesit dhe shitësit të interesave të FD Slovakia dhe First Data Operation Austri në cilësinë e zotëruesit dhe shitësit të aksioneve të shoqërisë FD Greqi. Marrëveshja është lidhur më datë 24 maj 2018.

Blerësi: **SIA S.p.A.**, një shoqëri aksionare e themeluar në datë 19.02.1996 dhe ekzistuese sipas ligjeve të Italisë, me nr regjistrimi 10596540152, me seli në adresën Via Francesco Gonin 36/38, 20147 Milano, Itali. SIA ka objekt të veprimtarisë së saj studim, projektim, realizim dhe menaxhim të infrastrukturës telematike, sistemeve të informacionit, sistemet e të dhënave bankare të dhënies së kredive dhe financimeve për zbatimin e transaksioneve nëpërmjet bankave dhe qarkullimin e informacioneve të interesit të përbashkët si brenda sistemit të kredidhënies ashtu edhe jashtë saj. Instrumentet informatike dhe telematike në tregun financiar, sistemet dhe shërbimet e pagesave elektronike, ndërtimin dhe mbështetjen e shërbimeve me karakter institucional apo në favor të palëve të treta.

Referuar faqes zyrtare të SIA S.p.A.²³ konstatohet se shoqëria SIA S.p.A. zotërohet nga FSIA Investment S.r.l me XX% të aksioneve; F2i Fondi Italiani për le Infrastrutture me XX%, HAT orizonte sgr me XX% dhe

²³ <https://www.sia.eu/en/sia-group/shareholders>

shoqëritë Banko BPM. Intesa SanPaolo, UnCredit, Mediolanum, Deutsch Bank me më pak se XX% të kuotave.

Shitësi 1: FIRST DATA HOLDING I (NETHERLANDS) BV, shoqëri e organizuar dhe ekzistuese sipas ligjeve të shtetit të Holandës, i regjistruar ne Dhomën e Tregtisë me numër 34205739 dhe seli në adresën Naritaweg 165, 1043 BW Amsterdam.

Shitësi 2: FIRST DATA OPERATION (AUSTRI), shoqëri e organizuar dhe ekzistuese sipas ligjeve të shtetit të Austrisë, i regjistruar me numër FN 258383 dhe seli në adresën 1220, Kulla e Saturnit. Leonard-Bernstein-Straße, Vjenë.

Garantuesi: FIRST DATA CORPORATION, një shoqëri e themeluar në mënyrë të rregullt dhe ekzistuese sipas ligjeve të Shtetit të Delaware, me nr regjistrimi 2192851, me seli kryesore 5565 Glenridge Connector NE, SHBA.

Shoqëria target 1: FIRST DATA SLOVAKIA s.r.o. (FD Slovakia), shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas ligjeve të shtetit të Sllovakisë në datë 19.05.1994 me numër regjistrimi 58030/B dhe seli ne Digital Park II 25, Bratislave. Objekt i veprimtarisë së shoqërisë është përpunimi i të dhënave të automatizuara, ofrimi i software-ve, zbatimi dhe përditësimi i programeve në fushën e biznesit etj. Referuar ekstraktit të shoqërisë, First Data Holding I (Holandë) është zotëruese e XX% e kapitalit të shoqërisë.

Shoqëria target 1: FIRST DATA HELLAS S.A. (FD Greqi), shoqëri anonime, e regjistruar në Regjistrin Tregtar të Greqisë në datë 29.10.2012 me numër 1410644. Sipas dokumentacionit të deklaruar nga pala njoftuese, shoqëria zotërohet nga FIRST DATA OPERATION (AUSTRI).

Transaksioni plotëson kriteret e përcaktuara në nenet 10 dhe 12 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar duke përbërë objekt shqyrtimi dhe vlerësimi nga Autoriteti i Konkurrencës.

II. Vlerësimi i përqendrimit

Referuar nenit 3, pika 7, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, Udhëzimit Nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës” u konsiderua se tregu përkatës i produktit do të mund të konsiderohet tregu i përpunimit të pagesave me kartë, i përpunimit të ATM dhe i ofrimit të terminaleve POS dhe shërbimet e lidhura me to dhe tregu përkatës gjeografik do të jetë territori i Republikës së Shqipërisë.

Duke qenë se transaksioni nuk pritet të ketë asnjë ndryshim në tregun shqiptar, përcaktimi i saktë i tregut përkatës të produktit mund të lihet i hapur.

Transaksioni i propozuar është përfthimi i kontrollit të shoqërive First Data Slovakia S.R.O dhe First Data Hellas Processing Services and Holdings S.A. nga shoqëria SIA S.p.A.

Transaksioni i synuar nuk do të sjellë asnjë ndryshim në tregun shqiptar të përpunimit të pagesave me kartë, të përpunimit të ATM dhe të ofrimit të terminaleve POS dhe shërbimet e lidhura me to.

Si konkluzion ky përqendrim nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërive First Data Slovakia S.R.O dhe First Data Hellas Processing Services and Holdings S.A. nga shoqëria SIA S.p.A.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 559, Datë 15.10.2018

“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të përbashkët mbi një ndërmarrjeje të re nga Dr.Ing.h.c.F.Porsche Aktiengesellschaft dhe Schuler Aktiengesellschaft”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 15.10.2018, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të përbashkët mbi një ndërmarrjeje të re të krijuar nga Dr.Ing.h.c.F.Porsche Aktiengesellschaft dhe Schuler Aktiengesellschaft.

Baza ligjore: Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64. Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe formulari i njoftimit të përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të përbashkët mbi një ndërmarrjeje të re të krijuar nga Porsche AG dhe Schuler AG,

VËREN SE:

I. Transaksioni dhe përqendrimi

Autoriteti i Konkurrencës është njoftuar në lidhje me transaksionin e ndodhur midis palëve Porsche AG dhe Schuler AG lidhur me krijimin e një ndërmarrjeje të re Joint Venture (JV) e zotëruar në masën XX% nga secila prej tyre dhe ku këto dy shoqëri do të kenë kontroll të përbashkët.

Palët në transaksion janë:

Pala 1: Dr.Ing.h.c.F.Porsche Aktiengesellschaft, shoqëri e themeluar në përputhje me ligjet dhe rregullat e shtetit gjerman. Shoqëria prodhon dhe merret me shitjen e automjeteve dhe motorëve të të gjitha llojeve dhe të pjesëve përbërëse dhe shërbime të tjera teknike; merret me ndërtimin e zhvillimin në fushën e ndërtimit të automjeteve dhe motorëve; merret me zhvillimin e përpunimit të të dhënave e prodhimin dhe shpërndarjen e produkteve të përpunimit të të dhënave, etj. Porsche është pjesë e grupit Volkswagen, një shoqëri me ofertë publike, me seli në Gjermani.

Në Shqipëri shoqëria është prezent përmes tre filialeve: Porsche Albania SHPK; Porsche Leasing SHPK dhe Porsche Mobility SHPK.

Pala 2: Schuler Aktiengesellschaft, është një shoqëri aksionare e themeluar në përputhje me ligjet dhe rregullat e shtetit gjerman, aktiv në fushën e krijimit dhe prodhimit të makinave shtypëse te metaleve, proceseve të automatizuara, veglave, përpunimit të mënyrës se si realizohet një proces dhe shërbimeve për

gjithë industrinë e përpunimit të metaleve si dhe atë të ndërtimit të automjeteve të lehta. Schuler i përket grupit austriak Andritz.

Shoqëria Schuler ofron në Shqipëri shërbime që lidhen me instalimin, ndërtimin, mbikëqyrjen dhe komisionimin e pajisjeve mekanike për hidrocentrale përmes degës shqiptare të ADRITZ HYDRO GmbH për klientë KESH dhe Energji Ashta.

Transaksioni i propozuar është përftimi i kontrollit të shoqërive Porsche dhe Schuler mbi një shoqëria të re, Joint-Venture, të sapokrijuar, me funksione të plota dhe palët në transaksion plotësojnë kufirin e xhiros së realizuar në tregun shqiptar dhe atë ndërkombëtar. Për këto arsye transaksioni behet objekt vlerësimi sipas nenit 10 dhe 12 të Ligjit nr. 9121 datë 28.07.2008 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”.

Shoqëria e re, Joint Venture, nuk do të operojë në Shqipëri.

Megjithëse Porsche AG dhe Schuler AG operojnë në Shqipëri nëpërmjet degëve të tyre në tregje të ndryshme, përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar, kështu që në lidhje me tregun shqiptar nuk identifikohen tregje të prekura. Transaksioni i synuar nuk do të sjellë asnjë ndryshim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të përbashkët mbi një ndërmarrjeje të re nga Dr.Ing.h.c.F.Porsche Aktiengesellschaft dhe Schuler Aktiengesellschaft;
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 563, Datë 25.10.2018

“Mbi miratimin e Rregullores “Për Organizimin dhe Funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës””

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 25.10.2018, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Miratimi i Rregullores “Për Organizimin dhe Funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës”

Baza ligjore: Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, neni 24, germa c, neni 84, germa a; Vendimit Nr. 43, datë 13.04.2017 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë “Për Miratimin e Strukturës dhe Organikës së Autoritetit të Konkurrencës”; Vendimit Nr.58, datë 05.04.2018 “Për një shtesë në Strukturën dhe Organikën e Autoritetit të Konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe Projekt-Rregullores “Për Organizimin dhe Funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës”,

VËREN SE:

Me vendimin Nr. 43/2017 “Për miratimin e Strukturës dhe Organikës së Autoritetit të Konkurrencës” dhe Vendimin Nr. 58/2018 “Për një shtesë në Strukturën dhe Organikën e Autoritetit të Konkurrencës”, Kuvendi ka miratuar strukturën e re të Autoritetit të Konkurrencës.

Kjo strukturë synon të operojë në mënyrë më eficiente, duke krijuar hapësira për me shumë fleksibilitet në procesin e monitorimit, inspektimit, hetimit dhe vendimmarrjes.

Rregullorja parashikon qartë rregullat e brendshme të funksionimit të Autoritetit të Konkurrencës, përcaktimin e kompetencave mes strukturës vendimmarrëse, Komisionit të Konkurrencës dhe strukturës ekzekutive dhe teknike, Sekretarit të Konkurrencës.

Autoriteti i Konkurrencës me miratimin e strukturës së re horizontale, ushtron funksionet e tij në zbatim të Ligjit 9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, duke pasur në përbërje të tij 6 drejtori teknike, duke përcaktuar qartë objektin e veprimtarisë së tyre.

Funksionimi i Autoritetit të Konkurrencës nëpërmjet kësaj strukture të re, e ka sjellë institucionin më afër me natyrën dhe dinamikën që paraqet sot tregu në Shqipëri, në përputhje edhe me kërkesat dhe nevojat e konsumatorit, në funksion të rritjes së mirëqenies së tij.

Funksionet kryesore të parashikuara në Ligjin 9121/2003 dhe konkretisht: Marrëveshjet e ndaluara, Abuzimi me Pozitën Dominuese në treg, Përqendrimi i Ndërmarrjeve, do të kryhet nga këto drejtori duke marrë për bazë si natyrën e tregjeve në funksion të rolit që ato kanë sot në fushën e prodhimit dhe shërbimit, por edhe duke u përshtatur dhe modeluar sipas një standardi të zbatuar pothuajse nga të gjitha Autoritetet e Konkurrencës si në Evropë edhe në rajon, ku tregjet ndahen sipas fushave përkatëse të veprimtarisë së tyre.

Rregullorja në tërësi, parashikon përmbushjen e detyrimeve ligjore për mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg.

Si përfundim:

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja c të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të miratojë Rregulloren “Për Organizimin dhe Funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Rregullorja “Për Funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës”, e ndryshuar, miratuar me Vendimin Nr. 58, datë 15.10.2007 të Komisionit të Konkurrencës shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 565, Datë 29.10.2018

“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të GORENJE GOSPODINJSKI APARATI D.D. nga HISENSE GROUP CO. LTD”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 29.10.2018, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të GORENJE GOSPODINJSKI APARATI D.D. nga HISENSE GROUP CO., LTD.

Baza ligjore: Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64. Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe formulari i njoftimit të përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë, mbi njoftimin e përqendrimit në lidhje me përfutimin e kontrollit të GORENJE GOSPODINJSKI APARATI D.D. nga HISENSE GROUP CO., LTD,

VËREN SE:

I. Transaksioni dhe përqendrimi

Pala njoftuese, Hisense Group Co. Ltd, ka informuar Autoritetin e Konkurrencës lidhur me një transaksion që synon përfutimin e kontrollit të Gorenje Gospodinjski Aparati D.D. nga Hisense Group Co., Ltd. Përqendrimi i propozuar është realizuar nëpërmjet një tenderi me ofertë publike.

Palët në transaksion janë:

Blerësi: Hisense Group Co., Ltd, shoqëri e themeluar në Republikën Popullore të Kinës. Hisense është prodhuesi dhe furnizuesi kryesor i pajisjeve elektronike dhe teknologjisë së informacionit në Kinë me katër segmente kryesore biznesi: pajisjet shtëpiake, multimedia, sistemet inteligjente informatike IT dhe zhvillimin e pronës. Hisense është kryesisht aktiv në Kinë dhe në rajonin e Azisë/paqësorit.

Hisense nuk ka degë apo përfaqësi të sajën në Shqipëri, por realizon të ardhura nëpërmjet furnizimit me pajisje të mëdha elektroshtëpiake (të quajtura mallra të bardha) si: frigoriferë, ngrirës dhe lavatrice nëpërmjet shoqërisë Merja-Outlet SHPK

Shitësi: Gorenje Gospodinjski Aparati d.d. një shoqëri aksionare e organizuar sipas ligjeve të Sllovenisë. Gorenje është shoqëria mëmë e Gorenje Group që është aktive në prodhimin, shitjen dhe servisimin e pajisjeve elektrike dhe jo-elektrike shtëpiake dhe elektro-termike, frigoriferë, grirësit dhe sistemet e ftohjes, lavatrice, tharëse dhe lavastovilje, sobat elektrike dhe gaz, furrat dhe sobat e kombinuara, etj. Gorenje është aktive në më shumë se XX vende në të gjithë botën.

Në Shqipëri Gorenje është prezent përmes degës së saj Gorenje Albania SHPK.

II. Vlerësimi i përqendrimit

Transaksioni i propozuar është përfitim i kontrollit të shoqërisë Gorenje Gospodinjski Aparati d.d. nga shoqëria Hisense Group Co., Ltd.

Në Shqipëri, si Hisense edhe Gorenje janë aktive në tregun e furnizimit me pajisje të mëdha elektroshtëpiake tek shitësit me pakicë duke përdorur markën e tyre tregtare.

Gorenje është gjithashtu aktive në treg për furnizimin me pajisje të vogla shtëpiake, dhe për produktet për ngrohje, ventilim dhe ajrin e kondicionuar .

Referuar nenit 3, pika 7, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, si edhe Udhëzimit Nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës u konsiderua tregu i importit dhe shitjes me pakicë i pajisjeve shtëpiake në Shqipëri.

Gorenja Albania SHPK zotëron XXX % të tregut përkatës të produktit kurse Merja–Outlet SHPK vetëm XXX % të tij.

Pas përqendrimit pritet që pjesa e tregut e shoqërisë Gorenja Albania të jetë XXX % me një delta HHI më pak se XXX.

Mbi bazën e këtyre treguesve konkludojmë se transaksioni i synuar do të ketë një ndikim të pandjeshëm në strukturën e tregut të importit dhe shitjes me pakicë të pajisjeve shtëpiake dhe nuk do të ndikojë konkurrencën në treg.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të GORENJE GOSPODINJSKI APARATI D.D. nga HISENSE GROUP CO., LTD
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 566, Datë 07.11.2018

“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të përbashkët nga Daimler FS dhe nga Volkswagen FS mbi Mobility Trader Holding GmbH.”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 07.11.2018, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të përbashkët nga Daimler FS dhe nga Volkswagen FS mbi Mobility Trader Holding GmbH.

Baza ligjore: Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, nenet 2, 10-12, neni 24, gërma d, dhe nenet 53-64. Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe formulari i njoftimit të përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë, mbi njoftimin e përqendrimit mbi përfitimin e kontrollit të përbashkët nga Daimler FS dhe nga Volkswagen FS mbi Mobility Trader Holding GmbH.;

VËREN SE:

1. Transaksioni dhe përqendrimi

Autoriteti i Konkurrencës është njoftuar në lidhje me një transaksion që synon marrjen e kontrollit të përbashkët nga ana e Daimler FS dhe nga Volkswagen FS mbi Mobility Trader Holding GmbH.

Palët në transaksion janë:

Blerësi: Leonie FS DVB GmbH (Daimler FS) me seli në Gjermani, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me objekt veprimtarie mbajtjen dhe menaxhimin e aseteve dhe investimeve. Kjo shoqëri është degë e Daimler Grup e cila prodhon dhe shpërndan makina të pasagjerëve dhe automjeteve tregtare. Gjithashtu shoqëria ofron shërbime financiare, duke përfshirë financimin, leasing-un, sigurimin dhe shërbimet e menaxhimit të flotës së automjeteve.

Grupi Daimler është i pranishëm në Shqipëri në tregun e shitjes së automjeteve, por nuk operon një platformë on-line për shitjen e automjeteve të përdorura të cilësisë së lartë në Shqipëri apo fokusuar në Shqipëri.

Shitësi: Volkswagen Financial Services Aktiengesellschaft (Volkswagen FS), shoqëri aksionere, pjesë e Volkswagen Grup, i cili është aktiv në zhvillimin, prodhimin, shitjen dhe shpërndarjen e mjeteve motorike duke përfshirë pjesë këmbimi dhe aksesore, motorë dizel dhe motoçikleta.

Grupi Volkswagen është aktiv në Shqipëri nëpërmjet pjesëve kryesore të biznesit të tij, shitjen dhe shpërndarjen e automjeteve motorike, duke përfshirë pjesë këmbimi dhe aksesore të tjerë, motorët më naftë dhe motoçikleta.

Targeti: **Mobility Trader Holding GmbH (MT Holding)** është një shoqëri gjermane me përgjegjësi të kufizuar, me objekt të aktivitetit menaxhimin e pasurive të veta, në veçanti ngritja e filialeve për të operuar një ose më shumë portale të internetit për shitjen e makinave të përdorura dhe ndërtimin dhe funksionimin e rrjeteve të të dhënave për të kombinuar ofertën dhe kërkesën në tregun e përdorur të automjeteve.

Mobility Trader GmbH (MT GmbH) i ofron konsumatorëve në Gjermani një platformë on-line të shitjes së automjeteve të përdorura, të cilësisë së lartë, që quhet “heycar” (www.hey.car).

Shoqëria Target Mobility Trader Holding GmbH nuk operon në Shqipëri.

Transaksioni i propozuar është përfitim i kontrollit të përbashkët nga Daimler FS dhe nga Volkswagen FS mbi shoqërinë Mobility Trader Holding GmbH.

Megjithëse Grupi Volkswagen dhe Grupi Daimler operojnë në Shqipëri nëpërmjet degëve ose përfaqësive të tyre, përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar, pasi transaksioni ndodh në tregun e shitjes online të automjeteve të përdorura vetëm në territorin e Gjermanisë. Në tregun shqiptar nuk identifikohen tregje të prekura.

Transaksioni i synuar nuk do të sjellë asnjë ndryshim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të përbashkët nga Daimler FS dhe nga Volkswagen FS mbi Mobility Trader Holding GmbH;
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 570, Datë 22.11.2018

“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të Danske Commodities A/S nga Equinor Refining Norway AS”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 22.11.2018, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të Danske Commodities A/S nga Equinor Refining Norway AS.

Baza ligjore: Ligji Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, nenet 2, 10-12, neni 24, gërma d, dhe nenet 53-64. Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të Danske Commodities A/S nga Equinor Refining Norway AS;

VËREN SE:

Transaksioni dhe përqendrimi

Autoriteti i Konkurrencës është njoftuar në lidhje me një transaksion që synon përfimin e kontrollit të Danske Commodities A/S nga Equinor Refining Norway AS.

Pala blerëse: Equinor Refining Norway AS, është një shoqëri e themeluar dhe regjistruar sipas legjislacionit norvegjez. Equinor zotërohet tërësisht nga Equinor Group e cila kontrollohet nga Equinor ASA, shoqëria mëmë finale e Equinor Group. Equinor ASA kontrollohet nga Qeveria Norvegjeze nëpërmjet Ministrisë Norvegjeze të Naftës dhe Energjisë.

Equinor Group është aktiv në sektorët: (i) eksplorimi i naftës bruto dhe gazit natyror; (ii) zhvillimi dhe prodhimi i naftës bruto dhe gazit natyror; (iii) marketing dhe përpunimi i naftës bruto dhe gazit natyror; dhe (iv) energjia e rinovueshme, në veçanti energjia e erës.

Equinor Group nuk është i regjistruar, nuk është aktiv dhe nuk ka gjeneruar të ardhura në Shqipëri.

Pala shitëse: Lind Invest ApS; Danske Share ApS dhe Danske Share II ApS, janë shoqëri të themeluara dhe të regjistruara në bazë të ligjeve të Danimarkës. Këto shoqëri kontrollojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë shoqërinë **Danske Commodities A/S**.

Targeti: Danske Commodities A/S, një shoqëri e themeluar sipas legjislacionit danez. Shoqëria është e specializuar në tregtimin fizik dhe financiar të energjisë elektrike dhe gazit. Danske Commodities bashkon prodhuesit, furnizuesit dhe konsumatorët nëpër tregjet e liberalizura të Europës. Danske Commodities është

aktive në marrjen nga origjina dhe siguron balancimin, optimizmin, mbulimin, certifikatat dhe furnizimin me rezerva për gjeneratorët e energjisë , shoqëritë industruale, furnizuesit dhe operatorët neto.

Danske Commodities A/S operon në Shqipëri nëpërmjet degës së tij Danske Commodities Albania SHPK, me objekt të aktivitetit të saj tregtimin e energjisë elektrike fizike.

Danske Commodities Albania SHPK është aktive në tregtimin e energjisë elektrike fizike. Kjo shoqëri ka një licencë të Tregtimit të Energjisë Elektrike dhe një licencë të Furnizimit me Energji Elektrike. Danske Commodities Albania SHPK tregton vetëm energji elektrike me Danske Commodities A/S në kufijtë e Shqipërisë dhe me palë të tjera në tregun me shumicë në Shqipëri.

Transaksioni i njoftuar është përfitim i kontrollit të Danske Commodities A/S nga Equinor Refining Norway AS. Danske Commodities Albania SHPK nuk do të ndikohet nga transaksioni dhe do të ruajë të njëjtat pozita edhe pas tij.

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar, kështu që në lidhje me tregun shqiptar nuk identifikohen tregje të prekura. Për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë asnjë ndryshim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të Danske Commodities A/S nga Equinor Refining Norway AS.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 571, Datë 22.11.2018

“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet shitblerjes së aksioneve prej 88.89% tek Societe Generale Albania SHA nga Societe Generale tek OTP Bank Nyrt.”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 22.11.2018, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet shitblerjes së aksioneve prej 88.89% të Societe Generale Albania SHA nga Societe Generale tek OTP Bank Nyrt.

Baza ligjore: Ligji Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, nenet 2, 10-12, neni 24, gërma d, dhe nenet 53-64. Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe formulari i njoftimit të përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë, mbi njoftimin e përqendrimit në lidhje me shitjen e aksioneve përkatëse shoqërisë OTP Bank Nyrt nga Societe Generale.

VËREN SE:

I. Transaksioni dhe përqendrimi

Përfaqësuesi ligjor i palës njoftuese ka depozituar pranë Autoritetit të Konkurrencës dokumentacionin përkatës në lidhje me transaksionin nëpërmjet të cilit OTP Bank Nyrt kërkon të përftojë kontrollin e drejtpërdrejtë nëpërmjet blerjes së aksioneve të Banka Societe Generale Albania SHA. OTP Bank Nyrt synon të blejë 88.89 % të aksioneve me të drejtë vote të Societe Generale.

Palët në transaksion janë:

Blerësi: OTP Bank Nyrt është shoqëri aksionare hungareze. Aktivitetet e OTP janë ndërmjetësim monetar si dhe qira financiare, aktivitete të tjera të shërbimeve financiare, përveç fondit të sigurimeve dhe pensione; brokerimi i kontratave të letrave me vlerë; aktivitete të tjera ndihmëse të shërbimeve financiare, përveç fondit të sigurimeve dhe pensionit; aktiviteti i agjentëve dhe brokerave të sigurimit; aktiviteti i menaxhimit të fondeve; aktiviteti i kontabilitetit; llogari-mbajtjes dhe auditimit, konsulencës fiskale; qiradhënia dhe operimi i pasurive të paluajtshme në pronësi ose me qera.

Shqipëri: OTP nuk ka prezencë në Shqipëri. Asnjë nga aktivitetet e mësipërme nuk ushtrohen nga OTP në Shqipëri.

Shitësi: Societe Generale është shoqëri anonime franceze, një nga organizatat më të mëdha për ofrimin e shërbimeve financiare në Evropë. Aktivitetet e saj përfshijnë shërbime bankare për konsumatorët, kredi për shtëpi, kredi personale, depozita personale; shërbime bankare për korporatat dhe investime, kredi, depozita,

llogari bankare për entitete juridike; shërbime financiare; shërbime bankare private; menaxhimi i aseteve; shërbime me letrat me vlerë etj.

Shqipëri: Filiali i kësaj shoqërie në Shqipëri është Banka Societe Generale Albania SHA.

Shoqëria target: Banka Societe Generale Albania SHA, shoqëri aksionare e krijuar dhe që ekziston sipas legjislacionit në Shqipëri. Kjo shoqëri ushtron aktivitetin e saj në sektorin financiar dhe bankar në Shqipëri.

Aktiviteti i shoqërisë në Shqipëri ushtrohet nëpërmjet marrjes së depozitave monetare ose e fondeve të tjera të ripagueshme nga publiku dhe dhënia e kredive ose depozitimi për llogarinë e vet; huadhënia e të gjitha llojeve përfshirë ndër të tjera kredinë hipotekore dhe kredinë konsumatorë; qiraja konsumatorë; qiraja financiare; të gjitha pagesat dhe shërbimet e transferimit të parave; garanci dhe letër krediti etj.

II. Vlerësimi i përqendrimit

Transaksioni është përfitim kontrolli nëpërmjet shitblerjes së aksioneve prej 88.89% të Societe Generale Albania SHA nga Societe Generale tek OTP Bank Nyrt.

Palët në transaksion plotësojnë kriteret e përcaktuar në nenin 10, pika b) dhe nenin 12, pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar dhe si rrjedhojë ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

OTP Bank Nyrt, ka realizuar disa blerje në vendet e Evropës Lindore dhe Qendrore dhe aktualisht vepron në 8 vende të rajonit si Rumani, Bullgari, Kroaci, Serbi, Sllovaki, Ukrainë, Mal i zi dhe Rusi.

Sipas planit të biznesit të OTP, Shqipëria dhe tregje të ngjashme kanë një mjedis të favorshëm makroekonomik dhe nivel të lartë të investimeve direkte të huaja duke përfaqësuar një mundësi premtuese në tregun bankar. OTP beson se kjo blerje është e suksesshme dhe që do të përshtatet më së miri me strategjinë e zgjerimit të OTP duke i ofruar konsumatorit shqiptar shërbime më profesionale.

Referuar nenit 3, pika 7, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, si edhe Udhëzimit Nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës i produktit u konsiderua tregu i shërbimeve bankare dhe treg përkatës gjeografik konsiderua territori i Republikës së Shqipërisë.

Tregu i shërbimeve bankave ka qenë objekt vlerësimi dhe analize në këndvështrim të ligjit nr.9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar nëpërmjet procedurave të vlerësimit të përqendrimit dhe monitorimit.

Nga analiza e treguesve të përqendrimit konstatohet se tregu bankar në Shqipëri është një treg mesatarisht i përqendruar pa praninë e bankave me pozitë dominuese. Para përqendrimit, pjesët e tregut të Societe Generale Albania SHA sipas aseteve, depozitave dhe kredive luhaten nga XX %. Duke qenë se OTP Bank Nyrt nuk operon në Shqipëri, pas transaksionit nuk do të kemi ndryshim të strukturës së tregut pasi përqendrimi i realizuar nuk do të shkaktojë rritje të tregut përkatës të shoqërisë Target.

Pjesa e tregut të Societe Generale Albania SHA do të mbetet në nivelet XX % duke mos sjellë ndryshime të strukturës së tregut edhe pas përqendrimit.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit nëpërmjet shitblerjes së aksioneve prej 88.89% të Societe Generale Albania SHA nga Societe Generale tek OTP Bank Nyrt.

2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 576, Datë 11.12.2018

“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të Bankës Ndërkombëtare Tregtare SHA nga Union Bank SHA”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 11.12.2018, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të Bankës Ndërkombëtare Tregtare SHA nga Union Bank SHA.

Baza ligjore: Ligji Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, nenet 2, 10-12, neni 24, gërma d, dhe nenet 53-64. Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe formulari i njoftimit të përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të Bankës Ndërkombëtare Tregtare SHA nga Union Bank SHA,

VËREN SE:

I. Transaksioni dhe përqendrimi

Autoriteti i Konkurrencës është njoftuar në lidhje me transaksionin e blerjes së aksioneve të Bankës Ndërkombëtare Tregtare SHA nga Union Bank SHA.

Pala blerëse: *Union Bank SHA*, një institucion financiar e licencuar në 20.02.1997 për kryerjen e transfertave, kredidhënie dhe aktivitet depozitues si dhe aktivitete të tjera sipas Ligjit Nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, Ligjit Nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për Bankat në Republikën e Shqipërisë” si dhe në përputhje me rregulloret e aprovuara nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë.

Pala shitëse: *ICB Financial Group Holdings AG* është shoqëri e themeluar sipas legjislacionit zviceran, e cila ushtron aktivitetin e saj si shoqëri investimesh për disa shoqëri tregtare dhe shoqëri financiare që operojnë kryesisht në Afrikë, Azi dhe në Evropë, përkatësisht nëpërmjet Bankës Ndërkombëtare Tregtare në Shqipëri, International Commercial Bank LTD në Tanzani dhe International Commercial Bank LTD në Bangladesh.

Target: *Banka Ndërkombëtare Tregtare SHA* është një shoqëri shqiptare, e licencuar në 20.02.1997 për kryerjen e transfertave, kredidhënie dhe aktivitet depozitues si dhe aktivitete të tjera sipas Ligjit Nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, Ligjit Nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për Bankat në Republikën e Shqipërisë” si dhe në përputhje me rregulloret e aprovuara nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë.

II. Vlerësimi i përqendrimit

Transaksioni është një përfutim kontrolli i Bankës Ndërkombëtare Tregtare SHA nga Union Bank SHA.

Palët në transaksion plotësojnë kriteret e përcaktuar në nenin 10 dhe nenin 12 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar dhe si rrjedhojë ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Referuar nenit 3, pika 7, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, si edhe Udhëzimit Nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës i produktit u konsiderua tregu i shërbimeve bankare dhe treg përkatës gjeografik konsiderua territori i Republikës së Shqipërisë.

Tregu bankar në Shqipëri është një treg mesatarisht i përqendruar në terma të aseteve, depozitave dhe kredive.

Referuar Udhëzimit “Për vlerësimin e përqendrimeve horizontale”, pika 12, në ato përqendrimet ku indeksi HHI pas përqendrimit është midis 1000 dhe 2000 dhe delta HHI është nën 250, Autoriteti nuk identifikon probleme që lidhen me konkurrencën në nivel horizontal. Para përqendrimit, pjesët e tregut të Union Bank SHA sipas aseteve, depozitave dhe kredive luhaten nga XX-XX % ndërkohë që për Bankën Ndërkombëtare Tregtare SHA pjesa e tregut është më e vogël se XX%. Pas transaksionit pjesët e kombinuara të tregut të Union Bank SHA me Bankën Ndërkombëtare Tregtare SHA, sipas aseteve, depozitave dhe kredive do të luhaten nga XX%.

Nga vlerësimi i strukturave të tregjeve pas përqendrimit sipas produkteve kryesore, rezulton që ndryshimi i indeksit të përqendrimit do të variojë nga XX-XX.

Përqendrimi i realizuar nuk do të sjellë ndryshime të ndjeshme të strukturës së tregut përkatës dhe marrja e kontrollit nga Union Bank do të jetë mundësi klientëve të Bankës Ndërkombëtare Tregtare të përfitojnë nga shërbimet shtesë që do të ofrojë Union Bank SHA duke rritur cilësinë e shërbimit dhe mundësinë e shërbimeve/ produkteve të reja.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të Bankës Ndërkombëtare Tregtare SHA nga Union Bank SHA.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 579, Datë 20.12.2018

“Për fillimin e procedurës së thelluar në vlerësimin e transaksionit të ndodhur midis PIRAEUS BANK SA dhe BALFIN SHPK e KOMERCIJALNA BANKA AD SKOPJE”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 20.12.2018, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet shitblerjes së 98,83% të aksioneve të Tirana Bank SHA nga Piraeus Bank SA tek Balfin SHPK dhe Komercijalna Banka AD Skopje.

Baza ligjore: Ligji Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64. Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe formulari i njoftimit të përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet shitblerjes së 98,83% të aksioneve të Tirana Bank SHA nga Piraeus Bank SA tek Balfin SHPK dhe Komercijalna Banka AD SKOPJE,

VËREN SE:

I. Transaksioni dhe përqendrimi

Përfaqësuesi ligjor i palës blerëse ka njoftuar pranë Autoritetit të Konkurrencës transaksionin në lidhje me shitblerjen e 98.83% të kuotave të Tirana Bank, nga Piraeus Bank S.A te Balfin Shpk dhe Komercijalna Banka AD Skopje.

Palët në transaksion janë:

Blerësi 1: Balfin SHPK, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e regjistruar sipas legjislacionit shqiptar. Objekt i aktivitetit të kësaj shoqërie është investimi me pjesëmarrje në kuota, ofrimi i shërbimit të konsulencës në fushën e biznesit, menaxhimit, taksave, informatikës etj. Balfin është pjesë e Balfin Group, aktiv në tregun e pasurive të paluajtshme, shitjes me shumice dhe pakicë, menaxhimin e hapësirave tregtare apo industriale, shërbimeve, telekomunikacion, industrisë minerare, turizëm, agrikulturë, energji etj. Balfin operon në Shqipërisë dhe në Rajon.

Blerësi 2: Komercijalna Banka AD Shkup, Maqedoni. Komercijalna Banka është themeluar në 1955 dhe aktivitetet financiare të kësaj banke përfshijnë mbledhjen e depozitave dhe burimeve të tjera të fondeve të kthyeshme; kreditimin në vend, duke përfshirë faktorizimin dhe financimin e transaksioneve tregtare; lëshimin dhe administrimin e mjeteve paguese; lëshimin e parave elektronike; leasing financiar; operacionet e shkëmbimit; operacionet e pagesave në vend dhe jashtë vendit, duke përfshirë edhe blerjen e valutës;

transferimin e shpejtë të parave; lëshimin e garancive të pagesave, letrave me vlerë dhe formave të tjera të kolateralit etj.

Shitësi: Piraeus Bank SA, shoqëri aksionare, me titull dallues “Piraeus Bank”, Athinë, Greqi. Piraeus Bank S.A është pjesë e Piraeus Bank Grup, i cili ofron një gamë të gjerë produktesh dhe shërbimesh financiare tek një numër i madh klientësh në Greqi. Piraeus Bank është themeluar në 1916 dhe ka pasur një rritje të menjëhershme në madhësi dhe aktivitete, duke përfaqësuar bankën lider në Greqi e cila zë XX% të tregut bankar përsa i përket depozitave dhe kredive.

Objekti i aktivitetit janë të gjitha aktivitetet bankare të ligjshme ose të vlefshme ligjërisht, përfshirë pranimin e depozitave ose fondeve të tjera të kthyeshme, dhënien e kredive ose financimeve të tjera; qiranë financiare; pagesat përfshirë edhe shërbimet e transfertave monetare; lëshimin dhe administrimin e instrumenteve të pagesave etj.

Shqipëri: Filiali i kësaj shoqërie në Shqipëri është Banka e Tiranës SHA.

Shoqëria target: Tirana Bank SHA është një institucion financiar bankar i nivelit të dytë, e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit Objekti i aktivitetit të kësaj banke përfshijnë veprimtaritë bankare lidhur me pranimin e depozitave monetare ose të fondeve të tjera të ri pagueshme nga publiku që do të përdoren për dhënie kredie e vendosje në emër dhe për llogari të vet; emetimin e mjeteve të pagesës në formën e parasë elektronike. Tirana Bank SHA zotërohet nga Piraeus Bank S.A me 496,098 aksione që përfaqësojnë rreth 98.829 % të kapitalit të emetuar të Tirana Bank, kurse Z.Ioannis Tzivelis zotëron 1.171% të kapitalit të Tirana Bank.

Marrëveshja e shitblerjes së aksioneve është nënshkruar më 3 Gusht 2018 dhe njoftimi pranë Autoritetit të Konkurrencës është bërë më 29 Gusht 2018, duke respektuar afatin 30 ditor që përcakton ligji.

Piraeus Bank SA, bazuar në udhëzimet e Fondit të Stabilitetit Financiar Helen dhe politikat e brendshme të bankës, duhet të tërhiqte investimet e kryera në vende të tjera përveç Greqisë. Për këtë arsye në prill 2018 shoqëria hapi tender për shitjen e aksioneve që Piraeus Bank S.A zotëronte të Tirana Bank SHA, Shqipëri. Pas procedurës, Piraeus Bank S.A përzgjodhi si blerës të kuotave në shitje dy shoqëritë Balfin SHPK, shoqëri shqiptare, dhe Komercijalna Banka Ad Skopje, shoqëri maqedonase.

II. Vlerësimi i përqendrimit

Transaksioni është një përftim kontrolli i Tirana Bank Sha nga Balfin SHPK dhe Komercijalna Banka AD Skopje.

Palët në transaksion plotësojnë kriteret e përcaktuar në nenin 10, pika b) dhe nenin 12, pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar dhe si rrjedhojë ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Referuar nenit 3, pika 7, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, si edhe Udhëzimit Nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës i produktit u konsiderua tregu i shërbimeve bankare dhe treg përkatës gjeografik u konsiderua territori i Republikës së Shqipërisë.

Tregu i shërbimeve bankare ka qenë objekt vlerësimi dhe analize në këndvështrim të ligjit nr.9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar nëpërmjet procedurave të vlerësimit të përqendrimit dhe hetimit.

Nga analiza e treguesve të përqendrimit konstatohet se tregu bankar në Shqipëri është një treg mesatarisht i përqendruar pa praninë e bankave me pozitë dominuese.

Para përqendrimit, pjesët e tregut të Tirana Bank SHA sipas aseteve, depozitave dhe kredive janë në vlerën XX% .

Duke qenë se Balfin SHPK nuk operon në tregun e shërbimeve bankare apo në tregje të lidhura me tregun bankar dhe Komercijalna Bank AD nuk operon dhe nuk gjeneron të ardhura në Republikën e Shqipërisë, pas transaksionit, në situatën aktuale nuk rezulton të kemi ndryshim të strukturës së tregut.

Duke qenë se transaksioni është një përqendrim konglomerat, pjesa e tregut të Tirana Bank SHA do të mbetet në nivelin XX% dhe shoqëria Balfin SHPK do të jetë aksionari kryesor i Tirana Bank SHA.

Nga analiza e të dhënave të depozituara konstatohet se shoqëria Balfin SHPK, nëpërmjet paketave kontrolluese, zotëron XX% të tregut të shitjes së pajisjeve elektronike, XX% të tregut të administrimit dhe dhënies me qera të hapësirave tregtare, XX% të tregut të shitjes më pakice të artikujve ushqimore, XX% të tregut të nxjerrjes dhe përpunimit të mineralit të kromit dhe XX% të mineralit të ferrokromit, XX% të tregut të shitjeve online të produkteve jo ushqimore, XX% në tregun e sigurimit të jetës dhe në shumë tregje të tjera më pjesë më të vogël tregu.

Nga vlerësimi ex-ante i transaksionit të blerjes së aksioneve, pritet që pas një kohe të shkurtër, Tirana Bank SHA mund të rrisë pjesën e tregut të shërbimeve pasi të gjitha shoqëritë tregtare të kontrolluara nga Balfin SHPK do ti orientojnë transaksionet dhe do të marrin shërbime nga Tirana Bank SHA. Kjo situatë mund të sjellë:

- ndikimin e veprimtarisë së Tirana Bank SHA nga veprimtaria ekonomike e shoqërive të kontrolluara nga Balfin SHPK,
- mundësia e një sjellje diskriminuese të Tiranë Bank SHA për klientët e tjerë kredi marrës të cilët mund të operojnë në tregje të njëjta më shoqëritë e kontrolluara nga Balfin SHPK.

Më qëllim vlerësimin e impaktit që mund të ketë sjellja e shoqërisë Balfin SHPK në tregun bankar, shoqëritë më të mëdha të kontrolluara nga Balfin SHPK të cilat zotërojnë pozitë dominuese në tregjet përkatëse ose që mund të kenë një aktivitet ekonomik të lidhur apo të influencuar nga sistemi bankat, do të vlerësohen në mënyrë më të plotë dhe do të trajtohen si aktivitete të lidhura me sistemin bankar pavarësisht objektit të veprimtarisë së tyre.

Vlerësimi do të përfshijë analizën e performancës ekonomike dhe financiare të shoqërive, nivelin e detyrime financiare të shoqërive të kontrolluara nga shoqëria Balfin SHPK dhe analiza do të shtrihet edhe në shoqëritë e kontrolluar kjo shoqëri, por që veprojnë jashtë territorit të Shqipërisë.

Pavarësisht pjesës së vogël të tregut që Tirana Bank SHA zotëron në tregun e kredisë, marrëdhënia mes bankës dhe klientit gjatë kohëzgjatjes së një kredie, i jep mundësi bankës të ketë pozitë monopolistike për shkak të kostove financiare dhe procedurale të ndryshimit të ofruesit të shërbimit (bankës). Në këto kushte, fuqia e bankës për të vendosur kushte mbi këtë marrëdhënie është e fortë dhe klientët mund të gjenden në kushte jo të favorshme. Tirana Bank SHA nuk duhet të abuzojë në lidhje me nevojat e bizneseve apo korporatave për kredimarrje.

Në kuptim të nenit 9 të Ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “ Ndalohet çdo abuzim me pozitën dominuese nga një ose më shumë ndërmarrje, nëpërmjet i) zbatimit të kushteve të pabarabarta për veprime tregtare të njëjta me palët, duke i vendosur ato në gjendje të pafavorshme konkurrence; ii) vendosjes së kushteve për lidhjen e kontratave me palët e tjera, që këto të fundit të pranojnë detyrime shtesë, të cilat, për vetë natyrën e tyre ose sipas praktikave tregtare, nuk kanë lidhje me objektin e kontratave në fjalë”.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1, germa b) dhe nenit 57 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës së thelluar për vlerësimin e përfuturit të kontrollit nëpërmjet shitblerjes së 98,83% të aksioneve të TIRANA BANK SHA nga PIRAEUS BANK SA tek BALFIN SHPK dhe KOMERCIJALNA BANKA AD SKOPJE.
2. Raporti i procedurës së thelluar duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se 3 muaj nga data e marrjes së këtij vendimit.
3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIME TË TJERA

VENDIM

Nr. 498, datë 15.02.2018

Për miratimin e Raportit Vjetor mbi veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2017 dhe prioritetet kryesore për vitin 2018

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 15.02.2018, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Shqyrtimi i materialit të Sekretarit të Përgjithshëm lidhur me përjashtimin “Raporti Vjetor mbi veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2017 dhe prioritetet kryesore për vitin 2018”.

Baza ligjore: Neni 24, shkronja (d) dhe (e), neni 26 dhe neni 29, pika 2, shkronja (ç) të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar (Ligji Nr. 9121/2003).

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të materialit të paraqitur nga Sekretari i Përgjithshëm “Raporti Vjetor mbi veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2017 dhe prioritetet kryesore për vitin 2018”, bazuar në nenin 24, shkronja (d) dhe (e), nenin 26 dhe nenin 29, pika 2, shkronja (ç) të Ligjit Nr. 9121/2003,

VENDOSI:

1. Miratimin e “Raporti Vjetor mbi veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2017 dhe prioritetet kryesore për vitin 2018”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 521, Datë 07.06.2018

“Për dhënien e rekomandimeve për Projektvendimin e Këshillit të Ministrave ‘Për miratimin e rregullores ‘Për kushtet dhe procedurat e dhënies dhe autorizimit të disa kategorive të ndihmës shtetërore’”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 07.06.2018, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Mbi vlerësimin e Projektvendimit të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores ‘Për kushtet dhe procedurat e dhënies dhe autorizimit të disa kategorive të ndihmës shtetërore’”

Baza Ligjore: Neni 24, shkronja d dhe f, neni 69 i ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës mbi vlerësimin e projekt-VKM “Për miratimin e rregullores ‘Për kushtet dhe procedurat e dhënies dhe autorizimit të disa kategorive të ndihmës shtetërore’”,

VËREN SE:

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është dërguar nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë shkresa nr. 8180 prot., datë 26.04.2018 për mendim lidhur me Projektvendimin e Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores ‘Për kushtet dhe procedurat e dhënies dhe autorizimit të disa kategorive të ndihmës shtetërore’”.

Autoriteti i Konkurrencës, në kuadrin e integritetit evropian dhe përafrimit të legjislacionit të *acquis* me BE, është koordinator dhe lider për kapitullin 8-të, “Politika e Konkurrencës” ku bën pjesë edhe Komisioni i Ndhmës Shtetërore pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Ky kapitull përbëhet nga tre komponentë Konkurrenca, Ndhma Ekonomike dhe Liberalizimi. Në zbatim të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit dhe Planit Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE) 2017-2020, ku paraqiten aktet ligjore të parashikuara për t’u përafruar me *acquis* të BE, në kapitullin 8, në pjesën e Ndhmës Shtetërore është i planifikuar edhe Projektvendimi i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores ‘Për kushtet dhe procedurat e dhënies dhe autorizimit të disa kategorive të ndihmës shtetërore’”. Qëllimi i këtij projektvendimi është plotësimi i kuadrit ligjor për ndihmën shtetërore sipas përcaktimeve në nenet 8/1, 10, 11, 12, 13/1 dhe 14 të ligjit nr. 9374, datë 24.04.2005 “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar.

Autoriteti bazuar në nenin 69 të ligjit nr. 9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, realizoi vlerësimin e Projektvendimit të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores ‘Për kushtet dhe procedurat e dhënies dhe autorizimit të disa kategorive të ndihmës shtetërore’”. Projekt VKM është në përafrim të kuadrit ligjor shqiptar me Rregulloren e Komisionit nr. 651/2014 “Deklarimi i disa kategorive të ndihmës në përputhje me tregun e brendshëm në zbatim të nenit 107 dhe 108 të Traktatit”.

Ky projekt-vendimi përcakton kushtet dhe procedurat për dhënien e ndihmës shtetërore rajonale, ndihmën për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, për punësimin e punëkërkuarve të papunë në vështirësi dhe me aftësi të kufizuara; ndihmën për trajnim; ndihmën për kërkim, zhvillim dhe inovacion; ndihma për mbrojtjen e mjedisit.

Në projekt-vendimin e dërguar përcaktohet intensiteti maksimal i ndihmës që mund të jepet, kostot që mund të mbulohen nga ndihma, përlllogaritjen e grantit ekuivalent dhe detyrimin për publikimin elektronik të dhënave të ndihmës shtetërore.

Projekt-vendimi ka të përcaktuara rregulla, kushte dhe procedura specifike, për të siguruar që ndihma e dhënë nga institucione apo agjenci shtetërore nuk kufizon konkurrencën, ka efekt nxitës dhe është transparente. Në këtë mënyrë projekt-vendimi synon që institucionet publike kur japin ndihmë shtetërore të sigurohen për efektet nxitëse të saj.

Në projekt-vendimi ka rregulla për transparencën, ku dhënësi i ndihmës është i detyruar të llogarisë paraprakisht vlerën e grantit, apo ekuivalentin bruto të grantit, të publikojë në faqen e internetit të dhëna për ndihmën, si përfituesit, afatet etj., sipas nenit 9 të projekt-vendimit. Kushtet dhe procedurat e vendosura mundësojnë monitorimin e tyre nga struktura përgjegjëse të ndihmës shtetërore.

Neni 5 i projekt-vendimit përcakton se ndihma është transparente kur: *ekuivalenti bruto i grantit (EBG) mund të llogaritet me saktësi përpara dhënies së ndihmës, pa pasur nevojë të kryhet një vlerësim risku për konkurrencën, në përputhje me kërkesat dhe parimet e parashtruara në këtë rregullore*. Lidhur me këtë dispozitë, mendojmë se koncepti i EBG nuk është sqaruar qartë në përkufizimet e kësaj rregullore.

Për sa më sipër vlerësojmë se në rastet e dhënies së ndihmës shtetërore nga Komisioni i Ndhmës Shtetërore, do të sugjerohet të kryhej paraprakisht vlerësim i konkurrencës në tregun përkatës. Në kuadër të këtij vlerësimi paraprak Komisioni i Ndhmës Shtetërore duhet të mbaj parasysh edhe Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 389, datë 14.12.2015 “Për domosdoshmërinë e marrjes së vlerësimit paraprak të AK për projekt-ligjin ‘Për disa ndryshime e shtesa në ligjin nr. 9374, datë 21.4.2005 ‘Për Ndhmën Shtetërore’” dhe Vendimi i Komisionit të Konkurrencës nr. 68, datë 24.12.2007 Për miratimin e Udhëzuesit “Mbi vlerësimin e pasojave të legjislacionit mbi konkurrencën”.

Si konkluzion shprehemi se mbështetur në nenin 69 të ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, projekt-VKM nuk sjell:

1. Kufizime sasiore për hyrjen në treg dhe tregtim;
2. Vendosjen e të drejtave ekskluzive ose të drejta të veçanta, në zona të caktuara, për ndërmarrje ose për produkte të caktuara.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24 shkronja d dhe f, nenin 69 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

— T’i rekomandojë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë që të bëjë këto shtesa dhe ndryshime në projekt-VKM, me përmbajtjen vijuese:

“Neni 5, pika 1 ndryshon:

1.Ndihma është transparente kur ekuivalenti bruto i grantit (EBG) mund të llogaritet me saktësi përpara dhënies së ndihmës duke vlerësuar paraprakisht konkurrencën në tregun përkatës.

Neni 9, pika 4 shtohet:

4. Para dhënies së çdo ndihme shtetërore, Komisioni i Ndhmës Shtetërore e dërgon për vlerësim projekt-aktin për dhënie e ndihmës pranë Autoritetit të Konkurrencës, për të vlerësuar nëse ai kufizon konkurrencën dhe bie në kundërshtim me ligjin nr. 9121/2003 'Për mbrojtjen e konkurrencës'.

— Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 546, Datë 24.09.2018

“Për dhënie mendimi lidhur me ligjin nr. 37/2018 “Për përcaktimin e procedurës së veçantë për vlerësimin, negociimin dhe lidhjen e kontratës me objekt “Projektimi dhe realizimi i projektit urban dhe godinës së re të Teatrit Kombëtar”””.

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 24.09.2018, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Vlerësimi ligjor i ligjit nr. 37/2018 “Për përcaktimin e procedurës së veçantë për vlerësimin, negociimin dhe lidhjen e kontratës me objekt “Projektimi dhe realizimi i projektit urban dhe godinës së re të Teatrit Kombëtar”

Baza Ligjore: Neni 24, shkronja d dhe ë, neni 69 i ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar (Ligji nr. 9121/2003).

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të informacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës “Lidhur me vlerësimin mbi ndyshimet e propozuara në ligjin nr. 37/2018 “Për përcaktimin e procedurës së veçantë për vlerësimin, negociimin dhe lidhjen e kontratës me objekt “Projektimi dhe realizimi i projektit urban dhe godinës së re të Teatrit Kombëtar”,

VËREN SE:

Në datë 14.09.2018, me anë të shkresës Nr. 28/20 Prot, datë 14.09.2018 Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, pranë Kuvendit të Republikës së Shqipërisë ka dërguar për mendim pranë Autoritetit të Konkurrencës ligjin nr. 37/2018 “Për përcaktimin e procedurës së veçantë për vlerësimin, negociimin dhe lidhjen e kontratës me objekt “Projektimi dhe realizimi i projektit urban dhe godinës së re të Teatrit Kombëtar”.

Bazuar në nenin 69 të ligjit nr. 9121/2003, Autoriteti i Konkurrencës kryen vlerësimin e projekt-akteve normative duke vlerësuar shkallën e kufizimit ose të pengimit të konkurrencës në treg.

Nga vlerësimi i realizuar konstatojmë se ligji nr. 37/2018 “Për përcaktimin e procedurës së veçantë për vlerësimin, negociimin dhe lidhjen e kontratës me objekt “Projektimi dhe realizimi i projektit urban dhe godinës së re të Teatrit Kombëtar”, nuk bie në kundërshtim me dispozitat e ligjit nr. 9121/2003, përkatësisht nenin 69 të tij.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24 shkronja d dhe ë, nenin 69, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Ligji nr. 37/2018 “Për përcaktimin e procedurës së veçantë për vlerësimin, negociimin dhe lidhjen e kontratës me objekt “Projektimi dhe realizimi i projektit urban dhe godinës së re të Teatrit Kombëtar” nuk bie në kundërshtim me dispozitat e ligjit nr. 9121/2003, përkatësisht nenin 69 të tij.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për dërgimin e këtij vendimi pranë Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 548, Datë 24.09.2018

“Për shqyrtimin e kërkesës së ERRU për revokimin e disa vendimeve të Komisionit të Konkurrencës”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 24.09.2018, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Shqyrtimi i kërkesës së Entit Rregullator të Ujit (ERRU) për revokim të disa vendimeve të Komisionit të Konkurrencës.

Baza Ligjore: Neni 24, gërma (d), neni 32, neni 69 dhe neni 70 i Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrotjtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar (Ligji Nr. 9121/2003);
Neni 128 e vijues të Ligjit Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” (K.P.A).

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës,

VËREN SE:

- I. Enti Rregullator i Ujit (ERRU) me shkresën Nr. 406 Prot., datë 13.09.2018, ka depozituar një kërkesë për revokimin e disa vendimeve të Autoritetit të Konkurrencës për dhënie rekomandimesh, si vijon:
Vendimi i Komisionit të Konkurrencës Nr. 522, datë 07.06.2018, “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor për “Ujësjetllës Gramsh” SHA”
- II. Sipas ERRU, nga Autoriteti i Konkurrencës është kërkuar vlerësimi paraprak për ndryshimin e nivelit tarifor për shoqërinë “Ujësjetllës Gramsh” SHA, por nga Autoriteti i Konkurrencës është marrë vendimi Nr. 522, datë 07.06.2018, jashtë afatit të kërkuar nga ERRU. Për këtë arsye, Komisioni Kombëtar i Entit Rregullator të Ujit miratoi Vendimin Nr. 33, datë 11.05.2018, “Për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë për shoqërinë Ujësjetllës Gramsh SHA”
- III. Nga analiza e rekomandimeve të dhëna nga Komisioni i Konkurrencës me vendimin Nr. 522, datë 07.06.2018, ERRU shprehet se vendimmarrja e Komisionit Kombëtar Rregullator Nr. 33, datë 11.05.2018 i përmban rekomandimet e Autoritetit të Konkurrencës për shoqërinë Ujësjetllës Gramsh SHA dhe propozon që të revokohet Komisioni i Konkurrencës.
— *Vendimi i Komisionit të Konkurrencës Nr. 518, datë 22.05.2018, “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor për “Ujësjetllës Kanalizime Skrapar” SHA”*
- IV. Sipas ERRU, nga Autoriteti i Konkurrencës është kërkuar vlerësimi paraprak për ndryshimin e nivelit tarifor për shoqërinë “Ujësjetllës Kanalizime Skrapar” SHA, por nga Autoriteti i Konkurrencës është marrë vendimi Nr. 518, datë 22.05.2018, jashtë afatit të kërkuar nga ERRU. Për këtë arsye, Komisioni

Kombëtar i Entit Rregullator të Ujit miratoi Vendimin Nr. 34, datë 11.05.2018, “Për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë për shoqërinë “Ujësjetllës Kanalizime Skrapar” SHA”

- V. Nga analiza e rekomandimeve të dhëna nga Komisioni i Konkurrencës me vendimin Nr. 518, datë 22.05.2018, ERRU shprehet se është në vëmendjen kryesore të saj që në të ardhmen shoqëritë t'i paraqesin të ndara kostot për shërbimin e furnizimit me ujë dhe për shërbimin e largimit të ujërave të ndotura dhe në analizën e tarifave të propozuara nga shoqëria “Ujësjetllës Kanalizime Skrapar” SHA, ka pasur parasysh jo vetëm kriterin e mbulimit nga shoqëria të kostove të shërbimeve por edhe përballueshmërinë e tarifave nga popullsia.
- *Vendimi i Komisionit të Konkurrencës Nr. 492, datë 28.12.2017 “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit dhe “Ujësjetllës Kanalizime Tiranë” SHA në lidhje me ndryshimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimit të ujërave të ndotura”*
- VI. Lidhur me rekomandimet e dhëna nga Autoriteti i Konkurrencës me Vendimin Nr. 492, datë 28.12.2017, ERRU shprehet se ka marrë parasysh të gjitha kostot për kategoritë e ndryshme të konsumatorëve dhe shërbimeve, nga të cilat përcaktohen nevojat për të ardhura, dhe në përfundim përcaktohen tarifat përkatëse.
- VII. Rritja graduale e tarifave është një princip logjik që ERRU ka parasysh në analizat dhe vlerësimet e saj për tarifat. Ky nuk është një parim i detyrueshëm për t'u aplikuar sidomos në rastet kur tarifat ekzistuese janë mjaft larg pragut të përballueshmërisë, siç ishte rasti i tarifës për UK Tiranë. Pra nuk ka qenë rasti që të mund të konsiderohet ky rekomandim i Komisionit të Konkurrencës.
- VIII. Duke pasur parasysh në kompleks të gjithë faktorët (tarifat ekzistuese, gjendjen e aseteve të sistemit të furnizimit me ujë e kanalizimeve, nevojat për investime, mundësinë reale të uljes së humbjeve, normën e arkëtimit etj.) ERRU e ka konsideruar të arsyeshme rritjen e të ardhurave 96% nga tarifat dhe 4% nga rritja e nivelit të arkëtimit, sepse kjo e fundit që shoqëria e ka përcaktuar si objektiv nga 80% që është aktualisht në 92% konsiderohet jo vetëm realist por edhe ambicioz.
- IX. Si përfundim ERRU-ja kërkon revokimin e vendimeve të Komisionit të Konkurrencës, përkatësisht për shoqëritë “Ujësjetllës Kanalizime Skrapar” SHA dhe “Ujësjetllës Gramsh” SHA, si edhe për pikat (b), (c) dhe (d) për “Ujësjetllës Kanalizime Tiranë” SHA.

Vlerësimi i Kërkesës së ERRU-së

- X. Në bazë të nenit 32 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar (Ligji Nr. 9121/2003), Autoriteti i Konkurrencës, në ushtrimin e funksioneve të tij, zbaton Kodin e Procedurave Administrative, përveç rasteve kur ky ligj parashikon ndryshe.
- XI. Referuar Ligjit Nr. 9121/2003, revokimi i një vendimi të Komisionit të Konkurrencës parashikohet në procedurat për marrëveshjet dhe abuzimin me pozitën dominuese (neni 46), procedurat për përjashtimin e marrëveshjeve nga ndalimi (neni 51) dhe në procedurat për kontrollin e përqendrimeve (neni 63).
- XII. Pra, Ligji Nr. 9121/2003 nuk parashikon revokimin e vendimit të Komisionit të Konkurrencës në rastin e dhënies së rekomandimeve sipas neneve 69 dhe 70 të tij dhe në zbatim të nenit 32 do i referohemi Ligjit Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” (K.P.A).
- XIII. Gjithashtu, referuar K.P.A-së, në asnjë nen të tij nuk parashikohet revokimi si mjet ligjor administrativ ndaj një veprimi apo mosveprimi administrativ. Mjetet ligjore administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ të përcaktuara në nenin 128 të K.P.A janë: Ankimi administrativ;

Kundërshtimi administrativ; dhe Rishikimi.

- XIV. Nga vlerësimi i mjeteve ligjore të mësipërme të përcaktuara në Kreun (II), (III) dhe (IV) të Pjesës Gjashtë të K.P.A-së dhe afateve brenda të cilëve duhet të paraqiten, rezulton se kërkesa e depozituar nga ERRU është jashtë afateve të përcaktuara në K.P.A dhe për këtë arsye nuk është e pranueshme dhe duhet të rrëzohet pa u shqyrtuar në themel të tij.
- XV. Procedurat për realizimin e mbledhjeve të Komisionit të Konkurrencës realizohen në bazë të nenit 11, pika 2, të “Rregullores për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës”, e cila parashikon edhe afatet kohore të shqyrtimit të rasteve.
- XVI. Si përfundim, referuar sa më sipër, rezulton se kërkesa e ERRU për revokimin e vendimeve të Komisionit të Konkurrencës, përkatësisht për shoqëritë “Ujësjellës Kanalizime Skrapar” SHA dhe “Ujësjellës Gramsh” SHA, si edhe për pikat b), c) dhe d) për “Ujësjellës Kanalizime Tiranë” SHA, nuk parashikohet në Ligjin Nr. 9121/2003, si dhe është paraqitur pranë Autoritetit të Konkurrencës jashtë afateve të përcaktuara në K.P.A dhe për këto arsye, kjo kërkesë nuk është e pranueshme dhe duhet të rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, gërma (d), nenin 32, nenin 69 dhe nenin 70 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar dhe neni 128 e vijues të Ligjit Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” (K.P.A)

VENDOSI:

1. Mospranimin për shqyrtim të kërkesës së ERRU për revokimin e vendimeve të Komisionit të Konkurrencës Nr. 522, datë 07.06.2018, Nr. 518, datë 22.05.2018 dhe pikave (b), (c) dhe (d) të vendimit Nr. 492, datë 28.12.2017;
2. Lënien në fuqi të vendimeve të Komisionit të Konkurrencës Nr. 522, datë 07.06.2018, Nr. 518, datë 22.05.2018 dhe Nr. 492, datë 28.12.2017;
3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e ERRU-së.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 553, Datë 04.10.2018

“Mbi vlerësimin ligjor të p/kontratës së Koncesionit/PPP, për ofrimin e shërbimeve diagnostikuese nga laboratorët mjekësorë”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 04.10.2018, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Vlerësimi i p/kontratës së Koncesionit/PPP, për ofrimin e shërbimit laboratorik.

Baza Ligjore: Neni 24, shkronja d, dhe neni 26 i Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”,

Ligji Nr. 44/2015 datë 30.04.2015 “Kodit të Procedurës Administrative në RSH”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm “Vlerësimi i p/kontratës së Koncesionit /PPP, për ofrimin e shërbimit laboratorik,

VËREN SE:

Autoriteti i Konkurrencës (AK), në një korrespondencë të gjatë me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS), mori së fundmi nga MSHMS, dokumentacionin zyrtar me shkresën nr.20/3 prot, datë 13.09.2018 “Kthim përgjigje”, prot i AK.

Bazuar në nenin 69 të ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, dokumentacionit të paraqitur në lidhje me Draft-kontratën e koncesionit/PPP “Për ofrimin e shërbimeve diagnostikuese nga laboratorët mjekësorë”, ju bë një vlerësim në kuptim të këtij neni.

Nga vlerësimi i dokumentacionit të depozituar, vërehet se procedura për dhënien me koncesion/PPP “Për ofrimin e shërbimeve diagnostikuese nga laboratorët mjekësorë”, është shoqëruar me një studim fizibiliteti, realizuar nga Korporata Financiare Ndërkombëtare (IFC), e cila ka vlerësuar situatën në tregun e shërbimeve laboratorike spitalore, gjatë vitit 2015 (rishikuar 2016).

Sipas raportit të IFC, studimi për ofrimin e shërbimeve diagnostikuese nga laboratorët mjekësorë paraqet vështirësi për shkak të mungesës së të dhënave sasiore mbi shërbimin publik, dhe për faktin se një pjesë e kërkesës konsumatore mbulohet nga shërbimi në sektorin privat.

Mbi gjetjet e evidentuara, studimi rekomandon: përmirësimin e kuadrit rregullator për mjekësinë laboratorike në Shqipëri; sigurimin e një buxheti maksimal mujor për të siguruar shërbimin e urgjencës; dhe hartimin e politikave sociale për grupet e punëtorëve, apo individëve të cilët pas dhënies së këtij shërbimi me koncesion nuk do të merren në punë.

Në dokumentacionin e depozituar, vërehet se nga momenti i vlerësimit të shërbimit laboratorik në sektorin publik dhe privat, dhe deri në draft-kontratën e paraqitur për vlerësim pranë AK, ka kaluar një kohë e konsiderueshme, e cila është shoqëruar me ndryshime të ndjeshme në strukturat e tregut spitalor.

Komisioni i Konkurrencës, me vendimin nr. 539, datë 24.07.2018 "Mbi ndryshimin e kontrollit të shoqërisë Hygeia Hospital Tirana SHA nga Diagnostic and Therapeutic Centre of Athens, Hygeia S.A tek American Hospital Tirana SHA", ka autorizuar transaksionin e shit-blerjes së spitalit Hygeia tek spitali Amerikan, ku pas këtij transaksioni Spitali Amerikan do të zotërojë XX% të tregut të shërbimit spitalor jopublik, duke sjellë një përqendrim të tregut dhe një shkallë të Indeksit të Hirschman Herfindahl (HHI) në XXX. Për këto arsye Komisioni i Konkurrencës ka vendosur monitorimin e këtij tregu për një periudhë 1 (një) vjeçare nga dita e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, për shkak se ky përqendrim sjell pozitë dominuese në treg.

Ndërkohë në tregun shëndetësor, po funksionojnë edhe dy koncesione të tjera: koncesioni i Check-up, dhe koncesioni i Dializës, ku referuar të dhënave të administruara nga Fondi i Sigurimeve të Detyrueshme të Kujdesit Shëndetësor (FSDKSH), shkresë nr.430/1prot i AK, datë 10.11.2017, për koncesionin e dializës spitali Amerikan është përfituesi më i madh fondeve buxhetore për këtë shërbim, nëpërmjet kontratave që ai ka me FSKSH, si dhe nëpërmjet shoqërisë Dia Vita SHPK, mbajtëse e së drejtës së koncesionit, e cila zotërohet në 15% të kuotave nga Spitali Amerikan.

Koncesionet e mësipërme, kanë ndryshuar ndjeshëm kushtet e tregut, dhe kjo dikton nevojën e një rishikimi të nevojave reale të tij, si dhe termave të projekt-kontratës së koncesionit për ofrimin e shërbimeve diagnostikuese nga laboratorët mjekësorë.

Në këto kushte, Autoriteti vlerëson se analiza mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur, e bën të pamundur vlerësimin e kufizimeve sasiore apo cilësore, që mund të sjellin të drejtat ekskluzive në tregun përkatës, ose në pjesë të tij, në kuptim të nenit 69 të ligjit nr.9121/2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës", i ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, germa d dhe nenit 42, pika 1 e Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", (i ndryshuar),

VENDOSI:

1. Projekt-kontrata e partneritetit publik privat "Për ofrimin e shërbimeve diagnostikuese nga laboratorët mjekësorë", për shkak të ndryshimeve që kanë ndodhur në tregun përkatës, dhe pasi të përcaktohen përfundimisht termat e kontratës mes palëve, të vlerësohet *ex-post*.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij Vendimi dhe për njoftimin e palëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

MENDIM PARALEL

Shpreh kundërshtitë e mia në lidhje me aplikimin e një sistemi PPP me koncesion të centralizuar në shkallë të gjerë, pasi një sistem i tillë monopolizon totalisht sistemin laboratorik mjekësor në vend, i cili do të prodhonte çmime të pakontrolluara dhe të larta. Këtë problematikë të koncesionit në lidhje me çmimet dhe volumet e analizave e ka ngritur edhe Min. Financave.

Aplikimi i kësaj procedure asfikson deri në zhdukje konkurrencën e lirë dhe të ndershme duke përbërë një rrezik për cilësinë dhe transparencën e shërbimit ndaj pacientit si dhe një rrezik të madh financiar.

Vetë KE në një material për koncesionet nën mjekësi thekson se: Faktorët kyç që shmangin riskun fiskal janë konkurrenca e pastër midis publikut dhe privatit.

Në këtë formë të centralizuar koncesioni kjo konkurrencë zhduket plotësisht.

Krijohet monopol dhe dominim tregu, pasi operatori privat do të orientohej nga fitimi duke u kufizuar dhe përqendruar në kompani diagnostike me të cilët do të bëjë marrëveshje preferenciale. Ndërkohë, për të patur një rezultat të saktë nga një ekzaminim laboratorik, sidomos ato komplekse, në praktikën laboratorike nevojitet shpesh përdorimi i disa prodhuesve alternativë.

Koncesionari do të ketë interes të rrisë numrin e analizave me qëllim rritjen e fitimit (rrezikohet të kemi inflacion testesh laboratorike). Për këtë qëllim ai do të nxisë mjekët klinikistë që të kërkojnë sa më shumë analiza dhe kështu do të rritet në mënyrë të konsiderueshme dhe fiktive pagesa që shteti, nëpërmjet taksapaguesve, duhet t'i rimbursojë kompanisë private.

Si përfundim desha të theksoj që nuk ka asnjë shembull, nga praktika ndërkombëtare, ku shërbimi laboratorik unikal universitar i një shteti të jepet me koncesion.

Helidon Bushati

Komisioner

VENDIM

Nr. 557, Datë 08.10.2018

“Mbi vlerësimin e projekt-vendimit të Entit Rregullator të Ujit lidhur me aplikimin për ndryshimit të nivelit tarifar për “Ujësjellës Kanalizime Librazhd-Prrenjas” SHA”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 08.10.2018, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Miratimi i projekt-aktit normativ, të nxjerra nga Komisioni Kombëtar Rregullator i ERRU-së, për miratimin e tarifave për Ujësjellës Kanalizime Librazhd-Prrenjas SH.A.

Baza Ligjore: Neni 24, germa d) dhe f); neni 26; neni 69 dhe 70 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” (i ndryshuar).

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit mbi vlerësimin nga Autoriteti i Konkurrencës, i projekt aktit normativ, të nxjerra nga Komisioni Kombëtar Rregullator i ERRU-së, për miratimin e tarifave për Ujësjellës Kanalizime Librazhd-Prrenjas SH.A.,

VËREN SE:

Enti Rregullator i Ujit nëpërmjet shkresës nr. 431 prot., datë 02.10.2018, informon Autoritetin e Konkurrencës se me vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 57, datë 20.07.2018 ka filluar procedurën për shqyrtimin e aplikimit për ndryshim tarife të shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Librazhd-Prrenjas SHA, e cila ka propozuar me anë të projekt- vendimit, të aplikojë tarifa të unifikuara për zonën pas riorganizimit.

Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i informacionit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifar si dhe projekt-vendimit përkatës “Mbi miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë për shoqërinë Ujësjellës Kanalizime Librazhd-Prrenjas SHA”, rezultoi se:

Aplikimi i metodologjisë për ndryshimin e tarifave ka filluar me analizën e kostove të operimit dhe mirëmbajtjes, të cilat duhet të jenë të justifikueshme, si dhe në analizën e performancës e cila tregon rritje të tarifave në mënyrë graduale në vitet në vazhdim, duke patur orientimin drejt kostove për ofrimin e këtij shërbimi.

Tarifat aktuale që aplikon Ujësjellës Kanalizime Librazhd-Prrenjas SHA për ujin e pijshëm për konsum publik janë miratuar me Vendimin nr. 4, datë 29.02.2012 të KKRR-së. Sipas UK niveli i tarifave në fuqi në raport me koston totale është realtivisht i ulët.

Shoqëria UK “Librazhd- Prrenjas” SHA aplikon për herë të parë metodologjinë për vendosjen e tarifave për shërbimet e furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimit të ujërave të ndotura bazuar në vendimin Nr.42 datë 09.12.2015 të KKRR-së, konkretisht në analizën e kostove dhe të ardhurave për shërbimet e ofruara, ku janë bazuar këto tarifa të reja të cilat priten të miratohen.

Për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, aktualisht për konsumatorët familjar, shoqëria aplikon tarifa të padiferencuara për të gjithë zonën ekzistuese dhe konkretisht për zonën urbane XXX lekë/m³ dhe zonën rurale XXX lekë/m³, tarifa këto të miratuara nga ERRU.

Nga ana e UK Librazhd- Prrenjas janë përcaktuar dhe objektivat për treguesit e performancës, të cilat në vitin 2019 parashikohen të përmbushen bazuar dhe në hartimin e një plani biznesi XXX vjeçar, për të gjithë zonën e shërbimit, duke mbajtur në konsideratë humbjet fizike, masat për kontrollin dhe disiplinimin e konsumatorëve abuziv dhe lidhjeve të paligjshme.

Ndërmarrja është në gjendje të përballoj mbulimin e kostove O&M në rreth XXX% ose XXX% të kostove totale në 2019 krahasuar me XXX% që është aktualisht. Për pasojë, kjo ndërmarrje ka ende nevojë, për një periudhë të paktën afat shkurtër, për subvencione për mbulimin e kostove të O&M me synimin që në 2019 të jetë një shoqëri me fitim në masën XXX%.

Ndërmarrja ka nevojë për investime emergjente dhe afat mesme, pasi rrjeti është shumë i amortizuar. Nisur nga analiza e treguesve të performancës nga ana e ERRU-së është konstatuar se:

— **Uji pa të ardhura** parashikohet të rritet në nivelin XXX% në vitin 2019 duke patur një ndryshim pozitiv në krahasim me 2017, sepse sistemi i furnizimit me ujë nuk është me ngritje mekanike, ky konsiderohet një nivel i pranueshëm i këtij treguesi.

— **Niveli i matjes** aktualisht për të tre kategoritë e klientëve është XXX për klientët jo familjarë, për rrjedhojë ndërmarrja ka vendosur prioritet instalimin e ujëmatësave, si për klientët jo familjar dhe ata familjarë, që niveli i matjeve për vitin 2019 të jetë XXX.

— **Norma e arkëtimit** parashikohet të rritet me XXX%, pasi shoqëria ka një plan veprimi lidhur me efikasitetin e mbledhjes së të ardhurave, e cila ka dhënë rezultat për vitin 2017.

— **Kohëzgjatja e furnizimit të ujit** parashikohet të përmirësohet duke shërbyer me 24 orë ujë në ditë duke përfshirë dhe zonat e reja urbane për shkak të zgjerimit administrativ territoriale, e cila është aktualisht 24 orë/7 ditë të javës, por vetëm për zonat urbane.

— **Efikasiteti i stafit** parashikohet të përmirësohet duke u ulur në XXX punonjës për XXX lidhje, si rezultat i rritjes së numrit të lidhjeve nga zgjerimi i zonës dhe kryesisht nga evidentimi i lidhjeve të paligjshme, realizimi i investimeve, nga XXX punonjës Staf/XXX që ishte në 2017.

Mbulimi me kanalizime. Gjendja aktuale në 2017 është XXX% e mbulimit faktik dhe sipas objektivat nga shoqëria në 2019 vlerësohet të jetë XXX më shumë se aktualisht.

ERRU shprehet se tarifat e propozuara janë në përputhje me parimin e rregullatorit mbi përballueshmërinë që fatura e llogaritur me tarifat e reja të mos jetë më shumë se XX% të shpenzimeve mujore të një familje sipas të dhënave të INSTAT (2014).

Sipas ERRU rritja e tarifave është mëse e domosdoshme, sepse duhet të rritet gradualisht përmbushja e objektivat për investime fizike, me qëllim zgjerimin e zonës së pambuluar me shërbime.

Në këto kushte ERRU në analizën ekonomike financiare të saj ka marrë në konsideratë të gjithë treguesit e sipërcituar dhe për të ofruar një shërbim cilësor, gjithashtu ka dhënë disa rekomandime për rritjen e investimeve sepse ky është nivel shumë i ulët i gjendjes aktuale vetëm XXX%, vendosjen e pajisjeve matëse të burimeve dhe rezervuarve, reduktimin e numrit të stafit, hartimin e një plani biznesi 5-vjeçar brenda vitit 2019, hartimin e një plani masash të detajuara që lidhen me mirë menaxhimin dhe efikasitetin e mbledhjes së të ardhurave, debive, si dhe planin e kontrollit dhe disiplinimin e konsumatorëve abuziv dhe lidhjeve të paligjshme.

Për sa më sipër, rritja e tarifave duhet të bëhet gradualisht në vitet në vazhdim, me kusht që çdo rritje të pasqyrohet me përmirësime të performancës së shërbimeve. Tarifat e reja duhet të jenë të orientuara drejt kostos së shërbimeve për të cilat ato aplikohen, kosto të cilat duhet të jenë të nevojshme për marrjen e këtyre shërbimeve.

Realizimi i investimeve për përmirësimin e rrjetit të ujësjellësit, duhet të jetë transparent, i përshtatshëm, efikas, fitimprurës, dhe të nxitin reduktimin e kostove nga niveli aktual si dhe përdorimin në mënyrë efektive të burimeve ujore ashtu edhe në ofrimin cilësor të shërbimit.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenet: 24, germa d) e f); 69 dhe 70 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” (të ndryshuar), me propozim të Sekretariatit,

VENDOSI:

1. Projekt-akti normativ për miratimin e tarifave të UK Librazhd-Prrenjas, nuk bie në kundërshtim me ligjin nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, pasi nuk krijon barriera kufizuese të cilat sjellin pasoja për konkurrencën në treg.
2. T’i rekomandojë Entit Rregullator të Ujit si vijon:
 - a) Në projekt-vendimin “Mbi miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe ujërat e ndotura për shoqërinë Ujësjellës Kanalizime Librazhd- Prrenjas SHA”, në pjesën e rekomandimeve të dhëna ndërmarrjes UK Librazhd-Prrenjas, të shtohen edhe rekomandimet e mëposhtme:
 - i. Tarifat që do të miratohen nga ERRU për UK Librazhd-Prrenjas, të jenë të orientuara drejt kostos së shërbimeve për të cilat ato aplikohen, duke verifikuar të gjithë ofruesit e shërbimit me matës dhe pamatës, me linjë të ofrimit të shërbimit nga UK Librazhd Prrenjas SHA dhe ata që furnizohen me burime të tjera alternative, kosto të cilat duhet të jenë të nevojshme për marrjen e këtyre shërbimeve.
 - ii. Ndërmarrja UK Librazhd- Prrenjas gjatë hartimit të planit 5 vjeçar duhet të mbaj në konsideratë ndarjen e kostove të shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm nga shërbimi i kanalizimeve të ujërave të ndotura, pasi kjo do të siguroj një analizë më të saktë dhe vendosje të tarifave më të drejta për ofrimin e secilit shërbim.
 - iii. Ndërmarrja UK Librazhd- Prrenjas të bëj sa më transparente investimet për përmirësimin e rrjetit të ujësjellësit, duke i përdorur ato në mënyrë sa më të përshtatshme, efikase e fitimprurëse, me qëllim reduktimin e kostove nga niveli aktual dhe përdorimin në mënyrë efektive të burimeve ujore.
 - iv. Evidentimit nga ana e ndërmarrjes të një data baze të të gjithë abonentëve në zonat urbane /rurale, që përdorin burime alternative furnizimi me ujë, me qëllim faturimin sa më transparent të tyre dhe ofrimin e shërbimit sa më cilësor (klorifikim, mirëmbajtje).
 - v. Rivlerësimin e numrit të lidhjeve me/pa matës sipas popullsisë në zonat urbane dhe rurale që janë aktualisht, për shkak të reduktimit të numërit të tyre në këto zona, si edhe rillogaritjen e të dhënave financiare në vazhdi duke mbajtur në konsideratë gjendjen reale të abonentëve.
3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 568, Datë 15.11.2018

“Për dhënien e disa rekomandimeve Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare në tregun e shërbimeve celulare”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 15.11.2018, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Dhënia e disa rekomandime Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) në tregun e shërbimeve celulare

Baza ligjore: Neni 24, gërma (d), neni 70 i Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar (Ligji Nr. 9121/2003).

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës;

VËREN SE:

1. Këshilli Drejtues i AKEP-it me vendimin Nr. 16, datë 22.02.2018, miratoi nxjerrjen për këshillim publik të dokumentit “Analizë e tregut celular: tregu me shumicë i aksesit dhe origjinimit; tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare dhe tregu me pakicë i shërbimeve celulare”. Lidhur me këtë dokument, Autoriteti i Konkurrencës dërgoi komentet e tij lidhur me pyetjet e ngritura nga AKEP-i.
2. AKEP-i, pas marrjes së komenteve finale lidhur me dokumentin e mësipërm, me vendimin Nr. 78, datë 01.10.2018, miratoi dokumentin “Analizë e tregut celular: tregu me shumicë i aksesit dhe origjinimit; tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare dhe tregu me pakicë i shërbimeve celulare”.
3. Në vijim të analizës së miratuar me vendimin Nr. 78, datë 01.10.2018, AKEP-i me Vendimin Nr. 79 datë 01.10.2018, “Për përcaktimin e sipërmarrësit Vodafone Albania SHA me fuqi të ndjeshme në tregun me shumicë të aksesit dhe origjinimit, tregun me shumicë të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare dhe tregun me pakicë të shërbimeve celulare dhe masat përkatëse rregullatore”, ka përcaktuar sipërmarrësin Vodafone Albania SHA (Vodafone) me fuqi të ndjeshme në treg (FNT), përkatësisht: a) tregu me shumicë i aksesit dhe origjinimit; b) tregu me shumicë i terminimit të thirrjeve ndërkombëtare; dhe c) tregu me pakicë i shërbimeve celulare; si dhe ka vendosur masat përkatëse rregullatore.
4. AKEP-i bazuar në Vendimin Nr. 78 datë 01.10.2018, me vendimin Nr. 82, datë 01.10.2018 ka nxjerrë për këshillim publik dokumentin për rregullimin e tarifave të sipërmarrësve me FNT në tregun me shumicë të aksesit dhe origjinimit të shërbimeve celulare, i cili përmban propozimin e AKEP për metodën e rregullimit të tarifave të sipërmarrësve të përcaktuar me FNT në tregun me shumicë të aksesit dhe origjinimit në rrjetet celulare.
5. Rregullimi i tarifave për operatorët me FNT synon që të adresojë problemet e evidentuara nga analiza e tregut dhe dominanca për konkurrencën në treg, të cilat mund të jenë aplikimi i tarifave shumë të larta ose

i tarifave shumë të ulëta në dëm të konkurrencës dhe përdoruesve fundorë.

6. AKEP në vijim të bashkëpunimit dhe detyrimeve që përcakton neni 38 i Ligjit Nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (Ligji Nr. 9918/2008), dhe nenet 69 dhe 70 të Ligjit Nr. 9121/2003, me shkresën Nr. 2285/40 Prot., datë 08.10.2018, mirëpret komentet e Autoritetit të Konkurrencës për dokumentin e nxjerrë për këshillim publik.

Rregullimi i tarifave të sipërmarrësit FNT në Tregun me shumicë të akses origjinimit të shërbimeve celulare

7. Në nenin 53 të Ligjit Nr. 9918/2008, përcaktohet se qëllimi i rregullimit të tarifave është parandalimi i sjelljeve antikonkurruese dhe i diskriminimit të përdoruesve fundorë dhe konkurruesve në treg që mund të rezultojnë nga veprimet e sipërmarrësit me fuqi të ndjeshme në treg për tarifën. Masat për rregullimin e tarifave duhet të jenë të bashkërenduara dhe proporcionale në relacion me rregullimin e përcaktuar në nenin 7 të këtij ligji.
8. Në pikën 2, të nenit 56, të Ligjit Nr. 9918/2008, përcaktohet se: *“Nëse nga analiza e tregut të kryer, në përputhje me nenin 34 të këtij ligji, për tregun përkatës për përdoruesit fundorë (tregu i pakicës) është arritur në përfundimin se në këtë treg nuk ka konkurrencë efektive dhe nëse masat e parashikuara në pikën 1 të këtij neni nuk janë të mjaftueshme, AKEP-i ka të drejtë të vendosë ndaj sipërmarrësit me fuqi të ndjeshme në treg detyrime të veçanta sipas shkronjave “a” ose “b” të kësaj pike: a) detyrimet e veçanta përfshijnë kërkesat që sipërmarrësi: i) të mos zbatojë tarifa tepër të larta; ii) të mos pengojë hyrjen në treg të lojtarëve të rinj; iii) të mos kufizojë konkurrencën, nëpërmjet zbatimit të tarifave të larta të paarsyeshme ose tarifave të ulëta të paarsyeshme; iv) të mos shfaqë parapëlqime të diferencuara ndaj përdoruesve fundorë të veçantë; v) të mos ofrojë paketa të paarsyeshme shërbimesh; b) detyrimin për nxjerrjen e vendimit përkatës për rregullimin e tarifave, sipas nenit 57 të këtij ligji”.*
9. Referuar nenit 57 të Ligjit Nr. 9918/2008, AKEP-i zbaton rregullimin e tarifave nëpërmjet metodave si vijon: a) përcaktimit të nivelit minimal ose maksimal të tarifave; b) korrigjimit të ecurisë së tarifave, duke përcaktuar kushte të tilla si: i) kufirin maksimal të normës së ndryshimit (rritjes/uljes) të mundshëm të tarifës brenda një periudhe të caktuar kohe; ii) raportin maksimal të rritjes së tarifës, që imponohet nga rritja e çmimeve të elementeve përbërëse (inputeve), brenda një periudhe kohe të caktuar; iii) procedura, që do të përdoret për përcaktimin ose llogaritjen e tarifës, përfshirë detyrimin për orientimin në kosto, përcaktimin e kostove efikente, që mundëson realizimin e një fitimi të arsyeshëm;
10. Në rregullimin e tarifës, AKEP-i vlerëson edhe të dhënat më të fundit për: a) praktikën më të mirë të vendeve të BE-së; b) tarifën mesatare të vendeve të BE-së; c) tarifën e vendeve të rajonit me zhvillim të ngjashëm me Republikën e Shqipërisë; ç) raportet ndërmjet tarifave të shumicës dhe pakicës; d) normën e fitimit të arsyeshëm, të realizuar nga sipërmarrësit e tjerë të komunikimeve elektronike në vendet e BE-së dhe në vendet me zhvillim të ngjashëm me Republikën e Shqipërisë. Metodën e rregullimit të tarifave mund të jenë të kombinuara.
11. Sipas përfundimeve të analizës së tregut celular, Vodafone është përcaktuar me FNT në tregun me shumicë të akses/origjinimit dhe ndër detyrimet për FNT, AKEP ka vendosur dhe detyrimin për kontroll të tarifave dhe orientim në kosto (neni 45 i Ligjit 9918/2008). Për këtë detyrim AKEP-i ka përcaktuar:
- a) Tarifën e aksesit dhe origjinimit të thirrjeve dhe shërbimeve të interkoneksionit të lidhura me këto shërbime në rrjetin Vodafone Albania janë objekt kontrolli dhe rregullimi nga AKEP;
- b) Metoda e rregullimit të tarifave të shërbimeve të mësipërme përcaktohet me vendim të veçantë nga AKEP, sipas përcaktimeve të nenit 55 e në vijim të Ligjit 9918/2008.

12. Në vijim të përcaktimeve të Ligjit 9918/2008 dhe rekomandimeve të KE dhe udhëzimeve të BEREC,

AKEP, propozon, që detyrimi i kontrollit dhe rregullimit të tarifave në tregun me shumicë të akses/origjinimit për sipërmarrësin me FNT Vodafone, të përfshijë:

- a) Rregullimin e tarifave me shumicë të akses/origjinimit të aplikuara nga Vodafone Albania për operatorët MVNO (Mobile Virtual Network Operator) nëpërmjet orientimit në kosto të tyre dhe përcaktimit të nivelit maksimal të tyre;
 - b) Ndalimin e aplikimit të tarifave të ulëta të paarsyeshme në tregun me pakicë në raport me tarifat me shumicë nëpërmjet aplikimit të testit margin squeeze/ERT.
13. Rregullimi i mësipërm sipas AKEP synon të adresojë problemet e identifikuar në analizën e tregut celular, sidomos problemin e tarifave të ulëta të paarsyeshme të aplikuara në tregun me pakicë, të cilat nuk krijojnë mundësi replikimi ekonomik (me fitim të arsyeshëm) nga operatorët e tjerë në treg apo të mundshëm për të hyrë në tregun me pakicë si MVNO.
14. Për rregullimin e nivelit maksimal të tarifave me shumicë të akses/origjinimit. AKEP-i propozon që nivelet maksimale të tarifave më shumicë të akses/origjinimit në rrjetin Vodafone të jenë sa nivelet e tarifave të terminimit MTR (Mobile Termination Rate) për këtë operator, 1,22 lek/min deri më 01/12/2018 dhe 1.11 lek/min pa TVSH deri më 01.12.2019.
15. Lidhur me propozimin e mësipërm të AKEP-it, vlerësojmë se tarifa e akses origjinimit për ndërmarrjen me FNT Vodafone duhet të jetë e orientuar drejt koston dhe në mungesë të koston reale të tarifës së akses origjinimit, të fillohet me aplikimin e tarifës së terminimit, por në momentin e llogaritjes së koston së këtij shërbimi tarifa e akses origjinimit të orientohet drejt kësaj kostoje.
16. Gjithashtu, AKEP, propozon masa për të rregulluar çmimet në tregun e shumicës nëpërmjet aplikimit të testit margine squeeze (MS) apo replikueshmërisë ekonomike (ERT) për ndërmarrjen me FNT Vodafone. Sipas AKEP, ndërmarrja me FNT ka detyrimin që të vërtetojë që tarifat me pakicë plotësojnë këtë kusht.
17. Lidhur me propozimin e mësipërm të AKEP-it, vlerësojmë aplikimin ex-ante të testit të margin squeeze nga AKEP, përpara hedhjes në treg të paketave, promocioneve dhe skontove nga ndërmarrja me FNT.
18. Në dokumentin e analizës së AKEP-it, të miratuar me vendimin Nr. 78 datë 01.10.2018, evidentohen problematikat e shfaqura lidhur me mungesën e konkurrencës efektive ku i referohet kryesisht:
- a) On-net vs off net në mungesë të masave të rregullimit të tarifave të shumicës për terminimin e thirrjeve;
 - b) Tarifat standarde jashtë ofertave janë shumë të larta;
19. Lidhur me problematikën e tarifave standarde Autoriteti i Konkurrencës me Vendimin Nr. 475, datë 21.09.2017 "Për mbylljen e hetimit paraprak në tregun me pakicë të shërbimeve celulare dhe dhënien e disa rekomandimeve" i ka rekomanduar AKEP-it: *"Të kryej analiza për zhvillimin dhe orientimin drejt koston së tarifave standarde të aplikuara për përdoruesit me parapagesë, që përdorin tarifat standarde jashtë ofertave për operatorët me fuqi të ndjeshme në këtë treg."*
20. Meqenëse aktualisht nga AKEP-i ndërmarrja Vodafone është shpallur me FNT në tregun me pakicë të shërbimeve celulare dhe nga kjo analizë janë adresuar vetëm problematika e ngjeshjes së çmimit nga aplikimi i tarifave shumë të ulëta, vlerësojmë se është e nevojshme që AKEP të marrë në analizë rregullimin e tarifave të tregut me pakicë për të shmangur sjelljet antikonkurruese të ndërmarrjes me FNT nëpërmjet aplikimit të tarifave shumë të larta.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, gërma (d) dhe nenin 70 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 "Për Mbrotjtjen e Konkurrencës", i ndryshuar,

VENDOSI:

4. Ti rekomandojë Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, si vijon:

- a) Tarifa e akses origjinimit për ndërmarrjen me FNT Vodafone duhet të jetë e orientuar drejt kostos;
- b) Në mungesë të kostos reale të tarifës së akses origjinimit, të fillohet me aplikimin e tarifës së terminimit, por në momentin e llogaritjes së kostos së këtij shërbimi tarifa e akses origjinimit të orientohet drejt kësaj kostoje.
- c) Aplikimin e testit të margin squeeze përpara hedhjes në treg të paketave nga ndërmarrja me FNT për të eliminuar sjelljet antikonkurruese të ndërmarrjes me FNT lidhur me ngjeshjen e çmimit dhe nxjerrjen e konkurrentëve nga tregu nëpërmjet aplikimit të tarifave të ulëta të pakicës.
- d) Ndërmarrja me FNT, përpara hedhjes në treg, brenda një afati të arsyeshëm, të depozitojë pranë AKEP-it paketat standarde, promocionet dhe skontot e përkohshme, me qëllim vlerësimin nëse këto paketa janë konkurruese.
- e) Përzgjedhja e paketave për kryerjen e testit të margin squeeze të fillojë sipas peshës specifike dhe rëndësisë që zë paketa në të ardhurat e ndërmarrjes me FNT, pa përjashtuar paketat e reja që do të hidhen në treg.
- f) Vlerësimi i të gjitha promociioneve dhe skontove të përkohshme të ndërmarrjes me FNT;
- g) Të vendosë nën rregullim tarifat e shërbimeve celulare me pakicë për ndërmarrjen me FNT, sipas parashikimeve të Ligjit Nr. 9918/2008 të njëkohshme me tregun me shumicë akses origjinimit, për nxitjen e konkurrencës efektive në këtë treg, pa pritur rezultatet e rregullimit të tarifave të tregut të akses origjinimit.
- h) Rregullimi i tarifave me pakicë për operatorin me FNT duhet të adresojë problemet e evidentuara nga analiza e tregut e AKEP, si:
 - i. On-net vs off-net në mungesë të masave të rregullimit të tarifave të shumicës për terminimin e thirrjeve;
 - ii. Tarifat standarde jashtë ofertave janë shumë të larta;
- i) Krijimin e lehtësirave për hyrjen në treg të MVNO-ve, duke vendosur detyrime të qarta për ndërmarrjen me FNT për akses dhe interkoneksion dhe përdorimin e përbashkët të faciliteteve të rrjetit.

5. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 577, Datë 20.12.2018

“Mbi miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në Rregulloren “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 20.12.2018, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Mbi miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në Rregulloren “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”.

Baza ligjore: Nenet 24, shkronja dh) dhe 84, shkronja c) të Ligjit 9121/2003 ‘Për Mbrojtjen e Konkurrencës’, i ndryshuar; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, e ndryshuar.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm,

VËREN SE:

1. Depozitimi i dy dosjeve origjinale ose të njehsuara me origjinalen krijon kosto shtesë për palën njoftuese;
2. Në kuadër të ruajtjes dhe mbrojtjes së mjedisit;
3. Në mbështetje të Ligjit nr.9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat”, në arkivin e institucionit do të depozitohet një dosje për efekt të arkivimit të materialeve;

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja dh) dhe 84, shkronja c) të Ligjit 9121/2003 ‘Për Mbrojtjen e Konkurrencës’, i ndryshuar, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, e ndryshuar,

VENDOSI:

1. Miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në Rregulloren “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, si më poshtë:

Neni 10 i Rregullores ndryshohet si më poshtë:

1. Një kopje origjinale ose e njehsuar me origjinalen të njoftimit dhe të dokumenteve bashkëlidhur (të përcaktuara në formularin e njoftimit), duhet të dorëzohen në Zyrën e Arkiv Protokollit të Autoritetit të Konkurrencës.
2. Nuk ndryshon.
3. Nuk ndryshon.
4. Nuk ndryshon.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

UDHËZIME

UDHËZIM²⁴

Nr. 1, datë 25.06.2018

“Për kufizimet drejtpërdrejt të lidhura dhe të nevojshme me përqendrimet”

Komisioni i Konkurrencës, mbështetur në nenet 10,13, 24, germa dh, 25, germa c, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

UDHËZOJ:

Miratimin e Udhëzimit “Për kufizimet drejtpërdrejt të lidhura dhe të nevojshme me përqendrimet”.

HYRJJE

Udhëzimi, synon që ndërmarrjeve të interesuara t’u japë siguri ligjore nëpërmjet interpretimit të koncepteve të kufizimeve të lidhura drejtpërdrejtë dhe të nevojshme me përqendrimet. Rregullat e parashikuara në dispozitat e këtij Udhëzimi, pasqyrojnë thelbin e praktikave të Komisionit Evropian, dhe përcaktojnë parimet për vlerësimin dhe autorizimin e përqendrimeve, nga Autoritetet kombëtare.

I. PARIME TË PËRGJITHSHME

1. Një përqendrim i referohet marrëveshjeve kontraktore dhe marrëveshjeve që sjellin ndryshimin e qëndrueshëm të kontrollit, sipas nenit 10, të ligjit nr.9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar (këtu e në vazhdim ligji nr. 9121/2003). Të gjitha marrëveshjet që kanë si objekt kryesor përqendrimin si përshembull që lidhen me shitjen e aksioneve, apo aktiveve të një ndërmarrjeje, janë pjesë përbërëse e vetë përqendrimit. Përveç këtyre marrëveshjeve, palët në përqendrim mund të lidhin marrëveshje të tjera, të cilat nuk janë pjesë përbërëse e përqendrimit, por mund të kufizojnë deri diku lirinë e palëve, për veprime në treg. Nëse marrëveshje të tilla përmbajnë kufizime shtesë, të cilat janë direkt të lidhura me përqendrimin dhe të nevojshme për implementimin e këtij përqendrimit, këto kufizime do të jenë pjesë e vendimit të Komisionit të Konkurrencës, i cili e deklaron përqendrimin në përputhje me ligjin nr.9121/2003 dhe tregun përkatës ku ndodh përqendrimi. Në rast të kundërt, nëse nuk vlerësohen si të tilla, atëherë jemi para rastit kur këto efekte kufizuese do të vlerësohen sipas neneve 4 dhe 9 të ligjit nr.9121/2003.
2. Kriteret e lidhjes së drejtpërdrejt dhe të nevojshme për përqendrimet duhet të jenë objektive. Për rrjedhojë kufizimet nuk do të konsiderohen si drejtpërdrejtë të lidhura dhe të nevojshme për zbatimin e një përqendrimit, vetëm sepse palët i konsiderojnë ato si të tilla.
3. Në mënyrë që kufizimet të konsiderohen si “drejtpërdrejt të lidhura me implementimin e një përqendrimit”, ato duhet të jenë ngushtësisht të lidhura me vetë përqendrimin. Për këtë nuk mjafton vetëm fakti që marrëveshja të jetë lidhur në të njëjtin kontekst, ose në të njëjtën kohë me përqendrimin. Kufizimet e drejtpërdrejta të lidhura me përqendrimin janë ekonomikisht të lidhura me transaksionin kryesor dhe kanë për qëllim të lejojnë një tranzicion të qetë në strukturën e ndryshuar të shoqërisë pas përqendrimit.

²⁴ Sipas njoftimit të Komisionit Evropian (2005/C 56/03) “Për kufizime drejtpërdrejt të lidhura dhe të nevojshme me përqendrimet”
XIV / 2018

4. Marrëveshjet duhet të jenë “të nevojshme për zbatimin e përqendrimit”, gjë që do të thotë se, në mungesë të këtyre marrëveshjeve, përqendrimi nuk mund të zbatohet, ose mund të zbatohen vetëm në kushte mjaft të pasigurta, me kosto më të larta, për një periudhë kohore qartësisht më të gjatë, ose me vështirësi shumë më të mëdha. Marrëveshjet e nevojshme për zbatimin e një përqendrimit synojnë në mënyrë tipike të mbrojnë vlerën e transferuar, të ruajnë vazhdimësinë e furnizimit pas shpërbërjes së ish subjektit ekonomik, ose të bëjnë të mundur krijimin e një subjekti të ri juridik. Për të përcaktuar nëse një kufizim është i nevojshëm, duhet të merret parasysh jo vetëm natyra e tij, por të sigurohet që edhe kohëzgjatja e tij, objekti dhe zona gjeografike e zbatimit të mos e tejkalojnë atë që në mënyrë të arsyeshme kërkon zbatimin e përqendrimit. Në rast se mundësohen alternativa të tjera, të cilat janë njësoj efikase për të arritur synimin legjitim ndërmarrjet duhet të zgjedhin atë që është objektivisht më pak kufizuese për konkurrencën.
5. Për përqendrimet që kryhen në disa faza, rregullimet kontraktuale në lidhje me fazat përpara përftimit të kontrollit, normalisht nuk mund të konsiderohen kufizime të nevojshme dhe të lidhura drejtpërdrejtë për zbatimin e përqendrimit.
6. Megjithatë, marrëveshja për të hequr dorë nga ndryshimet materiale në veprimtarinë tregtare të ndërmarrjes deri në përfundimin e përqendrimit, konsiderohet drejtpërdrejt e lidhur dhe e nevojshme për zbatimin e ofertës së përbashkët. E njëjta gjë vlen, në kontekstin e një oferte të përbashkët, për marrëveshjen mes blerësve të përbashkët të një ndërmarrje, për të mos bërë oferta individuale konkurruese për të njëjtën ndërmarrje, ose për të përfituar kontrollin.
7. Marrëveshjet që shërbejnë për të lehtësuar përfitimin e përbashkët të kontrollit duhet të konsiderohen drejtpërdrejt të lidhura dhe të nevojshme për zbatimin e përqendrimit. Kjo do të zbatohet për marrëveshjet mes palëve për përfitimin e përbashkët të kontrollit që synon zbatimin e ndarjes së aktiveve, në mënyrë që të ndahen objektet e prodhimit, apo rrjetet e shpërndarjes mes tyre, bashkë me markat tregtare ekzistuese të ndërmarrjes, të përfituara bashkërisht.
8. Nëse një ndarje e tillë përfshin shpërbërjen e një njësie ekonomike ekzistuese, marrëveshjet që bëjnë të mundur këtë ndarje në kushte të arsyeshme, konsiderohen drejtpërdrejtë të lidhura dhe të nevojshme për zbatimin e përqendrimit, sipas karakteristikave të përcaktuara më poshtë.

II. PARIMET E ZBATUESHME NË RASTET E KUFIZIMEVE GJATË PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË NJË NDËRMARRJE

9. Kufizimet, për të cilat është rënë dakord mes palëve, në rast transferimi të një ndërmarrjeje mund të jenë në përfitim të blerësit, ose të shitësit. Në përgjithësi, nevoja e blerësit për të përfituar nga një mbrojtje e caktuar është më detyruese sesa nevoja nga ana e shitësit. Blerësi është ai, i cili ka nevojë të sigurohet që do të mund të përfitojë dhe gëzojë vlerën e plotë të biznesit të blerë. Si rregull i përgjithshëm, kufizimet që favorizojnë shitësin ose nuk janë drejtpërdrejtë të lidhura, apo të nevojshme, për zbatimin e përqendrimit, ose qëllimi dhe/ose kohëzgjatja e tyre, duhet të jenë më të kufizuara, se ato klauzola që favorizojnë blerësin.

A. Klauzola jo-konkurruese²⁵

10. Detyrimet jo-konkurruese të vendosura ndaj shitësit, në rastin e transferimit të një ndërmarrjeje, ose të një

²⁵Në një kontratë, një klauzolë jo-konkurruese është një klauzolë në të cilën njëra palë (zakonisht një punonjës) bie dakord të mos kryej një profesion të ngjashëm ose të mos bëjë tregti konkurruese më palën tjetër (zakonisht punëdhënësi). Disa gjykata i referohen këtyre marrëveshjeve si "marrëveshje kufizuese". https://en.wikipedia.org/wiki/Non-compete_clause

pjesë të saj, mund të jenë drejtpërdrejt të lidhura dhe të nevojshme për zbatimin e përqendrimit. Për të siguruar vlerën e plotë të aktiveve të transferuara, blerësi duhet të përfitojë një lloj mbrojtjeje ndaj konkurrencës nga shitësit, për të fituar besimin e konsumatorëve dhe për të përvetësuar dhe shfrytëzuar njohuritë (know-how). Këto klauzola jo-konkurrese i garantojnë blerësit transferim tëvlerës së plotë të aktiveve, të cilat në përgjithësi përfshijnë aktive të trupëzuara dhe aktivet të patrupëzuara, të tilla si emri i mirë ose përvoja (know-how) e zhvilluar nga shitësi. Këto klauzola, jo vetëm që lidhen drejtpërdrejt me përqendrimin, por janë të nevojshme edhe për zbatimin e tij, sepse mungesa e tyre, do të vështirësonte, apo do të pengonte shitjen e ndërmarrjes, apo e një pjesë të saj.

11. Megjithatë, këto klauzola jo-konkurrese justifikohen vetëm nga objektivat e ligjshme të zbatimit të përqendrimit, në rast se kohëzgjatja e tyre, zona gjeografike e zbatimit, objekti i tyre dhe personat e lidhur me to nuk e tejkalojnë atë ç'ka është e nevojshme për arritjen e tyre.
12. Klauzolat jo-konkurrese justifikohen për periudha deri në 3 (tre) vjet, në rastet kur transferimi i ndërmarrjes përfshin transferimin e besimit të konsumatorëve, në formën e emrit të mirë dhe përvojës (know-how). Në rast se përfshihet vetëm emri i mirë, (pa përfitimin e përvojës (know-how).) ato justifikohen për periudha deri në 2 (dy) vjet.
13. Në të kundërt, klauzolat jo-konkurrese nuk mund të konsiderohen të nevojshme, në rast se transferimi është i kufizuar në aktive të trupëzuara (si p.sh.m. toka, ndërtesa, apo makineri-pajisje), apo në të drejta ekskluzive të pronësisë industriale dhe tregtare, mbajtësit e të cilëve mund të marrin masa të menjëhershme kundër shkeljeve nga transferuesi i këtyre të drejtave.
14. Shtrirja gjeografike e një klauzole jo-konkurrese duhet të kufizohet në zonën, në të cilën shitësi ka ofruar produkte, apo shërbimet përkatëse përpara transferimit, pasi blerësi nuk ka nevojë të jetë i mbrojtur ndaj konkurrencës nga shitësi në territore të paprekura më parë nga ai. Shtrirja gjeografike vepron në territore në të cilat shitësi ka planifikuar të hyjë në momentin e transaksionit, me kusht që të ketë investuar më parë për këtë transaksion.
15. Po ashtu, klauzolat jo-konkurrese duhet të kufizohen për produkte (duke përfshirë versionet e përmirësuara, ose të përditësuara të produkteve, si dhe modeleve pasardhëse) dhe shërbimet që përbëjnë veprimtarinë ekonomike të ndërmarrjes së transferuar. Këtu mund të përfshihen produkte dhe shërbime në një fazë të përparuar të zhvillimit, në kohën e transaksionit, ose produkte, të cilat janë zhvilluar plotësisht, por që ende nuk tregtohen. Mbrojta kunder konkurrencës nga shitësi në tregjet e produkteve apo shërbimeve ku ndërmarrja e zhvendosur nuk ka qenë aktive para transferimit, nuk konsiderohet e nevojshme.
16. Shitësi mund të bëjë objekt detyrimi veten, filialet e tij dhe agjentët tregtar. Megjithatë, detyrimi për të vendosur kufizime të ngjashme për të tjerët nuk do të konsiderohet si drejtpërdrejt i lidhur dhe i nevojshëm për zbatimin e përqendrimit. Kjo vlen, në veçanti, për klauzola që kufizojnë lirinë e për të rishitur, apo përdoruesve për import, ose eksport.
17. Klauzolat që kufizojnë të drejtën e shitësit për të blerë apo për të mbajtur aksione në një shoqëri konkurren të biznesit të transferuar, konsiderohen drejtpërdrejt të lidhura dhe të nevojshme për zbatimin e përqendrimit, sipas të njëjtave kushte të përshkruara më sipër për klauzolat jo-konkurrese, me përjashtim të rastit kur ato parandalojnë shitësin nga blerja apo zotërimi i aksioneve vetëm për qëllime investimi financiar, pa i dhënë atij/asaj, drejtpërdrejt, ose tërthorazi, funksione administruese, apo ndonjë funksion tjetër ndikues në shoqërinë konkurren të.

18. Klauzolat mos-përfshirëse²⁶ dhe të konfidencialitetit²⁷ kanë një efekt të krahasueshëm dhe si të tilla ato vlerësohen në mënyrë të ngjashme me klauzolat jo-konkurruese.

B. Marrëveshjet e licencimit

19. Transferimi i ndërmarrjes, apo i një pjese të saj, mund të përfshijë transferimin të blerësi, për të shfrytëzuar plotësisht aktivitetet e transferueshme, të drejtat e pronësisë intelektuale, apo të përvojës (know – how). Megjithatë, shitësi mund të mbetet titullar i të drejtave, për t'i shfrytëzuar ato, për aktivitete të ndryshme nga ato të transferuara. Në këto raste, mënyra e zakonshme për t'u siguruar se blerësi do të gëzojë përdorimin e plotë të aktiveve të transferuara është nënshkrimi i marrëveshjeve të licencimit në favor të tij/saj. Po kështu, kur shitësi transferon, bashkë me veprimtarinë tregtare, të drejtat e pronësisë intelektuale, ai mund të vazhdojë të përdorë disa, apo të gjitha, këto të drejta, për veprimtari të tjera, të ndryshme nga ato të transferuara. Në të tilla raste blerësi i jep një licencë shitësit.
20. Licenca e patentave, të pronësisë industriale, apo të drejtave të ngjashme, si dhe ato të përvojës (know – how) mund të konsiderohen të nevojshme për zbatimin e përqendrimit. Gjithashtu, ato mund të konsiderohen si pjesë përbërëse e përqendrimit dhe në çdo rast nuk është e nevojshme të jenë me afat të kufizuar. Këto licenca mund të jenë të thjeshta apo ekskluzive dhe mund të kufizohen në disa fusha të caktuara përdorimi, deri në masën që përkohet me aktivitetet e ndërmarrjes së transferuar.
21. Megjithatë, kufizimet territoriale për prodhimin që pasqyrojnë territorin e aktivitetit të transferuar nuk janë të nevojshme për zbatimin e transaksionit. Për sa i përket licencave që shitësi i një veprimtarie tregtare i jep blerësit, shitësi mund të bëhet objekt i kufizimeve territoriale në marrëveshjen e licencimit, sipas të njëjtave kushte të përcaktuara për klauzolat jo-konkurruese në kontekstin e shitjes së një veprimtarie tregtare.
22. Kufizimet në marrëveshjet e licencimit që shkojnë përtej dispozitave të mësipërme, si p.sh. ato që mbrojnë licencuesin dhe jo të licencuarin, nuk janë të nevojshme për zbatimin e përqendrimit.
23. Po ashtu, në rastin e licencave të markave tregtare, emrave tregtar, të drejtës të dizajnit, të drejtave të autorit apo të drejtave të tjera të lidhura me to, mund të ketë situata ku shitësi dëshiron të mbetet titullar (pronar) i të drejtave të tilla në lidhje me aktivitetet e mbajtura prej tij, por nga ana tjetër blerësit i duhen këto të drejta për të shitur mallrat apo shërbimet e ofruara nga ndërmarrja apo nga ajo pjesë e ndërmarrjes që është transferuar. Këtu, zbatohen të njëjtat elementë si më sipër.

C. Detyrimet e blerjes dhe furnizimit

24. Në shumë raste, transferimi i një ndërmarrje ose i një pjese të saj mund të sjellë ndërprerje të linjave tradicionale të blerjes dhe furnizimit, të cilat kanë ekzistuar si rezultat i integritetit të mëparshëm të aktiviteteve në kuadër të unitetit ekonomik të shitësit. Për të mundësuar shpërbërjen e unitetit ekonomik të shitësit dhe transferimin e pjesshëm të aktiveve të blerësi, në kushte të arsyeshme, shpesh është e nevojshme të ruhen, për një periudhë të përkohshme, lidhjet ekzistuese apo të ngjashme mes shitësit dhe blerësit. Ky objektivi arrihet normalisht përmes detyrimeve të blerjes dhe furnizimit për shitësin dhe/ose

²⁶ Një marrëveshje mospërfshirëse është një premtim i bërë ndërmjet blerësit dhe shoqërisë target, që për një periudhë të caktuar kohe pas transaksionit, ato nuk do të angazhohen në marrëdhënie tregtare, e cila do të ishte konkurruese me shoqërinë ekzistuese ose të përfshirë, dhe nuk do të përpiqen të marrin klientët ose punonjësit e njëri-tjetrit. Kjo marrëveshje është veçanërisht e rëndësishme kur një ndërmarrje më e madhe blen një ndërmarrje më të vogël që vepron në të njëjtën industri. (<https://www.divestopedia.com/definition/4943/non-solicitation-agreement>)

²⁷ Një marrëveshje konfidencialiteti është një kontratë ndërmjet të paktën dy palëve, ku përshkruhet rëndësia e konfidencialitetit, njohurisë ose informacionit që palët dëshirojnë të ndajnë me njëri-tjetrin për qëllime të caktuara, por dëshirojnë të kufizojnë aksesin nga palët e treta. Nëpërmjet kësaj marrëveshje krijohet një marrëdhënie konfidenciale mes palëve për të mbrojtur çdo lloj informacioni konfidencial dhe/ose sekrete tregtare. (https://en.wikipedia.org/wiki/Non-disclosure_agreement)

blerësin e ndërmarrjes ose të një pjese të saj. Duke patur në konsideratë situatën specifike që rezulton nga shpërbërja e unitetit ekonomik të shitësit, detyrime të tilla, të cilat mund të cojnë në kufizime për konkurrencën, mund të njihen si të nevojshme dhe drejtpërdrejt të lidhura për zbatimin e përqendrimit. Ato mund të jenë në favor të shitësit si dhe të blerësit, në varësi të rrethanave të veçanta të rastit.

25. Qëllimi i detyrimeve të tilla mund të jetë garantimi i vazhdimësisë së furnizimit si për palën e shitësit në lidhje me produktet e nevojshme për të kryer aktivitetet e mbajtur nga ai ashtu edhe për blerësn në lidhje me aktivitetin e ndërmarr nga ai. Megjithatë, kohëzgjatja e detyrimeve të blerjes dhe furnizimit, duhet të kufizohet në një periudhë të nevojshme për zëvendësimin e marrëdhënies së varësisë nga autonomia në treg. Kështu që, detyrimet e blerjes apo furnizimit, që synojnë garantimin e sasive të furnizuara më parë mund të justifikohen për një periudhë të përkohshme deri në 5 (pesë) vjet.
26. Si detyrimet e furnizimit ashtu edhe ato të blerjes për sasitë fikse, mundësisht me një klauzolë ndryshimi, njihen si drejtpërdrejt të lidhura dhe të nevojshme për zbatimin e përqendrimit. Megjithatë, detyrimet lidhur me sasitë e pakufizuara, për ekskluzivitet apo për dhënien e statusit të furnitorit të preferuar, apo blerësit të preferuar nuk janë të nevojshme për zbatimin e përqendrimit.
27. Marrëveshjet e shërbimit dhe të shpërndarjes janë të barasvlershme me marrëveshjet e furnizimit, rrjedhimisht zbatohen të njëjtët elementë si më sipër.

III. PARIMET E ZBATUESHME NË RASTET E KUFIZIMEVE GJATË KRIJIMIT TË NDËRMARRJEVE TË PËRBASHKËTA/JOINT VENTURE.

A. Detyrime jo-konkurruese

28. Ndërmarrjet e përbashkëta, të njohura si joint venture, formohen si rrjedhojë e përqëndrimeve në zbatim të nenit 10, pika 1, germa c; dhe pikës 3, të ligjit nr.9121/2003. Një detyrim jo-konkurrues, mes ndërmarrjes “mëmë” dhe një joint venture, mund të konsiderohet drejtpërdrejt i lidhur dhe i nevojshëm për zbatimin e përqendrimit, në rastet kur detyrime të tilla përkojnë me produktet, shërbimet dhe territoret e mbuluara nga marrëveshja joint venture e shoqërive, ose nga statuti/rregullorja e tyre. Klauzola të tilla jo-konkurruese reflektojnë, *inter alia*, nevojën për të siguruar mirëbesim gjatë negociatave. Gjithashtu mund të pasqyrojnë nevojën për të shfrytëzuar plotësisht aktivet e joint venture, apo për t’i mundësuar asaj të përvetësojë njohuritë (know – how), si dhe emrin e mirë, të siguruar nga “shoqëria mëmë”; ose nevojën për të mbrojtur interesat e “shoqërisë mëmë” në këtë joint venture, përkundër veprimeve të tjera konkurruese, *inter alia*, me anë të aksesit të privilegjuar të “shoqërisë mëmë” në përvojën (know – how) dhe emrin e mirë të transferuar, apo zhvilluar nga joint venture. Këto detyrime jo-konkurruese ndërmjet “shoqërive-mëma” dhe joint venture, mund të konsiderohen si drejtpërdrejt të lidhura dhe të nevojshme për zbatimin e përqendrimit, gjatë gjithë jetëgjatësisë së joint venture.
29. Shtrirja gjeografike e një klauzole jo-konkurruese duhet të kufizohet në zonën ku “shoqëritë mëma” kanë ofruar produktet, apo shërbimet përkatëse, përpara krijimit të joint venture. Kjo shtrirje gjeografike mund të zgjerohet edhe në territore, ku “shoqëritë mëma” kanë planifikuar të hyjnë në momentin e transaksionit, me kusht që të kenë investuar më parë për këtë transaksion.
30. Po ashtu, klauzolat jo-konkurruese duhet të kufizohen për produkte dhe shërbime, të cilat përbëjnë veprimtarinë ekonomike të joint venture. Këtu mund të përfshihen produkte dhe shërbime, në një fazë të avancuar të zhvillimit në momentin e transaksionit, si edhe produkte dhe shërbime, të cilat janë zhvilluar plotësisht, por që ende nuk tregtohen.
31. Nëse joint venture krijohet për të hyrë në një treg të ri, bëhet referimi në produktet, shërbimet dhe territoret, në të cilat joint venture do të operojë, sipas marrëveshjes apo rregulloreve të tij. Megjithatë, prezumohet se

interesi i njërës “shoqërie mëmë” në joint venture nuk ka nevojë të mbrohet nga konkurrenca e shoqërisë tjetër “mëmë” në tregje të tjera, të ndryshme nga ato, ku joint venture do të jetë aktive që nga fillimi.

32. Përveç kësaj, detyrimet jo-konkurruese ndërmjet “shoqërive mëma” jo-kontrolluese dhe një joint venture, nuk janë drejtpërdrejt të lidhura dhe të nevojshme për zbatimin e përqendrimit.
33. Të njëjtat rregulla dhe karakteristika, si për klauzolat jo-konkurruese, zbatohen edhe për klauzolat mospërfshirëse dhe klauzolat e konfidencialitetit.

B. Marrëveshjet e Licensave

34. Licencat e dhëna nga shoqëritë “mëma” për joint venture mund të konsiderohen drejtpërdrejt të lidhura dhe të nevojshme për zbatimin e përqendrimit. Kjo zbatohet pavarësisht faktit nëse licencat janë ekskluzive dhe nëse janë, apo jo, me afat të kufizuar. Licenca mund të kufizohet në një fushë të veçantë përdorimi, e cila përkon me veprimtarinë e joint venture.
35. Licencat e dhëna nga joint venture për një nga “shoqëritë mëma”, apo marrëveshjet e ndër-licencimit, mund të konsiderohen si drejtpërdrejt të lidhura dhe të nevojshme për zbatimin e përqendrimit, sipas të njëjtave kushte, si në rastin e blerjes së një ndërmarrjeje. Marrëveshjet e licencës ndërmjet shoqërive mëma nuk konsiderohen si drejtpërdrejt të lidhura dhe të nevojshme për zbatimin e përqendrimit.

C. Detyrimet e Blerjes, ose të Furnizimit

36. Nëse shoqëritë mëma mbeten të pranishme në tregun e *rrjedhjes së sipërme*, apo në tregun e *rrjedhjes së poshtëme* me atë të joint ventures, çdo marrëveshje blerje dhe shitje duke përfshirë edhe marrëveshjet e shërbimit dhe të shpërndarjes u nënshtrohet të njëjtave parime të zbatueshme si në rastin e transferimit të një ndërmarrjeje.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

UDHËZIM²⁸

Nr. 2, datë 20.12.2018

“Për zbatimin e rregullave të konkurrencës në vlerësimin e marrëveshjeve të aksesit në sektorin e telekomunikacionit”

Komisioni i Konkurrencës, mbështetur në nenet 4, 9, 10, 13, 24, gërma dh, 25, gërma c, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

UDHËZOJ:

Miratimin e Udhëzimit “Për vlerësimin e marrëveshjeve në sektorin e telekomunikacionit”.

HYRJE

Në tregun e telekomunikacioneve, marrëveshjet e aksesit janë të rëndësishme në lejin e pjesëmarrësve të tregut për të përfituar nga liberalizimi.

QËLLIMI

1. Përcaktimi i parimeve të aksesit, që burojnë nga Ligji 9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, në mënyrë që të krijohet një siguri më e madhe në treg dhe kushtet për investime dhe nisma tregtare në sektorët e telekomunikacionit dhe multimedias;
2. Përcaktimi dhe qartësimi i marrëdhënies midis ligjit të konkurrencës dhe legjislacionit në fushën e telekomunikacioneve (veçanërisht kjo lidhet me marrëdhënien ndërmjet rregullave të konkurrencës dhe legjislacionit për ofrimin e rrjetit të hapur);
3. Shpjegimi/sqarimi se si rregullat e konkurrencës do të zbatohen në mënyrë të qëndrueshme në të gjithë sektorët e përfshirë në ofrimin e shërbimeve të reja dhe në veçanti për të pasur akses në çështjet e këtij konteksti.

TË PËRGJITHSHME

1. Trajtimi i marrëveshjeve të aksesit në sektorin e telekomunikacionit mund të kryhet edhe sipas rregullave të konkurrencës. Ky udhëzim trajton çështjet se si rregullat dhe procedurat e konkurrencës zbatohen për marrëveshjet e aksesit.
2. Në sektorin e telekomunikacioneve, legjislacioni i liberalizimit dhe harmonizimit lejon dhe thjeshton aktivitetin e ndërmarrjeve në treg, në nisjen e aktiviteteve të reja në tregje të reja dhe rrjedhimisht i lejon përdoruesit të përfitojnë nga rritja e konkurrencës. Këto avantazhe të ndërmarrjeve nuk duhet të rrezikohen nga praktikatat kufizuese ose abuzive të ndërmarrjeve të tjera. Rregullat e konkurrencës në treg janë të rëndësishme për të siguruar përfundimin me sukses të këtij zhvillimi. Hyrësve të rinj duhet që t'i garantohen të drejtat për të pasur akses, që në fazat fillestare, në rrjetet e operatorëve ekzistues të telekomunikacioneve (OT/TO/*Telecommunication Operators*). Autoritete të ndryshme, në nivel rajonal, kombëtar dhe komunitar, kanë një rol në rregullimin e këtij sektori. Nëse procesi i konkurrencës do të funksionojë mirë në tregun e brendshëm, duhet të sigurohet koordinimi efektiv ndërmjet këtyre

²⁸ (31998Y0822 (01)); Njoftim për aplikimin e rregullave të konkurrencës në vlerësimin e marrëveshjeve në sektorin e telekomunikacionit (98/C 265/02)

institucioneve.

3. *Pjesa I* e Udhëzimit përcakton kuadrin ligjor dhe detajon se si mund të shmangët dublikimi i panevojshëm i procedurave, duke mbrojtur të drejtat e ndërmarrjeve dhe përdoruesve sipas rregullave të konkurrencës. Në sektorin e telekomunikacionit, procedurat specifike në kuadër të dispozitave të tregut të hapur²⁹ gjithashtu synojnë në zgjidhjen e problemeve të aksesit, në radhë të parë në një nivel të decentralizuar, kombëtar. *Pjesa II* përcakton qasjen që do të ndiqet për përcaktimin e tregut në këtë sektor. *Pjesa III* detajon parimet që do të ndiqen në zbatimin e rregullave të konkurrencës. Qëllimi është të ndihmojë pjesëmarrësit e tregut të telekomunikacioneve të hartojnë marrëveshjet e tyre të aksesit, duke shpjeguar kërkesat e ligjit për konkurrencën. Parimet e përcaktuara në këtë Udhëzim zbatohen jo vetëm për tregjet e telekomunikacionit tradicional fiks, por edhe për të gjitha tregjet e tjera të telekomunikacionit, duke përfshirë fusha të tilla si komunikimet satelitore dhe komunikimet nëpërmjet telefonisë celulare.

PJESA I

1. Kuadri Ligjor

Rregullat e konkurrencës dhe rregulloret specifike të sektorit.

1. Problemet e aksesit, në kuptimin më të gjerë të fjalës, mund të trajtohen në nivele të ndryshme dhe në bazë të një sërë dispozitash ligjore, bazuar në origjinën kombëtare dhe atë të Bashkimit Evropian. Një ofrues i shërbimeve mund të parashikojë disa zgjidhje në rastet kur përballlet me një problem aksesit, siç është refuzimi i pajustifikuar i OT-së për të dhënë (me kushte të arsyeshme) me qera një linjë të cilën aplikuesi e ka të nevojshme për të ofruar shërbime për klientët e tij. Në përgjithësi, palët e dëmtuara do të kenë një numër përfitimesh, të paktën në një fazë fillestare, për të kërkuar dëmshpërblim në nivel kombëtar. Në nivel kombëtar, aplikanti ka dy zgjedhje kryesore, përkatësisht: (1) procedurat kombëtare specifike rregullatorë, dhe (2) një veprim sipas ligjit kombëtar përpara se të kalojë në një gjykatë kombëtare ose tek autoritetit kombëtar i konkurrencës.
2. Ankesat që i drejtohen Autoritetit të Konkurrencës (AK) në zbatim të rregullave të konkurrencës, pavarësisht atyre ankesave që iu janë drejtuar gjykatave, AK do t'i trajtojë sipas prioritetit, duke pasur parasysh urgjencën, risinë dhe natyrën e problemit të përfshirë, dhe duke marrë parasysh nevojën për të shmangur procedurat e dubluara.
3. Autoriteti i Konkurrencës, gjatë ushtrimit të funksioneve të tij, zbaton rregullat e konkurrencës. *Së pari*, entet rregullatore veprojnë sipas ligjit kombëtar. *Së dyti*, ky ligj, mund të ketë objektiva të ndryshme, por zakonisht ato janë në përputhje me objektivat e politikës së konkurrencës së Bashkimit Evropian, i cili bashkëpunon sa më shumë të jetë e mundur me entet rregullatore.
4. Rregullat e konkurrencës nuk janë të mjaftueshme për të ndrequr të gjitha problemet e ndryshme në sektorin e telekomunikacionit. Prandaj, entet rregullatore kanë një ndikim më të gjerë dhe një rol të rëndësishëm në rregullimin e sektorit.
5. Duhet të theksohet se legjislacioni për ORH-së i imponojnë OT-ve, të cilat kanë fuqi të ndjeshme në treg (OFNT³⁰) në treg, detyrime të caktuara lidhur me transparencën dhe mosdiskriminimin. Direktivat e ORH-së përcaktojnë detyrimet që kanë të bëjnë me transparencën, detyrimet për të furnizuar/ofruar shërbime dhe praktikën e vendosjes së çmimeve. Këto detyrime zbatohen nga entet rregullatore, të cilat gjithashtu kanë juridiksion për të ndërmarrë hapa për të siguruar konkurrencën efektive.
6. Udhëzimi është hartuar sikur të kishte një operator në tregun e telekomunikacionit, që ka pozitë

²⁹ ONP Framework: *Open Network Provision*-Ofrimi i Rrjetit të Hapur (OHR)

³⁰ OFNT-Operatorë me Fuqi të Ndjeshme në Treg

dominuese. por sigurisht mund të ketë edhe raste të tjera, për shembull; rrjetet e reja të telekomunikacionit që ofrojnë mbulim gjithnjë e më të gjerë, do të zhvillohen në mënyrë progresive. Këto rrjete alternative të telekomunikacionit mund të jenë detyruesisht të mëdha dhe të gjera mjaftueshëm për të qenë pjesërisht, ose madje plotësisht zëvendësues për rrjetet ekzistuese kombëtare. Ekzistenca dhe pozicioni në treg i operatorëve konkurrues do të jetë i rëndësishëm në përcaktimin e pozitës dominuese të vetme ose të përbashkët.

7. Duke pasur parasysh përgjegjësinë për zbatimin e politikës së konkurrencës, Autoriteti i Konkurrencës duhet t'i shërbejë interesit të përgjithshëm. Burimet administrative mund të jenë të kufizuara dhe nuk mund të përdoren për t'u marrë me të gjitha rastet e paraqitura në vëmendjen e tij. Prandaj, në përgjithësi, duhet të merren të gjitha masat organizative të nevojshme për kryerjen e detyrave dhe në veçanti, në përcaktimin e prioriteteve.
8. Autoriteti i Konkurrencës, nëpërmjet kompetencave që i ka dhënë Ligji 9121/2003, përqendrohet në njoftimet, ankesat dhe procedurat, të cilat kanë rëndësi për tregun.
9. Njoftimi i një marrëveshjeje aksesi tek enti rregullator nuk bën të panevojshme njoftimin e saj pranë Autoritetit të Konkurrencës. Entet rregullatore duhet të sigurojnë që veprimet e ndërmarra prej tyre janë në përputhje me ligjin e konkurrencës. Kjo kërkon që entet rregullatore në veprimet e tyre të sigurojnë mbrojtjen efektive të rregullave të konkurrencës. Prandaj, ata nuk mund të miratojnë marrëveshje, që janë në kundërshtim me rregullat e konkurrencës.
10. Marrëveshjet e aksesit, në parim rregullojnë ofrimin e shërbimeve të caktuara ndërmjet ndërmarrjeve të pavarura dhe nuk çojnë në krijimin e një njësie të pavarur, e cila do të ishte e dallueshëm nga palët e marrëveshjeve. Marrëveshjet e aksesit janë përgjithësisht jashtë objektit dhe nuk trajtohen sipas rregullave të përqendrimeve.
11. Autoritetit të Konkurrencës mund t'i drejtohen, duke kërkuar lidhur me një çështje që lidhet me marrëveshjet e aksesit nëpërmjet: (a) njoftimit të një marrëveshjeje aksesi nga një ose më shumë palë të përfshira; (b) përmes një ankese kundër një marrëveshjeje aksesi kufizuese, ose kundër sjelljes së një kompanie dominuese në dhënien ose refuzimin e aksesit, (c) nëpërmjet një procedure të iniciuar nga vetë Autoriteti, ose nëpërmjet një studimi tregu. Përveç kësaj, një ankimues mund të kërkojë që Autoriteti i Konkurrencës të marrë masa të përkohshme (masa të ndërmjetme ose kushte dhe detyrime) në rrethanat kur ka rrezik të menjëhershëm për dëm serioz dhe të pariparueshëm për ankimuesin ose për interesin publik. Sidoqoftë, duhet të theksohet se në çdo rast, përveç Autoritetit të Konkurrencës, ekziston edhe mundësia e një ankese pranë gjykatave kompetente, në mënyrë që t'i japin fund shkeljeve.
12. Ekzistojnë shumë sektorë, ku marrëveshjet do t'i nënshtrohen edhe rregullave të konkurrencës dhe rregullave specifike sipas sektorëve specifike. Ndërmarrjet që veprojnë në sektorin e telekomunikacionit duhet të jenë të vetëdijshme se veprimtaria e tyre të jetë në pajtueshmëri me rregullat e konkurrencës.

2. Veprimtaria e Autoritetit të Konkurrencës në lidhje me marrëveshjet e aksesit

Marrëveshjet e aksesit, të marra si një e tërë, janë të një rëndësie të madhe dhe për këtë arsye është e përshtatshme që Autoriteti i Konkurrencës të përcaktojë sa më qartë kuadrin ligjor, brenda të cilës duhet të zgjidhen dhe sqarohen këto marrëveshje. Duhet patur parasysh nëse kemi raste ku këto marrëveshje duhet të trajtohen sipas nenit 4 apo nenit 9 të Ligjit 9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.

2.1 Njoftimet

Në zbatimin e rregullave të konkurrencës, Autoriteti i Konkurrencës do të mbështetet në kuadrin ligjor në fuqi. Rastet kur marrëveshjet përfitojnë nga ndalimi i përjashtimit sipas parashikimeve të nenit 5 dhe 6 të Ligjit 9121/2003, ato njoftohen pranë Autoritetit të Konkurrencës.

a. Ankesat

Personat fizikë ose juridikë, të cilët kanë një interes të ligjshëm, mund të paraqesin në rrethana të caktuara një ankesë pranë Autoritetit të Konkurrencës, duke kërkuar që AK me vendim të kërkojë që të ndalohet shkelja dhe të ndërpritet sipas parashikimeve të nenit 4 dhe 9 të ligjit 9121/2003. Një ankimues, gjithashtu mund të kërkojë që Autoriteti i Konkurrencës, të marrë masa të përkohshme kur ka një rrezik urgjent të dëmit serioz dhe të pariparueshëm. Një ankues i mundshëm ka edhe mundësi të tjera, siç është p.sh ankimi pranë gjykatës kompetente. Edhe gjykatat mund të ofrojnë avantazhe për individë dhe ndërmarrjet:

- a) gjykatat mund të shqyrtojnë dhe shprehen lidhur me dëmet që rrjedhin nga një shkelje e rregullave të konkurrencës;
- b) gjykatat mund të miratojnë masa të përkohshme dhe të urdhërojnë ndërprerjen e një shkelje;
- c) shpenzimet dhe kostot mund t'i jepen aplikantit të suksesshëm (përpara/në) nga një gjykatë.

b. Përdorimi i procedurave kombëtare

1. Siç u tha më lart, Autoriteti i Konkurrencës synon mbrojtjen e konkurrencës së lire dhe efektive në treg. Në vlerësimin dhe ruajtjen e këtij synimi, AK shqyrton rëndësinë e shkeljes në lidhje me funksionimin e tregut, mundësinë për të vërtetuar ekzistencën e shkeljes duke kryer edhe procedura investigative me qëllim respektimin e dispozitave të ligjit dhe ndalimin e rasteve të shkeljeve sipas neneve 4 dhe 9 të Ligjit.
2. Për sa i përket veprimeve para enteve rregullatore, entet rregullatore duhet të marrin parasysh “nevojën për të nxitur një treg konkurrues” dhe mund të vendosin kushte për një ose më shumë palë, inter-alia “për të siguruar konkurrencë efektive”.
3. Në çdo rast, Autoriteti i Konkurrencës mund të bashkëpunojë me entet rregullatore për të shmangur procedurat e filluara nga disa autoritete apo institucione njëkohësisht.

c. Ruajtja e të drejtave të ankimuesit

1. Duhet patur parasysh se në sektorin e telekomunikacionit, ciklet e inovacionit janë relativisht të shkurtra dhe çdo vonesë substanciale në zgjidhjen e mosmarrëveshjes në praktikë, mund të jetë ekuivalent në praktikë me refuzimin e aksesit, duke paragjykuar kështu zgjidhjen përfundimtare të rastit.
2. Për këtë arsye, një mosmarrëveshje aksesi duhet të zgjidhet brenda një periudhe të arsyeshme kohore, në mënyrë që të mos kalojë një kohë e gjatë, pa pasur vëmendjen e institucionit. Në këtë mënyrë do të mbroheshin të drejtat e ankimuesit.
3. Përveç kësaj, Autoriteti i Konkurrencës shqyrton rast pas rasti. Ai do të ndërmar veprime, nëse mendon se në një rast të veçantë ekziston një interes, i cili prek ose mund të ndikojë konkurrencën në treg.

d. Masat e përkohshme

1. Për sa i përket çdo kërkesë për masa të përkohshme, ekzistenca ose mundësia e procedurave përkatëse është e rëndësishme për të përcaktuar nëse ekziston rreziku i dëmit serioz dhe të pariparueshëm. Procedura të tilla duhet që fillimisht të shmangin rrezikun nga një dëm i tillë i pariparueshëm dhe për këtë arsye nuk do të ishte e përshtatshme që Autoriteti i Konkurrencës të marrë masa të përkohshme në mungesë të provave, që një rrezik i tillë ekziston vërtet në treg.
2. Mundësia e dhënies së masave të përkohshme dhe kriteret në dhënien e këtyre masave janë faktorë të rëndësishëm, që Autoriteti i Konkurrencës duhet të marrë parasysh për arritjen e konkluzioneve të tij. Në rast se nuk mund të jepen të tilla masa të përkohshme, ose këto masa nuk ka të ngjarë të mbrojnë të drejtat e ankimuesit, atëherë Autoriteti i Konkurrencës do të marrë në konsideratë faktin që procedura të tilla nuk shmangin rrezikun e dëmit dhe prandaj mund të fillojnë shqyrtimin e çështjes.

3. Hetimet e nisura nga vetë Autoriteti i Konkurrencës dhe studimet e tregut

Nëse është e nevojshme, Autoriteti i Konkurrencës do të hapë një hetim me nismën e vet. Ai, gjithashtu, mund të fillojë një studim tregu, për rastin në fjalë.

3.1.Gjobat

1. Autoriteti i Konkurrencës mund të vendosë gjoba deri në 10% të xhiros totale të vitit të kaluar kalendarik mbi ndërmarrjet që shkelin nenin 4 ose nenin 9 të Ligjit 9121/2003). Kur marrëveshjet janë njoftuar në përputhje me nenet 5 dhe 6 të ligjit, nuk mund të vendoset gjoba nga Autoriteti në lidhje me aktivitetet e përshkruara në njoftim, për periudhën pas njoftimit. Sidoqoftë, Autoriteti i Konkurrencës mund të tërheqë imunitetin nga gjobat duke informuar ndërmarrjet e interesuara që, pas shqyrtimit paraprak, është i mendimit të zbatohet neni 4 i ligjit dhe se zbatimi i nenit 5/6) nuk është i justifikuar dhe nuk mbështetet në dispozitat ligjore.
2. Autoriteti i Konkurrencës do të vendos penalitete dhe gjoba mbi ndërmarrjet në rastet kur:
 - a) marrëveshja dëshmon të përmbajë dispozita në kundërshtim me nenin 9; dhe / ose
 - b) shkelja e nenit 4 është veçanërisht serioze.Metoda e përllogaritjes së gjobave kryhet sipas dispozitave të Ligjit dhe të Rregullores “Për Gjobat dhe lehtësimin prej tyre”.
3. Njoftimi i kryer pranë entit rregullator nuk zëvendëson një njoftim, i cili duhet të kryhet pranë Autoritetit të Konkurrencës, duke mos kufizuar mundësinë që palët e interesuara të paraqesin një ankesë pranë AK, ose që AK të fillojë një hetim me nismën e vet për marrëveshjet e aksesit. Gjithashtu, një njoftim i tillë nuk kufizon të drejtat e një pale për të kërkuar dëmshpërblim para një gjykate kombëtare për dëmin e shkaktuar nga marrëveshjet antikonkurrese.

Pjesa II

1. Tregjet Përkatëse

1. Gjatë rasteve hetimore, brenda kuadrit ligjor të përcaktuar në Pjesën I më lart, Autoriteti i Konkurrencës do të bazohet në qasjen ndaj përcaktimit të tregjeve përkatëse sipas parashikimeve edhe të Udhëzimit “Për përcaktimin e tregut përkatës”.
2. Ndërmarrjet u nënshtrohen tre burimeve kryesore të kufizimeve konkurruese: zëvendësimi i kërkesës, zëvendësimi i ofertës dhe konkurrenca potenciale. Zëvendësimi i kërkesës përbën forcën disiplinore më efektive dhe më të shpejtë mbi furnizuesit/ofruesit e një produkti ose shërbimi të caktuar. Zëvendësueshmëria e kërkesës është pra mjeti kryesor që përdoret për të përcaktuar tregun përkatës të produktit, në të cilin mund të identifikohen kufizimet e konkurrencës për qëllimet e zbatimit të nenit 4 dhe 9 të ligjit.
3. Zëvendësueshmëria e ofertës mundet që në rrethana të përshtatshme të përdoret si një element plotësues për të përcaktuar tregjet përkatëse. Në fakt, në praktikë nuk mund të dallohet qartë nga konkurrenca potenciale. Zëvendësueshmëria e ofertës dhe konkurrenca potenciale përdoren me qëllim për të përcaktuar nëse ndërmarrja ka një pozitë dominuese, ose nëse kufizimi i konkurrencës është i rëndësishëm në kuptim të nenit 4, ose nëse ekziston eliminimi i konkurrencës.
4. Në vlerësimin e tregjeve përkatëse është e nevojshme të shikohen zhvillimet në treg në një periudhë afatshkurtër.

Seksionet e mëposhtme përcaktojnë disa parime bazë me rëndësi të veçantë për sektorin e telekomunikacionit.

2. Tregu përkatës i produktit

Tregu përkatës i produktit përcaktohet sipas Udhëzimit “Për përcaktimin e tregut përkatës”, pika 8.1.

1. Liberalizimi i sektorit të telekomunikacionit do të çojë në shfaqjen e një lloji të dytë të tregut, atë të aksesit që aktualisht është i nevojshme për të ofruar këto shërbime të liberalizuara. Ndërlidhja në rrjetin publik të telekomunikacionit do të ishte një shembull tipik i një aksesit të tillë. Palët e treta nuk do ta kenë të mundur nga ana tregtare pa ndërlidhjen, që të sigurojnë për shembull, shërbime të telefonisë zanore gjithëpërfshirëse.
2. Është e qartë pra, se në sektorin e telekomunikacioneve ekzistojnë të paktën dy lloje të tregjeve përkatëse që duhet të merren parasysh – tregu i shërbimit që duhet t'u ofrohet përdoruesve fundorë dhe tregu i aksesit në ato objekte të nevojshme për të siguruar atë shërbim për përdoruesit përfundimtarë (informacion, rrjet fizik, etj). Në kontekstin e çdo rasti të veçantë, do të jetë e nevojshme të përcaktohen tregjet përkatëse të aksesit dhe shërbimeve, si interkoneksioni në rrjetin publik të telekomunikacionit dhe sigurimi i shërbimeve publike të telefonisë zanore.
3. Kur është e përshtatshme, Autoriteti i Konkurrencës do të përdorë testin e tregut përkatës, i cili bëhet duke pyetur nëse të gjithë furnizuesit e shërbimeve do të rrisnin çmimet e tyre me 5 deri 10% nëse fitimet e tyre kolektive do të rriteshin. Sipas këtij testi, nëse fitimet e tyre do të rriteshin, tregu i konsideruar është një treg i veçantë përkatës.
4. Parimet e ligjit të konkurrencës që rregullojnë këto tregje mbeten të njëjta pavarësisht nga tregu i caktuar në fjalë. Çdo përpjekje për të përcaktuar tregje të veçanta të produktit, do të mbarte rrezikun që të bëheshin të pasaktë ose të parëndësishëm, duke patur parasysh ritmin e ndryshimeve teknologjike në këtë sektor. Përkufizimi i tregjeve të veçanta të produkteve, për shembull, përcaktimi nëse origjina e thirrjeve dhe thirrjet e terminimit janë pjesë e të njëjtit treg pajisjesh, bëhet më së miri duke shqyrtuar me detaje një rast individual.

3. Tregjet e shërbimit

Ky treg mund të përcaktohet gjerësisht si ofrimi i çdo shërbimi të telekomunikacionit për përdoruesit. Shërbimet e ndryshme të telekomunikacionit do të konsiderohen të zëvendësueshme, nëse ato tregojnë një shkallë të mjaftueshme të ndërveprimit për përdoruesit e fundit. Kjo do të thotë që ekziston konkurrencë efektive ndërmjet ofruesve të ndryshëm të këtyre shërbimeve.

4. Aksesit në objekte

1. Një ofrues shërbimi, shpesh kërkon akses në një ose më shumë objekte (në rrjedhën e sipërme ose të poshtme) për të ofruar një shërbim. Për shembull, për t'u siguruar përdoruesve fundorë shërbimin, nevojitet që të kenë akses në pikat e terminimit në rrjetin e telekomunikacionit, me të cilin janë të lidhur përdoruesit fundorë. Ky akses mund të arrihet në nivel fizik përmes një infrastrukture lokale të dedikuar ose të përbashkët, qoftë të ofruar vetë ose të marrë me qira nga një ofrues lokal i infrastrukturës. Kjo mund të realizohet ose nëpërmjet një ofruesi të shërbimit, i cili tashmë ka përdorues fundorë si pajtimtarë/abonentë, ose nëpërmjet një ofruesi interkoneksioni, i cili ka akses direkt ose indirekt në pikat e terminimit përkatës.
2. Përveç aksesit fizik, një ofrues shërbimi mund të ketë nevojë për akses edhe në objekte të tjera, në mënyrë që t'i vërë në dispozicion shërbimet e tij përdoruesve fundorë. Për shembull, një ofrues shërbimi duhet të jetë në gjendje t'i vërë në dijeni përdoruesit e tij fundorë për shërbimet e tij. Kur një organizatë ka një pozitë dominuese si ofrues i shërbimit, do të ngrihen të njëjtat shqetësime dhe problematika, si me çështjet e aksesit fizik.
3. Çështjet e aksesit fizik janë të rëndësishme dhe duhen shqyrtuar, duke vlerësuar aksesin në objektet e rrjetit

të Operatorit të Telekomunikacioneve (OT), i cili ka pozitë dominuese.

4. Disa OT ekzistuese rezistojnë dhe mund të përdoren për të siguruar akses tek ofruesit e shërbimit të palëve të treta, veçanërisht në fushat ku shërbimi i propozuar do të jetë në konkurrencë me shërbimin e ofruar nga vetë OT- të. Kjo rezistencë shpesh shfaqet si vonesë e pajustificueshme në dhënien e aksesit, si ngurrim për të lejuar hyrjen ose si gatishmëri për ta lejuar atë vetëm nën kushte të pafavorshme. Qëllimi dhe objekti i rregullave të konkurrencës është që të sigurojë që këto tregje (prospective) aksesit të lejohen që të zhvillohen dhe OT- të ekzistuese nuk lejohen që të përdorin kontrollin e tyre drejt aksesit që të zhvillohen tregjet e tyre të shërbimit.
5. Vlen për t'u theksuar që në sektorin e telekomunikacionit, liberalizimi pritet që të çojë drejt zhvillimit të rrjeteve të reja alternative, të cilat do të kenë me doemos një ndikim në përcaktimin e tregut të aksesit, duke përfshirë dhe operatorët ekzistues të telekomunikacionit.

5. Tregu përkatës gjeografik

1. Tregu përkatës gjeografik përcaktohet sipas Udhëzimit “Për përcaktimin e tregut përkatës”, pika 8.2.
2. Sa i përket ofrimit të shërbimeve të telekomunikacionit dhe tregjeve të aksesit, tregu gjeografik përkatës do të jetë zona, ku kushtet objektive të konkurrencës për ofruesit e shërbimeve janë të ngjashme, dhe ku konkurrentët janë në gjendje të ofrojnë shërbimet e tyre. Është e nevojshme që të shqyrtohet mundësia që këta ofrues shërbimesh të kenë akses tek përdoruesit përfundimtarë në secilën pjesë të kësaj zone, me kushte të ngjashme dhe ekonomikisht të qëndrueshme. Kushtet/kriteret rregulluese, siç janë kriteret për licencën dhe çdo e drejtë ekskluzive ose e veçantë që kanë konkurrentet lokalë të aksesit, janë veçanërisht të rëndësishëm.

Pjesa III

1. Parimet

Autoriteti i Konkurrencës do të zbatojë parimet si më poshtë:

1. Autoriteti i Konkurrencës zbaton dispozitat ligjore në fuqi në fushën e konkurrencës dhe konkretisht Ligjin Nr 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. I gjithë legjislacioni tjetër në fushën e telekomunikacioneve interpretohen në mënyrë konsistente me ligjin e konkurrencës, në mënyrë që të sigurohet zbatimi më i mirë i tyre në sektorin e telekomunikacioneve.
2. Në kontekstin e marrëveshjeve të aksesit, legjislacioni në fushën e konkurrencës është i rëndësishëm dhe i zbatueshëm për funksionimin e duhur të sektorit. Gjithashtu, duhet të kihet parasysh se disa parime të ligjit të konkurrencës të marra parasysh më poshtë, mbulohen edhe nga rregullat e veçanta të kuadrit ligjor në fushën e telekomunikacioneve. Zbatimi i duhur i këtyre rregullave shpeshherë mund edhe të shmangë nevojën për zbatimin e rregullave të konkurrencës,
3. Për sa i përket sektorit të telekomunikacionit, duhet t'i kushtohet vëmendje kostove të detyrimeve për ofrimin universal. Detajet e detyrimeve të shërbimit universal janë një çështje rregullatore, megjithatë në çdo rast do të respektohen edhe parimet e konkurrencës.
4. Nëse një ndërmarrje gëzon të drejtat e veçanta ose ekskluzive, ose nëse një ndërmarrje që zotërohet nga Shteti, do t'i kërkohej ose do të autorizohet nga një ent rregullator kombëtar, që të bashkohej në një sjellje që çon drejt abuzimit të pozitës së tij dominuese, atëherë Autoriteti i Konkurrencës mund të merrte një vendim duke kërkuar përfundimin e shkeljes.

2. Pozita dominuese

1. Në mënyrë që një ndërmarrje të ofrojë shërbim në tregun e shërbimeve të telekomunikacionit, ajo duhet të

ketë akses në disa objekte/facilitete. Për shembull, interkoneksioni me rrjetin e ndërlidhur publik të telekomunikacionit do të jetë i nevojshme për ofrimin e shërbimeve të telekomunikacionit. E drejta për të hyrë në këtë rrjet do të jetë gjithmonë në dorë të një OT-je me pozitë dominuese. Për sa i përket marrëveshjeve të aksesit, pozita dominuese që vjen nga kontrolli i objekteve duhet të jetë shumë i rëndësishëm për vlerësimin që kryen Autoriteti i Konkurrencës.

2. Pozita dominuese e një ndërmarrje nuk varet vetëm nga të drejtat ligjore që i janë dhënë asaj ndërmarrjeje. Fundi i ndërmarrjeve monopole ligjore nuk do të thotë detyrimisht edhe fundin e pozitave dominuese. Zhvillimi i konkurrencës efektive nga ofruesit e rrjeteve alternative me kapacitet të përshtatshëm dhe shtrirje gjeografike, do të kërkojë kohë.
3. Rasti i Tetra Pak³¹ është i rëndësishëm në sektorin e telekomunikacionit. Gjykata u shpreh se lidhjet shumë të ngushta midis tregut të pozitës dominuese dhe atij jo dominuese, dhe pjesës jashtëzakonisht të lartë të tregut me pozitë dominuese, Tetra Pak ishte 'në një situatë të krahasueshme me atë të mbajtjes së një pozite dominuese në tregun në fjalë si një e tërë'. Rasti Tetra Pak ka të bëjë me tregjet horizontale të lidhura ngushtë: analiza është njësoj e zbatueshme, edhe për tregjet e lidhura ngushtë vertikale, të cilat do të jenë të zakonshme në sektorin e telekomunikacionit. Në sektorin e telekomunikacionit, shpesh ndodh që një operator i veçantë, ka një pozitë jashtëzakonisht të fortë në tregjet e infrastrukturës dhe në tregjet në rrjedhën e poshtme të asaj infrastrukture. Shpenzimet e infrastrukturës gjithashtu zakonisht përbëjnë koston e vetme më të madhe të veprimeve në rrjedhën e poshtme. Për më tepër, operatorët shpesh do të përballen me konkurrentët e njëjtë si në infrastrukturë, edhe në tregjet e rrjedhës së poshtme.
4. Prandaj është e mundur të parashikohen një numër situatash, ku do të ketë tregje të lidhura ngushtë, së bashku me një operator që ka një shkallë shumë të lartë të fuqisë së tregut në të paktën një nga këto tregje.
5. Nëse këto rrethana janë të pranishme, mund të jetë i përshtatshëm konstatimi se operatori i veçantë ka qenë në një situatë të krahasueshme me atë të mbajtjes së një pozite dominuese në tregjet në fjalë si një e tërë.
6. Në sektorin e telekomunikacionit, koncepti i "objekteve/faciliteteve (lehtësira) thelbësore" në shumë raste do të jetë i rëndësishëm në përcaktimin e detyrave të OT-ve me pozitë dominuese. Shprehja e objektit thelbësor përdoret për të përshkruar një strukturë ose infrastrukturë, e cila është thelbësore për mbërritjen deri tek konsumatorët, dhe/ose mundësimin e konkurrentëve për të vazhduar aktivitetin e biznesit të tyre dhe që nuk mund të përsëriten me ndonjë mjet tjetër të arsyeshëm.
7. Një ndërmarrje që kontrollon aksesin në një strukturë thelbësore gëzon një pozitë dominuese. Në anën tjetër, një ndërmarrje mund të gëzojë një pozitë dominuese edhe pa kontrolluar një strukturë thelbësore.

3. Tregjet e shërbimit

Një nga faktorët që përdoren për të matur fuqinë e tregut të një ndërmarrjeje, janë shitjet që i përkasin asaj ndërmarrjeje, të shprehur në përqindje të shitjeve totale në treg për shërbimet që janë të zëvendësueshme në zonën përkatëse gjeografike. Për sa i përket tregut të shërbimeve, do të vlerësohet *inter-alia*, xhiroja e gjeneruar nga shitjet për shërbimet e zëvendësueshme, duke përjashtuar shitjet ose përdorimin e brendshëm të shërbimeve të interkoneksionit dhe shitjet e përdorimit të brendshëm të infrastrukturës lokale, duke marrë në konsideratë kushtet konkurruese dhe strukturën e ofertë- kërkesës në treg.

4. Aksesin në objekte / lehtësira

1. Koncepti i "aksesit" mund të lidhet me një sërë situatash, duke përfshirë disponueshmërinë e linjave të

³¹ Në secilin treg, Tetra Pak u përball me të njëjtat klientë potencialë dhe konkurrentët aktualë. Rasti C-333/94 P, Tetra Pak International SA kundër Komisionit [1996] ECR I-5951.

dhëna me qira, që mundësojnë një ofrues të shërbimit të ndërtojë rrjetin e vet dhe ndërlidhjen në kuptimin e ngushtë, që është ndërlidhja e dy rrjeteve të telekomunikacionit, për shembull celular dhe fiks. Në lidhje me aksesin është e mundur, që operatori ekzistues të mbetet dominant edhe për disa kohë pasi ka ndodhur liberalizimi ligjor. Operatori ekzistues, i cili kontrollon objektet, është shpesh edhe ofruesi më i madh i shërbimeve, dhe në të kaluarën nuk ka pasur nevojë të dallojë ndërmjet bartjes së shërbimeve të telekomunikacionit dhe ofrimit të këtyre shërbimeve tek përdoruesit fundorë. Tradicionalisht, një operator i cili është gjithashtu një ofrues shërbimi, nuk ka kërkuar që krahu i tij operativ në tregjet e rrjedhës së poshtme të paguajë për akses dhe për këtë arsye nuk ka qenë e lehtë për të llogaritur të ardhurat që do të alokohen në objekt. Në rastin kur një operator siguron si akses ashtu edhe shërbime, është e nevojshme të ndahen të ardhurat si bazë për llogaritjen e pjesës së kompanisë në cilindo treg të përfshirë. Në këtë rast mund të mbahet një llogari e veçantë (në bilanc) për "aktivitetet që lidhen me interkoneksionin, duke përfshirë të dy shërbimet e interkoneksionit të ofruara brenda dhe shërbimet e interkoneksionit që u ofrohen të tjerëve dhe aktivitetet e tjera".

- Domethënia ekonomike e marrjes së aksesit gjithashtu varet nga mbulimi i rrjetit, me të cilin kërkohet ndërlidhja. Prandaj, përveç përdorimit të shifrave të xhiros, kur është e mundur, do të merret parasysh edhe numri i konsumatorëve që kanë nënshkruar për shërbimet e ofruara nga kompania me pozitë dominuese. Këto shërbime janë të krahasueshme me ato që ofruesi i shërbimit që kërkon akses ka për qëllim të ofrojë. Prandaj, fuqia e tregut për një ndërmarrje të caktuar do të matet pjesërisht nga numri i pajtimtarëve që janë të lidhur me pikat e përfundimit të rrjetit të telekomunikacionit të asaj ndërmarrjeje, e shprehur si përqindje e numrit të përgjithshëm të pajtimtarëve të lidhur me pikat e përfundimit në zonën përkatëse gjeografike.

5. Zëvendësueshmëria nga ana e ofertës

Zëvendësueshmëria nga ana e ofertës është gjithashtu e rëndësishme për çështjen e pozitës dominuese. Një pjesë e tregut prej mbi 50%, zakonisht është e mjaftueshme për të treguar dominancë, edhe pse duhet të shqyrtohen faktorë të tjerë. Për shembull, shqyrtimi i ekzistencës së ofruesve të tjerë të rrjetit, nëse ka, në zonën përkatëse gjeografike, për të përcaktuar nëse infrastrukturën e tilla alternative janë mjaft të dendura për të siguruar konkurrencë në rrjetin e ndërtuar tashmë, dhe masën në të cilën do të ishte e mundur që ofruesit e aksesit të ri të hynin në treg.

6. Faktorë të tjerë të rëndësishëm

- Për të përcaktuar nëse një operator është në pozitë dominuese, përveç të dhënave të aksioneve të tregut dhe zëvendësueshmërisë nga ana e ofertës, gjithashtu do të shqyrtohet, nëse operatori ka akses të privilegjuar në objekte të cilat nuk mund të kopjohen në mënyrë të arsyeshme brenda një afati kohor të përshtatshëm, qoftë për arsye ligjore ose për shkak se do të kushtonte shumë.
- Duke qenë se ofruesit konkurrues të aksesit shfaqen dhe sfidojnë pozitën dominuese të ofruesve ekzistues, fusha e veprimit të tyre dhe sidomos shtrirja e tyre territoriale, do të luajë një rol të rëndësishëm në përcaktimin e fuqisë së tregut. Autoriteti i Konkurrencës ndjek zhvillimin e tregut në lidhje me këto çështje dhe do të marrë parasysh çdo kusht të ndryshuar të tregut në vlerësimin e tij për çështjet e aksesit nën rregullat e konkurrencës.

7. Dominanca e përbashkët/kolektive

- Rregullat e konkurrencës zbatohen edhe kur më shumë se një ndërmarrje zotëron një pozitë dominuese.
- Shprehja "abuzimi nga një ose më shumë ndërmarrje", përshkruan diçka të ndryshme nga ndalimi i marrëveshjeve antikonkurruese ose praktikave të bashkërenduara sipas nenit 4 të Ligjit.
- Dy ndërmarrje, secila me pozitë dominuese në një treg të veçantë kombëtar, nuk janë e njëjta gjë si dy ndërmarrje me pozitë dominuese të përbashkët. Për dy ose më shumë ndërmarrje të jenë në një pozicion

të përbashkët dominues, duhet të kenë në thelb të njëjtin pozicion ndaj klientëve dhe konkurrentëve të tyre, siç ka një ndërmarrje e vetme nëse ajo është në një pozitë dominuese. Me referencë specifike në sektorin e telekomunikacioneve, dominimi i përbashkët mund të arrihet nga dy operatorë të infrastrukturës së telekomunikacionit që mbulojnë të njëjtin treg gjeografik.

4. Përveç kësaj, për dy ose më shumë ndërmarrje që të jenë në pozitë dominuese të përbashkët, është e nevojshme, edhe pse jo e mjaftueshme, që të mos ketë konkurrencë efektive midis ndërmarrjeve në tregun përkatës. Kjo mungesë e konkurrencës në praktikë mund të jetë për shkak të faktit, se kompanitë kanë lidhje të tilla si marrëveshjet për bashkëpunim, ose marrëveshjet e interkoneksionit. Megjithatë, kjo nuk nënkupton që lidhjet e tilla janë ligjërish të nevojshme që të ekzistojë një pozitë e përbashkët dominuese, si duke marrë në konsideratë teorinë ekonomike, ashtu edhe parimet e konkurrencës. Është një lidhje ekonomike që ekziston kur ka një lloj ndërvarësie që shpesh ndodh në situatat oligopoliste. Nuk ka ndonjë arsye në ligj apo në teorinë ekonomike për të kërkuar ndonjë lidhje tjetër ekonomike midis kompanive të përbashkëta dominuese. Duke pasur parasysh këtë, në praktikë lidhjet e tilla shpesh do të ekzistojnë në sektorin e telekomunikacionit, ku OT-të kombëtare në mënyrë të pashmangshme kanë lidhje të llojeve të ndryshme me njëri-tjetrin.
5. Për të marrë si shembull aksesin në rrjetin lokal, në disa vende kjo mund të kontrollohej në të ardhmen e afërt nga dy operatorë, nga operatori ekzistues dhe nga një operator kabllor. Për të ofruar shërbime të veçanta për konsumatorët, është e nevojshme aksesin në rrjetin lokal të operatorit të televizionit ose të televizionit kabllor. Në varësi të rrethanave të rastit dhe në veçanti në marrëdhëniet midis tyre, është e pamundur që ndonjë operator të ketë një pozitë dominuese. Megjithatë, së bashku ato mund të mbajnë një monopol të përbashkët të aksesit në këto objekte. Në planin afatgjatë, zhvillimet teknologjike mund të çojnë drejt zbatimit të mekanizmave të tjerë të aksesit në rrjetin lokal, siç janë rrjetet e energjisë. Ekzistenca e mekanizmave të tillë do të merret parasysh në përcaktimin, nëse ekzistojnë ose jo pozitat dominuese, ose pozitat e përbashkëta dominuese.

8. Abuzimi me pozitën dominuese

1. Zbatimi i nenit 9 të ligjit presupozon ekzistencën e një pozite dominuese, dhe disa lidhje midis pozitës dominuese dhe sjelljes së supozuar abuzive. Shpesh do të jetë e nevojshme në sektorin e telekomunikacionit të ekzaminohet një numër tregjesh të lidhura, një ose më shumë prej të cilave mund të dominohen nga një operator i caktuar. Në këto rrethana, ka një numër situatash të mundshme ku mund të lindin abuzime:
 - a) sjellja në tregun dominant që ka efekte mbi tregun e dominuar;
 - b) sjellja në tregun e dominuar që ka efekte mbi tregje të ndryshme nga tregu i dominuar;
 - c) sjellja në një treg ndryshe nga tregu i dominuar dhe që ka efekte mbi tregun e dominuar;
 - d) sjellja në një treg ndryshe nga tregu i dominuar dhe që ka efekte mbi një treg ndryshe nga tregu i dominuar.
2. Edhe pse rrethanat faktike dhe ekonomike të sektorit të telekomunikacionit janë shpesh të reja, në shumë raste zbatohen parimet e ligjit të konkurrencës. Kur shikojmë problemet e konkurrencës në këtë sektor, është e rëndësishme të mbahet parasysh praktikat që mund të eksitojnë për shembull, në lidhje me shfrytëzimin e fuqisë së tregut, diskriminimin dhe paketat.

9. Refuzimi për të dhënë akses në objekte/facilitete dhe aplikimi për kushte të pafavorshme

1. Refuzimi për të dhënë akses mund të ndalohet sipas nenit 9 të ligjit, nëse refuzimi është bërë nga një kompani që ka pozitë dominuese për shkak të kontrollit të saj të objekteve, duke pasur parasysh faktin që

OT- të ekzistuese në fjalë do të jenë për një të ardhme të parashikueshme. Refuzimi mund të ketë "efektin e pengimit të ruajtjes së shkallës së konkurrencës ende ekzistuese në treg ose rritjes së konkurrencës". Refuzimi do të jetë abuziv, vetëm nëse ka efekte shfrytëzuese ose antikonkurruese. Tregjet e shërbimeve në sektorin e telekomunikacionit fillimisht do të kenë pak lojtarë konkurrues dhe refuzimet do të ndikojnë në përgjithësi në konkurrencën në ato tregje. Në të gjitha rastet e refuzimit, çdo justifikim do të shqyrtohet nga afër për të përcaktuar nëse është objektive.

2. Përgjithësisht ekzistojnë tre skenare relevante:

- (a) refuzimi i dhënies së aksesit për qëllimet e një shërbimi ku një operatori tjetër i është dhënë akses nga ofruesi i aksesit për të operuar në atë treg të shërbimeve;
- (b) refuzimi i dhënies së aksesit për qëllime të një shërbimi, kur asnjë operator tjetër nuk i është dhënë akses nga ofruesi i aksesit për të operuar në atë treg të shërbimeve;
- (c) tërheqjen e aksesit nga një klient ekzistues.

10. Diskriminimi

1. Sa i përket skenarit të parë të mësipërm, është e qartë se refuzimi për të furnizuar një klient të ri, në rrethanat kur një pronar i objekteve dominuese tashmë është duke furnizuar një ose më shumë klientë, që veprojnë në të njëjtin treg në rrjedhën e poshtme, do të përbënte një trajtim diskriminues, i cili nëse do të kufizonte konkurrencën në tregun në rrjedhën e poshtme, do të ishte një abuzim. Kur operatorët e rrjetit ofrojnë shërbime të shitjes me pakicë të njëjta ose të ngjashme me ato si pala që kërkon akses, ato mund të kenë nxitjen dhe mundësinë për të kufizuar konkurrencën dhe për të keqpërdorur pozitën e tyre dominuese në këtë mënyrë. Natyrisht, mund të kenë arsye të për një refuzim të tillë, për shembull, kundrejt aplikuesve që paraqesin rrezik potencial të kredencialeve. Në mungesë të ndonjë justifikimi objektiv, një refuzim zakonisht do të ishte një keqpërdorim i pozitës dominuese në tregun e aksesit.
2. Në përgjithësi, detyra e ndërmarrjes me pozitë dominuese është të sigurojë aksesin, në mënyrë të tillë që mallrat dhe shërbimet që ofrohen për kompanitë e mëvonshme, të jenë të disponueshme në kushte jo më pak të favorshme sesa ato që u jepen palëve të tjera, duke përfshirë edhe veprimet e saj përkatëse në rrjedhën e poshtme.

11. Lehtësi thelbësore/ objekte thelbësore³²

1. Sa i përket situatës së dytë të mësipërme, lind pyetja nëse ofruesi i aksesit duhet të jetë i detyruar të lidhë kontratë me ofruesin e shërbimeve në mënyrë që të lejojë ofruesin e shërbimit të operojë në një treg të ri shërbimi. Aty ku kufizimet e kapaciteteve nuk janë një çështje problematike dhe kur kompania që refuzon të ofrojë akses në objektin e saj nuk ka siguruar akses në atë objekt, qoftë në krahun e tij të rrjedhës së poshtme apo në ndonjë ndërmarrje tjetër që vepron në atë treg të shërbimeve, atëherë nuk është e qartë se çfarë justifikimit tjetër objektiv mund të ketë.
2. Në fushën e transportit, në BE, nëse një firmë kontrollon një objekt thelbësor, duhet të japë akses në rrethana të caktuara. Të njëjtat parime zbatohen edhe për sektorin e telekomunikacionit. Nëse nuk ka alternativa komerciale të mundshme për aksesin që kërkohet, atëherë nëse aksesin nuk jepet, pala që kërkon akses nuk do të jetë në gjendje të operojë në tregun e shërbimit. Prandaj, refuzimi në këtë rast do të kufizonte zhvillimin e tregjeve të reja ose produkteve të reja në ato tregje ose pengonte zhvillimin e konkurrencës në tregjet ekzistuese. Refuzimi me këto efekte ka të ngjarë të ketë efekte abuzive.
3. Parimi, që i detyron ndërmarrjet me pozitë dominuese të nënshkruajnë kontrata në rrethana të caktuara,

³² Essential facilities

shpesh do të jenë relevante në sektorin e telekomunikacionit. Edhe aty ku kufizimet tashmë ekzistojnë, ose do të ngrihen së shpejti, konkurrenca në tregjet në rrjedhën e poshtme do të vazhdojë të varet nga çmimet dhe kushtet e aksesit në shërbimet e rrjetit në rrjedhën e sipërme, të cilat vetëm gradualisht do të reflektojnë forcat konkurruese të tregut. Duke pasur parasysh ritmin e ndryshimeve teknologjike në sektorin e telekomunikacionit, është e mundur të parashikohen situata ku kompanitë do të kërkonin të ofronin produkte ose shërbime të reja, të cilat nuk janë në konkurrencë me produktet ose shërbimet e ofruara tashmë nga operatori dominues i aksesit, por janë në konkurrencë për atë produkt të cilin ky operator është hezitues për të siguruar akses.

4. Autoriteti i Konkurrencës duhet të sigurojë, që kontrolli mbi objektet/facilitetet që gëzojnë operatorët ekzistues, nuk përdoret për të penguar zhvillimin e një mjedisi konkurrues në telekomunikacion. Një ndërmarrje që ka pozitë dominuese në tregun e shërbimeve dhe që kryen një abuzim në kundërshtim me nenin 9 në atë treg, mund t'i kërkohej, me qëllim që t'i jepet fund abuzimit, të ofrojë akses në objektin (facilitetet që ajo ofron) e saj për një ose më shumë konkurrentë në atë treg. Në veçanti, një ndërmarrje mund të abuzojë me pozitën e saj dominuese, nëse me veprimet e saj pengon daljen e një produkti apo shërbimi të ri.
5. Pika e nisjes për analizën që do të kryhet, do të jetë identifikimi i një tregu ekzistues ose potencial për të cilin kërkohej akses. Për të përcaktuar nëse duhet t'i jepet akses sipas parimeve të konkurrencës, do të merret në konsideratë një degë e ndërmarrjes me pozitë dominuese, për të mosdiskriminuar (shihni më poshtë), lidhur me elementët e mëposhtëm, të marrë të gjithë së bashku:
 - a) Aksesit në objektin (facilitetet që ofron) në fjalë është gjithmonë thelbësor, në mënyrë që ndërmarrjet të konkurrojnë në tregun përkatës. Çështja kryesore është se çfarë është me të vërtetë thelbësore/ e rëndësishme. Nuk mjafton fakti që pozita e ndërmarrjes që kërkon akses do të jetë më avantazhuese nëse do të jepet aksesit, por refuzimi i aksesit duhet të çojë në faktin që aktivitetet e propozuara, ose të bëhen të pamundura ose jo ekonomike (në mënyrë të pashmangshme dhe shumë serioze jo ekonomike). Edhe pse, për shembull, infrastruktura alternative mund të jetë përdorur për shërbimet e liberalizuara, do të kalojë disa kohë përpara se kjo të jetë një alternativë e kënaqshme për objektet (facilitetet që ofron) e operatorit ekzistues. Një infrastrukturë alternative, në të tashmen, nuk ofron të njëjtin densitet mbulimi gjeografik, si ai i rrjetit të operatorit ekzistues;
 - b) Ka kapacitet të mjaftueshëm në dispozicion për të siguruar akses;
 - c) Zotëruesi i objektit nuk ka mundësi të kënaq kërkesën për tregun ekzistues të shërbimit ose prodhimit, bllokon emergjencën për një shërbim ose produkt të ri, ose e ndalon konkurrencën një treg ekzistues ose potencial mallrash e shërbimesh;
 - d) Ndërmarrja që kërkon akses është përgatitur të paguajë çmimin e arsyeshëm dhe jo diskriminues, dhe do të pranojë kushtet e aksesit jo diskriminues;
 - e) Nuk ka justifikim objektiv për të refuzuar aksesin e siguruar. Justifikimet në këtë rast mund të përfshijnë vështirësitë në sigurimin e aksesit për ndërmarrjen që e kërkon, ose nevojën e zotëruesit të objektit, i cili ka bërë investimin duke synuar prezantimin me produktin ose shërbimin e ri, që të ketë kohë ose mundësi të mjaftueshme që të përdorë objektin për të sjellë produktet ose shërbimet e reja në treg. Gjithsesi, edhe pse çdo justifikim do të shihet me kujdes rast pas rasti, është veçanërisht e rëndësishme në sektorin e telekomunikacionit që të mos nënvlerësohen përfitimet që vijnë nga fryma konkurruese për përdoruesit fundorë, si pasojë e aktivitetit të që ushtrojnë monopolistët shtetëror ekzistues, në mënyrë që të mos parandalohet konkurrencën nga zhvillimi.

Për të përcaktuar nëse është shkelur neni 9 i ligjit, do të merren parasysh si situata faktike, ashtu edhe zona gjeografike të tjera, dhe kur nevojitet, edhe marrëdhënia midis kërkesës së aksesit dhe konfigurimi teknik i objektit/facilitetit.

6. Çështja e justifikimit objektiv do të kërkojë analizë të veçantë në këtë fushë. Përveç përcaktimit nëse vështirësitë e përmendura në ndonjë rast të veçantë janë të mjaftueshme për të justifikuar refuzimin e dhënies së aksesit, autoritetet përkatëse duhet gjithashtu të vendosin nëse këto vështirësi janë të mjaftueshme për të tejkaluar dëmet e bëra ndaj konkurrencës, nëse aksesit refuzohet, ose bëhet më e vështirë nëse tregjet e shërbimeve në rrjedhën e poshtme janë të kufizuara.
7. Tre elemente të rëndësishme që kanë të bëjnë me aksesin, të cilat mund të manipulohen nga ofruesi i aksesit në mënyrë që, në fakt, të refuzojnë të ofrojnë akses janë koha, konfigurimi teknik dhe çmimi.
8. OT-të me pozitë dominuese kanë për detyrë të trajtojnë me efikasitet kërkesat për akses: vonesat e panevojshme dhe të pashpjegueshme, ose të pajustificuara në përgjigjen ndaj një kërkesë për akses mund të përbëjnë një abuzim. Në veçanti, megjithatë, Autoriteti do të kërkojë të krahasojë përgjigjen ndaj një kërkesë për akses me:
 - a) kohëzgjatjen dhe kushtet e zakonshme të zbatueshme, kur pala përgjegjëse i mundëson akses në facilitetet e saj degës së vet ose degës së saj operuese;
 - b) përgjigjet ndaj kërkesave për akses në facilitete të ngjashme;
 - c) shpjegimet e dhëna për çdo vonesë në trajtimin e kërkesave për akses.
9. Çështjet e konfigurimit teknik do të shqyrtohen në mënyrë të ngjashme në mënyrë që të përcaktojnë nëse ato janë të vërteta. Në parim, rregullat e konkurrencës kërkojnë që palës, që kërkon akses, duhet t'i jepet akses në pikën më të përshtatshme për palën kërkuese, me kusht që kjo pikë të jetë teknikisht e realizueshme për ofruesin e aksesit. Çështjet e mundësisë teknike mund të jenë justifikime objektive për refuzimin e furnizimit, për shembull, trafiku për të cilin kërkohet aksesit duhet të plotësojë standardet përkatëse teknike për infrastrukturën, ose mund të ketë edhe çështje të kufizimeve të kapaciteteve, ku duhet të jepet arsytet e veprimeve.
10. Çmimet e larta/i tepërt për akses, si dhe abuzimi në vetvete, gjithashtu mund të përbëjnë një refuzim efektiv për dhënien e aksesit.
11. Ka një numër elementësh të këtyre testeve që kërkojnë vlerësim të kujdesshëm. Çështja e çmimeve në sektorin e telekomunikacionit do të lehtësohen nga detyrimet që lindin në këtë sektor, për të pasur sisteme transparente të kostos së llogarive.

12. Tërheqja e furnizimeve/ofrimit

1. Ka shumë raste në praktikë që lidhen me tërheqjen e furnizimit (mos-ofrimi tek) nga konkurrentët e rrjedhës së poshtme³³.
2. Ndërprerja e njëanshme e marrëveshjeve të aksesit ngre çështje thelbësisht të ngjashme me ato të ekzaminuara në lidhje me refuzimet. Tërheqja e aksesit nga një klient ekzistues zakonisht do të jetë abuzive. Përsëri, arsyet objektive mund të ofrohen për të justifikuar përfundimin. Çdo arsye e tillë duhet të jetë proporcionale me efektet në konkurrencën e tërheqjes.

³³ Praktika e BE-së: Për ndërmarrjen tregtare Solvents, Gjykata u shpreh se "një ndërmarrje e cila ka një pozitë dominuese në tregun e lëndëve të para dhe e cila me qëllim të rezervimit të lëndës së parë për prodhimin e derivateve të veta refuzon të furnizojë një klient, i cili është vetë prodhues i këtyre derivateve dhe prandaj rrezikon të eliminojë të gjithë konkurrencën nga ana e këtij klienti, është duke abuzuar me pozitën e saj dominuese.

13. Forma të tjera të abuzimit

Refuzimi për të siguruar akses është vetëm një formë e abuzimit të mundshëm në këtë fushë. Abuzimet gjithashtu mund të lindin në kontekstin e aksesit që është dhënë. Një abuzim mund të ndodhë *inter-alia*, kur operatori po sillet në mënyrë diskriminuese ose veprimet e operatorit përndryshe kufizojnë tregjet ose zhvillimin teknik. Më poshtë janë shembuj jo të plotë të abuzimit që mund të ndodhin.

14. Konfigurimi i rrjetit

Konfigurimi i rrjetit nga një operator rrjeti me pozitë dominuese, që e bën aksesin/qasjen objektivisht më të vështirë për ofruesit e shërbimeve, mund të përbëjë një abuzim, me përjashtim të rasteve kur është e objektivisht i justifikueshëm. Një justifikim objektiv do të ishte rasti, kur konfigurimi i rrjetit përmirëson efikasitetin e rrjetit në përgjithësi.

15. Lidhja- Tying

Kjo praktikë është shumë shqetësuese, veçanërisht në rastet kur përshin lidhjen e shërbimeve, për të cilat OT ka pozitë dominuese, me ato shërbime për të cilat nuk ka pozitë domunuese. Kur operatori i rrjetit që ka pozitë dominuese dhe është i integruar vertikalisht, e detyron palën që kërkon akses për të blerë një ose më shumë shërbime pa justifikim të përshtatshëm, kjo mund të përjashtojë rivalët e ofruesit të aksesit me pozitë dominuese nga ofrimi i këtyre elementeve të paketës në mënyrë të pavarur. Kjo kërkesë mund të përbëjë një abuzim sipas nenit 9 të ligjit.³⁴

16. Vendosja e çmimit

Në përcaktimin nëse ekziston një problem çmimi sipas rregullave të konkurrencës, do të jetë e nevojshme të tregohet se kostot dhe të ardhurat ndahen në mënyrë të përshtatshme. Shpërndarja e gabuar e kostove dhe ndërhyrja në çmimet e transferimit mund të përdoren si mekanizma për fshehjen e çmimeve të larta/tepruara, çmimeve grabitqare ose shtrëngimi i çmimeve (*price squeeze*).

17. Çmimet padrejtësisht të larta

1. Problemet e çmimeve në lidhje me aksesin për ofruesit e shërbimeve në objektet/facilitetet e operatorit me pozitë dominuese, shpesh do të sillen rreth çmimeve tepër të larta. Në mungesë të një alternative tjetër të zbatueshme ndaj objektit/faciliteteve për të cilin kërkohet akses nga ofruesit e shërbimeve, operatori me pozitë dominuese mund të priret të vendosë çmime padrejtësisht të larta.
2. Çmimet padrejtësisht të larta janë përcaktuar si “të tepruara /tejet të larta në lidhje me vlerën ekonomike të shërbimit të ofruar”. Përveç kësaj, në praktikën e BE është qartësuar se një nga mënyrat që kjo mund të llogaritet është si më poshtë:

“Ky tejkalim, *inter-alia*, mund të përcaktohej objektivisht nëse do të ishte e mundur që ai të llogaritej duke bërë një krahasim midis çmimit të shitjes së produktit në fjalë dhe kostos së prodhimit.”

3. Është e nevojshme të përcaktohet, se cilat janë shpenzimet aktuale për produktin përkatës. Prandaj alokimi i duhur i kostos është thelbësor për të përcaktuar nëse një çmim është i tepruar/tejet i lartë. Për shembull, kur një ndërmarrje është e angazhuar në një numër aktivitete, do të jetë e nevojshme të alokohen shpenzimet përkatëse për aktivitetet e ndryshme, së bashku me një kontribut të përshtatshëm ndaj kostove të përbashkëta. Gjithashtu, mund të jetë e përshtatshme të përcaktohet metodologjia e duhur e shpërndarjes së kostove kur diskutohet një çështje e tillë.

³⁴ Gjykata Evropiane është shprehur se "... edhe kur shitjet e lidhura të dy produkteve janë në përputhje me përdorimin komercial ose ka një lidhje natyrore midis dy produkteve në fjalë, shitjet e tilla ende mund të përbëjnë abuzim në kuptim , me përjashtim të rastit kur janë të justifikuara objektivisht ... "

4. Përcaktimi, nëse përbën një çmim padrejtësisht të lartë, mund të merret parasysh legjislacioni përkatës i fushës për sektorin e caktuar.
5. Për më tepër, krahasimi me zonat e tjera gjeografike mund të përdoret gjithashtu si një tregues i një çmimi padrejtësisht të lartë: mund të bëhet një krahasim midis çmimeve të vëna nga një ndërmarrje me pozitë dominuese dhe atyre çmimeve të vendosura në tregje të cilat janë të hapura për konkurrencë. Një krahasim i tillë mund të sigurojë një bazë për të vlerësuar nëse çmimet e vendosura nga ndërmarrja me pozitë dominuese janë apo jo të drejta. Në rrethana të caktuara, kur të dhënat krahasuese nuk janë të disponueshme, autoritetet rregullatore përcaktojnë se cili do të ishte çmimi konkurrues në mënyrë që të ekzistonte një treg konkurrues. Në një rast të përshtatshëm, një analizë e tillë mund të merret parasysh nga Autoriteti i Konkurrencës në përcaktimin e një çmimi padrejtësisht të lartë.

18. Çmimet grabitqare

1. Çmimi grabitqar ndodh, *inter-alia*, kur një ndërmarrje me pozitë dominuese shet një të mirë ose shërbim nën kosto për një periudhë të qëndrueshme kohore, me qëllim të pengimit të hyrjes ose të largimit të një rivali nga tregu, duke i mundësuar ndërmarrjes me pozitë dominuese të rritë më tej fuqinë e saj të tregut dhe në një të ardhme të afërt, të rrisë fitimet e saj të grumbulluara. Çmime të tilla padrejtësisht të ulëta janë në kundërshtim me nenin 9 të ligjit. Një problem i tillë mund të ngrihet, për shembull, në kontekstin e konkurrencës ndërmjet rrjeteve të ndryshme të infrastrukturës së telekomunikacionit, ku një operator me pozitë dominuese mund të vendosë çmime të ulëta të aksesit, në mënyrë që të eliminojë konkurrencën nga ofruesit e tjerë të infrastrukturës. Në përgjithësi, çmimi është abuziv nëse është nën koston mesatare të ndryshueshme të ndërmarrjes me pozitë dominuese, ose nëse është nën mesataren e shpenzimeve totale dhe nëse është pjesë e një plani antikonkurrues. Në industritë e rrjetit, një zbatim i thjeshtë i rregullit të mësipërm nuk do të pasqyronte realitetin ekonomik të industrive të rrjetit³⁵.
2. Për të tregtuar një shërbim ose grup shërbimesh me fitim, një operator duhet të miratojë një strategji çmimi, me anë të së cilës kostot totale të saj shtesë në sigurimin e atij shërbimi ose grupi shërbimesh mbulohen nga të ardhurat shtesë të fituara si rezultat i ofrimit të atij shërbimi ose grupi shërbimesh. Kur një operator dominues vendos një çmim për një produkt ose shërbim të caktuar, i cili është nën koston totale mesatare të ofrimit të atij shërbimi, operatori duhet ta justifikojë këtë çmim në terma komercial: një operator me pozitë dominuese do të përfitonte nga një politikë e tillë çmimi vetëm nëse një ose më shumë nga konkurrentët e tij dobësohet/humbet fuqinë në treg dhe ky do të ishte një abuzim.
3. Shumë e rëndësishme, në të tilla raste është përcaktimi i çmimit nën të cilin një ndërmarrje mund të fitojë vetëm duke dobësuar, ose eliminuar një ose më shumë konkurrentë. Strukturat e kostos në industritë e rrjetit, kanë tendencë të jenë mjaft të ndryshme nga shumica e industrive të tjera, pasi ato ekzistueset kanë kosto të përbashkëta shumë më të mëdha.
4. Për shembull, në rastin e ofrimit të shërbimeve të telekomunikacionit, një çmim që barazohet me koston variable të një shërbimi mund të jetë shumë më i ulët se çmimi, që operatori ka nevojë për të mbuluar koston e ofrimit të shërbimit. Për të aplikuar testin AKZO (rasti AKZO i Komisionit Evropian) për çmimet që do të zbatohen me kalimin e kohës nga një operator dhe që do të përbëjnë bazën lidhur me vendimet që do të marrë operatori për të investuar, shpenzimet duhet të përfshijnë kostot totale që vijnë duke u rritur,

³⁵ Ky rregull u vendos në rastin AKZO³⁵, ku Gjykata e Drejtësisë (Evropiane) përcaktoi shpenzimet mesatare të ndryshueshme si 'ato që ndryshojnë në varësi nga sasitë e prodhuara' dhe shpjegoi arsyetimin pas rregullave si në vijim: "Një ndërmarrje me pozitë dominuese nuk ka interes të zbatojë çmime të tilla, përveç në rastet e eliminimit të konkurrentëve, në mënyrë që të mundësojë më pas rritjen e çmimeve duke shfrytëzuar pozitën e saj monopolistike, pasi duke qenë se secila shitje gjeneron një humbje, përkatësisht shumën totale të kostove fikse (që do të thotë, ato që mbeten konstante pavarësisht nga sasitë e prodhuara) dhe së paku një pjesë e kostove të ndryshueshme që lidhen me njësitë e prodhuara".

lidhur me ofrimin e shërbimit. Në analizimin e situatës, duhet t'i kushtohet vëmendje kornizës kohore të përshtatshme mbi të cilën duhet të analizohen kostot. Në shumicën e rasteve, ka arsye për të besuar se as afati shumë i shkurtër dhe as shumë i gjatë nuk janë të përshtatshme.

5. Në këto rrethana, shpesh duhet të analizohen kostot mesatare shtesë për ofrimin e një shërbimi dhe mund të jetë e nevojshme të analizohen shpenzimet mesatare shtesë për një periudhë më të gjatë se një vit.

19. Ngjeshja e çmimeve (*price squeeze*)

1. Kur operatori është në pozitë dominuese në tregun e produkteve ose shërbimeve, një ngjeshje e çmimeve mund të përbëjë një abuzim. Një ngjeshje e çmimit mund të jetë rasti, kur veprimet e vetë ndërmarrjes me pozitë dominuese në tregun e rrjedhës së poshtme, nuk mund të tregtojnë duke pasur fitim duke u bazuar në çmimin e vendosur në tregun e rrjedhës së sipërme ndaj konkurrentëve të tij, nga ata që operojnë në rrjedhën e sipërme të ndërmarrjes me pozitën dominuese. Një humbje në rrjedhën e poshtme mund të fshihet nëse operatori që ka pozitë dominuese, ka ndarë kostot për operimet e tij të aksesit, të cilat duhet të ndahen siç duhet në operacionet e rrjedhës së poshtme, ose nëse ka përcaktuar në mënyrë të parregullt çmimin e transferimit brenda organizatës. Në këtë rast do të ishte i përshtatshëm një rekomandim lidhur me mbajtjen e kontabilitetit të veçantë për fusha të ndryshme biznesi nga një operator me pozitë dominuese të integruar vertikalisht. Gjithashtu, mund të kërkohej nga ndërmarrja që ka pozitë dominuese, të krijojë llogari të ndara, të audituara që kanë të bëjnë me të gjitha aspektet e nevojshme të biznesit të ndërmarrjes me pozitë dominuese. Megjithatë, ekzistenca e llogarive të ndara nuk garanton se nuk ekziston asnjë abuzim: Autoriteti i Konkurrencës do të shqyrtojë faktet rast pas rasti.
2. Në rrethana të caktuara, gjithashtu mund të demonstrohet një ngjeshje e çmimeve duke treguar se diferenca midis çmimit të vendosur për konkurrentët në tregun e rrjedhës së poshtme (duke përfshirë edhe veprimet e ndërmarrjes me pozitë dominuese, nëse ka) për aksesin, dhe çmimin që operatori i rrjetit vendos në tregun e rrjedhës së poshtme, është i pamjaftueshëm për të lejuar një ofrues shërbimi eficient në tregun e rrjedhës së poshtme për të marrë një fitim normal (përveç rasteve kur ndërmarrja me pozitë dominuese mund të tregojë se aktiviteti i saj në rrjedhën e poshtme është jashtëzakonisht eficient).
3. Nëse do të ngrihej ndonjë prej këtyre skenarëve, konkurrentët në tregun e rrjedhës së poshtme do të përballeshin me një ngjeshje të çmimeve që mund t'i detyronte ata të dilnin jashtë tregut.

20. Diskriminimi

1. Një ofrues me pozitë dominuese i aksesit nuk mund të diskriminojë marrëveshjet e ndryshme midis palëve aksesuese, kur një diskriminim i tillë do të kufizonte konkurrencën. Çdo diferencim i bazuar në përdorimin që duhet të bëhet nga aksesin në vend të dallimeve ndërmjet transaksioneve për vetë ofruesin e aksesit, nëse diskriminimi ka mjaft gjasa të kufizojë ose të shtrembërojë konkurrencën aktuale ose të mundshme, do të ishte në kundërshtim me nenin 9. Ky diskriminim mund të marrë formën e imponimit të kushteve të ndryshme, duke përfshirë vënien/porositjen e çmimeve të ndryshme, ose ndryshe dallimin midis marrëveshjeve të aksesit, përveç rasteve kur një diskriminim i tillë do të ishte i justifikuar objektivisht, për shembull në bazë të kostos ose konsideratave teknike ose faktit që përdoruesit po veprojnë në nivele të ndryshme. Një diskriminim i tillë ka të ngjarë të kufizojë konkurrencën në tregun e rrjedhës së poshtme, në të cilën kërkohej aksesin ndërmarrjes, në mënyrë që të kufizonte mundësinë që ky operator të hynte në treg ose të zgjeronte veprimtarinë e tij në atë treg.
2. Një diskriminim i tillë në mënyrë të ngjashme mund të ketë efekt në konkurrencë, ku diskriminimi ka qenë midis operatorëve në tregjet e afërta të lidhura me të. Aty ku ekzistojnë dy tregje të dallueshme të produktit të rrjedhës së poshtme, por një produkt do të konsiderohej si i zëvendësueshëm për një tjetër, si pasojë e faktit se ka pasur një dallim çmimesh midis dy produkteve, diskriminimi në çmimin e vendosur për ofruesit e këtyre dy produkteve mund të zvogëlojë ekzistencën ose potencialin konkurrues. Për shembull, edhe pse

shërbimet e telefonisë zanore fikse dhe mobile tani për tani përbëjnë tregje të veçanta të produkteve, tregjet kanë të ngjarë të konvergojnë/takohen. Vendosija e çmimeve më të larta të interkonjeksionit tek operatorët celularë në krahasim me operatorët fiks do të tentonin të pengonin këtë konvergencë dhe prandaj do të kishin efekt në konkurrencë. Efekte të ngjashme në konkurrencë ka të ngjarë të ndodhin në tregjet e tjera të telekomunikacionit. Një diskriminim i tillë do të ishte në çdo rast i vështirë për t'u justifikuar duke pasur parasysh detyrimin për të caktuar çmimet e lidhura me koston.

3. Lidhur me diskriminimin e çmimeve, neni 9 ndalon diskriminimin e padrejtë nga një ndërmarrje me pozitë dominuese në mes të konsumatorëve të kësaj shoqërie, duke përfshirë diskriminimin ndërmjet konsumatorëve, në bazë të asaj nëse bien dakord ose jo, që të merren ekskluzivisht me atë ndërmarrje me pozitë dominuese³⁶.
4. Përcaktimi nëse dallime të tilla rezultojnë në shtrembërim të konkurrencës duhet të bëhen për raste të veçanta. Duhet të kihet parasysh se nenet 4 dhe 9 merren me konkurrencën dhe jo me çështjet rregullatore. Bazuar në nenin 9, nuk mund t'i kërkohej një ndërmarrjeje me pozitë dominuese, të trajtojë kategori të ndryshme të konsumatorëve ndryshe, përveç kur kjo është rezultat i kushteve të tregut dhe parimeve të nenit 9. Përkundrazi, neni 9 i ndalon ndërmarrjet me pozitë dominuese të bëjnë dallime ndërmjet transaksioneve të ngjashme, kur një diskriminim i tillë ka një efekt mbi konkurrencën në treg.
5. Diskriminimi pa justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, për sa i përket çfarëdo aspekti ose kushti të një marrëveshjeje aksesit, mund të përbëjë një abuzim. Diskriminimi mund të lidhet me elemente të tilla si çmimi, vonesat, aksesit teknik, listë preferencash operatorësh, numërimi, kufizimet në përdorimin e rrjetit që tejkalojnë kërkesat thelbësore dhe përdorimin e të dhënave të rrjetit të klientit. Megjithatë, ekzistenca e diskriminimit mund të përcaktohet vetëm rast pas rasti. Diskriminimi është në kundërshtim me nenin 9, pavarësisht nëse rezulton ose nuk është e qartë nga kushtet e një marrëveshjeje të veçantë aksesit.
6. Në këtë kontekst, ekziston një detyrë e përgjithshme për operatorin e rrjetit për të trajtuar konsumatorët e pavarur në të njëjtën mënyrë si degën/filialin e tij, ose filialin në tregun e rrjedhës së poshtme të shërbimeve. Natyra e klientit dhe kërkesat e tij mund të luajnë një rol të rëndësishëm në përcaktimin nëse transaksionet janë të krahasueshme. Çmimet e ndryshme për klientët në nivele të ndryshme (për shembull, me shumicë dhe pakicë) nuk përbëjnë domosdoshmërisht diskriminim.
7. Çështjet e diskriminimit mund të lindin në lidhje me konfigurimin teknik të aksesit, duke pasur parasysh rëndësinë e tij në kontekstin që ka aksesit.
 - a) *Shkalla e sofistikimit teknik të aksesit*: kufizimet në llojin ose "nivele" në hierarkinë e rrjetit të shkëmbimit të përfshirë në aksesin ose aftësitë teknike të këtij shkëmbimi kanë rëndësi të drejtpërdrejtë konkurruese. Këto mund të jenë lehtësirat/facilitetet në dispozicion për të mbështetur një lidhje ose llojin e ndërfaqes dhe sistemit të sinjalizimit që përdoret për të përcaktuar llojin e shërbimit në dispozicion të palës, që kërkon akses (për shembull, objektet/lehtësirat e rrjetit inteligjent).
 - b) *Numri dhe / ose vendndodhja e pikave kyçe*: mund të jetë e rëndësishme kërkesa për grumbullimin dhe shpërndarjen e trafikut për zona të veçanta të kalimit, të cilat i shërbejnë direkt asaj zone me tepër se sa një nivel më i lartë i hierarkisë së rrjetit. Pala që kërkon akses ka shpenzime shtesë edhe duke

³⁶ Legjislacioni i BE parashikon që "tarifa të ndryshme, afatet dhe kushtet për interkoneksionin mund të vendosen për kategoritë e ndryshme të ndërmarrjeve të cilat janë të autorizuar të ofrojnë rrjete dhe shërbime, kur dallime të tilla mund të justifikohen objektivisht në bazë të llojit të interkoneksionit të ofruar dhe / ose kushtet përkatëse kombëtare të licencimit ... "(me kusht që dallimet e tilla të mos shkaktojnë shtrembërim të konkurrencës).

siguruar lidhjet në një distancë më të madhe nga qendra e saj e shkëmbimit/kalimit ose duke u ngarkuar me pagesa më të larta të bartjes.

- c) *Aksesi i barabartë*: një tipar i telekomunikimeve konkurruese është mundësia për klientët e palës që kërkojnë akses për të marrë shërbimet e ofruara nga ofruesi i aksesit, duke përdorur të njëjtin numër shifrorësh që janë përdorur nga konsumatorët e këtij të fundit.

21. Justifikimi objektiv

Justifikimet mund të përfshijnë faktorë, që kanë të bëjnë me funksionimin aktual të rrjetit në pronësi të ofruesit të aksesit, ose kufizimet e licencimit, në përputhje me, për shembull, çështjen e të drejtave të pronësisë intelektuale.

22. Abuzimi me pozitën dominuese të përbashkët/kolektive

1. Në rastin e pozitës dominuese të përbashkët, sjellja nga një prej disa ndërmarrjeve që kanë pozitë dominuese kolektive mund të jetë abuzive edhe nëse të tjerët nuk sillen në të njëjtën mënyrë.
2. Përveç mjeteve juridike (kushteve dhe detyrimeve/masave) në bazë të rregullave të konkurrencës, nëse asnjë operator nuk ka qenë i gatshëm të japë akses, dhe nëse nuk ka ndonjë justifikim teknik ose tregtar për refuzimin, problem mund të zgjidhet nga rregullatori duke urdhëruar një ose më shumë nga kompanitë që të ofrojnë akses.

23. Marrëveshjet e hyrjes/aksesit

1. Kufizimet e konkurrencës, që vijnë si rrjedhojë e marrëveshjeve të aksesit, mund të kenë dy efekte të ndryshme: kufizimin e konkurrencës ndërmjet dy palëve në marrëveshjen e aksesit ose kufizimin e konkurrencës nga palët e treta, për shembull nëpërmjet ekskluzivitetit të një ose të dy palëve të marrëveshjes. Përveç kësaj, kur njëra palë ka pozitë dominuese, kushtet e marrëveshjes së aksesit mund të çojnë në forcimin e pozitës dominuese ose në shtrirjen e kësaj pozite dominuese në një treg të lidhur, ose mund të përbëjnë një shfrytëzim të paligjshëm të pozitës dominuese nëpërmjet imponimit/vendosjes së kushteve të padrejta.
2. Marrëveshjet e aksesit, kur aksesit në parim është i pakufizuar, nuk ka të ngjarë të jenë kufizuese për konkurrencën. Detyrimet e ekskluzivitetit në kontratat që sigurojnë akses në një ndërmarrje ka gjasa të kufizojnë konkurrencën, sepse ato kufizojnë aksesin në infrastrukturë për ndërmarrje të tjera. Në sektorin e telekomunikacioneve, shumica e rrjeteve kanë më shumë kapacitet sesa çdo përdorues i vetëm.
3. Marrëveshjet e aksesit/hyrjes mund të kenë efekte të rëndësishme pro-konkurruese pasi ato mund të përmirësojnë aksesin në tregun e rrjedhës së poshtme. Marrëveshjet e aksesit në kontekstin e interkoneksionit janë thelbësore për ndërveprimin e shërbimeve dhe infrastrukturës, duke rritur kështu konkurrencën në tregun e rrjedhës së poshtme të shërbimeve, që ka të ngjarë të përfshijë vlerë më të lartë të shtuar sesa infrastruktura lokale.
4. Megjithatë, ka të ngjarë të ketë efekte antikonkurruese në marrëveshjet e hyrjes/aksesit ose të dispozitave të tyre. Marrëveshjet e aksesit munden, për shembull:
 - a) të shërbejnë si një mjet për koordinimin e çmimeve;
 - b) të shërbejnë si një mjet për ndarjen e tregut;
 - c) të kenë efekte përjashtimi ndaj palëve të treta;
 - d) të çojnë në shkëmbimin e informacionit të ndjeshëm tregtar ndërmjet palëve.
5. Rreziku i koordinimit të çmimeve është veçanërisht shumë i rëndësishëm dhe i menjëhershëm në sektorin

e telekomunikacionit meqenëse tarifat e interkoneksionit shpesh përbëjnë 50% ose më shumë të kostos totale të shërbimeve të ofruara dhe ku zakonisht do të jetë e nevojshme ndërlidhja me një operator dominues. Në këto rrethana, fushëveprimi për konkurrencën në çmime është e kufizuar dhe rreziku (dhe serioziteti) i koordinimit të çmimeve përkatësisht më i madh.

6. Për më tepër, marrëveshjet e interkoneksionit ndërmjet operatorëve të rrjetit mund të jenë në rrethana të caktuara një instrument i ndarjes së tregut ndërmjet operatorit të rrjetit, që ofron akses, dhe operatorin e rrjetit që kërkon akses, në vend të shfaqjes së konkurrencës në rrjet midis tyre.
7. Në një mjedis të liberalizuar të telekomunikacionit, llojet e mësipërme të kufizimeve të konkurrencës do të monitorohen nga Autoriteti Konkurrencës dhe entet rregullatore sipas rregullave të konkurrencës.
8. Mund të ekzistojnë lloje të caktuara të kufizimeve që përfshihen në fushën e zbatimit të nenit 4 të ligjit dhe prandaj kërkojnë përjashtim individual. Këto dispozita do të lidhen më së shumti me kuadrin tregtar të aksesit.
9. Në sektorin e telekomunikacionit, është e natyrshme që palët do të kenë informacione të caktuara lidhur me klientët dhe trafikun/lëvizjen/ që ndodh rreth konkurrentëve të tyre. Ky shkëmbim informacioni mundet në disa raste të ndikojë në sjelljen konkurruese të ndërmarrjeve të interesuara dhe lehtësisht mund të përdoret nga palët për praktikatat e fshehta (*collusive practices*), siç është për shembull ndarja e tregut. Informacioni i marrë nga një organizatë që kërkon bashkëpunim/ndërlidhje, duhet të përdoret vetëm për qëllimet, për të cilat është dhënë/ofruar. Për të qenë në përputhje me rregullat e konkurrencës, operatorët do të duhet të paraqesin masa mbrojtëse për të siguruar që informatat konfidenciale të zbulohen/jepen vetëm në ato pjesë të ndërmarrjeve të përfshira në marrëveshjet e interkoneksionit dhe të sigurojnë që informacioni të mos përdoret për qëllime anti-konkurruese. Me kusht që këto masa mbrojtëse të jenë të plota dhe të funksionojnë si duhet, nuk ka arsye që marrëveshjet e thjeshta të interkoneksionit të jenë brenda fushës së veprimit të nenit 4 të ligjit.
10. Marrëveshjet e ekskluzivitetit, për shembull kur trafiku/lëvizja do të transmetohet ekskluzivisht përmes rrjetit të telekomunikacioneve të një ose të dy palëve në vend të rrjetit të palëve të tjera, me të cilat janë lidhur marrëveshjet e aksesit, në mënyrë të ngjashme do të kërkojë analizë sipas nenit 5 të ligjit. Nëse nuk ka justifikim të arsyeshëm në këtë rast, atëherë këto dispozita do të ndalohen. Dispozita të tilla ekskluzive, megjithatë zakonisht nuk janë pjesë e pandarë e marrëveshjeve të interkoneksionit.
11. Marrëveshjet e lidhura të aksesit, të cilat kanë objekt antikonkurrues në përgjithësi nuk përmbushin kriteret e përjashtimit individual nga ndalimi i marrëveshjeve të ndaluara.
12. Për më tepër, marrëveshjet e aksesit mund të kenë ndikim në strukturën konkurruese të tregut. Pagesat e aksesit lokal shpesh do të përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të kostos totale të shërbimeve që u ofrohen përdoruesve fundorë nga pala që kërkon akses, duke lënë kështu hapësirë të kufizuar për konkurrencën e çmimeve. Për shkak të nevojës për të mbrojtur këtë shkallë të kufizuar të konkurrencës, duhet t'i kushtohet vëmendje e veçantë shqyrtimit të marrëveshjeve të aksesit, duke parë kontekstin e efekteve të tyre të mundshme në tregjet përkatëse, me qëllim që të sigurohet që marrëveshjet të tilla nuk shërbejnë si një mjet i fshehtë dhe i tërthortë për fiksimin ose koordinimin e çmimeve fundore për përdoruesit fundorë, që përbën një nga shkeljet më të rënda të nenit 4 të ligjit. Ky do të ishte një shqetësim i veçantë në tregjet oligopolistike (tregje me pengesa në hyrje për firma të tjera).
13. Përveç kësaj, dispozitat që përfshijnë diskriminimin dhe që çojnë në përjashtimin e palëve të treta, janë gjithashtu kufizuese të konkurrencës. Më e rëndësishmja është diskriminimi në lidhje me çmimin, cilësinë ose aspekte të tjera tregtare të rëndësishme të aksesit në dëm të palës që kërkon akses, e cila në përgjithësi synon të favorizojë padrejtësisht veprimet e ofruesit të aksesit.

Konkluzione

1. Rregullat e konkurrencës dhe rregullimi i sektorit specifik formojnë një grup masash koherente për të siguruar një mjedis tregu të liberalizuar dhe konkurrues për tregjet e telekomunikacionit në vend.
2. Kur aplikohen rregulla të konkurrencës, Autoriteti i Konkurrencës do të shqyrtojë se cilat tregje janë relevante, dhe do të zbatojë nenet 4 dhe 9 në përputhje me parimet e parashtruara më lart.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.